

# ÇËSH TJET E BARAZISË GJINORE

në standardet  
ligjore dhe  
jurisprudencën  
kombëtare e  
ndërkombëtare

**UDHËZUES**



SHKOLLA E MAGJISTRATURËS

## FALËNDERIME

Ky Udhëzues u përgatit me përkrahjen e UNIFEM-it, nën kujdesin e Programit të Përbashkët të OKB-së për Barazinë Gjinore (2008 – 2010), nëpërmjet mbështetjes financiare të Qeverisë së Spanjës përmes Agjencisë Spanjolle të Bashkëpunimit Ndërkombëtar për Zhvillim dhe Fondit të Koherencës së Një OKB-së.

Shkolla e Magjistraturës dëshiron të falënderojë Ekipin e ekspertëve që kontribuan për zhvillimin e Udhëzuesit – Udhëheqësen e Ekipit, Dr. iur. Agnes Bernhard; ekspertet kombëtare: Prof.Dr. Arta Mandro dhe Prof.Dr. Aurela Anastasi. Dëshirojmë gjithashtu të falënderojmë pedagogët përkatës dhe ekspertët kombëtarë në fushën e jurisprudencës të cilët u takuan me Ekipin e ekspertëve që dhanë mendime dhe bënë komentet e tyre në këtë drejtim.

Përktheu nga anglishtja: Engjëllushe Shqarri  
Redaktimi juridik: Prof. Dr. Arta Mandro

Mendimet dhe pikëpamjet e shprehura në këtë Udhëzues nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht mendimet dhe pikëpamjet e UNIFEM-it, Kombeve të Bashkuara apo të Ambasadës Spanjolle dhe Agjencisë Spanjolle të Bashkëpunimit për Zhvillim Ndërkombëtar.

United Nations Development Fund for Women



# TABELA E LËNDËS

1. HYRJE	5
2. NJË VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM RRETH STANDARDEVE DHE NORMAVE TË BARAZISË GJINORE	9
2.1. Norma ndërkombëtare	9
2.1.1. Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave	9
2.1.2. Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNj)	14
2.2. Legjislacioni i BE-së.	22
2.2.1. Legjislacioni bazë	23
2.2.3. Direktivat	26
2.2.4. Lidhja e të drejtës së BE-së për barazinë gjinore me shqipërinë	35
2.3. Legjislacioni shqiptar	37
2.3.1. Kushtetuta	37
2.3.2. Konventat	38
2.3.3. Ligjet	40
3. NJË SHQYRTIM I SHKURTËR I JURISPRUDENCËS SE BARAZISË GJINORE	55
3.1. Parimet, Çështjet dhe Rekomandimet e Komitetit të CEDAW-t	55
3.3.1. Rekomandime të Përgjithshme	55
3.3.2. Çështje Ankesash Individuale	63
3.3.3. Çështja Juarez dhe Procedura e Hetimit	66
3.3.4. Zbatimi i CEDAW-t nga Gjykatat Kombëtare	67
3.2. Jurisprudenca gjinore e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut	70
3.2.1. Diskriminim i Drejtpërdrejtë dhe i Tërthortë; Diskriminim Formal dhe Substantiv	70
3.2.2. Çështje të Diskriminimit në Bazë Seksi	71
3.2.3. Dhuna në familje si shkelje e Nenit 14	77
3.2.4. Të Drejtat e Njeriut dhe Barazia e Grave kundër të Drejtave Fetare	78
3.2.5. Barazia Gjinore dhe e Drejta e Familjes	80
3.3. Jurisprudenca e Gjykatës Europiane të Drejtësisë për Barazinë Gjinore	81
3.3.1. Paga e barabartë	81
3.3.2. Seksi si faktor përcaktues i veprimtarive profesionale	85
3.3.3. Dispozita në lidhje me mbrojtjen e grave	87
3.3.4. Masat e Veprimit Pozitiv	97
3.3.5. Konflikti midis ILO-s dhe të Drejtës së Bashkimit Europian	104
3.4. Disa çështje për barazinë gjinore nga Shtete Anëtare të BE-së që vendosën precedent	104
3.4.1. Spanja	104
3.4.2. Gjermania	105
3.4.3. Italia	108
4. JURISPRUDENCA E BARAZISË GJINORE NË SHQIPËRI	111
4.1. Zbatimi i Konventës CEDAW në Shqipëri	111
4.2. Zbatimi i Nenit 14 të KEDNj-së në Shqipëri	114

## ANEKSE

Aneksi 1 Bibliografi e përzgjedhur

Aneksi 2 Indeksi i Jurisprudencës

## LISTA E SHKURTIMEVE

KSh	Kushtetuta shqiptare
CEDAW	Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave
KE	Komuniteti European
KEDNj	Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut
GjED	Gjykata Europiane e Drejtësisë
RGjE	Raportet e Gjykatave Europiane
KomEDNj	Komisioni European i të Drejtave të Njeriut
GjEDNj	Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut
KEE	Komuniteti Ekonomik European
BE	Bashkimi European
Ligji KDhF	Ligji (shqiptar) “Për masat kundër dhunës në marrëdhëniet familjare”
LBGj	Ligji (shqiptar) “Për barazinë gjinore në shoqëri”
ShA	Shtetet anëtare të BE-së
PSh	Protokolli Shtesë i CEDAW-t
TBE	Traktati i Bashkimit European
TFBE	Traktati për Funkcionimin e Bashkimit European
TR	Termet e Referencës

## 1. HYRJE


Qëllimi i Udhëzuesit është t'u japë pedagogëve, trajnuesve dhe studentëve të Shkollës së Magjistraturës një vështrim të përgjithshëm rreth standardeve ligjore më të rëndësishëm për barazinë gjinore në nivel ndërkombëtar, në nivel të BE-së, dhe në nivel kombëtar. Në Shqipëri, shteti ka marrë angazhime ligjore të rëndësishme dhe detyruese, ndërkombëtare dhe kombëtare, për të luftuar diskriminimin, mbështetur në pabarazinë seksuale dhe gjinore, dhe për të luftuar Dhunën në Familje. Udhëzuesi i jep lexuesit jo vetëm një ide të përgjithshme rreth këtyre detyrimeve, por edhe interpretimin (jurisprudencën) e këtyre parimeve nga Komiteti i CEDAW-t, GjEDNj-ja, KE-ja, dhe praktika gjyqësore e Gjykatës së Lartë shqiptare. Është me rëndësi të vihet në dukje se, kriteret e Kopenhagenit kërkojnë që vendet që aspirojnë për anëtarësim në BE, të kenë instrumente të cilat garantojnë, ndër të tjera, demokracinë, shtetin ligjor, të drejtat e njeriut, respektin dhe mbrojtjen e minoriteteve. Si të tilla, Shkolla e Magjistraturës, në bashkëpunim me UNIFEM-in dhe Qeverinë e Spanjës, kanë përvijuar këto dispozita të legjislacionit bazë dhe të direktivave të BE-së, të cilat duhet të zbatohen në Shqipëri.

Udhëzuesi synon të jetë një burim informacioni plotësues për pedagogët dhe studentët, për t'u përdorur së bashku me programin dhe planin mësimor të kursit.





**NJË VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM RRETH  
STANDARDEVE DHE NORMAVE TË BARAZISË GJINORE**



## NJË VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM RRETH STANDARDEVE DHE NORMAVE TË BARAZISË GJINORE

# 2

## 2.1. NORMA NDËRKOMBËTARE

### 2.1.1 Konventa për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave (CEDAW)

Deri tani, Konventa e CEDAW-t e 1979 është ratifikuar nga 185 shtete. Shqipëria e ratifikoi CEDAW-n më 1993 (Ligji 1769/ 9.11.1993)

Konventa CEDAW është një traktat novator i të drejtave të njeriut.

- 1 Ajo është konventa e parë e të drejtave të njeriut, e cila i detyron Shtetet Palë të modifikojnë dhe heqin dorë prej qëndrimeve sociale, modeleve dhe praktikave kulturore, të cilat mbështeten në idenë e inferioritetit apo superioritetit të secilit seks.
- 2 Ajo përshkruan shprehimisht detyrimet e Shteteve Palë për të eliminuar diskriminimin ndaj grave jo vetëm nga përfaqësues të shtetit, por edhe nga individë privatë, organizata apo sipërmarrje.
- 3 Ajo integron të drejtat civile të grave dhe të drejtat politike, dhe të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore në kuadrin normativ të mos-diskriminimit dhe të barazisë.
- 4 Konventa mbulon gjithashtu garancinë për të respektuar, mbrojtur dhe plotësuar të drejtat njerëzore të grave në sferën private të familjes. Diskriminimi ndaj grave në martesë dhe në jetën familjare nuk është vetëm një shkelje e të drejtave njerëzore në vetvete, por shpesh është bazë për diskriminimin e tyre edhe në fusha të tjera.
- 5 Konventa gjithashtu lejon zbatimin e masave të përkohshme të posaçme për korrigjimin e praktikave të diskriminimit.

Konventa CEDAW ka një qëllim të trefishtë. Ajo **bën të detyrueshme miratimin e masave të duhura dhe të efekshtme në tri nivele të ndryshme:**

- 1 Për të zbatuar barazi të plotë në ligj dhe në administratën publike;
- 2 Për të përmirësuar *de facto* gjendjen e grave;
- 3 Për të luftuar stereotipet sundonjës gjinorë dhe ideologjinë gjinore.

Kjo përjasje e trefishtë e CEDAW-t shkon shumë përtej gamës së të drejtave formale të njeriut (apo trajtimit të barabartë të grave krahasuar me burrat). **Të tre këto objektiva të Konventës nuk duhen ndarë apo klasifikuar, por duhen lexuar si tre aspekte të një qëllimi të vetëm të përbashkët: eliminimi i të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave.** Ato tregojnë tre strategji të ndryshme, që mund të përdoren të bashkërenduara, me synimin për të arritur këtë qëllim të përgjithshëm të Konventës.

Konventa përbëhet nga një Hyrje dhe tridhjetë nene. Hyrja përcakton qartë se të gjitha format dhe shfaqjet e diskriminimit ndaj grave shkelin “parimin e barazisë së të drejtave dhe respektin për dinjitetin njerëzor”.

Neni 1 deri tek 5 dhe Neni 24 i Konventës janë të ashtuquajturat nene kuadër. Brenda e tyre, sikundër shprehet në formën e përkufizimit dhe të detyrimeve të shteteve, është e rëndësishme jo vetëm në vetvete, por edhe sepse frymëzon Nenet e tjera substantive 6 deri në 16. Këto përkufizime dhe detyrime duhet të zbatohen nga Shtetet Palë sa herë që ata bëjnë përpjekje për të zbatuar ndonjërin prej tyre. Nenet 17 deri tek 23 dhe Nenet 25 deri tek 30 mbulojnë çështje procedurale.

CEDAW e përcakton diskriminimin ndaj grave si diçka që **“përfshin çdo lloj diskriminimi, përjashtimi apo kufizimi në bazë seksi, që ka si pasojë apo qëllim cenimin apo mohimin e njohjes, gëzimit apo ushtrimit nga gratë, pavarësisht statusit të tyre martesor, në bazë barazie të burrave dhe grave, të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore në fushën politike, ekonomike, sociale, kulturore, civile, apo në ndonjë fushë tjetër” (Neni 1).** Shteteve Palë iu kërkohet nga Konventa të eliminojnë një diskriminim të tillë ndaj grave në jetën publike dhe private, duke përfshirë edhe diskriminimin në familje. Të gjashtëmbëdhjetë nenet substantive të Konventës përcaktojnë fushat specifike të diskriminimit, të cilat janë me rëndësi të veçantë për gratë, si dhe mjetet për eliminimin e diskriminimit në këto fusha.

**Neni 17 i Konventës themelon Komitetin për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave si një organ ekspert,** me mandat shqyrtimin e përparimit të bërë nga Shtetet Palë në zbatimin e Konventës. Ai e ka kryer funksionin e monitorimit kryesisht përmes shqyrtimit të raporteve të paraqitura nga Shtetet Palë (Neni 18 i Konventës).

**Protokolli Shtesë i Konventës – i cili hyri në fuqi më 22 dhjetor 2000 - i ka shtuar një funksion gati gjyqësor Komitetit, përmes procedurës së ankimeve individuale.** Kur Komiteti e ka parë një komunikim si të pranueshëm, në mënyrë konfidenciale, ai i ka tërhequr vëmendjen për këtë komunikim Shtetit Palë, me kusht që ankimuesi apo ankimuesja të ketë

pranuar që identiteti i tij apo i saj t'i bëhet i ditur Shtetit Palë. Shtetit Palë i jepen gjashtë muaj kohë për të dhënë një shpjegim me shkrim apo për të bërë një deklaratë për ankesën. Procedura tjetër e futur nga Protokollit Shtesë është procedura e hetimit, e cila i jep mundësi Komitetit të nisë hetime *suo moto*, për gjendje të shkeljeve të rënda apo të vazhdueshme të të drejtave të grave. Deri tani, Komiteti ka bërë një hetim të tillë.

Sipas Nenit 18 të **Konventës, Shtetet Palë ndërmarrin të paraqesin raporte** për masat legislative, gjyqësore, administrative apo të tjera që ato kanë marrë për të zbatuar Konventën, si edhe për çdo faktor apo vështirësi që ata mund të kenë hasur gjatë një viti pas ratifikimit apo hyrjes në të. Raporte të tjera periodike kërkohen të paktën çdo katër vjet, apo sa herë që Komiteti e kërkon. Komiteti i shqyrton këto raporte në një dialog konstruktiv me përfaqësuesit e Shtetit Palë.

Neni 21 i Konventës i jep **Komitetit të drejtë të bëjë sugjerime dhe rekomandime** mbështetur në shqyrtimin e raporteve dhe informacionin e marrë nga Shtetet Palë. Deri tani, Komiteti ka miratuar 25 rekomandime të përgjithshme për të sqaruar nene të veçanta apo çështje që mbulohen nga Konventa

## NATYRA E DETYRIMEVE SHETËRORE TEK CEDAW

Detyrimet shtetërore për të respektuar, mbrojtur, dhe plotësuar të drejtat e grave për mos-diskriminim dhe barazi janë përcaktuar qartë në të gjitha nenet e Konventës, por çka ka më rëndësi dhe në mënyrë gjithëpërfshirëse, janë përcaktuar tek Neni 2, i cili i përshkruan ato mbi të gjitha si detyrim i Shteteve Palë për të dënuar dhe eliminuar diskriminimin ndaj grave përmes hapave ligjore dhe të tjerë. **Studiuesit e të drejtës ndërkombëtare bëjnë dallim midis detyrimeve të Shteteve për mjete apo për sjellje, të cilat janë detyrime “për të vepruar me mjete të përcaktuara për arritjen e qëllimeve që aspirohen” dhe detyrimeve cenuese apo rezultatit, të cilat janë detyrime për të “arritur rezultate të caktuara me çfarëdo mjeti që shihet si i përshtatshëm”.**<sup>1</sup> Konventa u jep Shteteve Palë të drejtën e vendosjes sipas diskrecionit të tyre, për të zgjedhur mjetet e tyre brenda kuadrit “të të gjitha masave të përshtatshme” përfshirë edhe ato ligjore. Kështu, ndërsa u takon Shteteve Palë të vendosin për llojet e masave për zbatimin, për shembull të “lejes së lindjes me pagesë, apo për përfitime të krahasueshme sociale, duke mos humbur punën e mëparshme, vjetërsinë në punë apo përfitimet shoqërore”<sup>2</sup>, Konventa e

<sup>1</sup> Cook Rebecca, 1994, Llogaridhënia e shtetit sipas Konventës për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave, tek: In Human Rights of Women: National and International Perspectives, red Rebecca Cook. Philadelphia: University of Pennsylvania Press, 231-232.

<sup>2</sup> Neni 11 (2 b) i CEDAW-t.

vendos qartë në formë detyruese se duhet përcaktuar një farë forme leje lindje me pagesë.

Tek Neni 2 (a-g), detyrimet e përgjithshme të rezultateve, përfshijnë detyrimet e Shteteve Palë për të eliminuar “diskriminimin në të gjitha format e tij”, që jo vetëm përfshijnë detyrimin për të “mishëruar parimin e barazisë së burrave dhe grave” në kushtetutat kombëtare dhe ligje të tjera, por edhe të sigurojnë “realizimin praktik të këtij parimi”. **Të gjitha format e diskriminimit – qofshin kur janë kryer nga përfaqësues të shtetit apo organizata private, sipërmarrje dhe persona – duhet të ndalohen me ligj dhe duhet të dënohen me “sanksione kur është e udhës” përmes “gjykatave kompetente të vendit dhe institucioneve të tjera publike”.**

Përveç kësaj, “ligjet, rregulloret, zakonet dhe praktikrat ekzistuese që përbëjnë diskriminim ndaj grave” duhet të modifikohen dhe të hiqen (shih Nenin 5 a).

Zbatimi i Konventës ka kontribuar për një përparim të dukshëm në lidhje me barazinë ligjore dhe ndonjëherë substantivë të grave me burrat. Megjithatë, duhet të vihet në dukje se, ndonëse e drejta e kufizuar për të monitoruar këtë zbatim është përmirësuar me miratimin e Protokollit Shtesë në vitin 1999, duke shtuar dy instrumente të tjerë monitorimi – procedurën e komunikimit dhe atë të hetimit, - zbatimi në praktikë është i kufizuar.

## PROTOKOLLI SHITESË (PSH) I KONVENTËS CEDAW

Njëzetë vjet pas miratimit të Konventës, PSh-ja është miratuar nga Asambleja e Përgjithshme në Sesionin e saj të 54-t, më 6 tetor 1999. Ai hyri në fuqi në 22 dhjetor 2000 dhe është ratifikuar, duke filluar nga gushti 2009, nga 85 shtete prej 185 Shtete Palë të Konventës. Ai parashikon dy procedura të tjera në Konventën CEDAW: komunikimin individual dhe procedurën e hetimit. Shqipëria e ratifikoi PSh-në në 2003 (Ligji 9052/17.4.2003).

Procedura e komunikimit individual është modeluar sipas procedurave të ngjashme ekzistuese të instrumenteve të tjerë detyrues ndërkombëtar të të drejtave të njeriut si Protokollit Shtesë i Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike. **Procedura e komunikimit individual mund të përdoret vetëm pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet e tjera të vendit.** Neni 4 (1) i PSh-së parashikon se, në rast se zbatimi i mjeteve të vendit zgjat në mënyrë të paarsyeshme apo nuk ka të ngjarë

të sjellë rezultate të efektshme, Komiteti i CEDAW-t, mund ta deklarojë komunikimin të pranueshëm. Këto deklarime janë me natyrë të shkruar dhe shpjen në opinione jo detyruese, që përmbajnë rekomandime konkrete dhe të përgjithshme për Shtetin Palë, kur shihet se Shteti ka shkelur të drejtën (të drejtat) e ankimesit (ankimesve). Sipas Nenit 5 (1) të Protokollit Shtesë, Komiteti ka të drejtë të marrë “masa të tilla të përkohshme që mund të jenë të nevojshme për të mënjanuar dëme të mundshme të pariparueshme për viktimën apo viktimat e shkeljes së pretenduar”.

## CEDAW, KRAHASUAR ME LEGJISLACIONIN E BE-SË PËR BARAZINË GJINORE

Të 27 Shtetet Anëtare të BE-së e kanë nënshkruar CEDAW-n. **Kjo do të thotë se legjislacioni dhe politikat e tyre – dhe legjislacioni dhe politikat e Bashkimit European po ashtu, - duhet të përputhen me objektin dhe qëllimin e Konventës.** Vetë BE-ja, nuk është nënshkruese e Konventës.

Në lidhje me objektin e Konventës, duhet të kihet parasysh se fushat e mbuluara nga CEDAW janë më të gjera se ato që mbulohen nga legjislacioni i BE-së për diskriminimin me bazë seks. Ky i fundit për një kohë të gjatë ishte i kufizuar në veprimtaritë ekonomike të grave, d.m.th., te të drejtat e punës së paguar dhe të sigurimeve shoqërore.<sup>3</sup> Konventa CEDAW lidhet me të gjitha aspektet e jetës politike, ekonomike, sociale dhe private të grave. Në Nenin 6 deri në 16, CEDAW-t përmban (përveç të tjerave) dispozita në lidhje me kujdesin shëndetësor, politikat e emigracionit, arsimimit, pjesëmarrjen në partitë politike, marrëdhëniet e punës, sigurimet shoqërore, dhunën ndaj grave, trafikimin e grave, të drejtat e grave në jetën familjare (dhe ligji i familjes) dhe gjendjen e grave në zonat rurale.

**Legjislacioni dhe jurisprudenca e BE-së e ndalon diskriminimin e drejtpërdrejtë dhe të tërthortë midis burrave dhe grave.**<sup>4</sup> Ky legjislacion kërkon që të gjitha ligjet, rregulloret dhe praktikat e Shteteve Anëtare – të paktën për sa i përket tregut të punës dhe politikave sociale – nuk duhet të përmbajnë asnjë lloj diskriminimi. Si rrjedhojë, në Shtetet Anëtare (SHA) ligjet e vendit janë ndryshuar dhe tani veprojnë ligjet kundër diskriminimit. Pra, përveç fushës së kufizuar të zbatimit të saj, e drejta e BE-së është pak a shumë në përputhje me qëllimin e parë të Konventës.

Qëllimi i dytë i Konventës CEDAW është **të përmirësojë gjendjen de facto të grave.** Ky qëllim është i shprehur shumë qartë në Nenin 3 të Konventës CEDAW. Ky Nen i detyron Shtetet të marrin masat e duhura për të siguruar zhvillimin e plotë dhe përparimin e grave, me synimin që t’u garantojë atyre ushtrimin dhe gëzimin e të drejtave dhe lirive themelore në bazë

<sup>3</sup> Kjo është rrjedhojë e faktit se Komiteti ka kryesisht objektiva dhe të drejta ekonomike. Shih po ashtu më poshtë.

<sup>4</sup> Pas ndryshimit të Direktivës 76/207/të KEE-së, tani edhe e drejta e KE-së e ndalon ngacmimin seksual në vendin e punës. Shih Direktivën 2002/73/të KE-së, mund ta gjeni tek: [http://www.europa.eu.int/eur-lex/en/dat/2002/l\\_269/l\\_26920021005en00150020.pdf](http://www.europa.eu.int/eur-lex/en/dat/2002/l_269/l_26920021005en00150020.pdf)

barazie me burrat.<sup>5</sup> Dispozitat thelbësore të CEDAW (përkatësisht Nenet 6-16) bëjnë thirrje për veprim në fushat përkatëse që mbulohen nga Konventa në lidhje me “Shtetet palë do të sigurojnë”, “Shtetet Palë do të japin” dhe “Shtetet Palë do të marrin të gjitha masat e duhura” dhe më pas do të përcaktojnë se çfarë veprimesh janë të nevojshme.<sup>6</sup> Kështu, Konventa jo vetëm e bën të detyrueshme normën për t’u përmbajtur ndaj diskriminimi ndaj grave (detyrim negativ), por edhe detyrimin për të bërë gjithçka që është e përshtatshme dhe e nevojshme për të përmirësuar *de facto* gjendjen e grave (detyrim pozitiv).

**Një përjasje paralele mund të gjendet tek Nenet 141(3) dhe 141(4) të Traktatit,** ku Komisioni European ka të drejtën të nxisë mundësi të barabarta dhe ku ShA-ve u jepet leje të miratojnë masa “që parashikojnë përfitime konkrete për seksin e nënpërfaqësuar”. Këto dispozita të Traktatit janë përfshirë në Direktivën e ndryshuar 76/207/të KEE-së (tani 2006/54/KE-së). Kjo përjasje në vetvete nuk imponon ndonjë detyrim konkret ndaj qeverive, institucioneve publike apo organizatave private dhe, ose sipërmarrjeve për të përmirësuar gjendjen e grave. Ai bën të mundur, por jo të detyrueshme, ndërmarrjen e programeve të veprimit pozitiv.

Gjithsesi, duhet theksuar, se **regjimi i të drejtës së BE-së është një korpus tepër i zbatueshëm ligjesh,** ndërsa ligji i CEDAW-t, që trajton detyrimet e tij ndaj Shteteve Palë, ka mundësi shumë të kufizuara për të sanksionuar shkelje.

## 2.1.2. KONVENTA EUROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT (KEDNJ)

Parimi i barazisë gjinore është një nga parimet themelore të ligjit të të drejtave të njeriut. **Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut vazhdimisht është shprehur se “barazia e sekseve është një nga qëllimet madhore të Shteteve Anëtare të Këshillit të Europës”, dhe kohët e fundit e ka deklaruar barazinë gjinore si një nga parimet themelore, thelbësore të Konventës.** Neni 14 i KEDNJ-së është dispozita bazë kundër diskriminimit. Në të përcaktohet se:

Gëzimi i të drejtave dhe lirive të parashikuara në këtë Konventë, do të sigurohet pa diskriminim, për çdo lloj arsyeje si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimi politik apo të tjera, origjina kombëtare apo sociale, të shoqëruarit me statusin e pakicës kombëtare, pronës, lindjes, apo ndonjë status tjetër. (Neni 14 i KEDNJ-së – Ndalimi i Diskriminimit)

<sup>5</sup> Shih po ashtu Nenin 4(1) të CEDAW-t, i cili lejon marrjen e masave të përkohshme, dhe Nenin 24, i cili përsërit detyrimin e përgjithshëm për të ndërmarrë veprim.

<sup>6</sup> Në të drejtën ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, detyrimet e ndryshme, sipas dokumenteve të të drejtave të njeriut, klasifikohen nga jo-detyruese në detyruese, sipas formulimit të dispozitave në fjalë. Një dispozitë ku përdoren fjalët do të sigurojë, ose do të japë, ose do të marrë masat e duhura shihet si një dispozitë detyruese. Në këtë rast “do të” lexohet “duhet”. Shih Andrew Byrnes & Jane Connors, *Enforcing the Human Rights of Women: A Complaint Procedure for the Women’s Convention?* Brooklyn Journal of International Law (1996), Vëll. XXI, f. 679-797 në faqen 718-726

Sikundër shihet nga ky përkufizim, hartuesit e Konventës nuk kishin për qëllim të përcaktonin një parim të përgjithshëm dhe të pavarur të trajtimit të barabartë. Ky nen është me karakter plotësues dhe si i tillë, synon kryesisht të garantojë ushtrimin e efektshëm të të drejtave dhe lirive të mbrojtura nga Konventa. Si rrjedhojë e karakterit plotësues të dispozitave, ankesat në lidhje me shkeljet e pretenduara të Nenit 14, do të ishin të pranueshme vetëm në rast se tregohet një lidhje e mjaftueshme midis diskriminimit të pohuar dhe një prej të drejtave apo lirive të mbrojtura nga një dispozitë substantive e Konventës, me qëllim që të përdoret me sukses ndalimi i diskriminimit.

Fillimisht, kërkesa për lidhjen midis dispozitave substantive të Konventës dhe Nenit 14 ishte mjaft e rreptë. Komisioni European për të Drejtat e Njeriut i deklaronte ankesat të pranueshme vetëm kur ai konstatohe një shkelje të dispozitës përkatëse substantive të Konventës.<sup>7</sup> Si rrjedhojë, ankesat për shkelje të Nenit 14 pothuaj asnjëherë nuk kanë qenë të suksesshme.

Kur Gjykatës iu dha mundësia për të vendosur për herë të parë për një rast administrativ, ajo bëri një interpretim disi më elastik të nevojës për një lidhje me një dispozitë substantive: sipas **vendimit të Gjykatës në rastin Linguistika Belge**<sup>8</sup>, një ankesë për diskriminim mund të jetë e pranueshme edhe kur një dispozitë substantive nuk është shkelur. Megjithatë, një farë prove e lidhjes me një dispozitë substantive përsëri kërkohet.

**Megjithatë, një pasojë problematike e karakterit plotësues është fakti se ai e ndalon Gjykatën të shqyrtojë një gamë të gjerë pretendimesh për diskriminim.** Gjykata është veçanërisht e kufizuar në shqyrtimin e dallimeve, që shkelin të drejtat sociale apo ekonomike, meqenëse Gjykata rrallë konstaton se këto të drejta hyjnë në gamën e Konventës. Si rrjedhojë, ankesa për trajtim të pabarabartë në lidhje me çështje të tilla si, qasje në punësim, trajnim profesional apo siguri sociale, shpesh do të deklarohen të papranueshme, edhe kur dallimi pretendohet se mbështetet në shkaqe të dyshuara të tilla si, raca, kombësia ose seksi.

Po ashtu **Neni 5 i Protokollit Nr. 7 të KEDNj-së**<sup>9</sup> përmend shprehimisht barazinë:

**Bashkëshortët do të gëzojnë barazi të drejtash dhe përgjegjësisht të karakterit të së drejtës private midis tyre dhe në marrëdhëniet me fëmijët e tyre, në lidhje me martesën, gjatë martesës dhe në rastin e zgjidhjes së saj. Ky nen nuk do t'i ndalojë Shtetet që të marrin masa të nevojshme në interesin e fëmijëve. (Neni 5 – Barazia midis bashkëshortëve)**

<sup>7</sup> Kërkesa 16/808, 8 mars 1960, Isop kundër Austrisë.

<sup>8</sup> GJEDNj, 23 korrik 1968. Belgian Linguistics case, Seria A, vëll. 6, para. 9. Nga çështjet e mëparshme gjyqësore, është e qartë, se kriteri plotësohet me lehtësi.

<sup>9</sup> Hyrja në fuqi në Shqipëri: 1 janar 1997.

Raporti shpjegues vë në dukje elementët e mposhtëm<sup>10</sup>:

➔ Sipas këtij neni, bashkëshortët do të gëzojnë barazi të drejtash dhe përgjegjësish në lidhje me martesën, gjatë martesës, dhe në rast të zgjidhjes së saj.

➔ Sipas këtij neni, barazia duhet të sigurohet vetëm në marrëdhëniet midis vetë bashkëshortëve, në lidhje me personin e tyre apo me pronën, dhe në lidhjet e tyre me fëmijët e tyre. Të drejtat dhe përgjegjësitë janë kështu me karakter të së drejtës private; neni nuk zbatohet për fusha të tjera të së drejtës, si ajo e të drejtës administrative, fiskale, penale, shoqërore, fetare, apo e ligjeve të punës;

➔ Fakti që bashkëshortët do të gëzojnë të drejta dhe përgjegjësi në marrëdhëniet e tyre me fëmijët nuk do t'i pengojë Shtetet që të marrin masa të tilla të nevojshme për interesin e fëmijëve. Në këtë drejtim, praktika e organeve të kontrollit të ngritur nga Konventa duhet pasur parasysh, në lidhje me, në veçanti, Nenet 8 dhe 14 të Konventës. Në lidhje me Nenin 8 (e drejta për respektuar jetën familjare), Komisioni Europian dhe Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut kanë theksuar nevojën për të marrë parasysh interesat e fëmijës. Për sa i përket Nenit 14 (parimi i mos-diskriminimit), Gjykata ka konstatuar se ai shkelet” në rast se dallimi nuk ka justifikim objektiv dhe të arsyeshëm” (Çështja që ka të bëjë me aspekte të caktuara të ligjeve për përdorimin e gjuhëve në Belgjikë, gjykimi i 23 korrikut 1968, Seria A, Voll. 6, f. 34, par. 10).

➔ Ky nen, i cili ka të bëjë me rastin e “bashkëshortëve”, përjashton periudhën para martesës dhe nuk zbatohet në rastin e zotësisë për të lidhur martesë, e cila parashikohet nga ligji i vendit (shih Nenin 12 të Konventës). Fjalët “për sa i përket martesës” kanë të bëjnë me pasojat ligjore që rrjedhin nga lidhja e martesës.

➔ Së fundi, ky nen nuk duhet kuptuar se i pengon autoritetet kombëtare që të kenë parasysh mirë të gjithë faktorët përkatës, kur marrin një vendim për ndarjen e pronës, në rast mbarimi apo zgjidhje të martesës.

Fjalët “në rast mbarimi (zgjidhje) të martesës” nuk nënkuptojnë ndonjë detyrim të një Shteti për të parashikuar zgjidhjen e martesës apo ndonjë formë të posaçme të mbarimit të saj.

<sup>10</sup> Teksti i raportit shpjegues, i përgatitur nga Komiteti Drejtues për të Drejtat e Njeriut dhe paraqitur në Komitetin e Ministrave të Këshillit të Europës, nuk përbën një instrument, i cili bën një interpretim autoritativ të tekstit të Protokollit, ndonëse mund të jetë me natyrë të tillë që e lehtëson të kuptuarit e dispozitave që përmbahen aty.

## PROTOKOLLI NR. 12 I KEDNJ-SË

Mbrojtja nga diskriminimi sipas Nenit 14, kohët e fundit u plotësua me Nenin 1 të Protokollit 12 të KEDNJ-së. Protokollin 12 e zgjeron gamën e zbatimit të Nenit 14, duke parashikuar **një zbatim krejtësisht të pavarur të parimit të mos-diskriminimit “për çdo të drejtë të përcaktuar me ligj”**. Ky protokoll veçanërisht zgjeron gamën e mbrojtjes nga mos-diskriminimi për të përfshirë detyrimin negativ të palëve kontraktuese si edhe një detyrim pozitiv (për të marrë masa për mbrojtje nga diskriminimi, edhe kur diskriminimi ndodh midis palëve private). Ai qëndron pranë Nenit 14, pa e ndryshuar apo shfuqizuar atë. Megjithatë, sikurse Neni 14, ai nuk garanton mos-diskriminim në terma absolute. Përkundrazi, ai ndjek përqasjen e miratuar nga GjEDNJ-ja në juridiksionin e saj.

Protokollin 12 i KEDNJ -së garanton një të drejtë që **qëndron më vete** (për barazinë). Ai shprehet:

Neni 1 – Ndalimi i përgjithshëm i diskriminimit

- 1** Gëzimi i një të drejte të parashikuar me ligj do të sigurohet pa diskriminim për asnjë shkak të tillë si, seksi, raca, ngjyra, feja, mendimi politik apo ndonjë mendim tjetër, origjina kombëtare apo shoqërore, lidhja me një pakicë kombëtare, pronë, lindje apo ndonjë status tjetër.
- 2** Askush nuk duhet të diskriminohet nga ndonjë autoritet publik për shkaqe të tilla si ato që përmenden në paragrafin 1.

Protokollin 12 është hartuar për të çuar përpara mbrojtjen e barazisë që ofron KEDNJ-ja përtej garancisë relativisht të kufizuar të Nenit 14, i cili garanton të drejtën e mos-diskriminimit vetëm në gëzimin e të drejtave të tjera sipas Konventës. Me qëllim që të zbatohet Neni 14, pra, duhet të përcaktohet se diferenca në trajtim hyn në gamën e një prej të drejtave të tjera të Konventës. Protokollin 12 hyri në fuqi për ato shtete që e kanë ratifikuar, ndër të tjerë, Shqipëria, e cila e ka ratifikuar atë më 1 prill 2005.

Raporti shpjegues nënvizon se “parimi i përgjithshëm i barazisë dhe mos-diskriminimit është një element themelor i të drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Ai është njohur si i tillë në Nenin 7 të Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut, Nenin 26 të Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, dhe në dispozita të ngjashme në instrumente të tjera ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Dispozita përkatëse në Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) në këtë drejtim është Neni 14. Megjithatë, mbrojtja e siguruar nga Neni 14 i Konventës në lidhje me barazinë

dhe mos-diskriminimin është e kufizuar, krahasuar me këto dispozita të instrumenteve të tjera ndërkombëtare. Arsyeja kryesore për këtë është fakti se Neni 14, ndryshe nga këto dispozita në instrumente të tjera, nuk përmban një ndalim të pavarur të diskriminimit, që do të thotë, ai ndalon diskriminimin vetëm në lidhje me “gëzimin e të drejtave dhe lirive” të përcaktuara në Konventë. Që nga 1950, janë përcaktuar garanci të tjera të caktuara, konkrete në lidhje me barazinë midis bashkëshortëve në Nenin 5 të Protokollit Nr. 7 të KEDNJ -së.

Trajtesa për dispozitat e Protokollit 12 shprehimisht thekson se, ndërsa “parimi i barazisë nuk del shprehimisht as në tekstin e Nenit 14 të Konventës, as në Nenin 1 të këtij Protokollit, duhet pasur parasysh se parimi i mos-diskriminimit dhe i barazisë janë ngushtësisht të lidhura. Për shembull, parimi i barazisë kërkon që gjendje të barabarta të trajtohen njëllë, ndërsa gjendje të pabarabarta, ndryshe. Mosveprimi në këtë mënyrë do të përbëjë diskriminim, në rast se nuk ekziston një justifikim objektiv dhe i arsyeshëm (shih para. 18 më poshtë). Gjykata, në vendimet e saj sipas Nenit 14, i është referuar “parimit të barazisë së trajtimit (shih, për shembull, **grykimin e 23 korrikut 1968 të Gjykatës në çështjen “Gjuhësia belge”**, Seria a, Nr. 6, para. 10) apo “**të barazisë së sekseve” (shih për shembull grykimin e 28 majit 1985 në çështjen Abdulaziz, Cabales dhe Balkandali kundër Mbretërisë së Bashkuar**, Seria A, Nr. 94, para 78).”

Për më tepër, trajtesa u referohet masave të marra me qëllimin për të nxitur barazinë e plotë dhe efektive dhe rikonfirmon, në pikën e tretë përshkruese të hyrjes, dhe deklaron se masa të tilla nuk do të pengohen nga parimi i mos-diskriminimit, me kusht që të ketë një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm për to (ky parim del ndërkohë në disa dispozita ekzistuese ndërkombëtare: shih, për shembull, Nenin 1, para. 4, të Konventës Ndërkombëtare për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor, Neni 4, para. 1, i CEDAW, dhe, në nivel rajonal, Neni 4, para. 3, i Konventës Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare). Fakti që ka grupe të caktuara apo kategori personash që janë të disavantazhuar, apo se pabarazitë ekzistojnë *de facto*, mund të përbëjë justifikim për marrjen e masave që parashikojnë përfitime të caktuara për nxitjen e barazisë, me kusht që të respektohet parimi i proporcionalitetit.

Në fakt, ka disa instrumente ndërkombëtare që i detyrojnë ose i nxisin shtetet të miratojnë masa pozitive (shih, për shembull, Neni 2, par. 2, të Konventës ndërkombëtare për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor, Neni 4, para. 2, i Konventës Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare dhe Rekomandimin Nr. R (85) 2 të Komitetit të Ministrave për Shtetet Anëtare për mbrojtjen ligjore ndaj diskriminimit të sekseve). Megjithatë, Protokollit aktual (12) nuk vendos ndonjë detyrim

për miratimin e masave të tilla. Një detyrim i tillë programatik do të binte ndesh me të gjithë natyrën e Konventës dhe sistemin e saj të kontrollit, të cilët mbështeten në garancinë kolektive të të drejtave të individit, të formuluar me terma mjaft specifike për të qenë të gjykueshme.

Në lidhje me Nenin 1, i cili përmban dispozitat kryesore substantive të Protokollit 12, trajtesa shpjegon se formulimi i tij mbështetet në konsiderata të përgjithshme si më poshtë:

“Nocioni i diskriminimit është interpretuar në mënyrë konsistente nga Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut në praktikën e saj ligjore, që ka të bëjë me Nenin 14 të Konventës. Në veçanti, këto çështje e kanë bërë të qartë se jo çdo dallim apo ndryshim në trajtim përbën diskriminim. Sikundër ka konstatuar Gjykata, për shembull, në gjykimin e saj në çështjen e Abdulaziz, Cabales dhe Balkandali kundër Mbretërisë së Bashkuar: “një ndryshim në trajtim është diskriminues në rast se ‘ai nuk ka justifikim objektiv dhe të arsyeshëm’, që do të thotë, në rast se ai nuk ndjek një ‘qëllim të ligjshëm’ apo kur nuk ka ‘një marrëdhënie të arsyeshme proporcionaliteti midis mjeteve të përdorura dhe qëllimit që kërkohet të arrihet’” (gjykimi i 28 majit 1985, Seria A, Nr 94, para. 2). Kuptimi i termit “diskriminim” në Nenin 1 ka për qëllim të jetë identik me atë të Nenit 14 të Konventës. Formulimi i tekstit në frëngjisht të Nenit 1 (“*sans discrimination aucune* – pa asnjë diskriminim”) ndryshon paksa nga ai i Nenit 14 (“*sans distinction aucune* - pa asnjë dallim”). Nuk synohet asnjë lloj ndryshimi në kuptim; përkundrazi, kjo është një përshtatje terminologjike që synon të pasqyrojë më mirë konceptin e diskriminimit sipas kuptimit të Nenit 14, duke e sjellë tekstin në frëngjisht në një linjë me tekstin në anglisht (shih, për këtë pikët konkrete, gjykimin e GjEDNj-së së datës 23 korrik 1968 në çështjen “Gjuhësia belge”, Seria , Nr 6, par. 10).

#### **Lista e shkaqeve të mos-diskriminimit në Nenin 1 të Protokollit 12 është e njëjtë me atë të Nenit 14 të Konventës.**

Kjo zgjidhje u konsiderua më e mirë nga të tjerat, si për shembull, ato që shprehimisht përcaktojnë disa shkaqe të tjera konkrete të mos-diskriminimit (për shembull, paaftësi fizike apo mendore, orientimi seksual apo mosha), jo për shkak të mungesës së ndërgjegjësimit se shkaqe të tilla janë bërë veçanërisht të rëndësishëm në shoqëritë e sotme, krahasuar me kohën kur është hartuar Neni 14 i Konventës, por sepse një përfshirje e tillë u konsiderua e panevojshme nga një këndvështrim ligjor, meqenëse lista e shkaqeve të mos-diskriminimit nuk është shteruese, dhe sepse përfshirja e ndonjë shkaku tjetër të caktuar mund të shpinte në një

*contrario interpretations* të panevojshëm në lidhje me diskriminimin e mbështetur në shkaqe të papërfshira si të tilla. Është pasur parasysh se Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut, ndërkohë, e ka zbatuar Nenin 14 në lidhje me shkaqet e diskriminimit që nuk përmenden shprehimisht në atë dispozitë (shih, për shembull, **për sa u takon shkaqeve të orientimit seksual, gjykimi i 21 dhjetor 1999 në çështjen Salgueiro da Silva Mouta kundër Portugalisë**).

Neni 1 i Protokollit 12 parashikon një klauzolë mos-diskriminimi dhe si pasojë ofron një gamë mbrojtje e cila shtrihet përtej “gëzimit të të drejtave dhe lirive të përcaktuara në Konventë”.

Në veçanti, gama shtesë e mbrojtjes, sipas Nenit 1 të Protokollit 12, ka të bëjë me raste kur një person diskriminohet:



- i. në gëzimin e çdo të drejte të dhënë posaçërisht një individ sipas ligjit të vendit;
- ii. në gëzimin e një të drejte e cila mund të nxirret nga një detyrim i qartë i një autoriteti publik sipas ligjit të vendit, që do të thotë, kur një autoritet publik e ka për detyrë sipas ligjit të vendit të sillet në një mënyrë të caktuar;
- iii. nga një autoritet publik gjatë ushtrimit të së drejtës diskrecionare (për shembull, duke dhënë subvencione të caktuara);
- iv. nga çdo akt tjetër apo mosveprim i një autoriteti publik (për shembull, sjellja e oficerëve të zbatimit të ligjit gjatë mbajtjes nën kontroll të një trazire).

Në këtë drejtim, u pa e nevojshme që të specifikohet se cili nga këta katër elementë mbulohet nga paragrafi i parë i Nenit 1 dhe cili nga i dyti. Të dy paragrafët janë plotësues dhe efekti i tyre i bashkërenduar është se të katër këta elementë mbulohen nga Neni 1. Gjithashtu, duhet të kihet parasysh se dallimet midis kategorive përkatëse *i-iv* nuk janë të prera, kështu që sistemet e brendshme ligjore mund të ndjekin përjasje të ndryshme në lidhje me përcaktimin se cili rast hyn në cilën kategori.

Formulimi i Nenit 1 pasqyron një përjasje të balancuar ndaj detyrimeve të mundshme pozitive të Palëve sipas kësaj dispozite. Kjo ka të bëjë me çështjen se deri në çfarë mase Neni 1 i detyron Palët të marrin masa për të parandaluar diskriminimin, edhe kur diskriminimi ndodh në marrëdhëniet midis personave privatë (të ashtuquajtur “efekte horizontale të tërthorta”).

E njëjta pyetje shtrohet edhe në lidhje me masat për të zgjidhur rastet e diskriminimit. Ndërsa detyrime të tilla pozitive nuk mund të përjashtohen krejtësisht, objektivi kryesor i Neni 1 është të mishërojë një detyrim negativ për Palët: detyrimin për të mos i diskriminuar individët.

Nga njëra anë, Neni 1 i Protokollit 12 siguron mbrojtje nga diskriminimi i autoriteteve publike. Neni nuk ka për qëllim që të vendosë një detyrim të përgjithshëm pozitiv për Palët për të marrë masa për parandalimin apo ndreqjen e të gjitha rasteve të diskriminimit në marrëdhëniet midis personave privatë. Një protokoll shtesë i Konventës, i cili përmban të drejta individuale të gjykueshme, i formuluar me dispozita koncize, nuk do të ishte një instrument i përshtatshëm për përcaktimin e elementëve të ndryshëm të një detyrimi të tillë të gjerë me karakter programatik. **Ndërkohë, rregulla të hollësishme, specifike janë përcaktuar në konventa të veçanta, kushtuar vetëm eliminimit të diskriminimit për shkaqe specifike që mbulohen prej tyre** (shih për shembull, Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor dhe CEDAW, të cilat, si njëra ashtu edhe tjetra, janë përpunuar nga Kombet e Bashkuara). Është e qartë se Protokollin aktual nuk duhet interpretuar sikur kufizon apo ul rëndësinë e dispozitave të brendshme apo të traktatit, të cilat sigurojnë mbrojtje të mëtejshme nga diskriminimi. Nga ana tjetër, nuk mund të përjashtohet krejtësisht se, detyra për “të siguruar”, sipas paragrafit të parë të Neni 1, mund të kërkojë detyrime pozitive. Për shembull, **kjo çështje mund të ngrihet në rast se ka një boshllëk të qartë në mbrojtjen nga diskriminimi në ligjin e brendshëm**. Në lidhje me, më konkretisht, marrëdhëniet midis personave privatë, mospajtimi i mbrojtjes nga diskriminimi në marrëdhënie të tilla mund të jetë kaq i dukshëm dhe i rëndë, sa që mund të jetë e qartë se kërkohet përgjegjësia e Shtetit. Në këtë rast mund të vihet në lëvizje Neni 1 i Protokollit 12 (shih, *mutatis mutandis*, gjykimi i Gjykatës i 26 marsit 1985 në çështjen **X dhe Y kundër Holandës, Seria A, Nr. 91**, para. 23-24, 27 dhe 30).

Megjithatë, shkalla e çdo detyrimi pozitiv, që rrjedh nga Neni 1, ka të ngjarë të jetë e kufizuar. Duhet të kihet parasysh se paragrafi i parë jashtëshkruhet nga referenca për “gëzimin e çdo të drejte të përcaktuar me ligj” dhe se paragrafi i dytë e ndalon diskriminimin “nga çdo autoritet publik”. Përveç kësaj, duhet pasur parasysh se Neni 1 i Konventës, vendos një kufizim të përgjithshëm për përgjegjësinë e shtetit, i cili është veçanërisht i përshtatshëm në çështje diskriminimi midis personave privatë.

**Këto konsiderata tregojnë se çdo detyrim pozitiv në fushën e marrëdhënieve midis personave privatë do të ketë të bëjë, maksimumi, me marrëdhëniet në fushën publike, që normalisht rregullohen me ligj, për të cilat shteti ka një farë përgjegjësie (për shembull, mohimi arbitrar i mundësisë për të punuar, për të përfituar nga**

shërbimet në restorante, apo nga shërbimet që mund të venë në dispozicion persona privatë për publikun si, kujdesi mjekësor apo shërbime publike të tilla si uji dhe elektriciteti, etj). Forma e saktë e reagimit që duhet të ndërmerret shteti do të ndryshojë sipas rrethanave. Është e kuptueshme se problemet thjesht private nuk do të preken. Rregullimi i problemeve të tilla do të ketë gjithashtu të ngjarë të ndërhyjë në të drejtën e individit për jetë private dhe familjare, shtëpinë dhe korrespondencën e tij, sikundër garantohen nga Neni 8 i KEDNj-së.

Paragrafi i parë i Nenit 1 të Protokollit 12 i referohet “çdo të drejtë të përcaktuar me ligj”. Kjo shprehje kërkon të përcaktojë gamën e garancive të siguruara në këtë paragraf dhe të kufizojë efektet e tij të mundshme të tërthorta horizontale (shih paragrafin 27 më sipër). Meqenëse mund të ketë një farë dyshimi nëse vetvete kjo fjali i mbulon të katër elementët, të cilët përbëjnë gamën bazë shtesë të Protokollit 12 (pyetja mund të shtrohet në veçanti në lidhje me elementët iii dhe iv – shih paragrafin 22 më sipër), duhet kujtuar se paragrafët e parë dhe të dytë të Nenit 1 janë plotësues. Rezultati është se këto katër elementë gjithsesi mbulohen nga Neni 1 në tërësi (shih paragrafin 23 më sipër). Fjala “ligj” mund të mbulojë gjithashtu edhe të drejtën ndërkombëtare, por kjo nuk do të thotë se kjo dispozitë kërkon që juridiksioni i Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut të shqyrtojë përputhshmërinë me rregullimet ligjore të instrumenteve të tjera ndërkombëtare.

Termi “autoritet publik” në paragrafin 2 është huazuar nga Neni 8, paragrafi 2, dhe Neni 10, paragrafi 1, i KEDNj dhe synon të ketë të njëjtin kuptim sikundër në këto dispozita. Ai mbulon jo vetëm autoritetet administrative, por edhe gjykatat dhe organet legjislative (shih paragrafin 23 më sipër).

## 2.2. LEGJISLACIONI I BE-SË.

Një shpjegim i shkurtër hyrës që meriton vëmendje është dallimi midis BE-së dhe KE-së. Aktualisht, pra, para hyrjes në fuqi të Traktatit të Lisbonës, Komuniteti European dhe si rrjedhojë edhe e drejta e KE-së, është vetëm një pjesë e të drejtës së Bashkimit European. **E gjithë e drejta e barazisë gjinore është një e drejtë që e ka zanafillën tek Traktati që ngriti Komunitetin European (Traktati i KE-së) që është më i vjetër se Traktati i BE-së.** Si rrjedhojë, ndërsa mund të flasim për të drejtën e barazisë gjinore të BE-së, referencat më të sakta janë ato ndaj Traktatit të KE-së. Kur – dhe në rast se – Traktati i Lisbonës hyn në fuqi, KE-ja dhe BE-ja do të shkrihen në një njësi të vetme, Bashkimi European. **Megjithatë, ne do të vazhdojmë të punojmë me dy traktate, Traktati i Bashkimit European (TBE) i cili përcakton strukturat dhe dispozitat bazë, dhe Traktati i Funkcionimit të BE-së (TFBE).**

Ky seksion jep një vështrim të shkurtër të dispozitave përkatëse të Traktatit të KE-së dhe Direktivave dhe përfundon me një shqyrtim të aspekteve të caktuara të së drejtës së BE-së për barazinë gjinore.

## 2.2.1. LEGJISLACIONI BAZË

### Një retrospektivë dhe një vështrim i dispozitave gjimore në legjislacionin bazë

Në Traktatin që ngrii Komunitetin Ekonomik Europian, të miratuar më 1957, u përfshi vetëm një dispozitë e vetme (**Neni 119 i Traktatit të KEE-së, tani Neni 141 i Traktatit të KE-së**) për të luftuar diskriminimin gjinor, pra, parimi i pagës së barabartë midis burrave dhe grave për punë të barabartë. Sfondi i kësaj dispozite ishte thjesht ekonomik: pra, fakti që Franca kish miratuar dispozita për pagë të barabartë për burrat dhe gratë shumë më herët se sa puna e lirë e femrave në Shtetet e tjera anëtare (ShA) do t'i vinte sipërmarrjet franceze në pozitë të pabarabartë.

**Gjithsesi, Gjykata Europiane e Drejtësisë (GjED) deklaroi se Neni 119 i KEE-së kishte jo vetëm qëllim ekonomik, por edhe social.<sup>11</sup>** Më pas, GjED-ja vendosi se qëllimi ekonomik është dytësor ndaj qëllimit social. Ajo gjithashtu deklaroi se parimi i pagës së barabartë është shprehje e një të drejte njerëzore themelore.<sup>12</sup>

Neni 119 duhet të ish zbatuar përpara janarit 1962, por ShA-të nuk ishin në gjendje, ose nuk donin ta bënin këtë. Kështu që parimi i pagës së barabartë u bë një nga përparësitë e programit social, të rënë dakord nga Shtetet Anëtare më 1974.

Qysh nga 1975 e këtej, kishte çështje që çoheshin në GjED, ku Gjykata ka vendosur se individët mund të mbështeteshin në Nenin 119 të KEE-së (tani Neni 141 i KE-së) përpara gjykatave kombëtare me qëllimin **për të marrë pagë të barabartë për punë të barabartë me vlerë të barabartë, pa asnjë diskriminim për shkaqe seksi.** Ndërsa kjo praktikë ligjore u dha mundësi individëve t'i shpinin çështjet e tyre në gjykatat e vendit, në të njëjtën kohë e bëri të qartë se është e vështirë të veçohet paga nga aspekte të tjera të kushteve të punës.

Bashkë me programin social të 1974, GjED-ja i dha një shtysë të madhe legjislacionit në fushën e trajtimit të barabartë të burrave dhe grave.

Me hyrjen në fuqi të **Traktatit të Amsterdimit në 1999, nxitja e barazisë midis burrave dhe grave në mbarë Komunitetin Europian është bërë një nga detyrat e qenësishme të Komunitetit (Neni 2 i KE-së).**

<sup>11</sup> GjED, 8 prill 1976, Çështja 43/75 Gabrielle Defrenne kundër Société Anonyme Belge de Navigation Aérienne Sabena [1976] ECR, 455 (Defrenne II), në para. 10-12.

<sup>12</sup> GjED, 10 shkurt 2000, Çështja-50/96 Deutsche Telekom AG kundër Lilli Schröder [2000] RgJE-se I-743 (Schröder), në par. 57.

Për më tepër, sipas Nenit 3 (2) të KE-së, Komuniteti do të synojë të eliminojë pabarazitë dhe të nxisë barazinë midis burrave dhe grave në të gjitha veprimtaritë e renditura në Nenin 3 të KE-së. Ky detyrim i përfshirjes së këndvështrimit gjinor do të thotë se, si Komuniteti ashtu edhe SHA-të, duhet të mbajnë mirë parasysh objektivin e barazisë midis burrave dhe grave, sa herë që ato hartojnë dhe zbatojnë ligje, politika dhe veprimtari.

Përveç kësaj, qysh nga 1999, Komuniteti ka pasur kompetencë të ndër marrë veprimet e duhura për të luftuar diskriminimin mbështetur në seks, origjinë racore apo etnike, fe apo besim, paaftësi, dhe moshë apo orientim seksual (Neni 13 (1) i KE-së). **Ky Nen ka siguruar një bazë ligjore për direktivat anti-diskriminim jo të lidhura me gjininë, por edhe për Direktivën për parimin e trajtimit të barabartë midis burrave dhe grave në qasje dhe furnizim me mallra dhe shërbime 2000/113/të KE-së.**

Momenti tjetër i rëndësishëm në zhvillimin e të drejtës së barazisë gjinore në BE, do të jetë miratimi i Kartës së të Drejtave Themelore të BE-së. Kjo Kartë, ndër të tjera, do të ndalojë diskriminimin për çdo lloj shkak, duke përfshirë seksin (Neni 21); ai njeh të drejtën e barazisë gjinore në të gjitha fushat, pra, jo vetëm në punësim, dhe nevojën e veprimeve pozitive për nxitjen e saj (neni 23). Karta garanton gjithashtu “të drejtën e lejes së paguar të lindjes dhe lejen prindërore” (Neni 33). Karta do të hyjë në fuqi me Traktatin e Lisbonës, duke u bërë një katalog detyrues i të drejtave themelore (shih Nenin 6 (1) TBE-së, ndryshuar nga Traktati i Lisbonës.

### **Dispozita bazë e Nenit 141 të Traktatit të KE-së**

Teksti origjinal i Nenit të mëparshëm të Traktatit të KE-së, siç u miratua më 1957, parashikonte që:

- ➔ “1. Çdo Shtet Anëtar duhet të (...) sigurojë dhe më pas të ruajë zbatimin e parimit se burrat dhe gratë duhet të marrin pagë të barabartë për punë të barabartë.
- 2. Për qëllimet e këtij Neni “pagë” do të thotë paga e zakonshme bazë ose minimale, apo rroga dhe çdo lloj shpërblimi tjetër, në para në dorë apo në natyrë, që punëmarrësi e merr drejtpërdrejt apo tërthorazi, në lidhje me punën e tij, nga punëdhënësi.
- Pagë e barabartë pa diskriminim mbështetur në seks do të thotë:
  - a) Se paga për të njëjtën punë me copë do të llogaritet në bazë të së njëjtës njësi matëse;
  - b) Se paga për punë me tarifa kohore do të jetë e njëjtë për të njëjtën punë”.

Në lidhje me marrëdhënien hierarkike midis legjislacionit bazë dhe legjislacionit dytësor, të gjitha ligjet e miratuara nga legjislatorët e BE-së

nuk duhet të bien ndesh me këtë dispozitë. Përveç kësaj, dispozita duhet të interpretohet sipas kuptimit të së drejtës së Komunitetit. GjED-ja është i vetmi institucion për të interpretuar në mënyrë autentike të drejtën e BE-së. Në dritën e juridiksionit të GjED-së, “punëtor” është një person i cili, për një periudhë të caktuar kohe, kryen shërbime për një person tjetër dhe sipas udhëzimeve të tij, në këmbim të të cilave, ai ose ajo merr shpërblim.<sup>13</sup> Koncepti i punëmarrësit nuk përfshin siguruesit e pavarur të shërbimeve, të cilët nuk janë në marrëdhënie vartësie me personin që merr shërbimet. Por, posa një person arrin të konsiderohet punëmarrës në kuptimin e Neni 141 të Traktatit të KE-së, natyra e marrëdhënies së tij apo të saj ligjore nuk vlen më për zbatimin e Neni. Kjo mund të nënkuptojë, ndër të tjera, se, edhe kur një person konsiderohet se është i vetë-punësuar sipas ligjit të vendit, përsëri, edhe në këtë rast, Neni 141 duhet të zbatohet.<sup>14</sup>

Sipas praktikës së zgjeruar ligjore të GjED-së për problemin e “pagës”, paga përfshin jo vetëm pagën bazë, por edhe – për shembull – shtesat e punës jashtë orarit<sup>15</sup>, shpërblimet e veçanta të paguara nga punëdhënësi<sup>16</sup>, lehtësirat e udhëtimit<sup>17</sup>, kompensimin për pjesëmarrje në kurse trajnimi dhe lehtësi trajnimi<sup>18</sup>, pagesat e ndërprerjes së punës në rast heqje nga puna<sup>19</sup> dhe pensionet profesionale<sup>20</sup>.

**Neni 141 i KE-së ndalon jo vetëm diskriminimin e drejtpërdrejt, mbështetur në seks, në fushën e pagës, por edhe diskriminimin e tërthortë.** Diskriminimi i drejtpërdrejt për shkak të seksit ndodh kur një person trajtohet në mënyrë më pak të favorshme për shkak të seksit të tij apo të saj. Diskriminimi i tërthortë i referohet diskriminimit i cili është rezultat i zbatimit të kriterit asnjans ndaj seksit, i cili i ve në pozitë të pafavorshme veçanërisht personat që i përkasin njërit seks krahasuar me personat e seksit tjetër.

<sup>13</sup> GjED, 3 korrik 1986, Çështja 66/86, Deborah Lawrie-Blum v Land Baden-Württemberg, [1986] ECR 2121 (Lawrie-Blum), në par. 17. Kjo çështje kishte të bënte me lëvizjen e lirë të punëtorëve. Megjithatë, tek GjED, 14 dhjetor 1995, Çështja-317/93 Inge Nolte v Landesversicherungsanstalt Hannover [1995] ECR I-04625 (Nolte) dhe ECJ 14 dhjetor 1995, Çështja 444/93 Ursula Megner dhe Hildegard Scheffel v Innungskrankenkasse Vorderpfalz [1995] ECR I-04741 (Megner), GjED-ja e bëri të qartë se i njëjti përkufizim vlen për të gjitha fushat e diskriminimit gjinor.

<sup>14</sup> GjED, 13 janar 2004, Çështja-256/01, Debra Allonby v Accrington & Rossindale College, Education Lecturing Services [2004], ECR I-873 (Allonby), në paragrafët 65-71.

<sup>15</sup> GjED, 6 dhjetor 2007, C-300/06 Ursula Voß v Land Berlin [2007] (Voß), ECR 2007, I-10573.

<sup>16</sup> GjED, 21 tetor 1999, C-333/97 Susanne Lewen v Lothar Denda [1999] (Lewen), ECR 1999, I-7243.

<sup>17</sup> GjED, 9 shkurt 1982, C-12/81 Eileen Garland v British Rail Engineering Limited [1982] (Garland), ECR 1982, I-359.

<sup>18</sup> GjED, 4 qershor 1992, C-360/90 Arbeiterwohlfahrt der Stadt Berlin e.V. v Monika Bötzel [1992] (Bötzel), ECR 1992, I-3589.

<sup>19</sup> GjED, 27 qershor 1990, C-33/89 Maria Kowalska v Freie Hansestadt Hamburg [1990] (Kowalska), ECR 1990, I-2591.

<sup>20</sup> GjED, 13 Maj 1986, 170/84 Bilka Kaufhaus GmbH v Karin Weber von Hartz [1986] (Bilka), RgJE-së 1986, 1607 dhe GjED, 17 maj 1990, C-262/88 Douglas Harvey Barber v Guardian Royal Exchange Group [1990] (Barber), ECR 1990, I-1889.

Me hyrjen në fuqi të Traktatit të Amsterdimit në 1 maj 1999, Neni i deriatëhershëm 119 i KEE-së u rinumërua në Nenin 141 të KE-së. Dy paragrafët e parë mbetën pothuaj të njëjtë; megjithatë dispozita në Nenin 141 (1) tani thotë shprehimisht se:

“Çdo Shtet Anëtar duhet të sigurojë parimin e pagës së barabartë për punëtorë meshkuj dhe femra për punë të barabartë ose punë të barabartë me vlerë të barabartë”.<sup>21</sup>

Për më tej, janë shtuar dy paragrafë të rinj. Sipas Nenin 141 (3) **Këshilli mund të miratojë masa për të siguruar zbatimin e parimit të mundësive të barabarta dhe trajtim të barabartë për burrat dhe gratë në çështje punësimi dhe profesioni, duke përfshirë parimin e pagës së barabartë për punë të barabartë apo për punë me vlerë të barabartë.**

Neni i ri 141 (4) gjithashtu lejon veprime pozitive:

“Me qëllimin për të siguruar barazi të plotë në praktikë midis burrave dhe grave në çështje të punës dhe të punësimit, parimi i trajtimit të barabartë nuk duhet t'i pengojë Shtetet Anëtare të mbajnë apo miratojnë masa që sigurojnë përfitime specifike, me qëllim që ta bëjnë më të lehtë për seksin e nën-përfaqësuar të ndjekë një veprimtari profesionale, të parandalojë apo kompensojë dizavantazhet në karrierë profesionale.”

### 2.2.3. DIREKTIVAT

#### Direktiva 75/117/e KEE-së për pagë të barabartë për burrat dhe gratë<sup>22</sup>

Kjo Direktivë përcakton detyrimet e ShA-ve. ShA-të duhet të heqin dorë nga çdo diskriminim midis burrave dhe grave që buron nga ligjet, të cilët bien ndesh me parimin e pagës së barabartë (Neni 3). ShA-të gjithashtu duhet të marrin të gjitha masat e nevojshme për të siguruar që dispozitat e marrëveshjeve kolektive, hierarkia e pagave, marrëveshjet e pagave dhe kontratat e punësimit individual, të cilat bien ndesh me parimin e pagës së barabartë, të jenë ose të deklarohen të pavlefshme apo të ndryshohen (Neni 4). Gjithashtu, ata duhet të sigurojnë zbatimin e parimit të pagës

21. Shtesa “punë me vlerë të barabartë” vetëm konfirmon atë që është bërë tashme e qartë me rastet ligjore të GjED-së, shih rastin Barber.

22. Direktiva e Këshillit 75/117/e KEE-se, 10 shkurt 1975 për përafrimin e ligjeve të Shteteve Anëtare që kanë të bëjnë me zbatimin e parimit të pagës së barabartë për burrat dhe gratë, Gazeta Zyrtare L 045, 19/02/1975 P. 0019 – 0020. Sikundër është vënë ndërkohë në dukje, kjo e ashtuquajtur Direktivë e Parë e Pagës së Barabartë, kish për qëllim të lehtësonte një zbatim më të efektshëm të parimit të pagës së barabartë.

së barabartë përmes miratimit të ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative (Neni 8). Sipas Nenit 1

“Parimi i pagës së barabartë për burrat dhe gratë i parashtruar në Nenin 119 të Traktatit, që tani e tutje do të quhet “parimi i pagës së barabartë”, do të thotë se, për të njëjtën punë apo për punë, të cilës i jepet një vlerë e barabartë, duhen eliminuar të gjitha format e diskriminimit për shkaqe seksi, në lidhje me të gjitha aspektet dhe kushtet e shpërblimit. Në veçanti, kur përdoret sistemi i klasifikimit të punëve për përcaktimin e pagës, ai duhet të mbështetet në të njëjtat kritere si për burrat ashtu edhe për gratë dhe të hartohet në mënyrë të tillë që të përjashtojë çdo lloj diskriminimi për shkaqe seksi”.

Për më tepër, Direktiva përmban dispozita në lidhje me informacionin që i duhet dhënë punonjësve rreth të drejtave të tyre për trajtim të barabartë (Neni 7) dhe zbatim të të drejtave (Nenet 2 dhe 6) dhe mbrojtjes nga pushimi nga puna prej punëdhënësit (Neni 5).

Sipas Nenit 34 të Direktivës së Ndryshuar<sup>23</sup> që hyn në fuqi duke filluar nga 15 gushti 2009, Direktiva 75/117/e KEE-së u shfuqizua.

### Direktiva 76/207/e KEE-së për trajtimin e barabartë të burrave dhe grave në punësim<sup>24</sup>

**Sipas kësaj Direktive, parimi i trajtimit të barabartë midis burrave dhe grave në punësim zbatohet edhe për punësimin, kualifikimin profesional dhe ngritjen në detyrë, edhe për kushtet e punës, duke përfshirë kushtet në të cilat bëhet pushimi nga puna (Neni 1 (1) dhe 5 (1)).** Direktiva ndalon si diskriminimin e drejtpërdrejtë, ashtu edhe atë të tërthortë. Neni 2 (1) përkufizon parimin e trajtimit të barabartë:

“Për qëllimet e dispozitave të mëposhtme, parimi i trajtimit të barabartë do të thotë se nuk do të ketë asnjë lloj diskriminimi për shkaqe seksi, qoftë drejtpërdrejt qoftë tërthorazi, duke iu referuar në veçanti statusit martesor apo familjar”.

Paragrafët 2 deri 4 të Nenit 2 përmbajnë përjashtime për ndalimin e diskriminimit të drejtpërdrejt për shkak seksi. Një përjashtim ka të bëjë me veprimtari profesionale për të cilat seksi i punëtorit është një

<sup>23</sup> Direktiva 2006/54/e KE-së e Parlamentit Europian dhe e Këshillit të 5 korrikut 2006 për zbatimin e parimit të mundësive të barabarta dhe trajtimin të barabartë të burrave dhe grave në çështjet e punësimit dhe profesionit (riformular), Gazeta Zyrtare L 204, 26/07/2006 P. 0023 – 0036.

<sup>24</sup> Direktiva e Këshillit 76/207/e KEE-së e 9 shkurtit 1976 për zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë të burrave dhe grave në lidhje me qasjen në punësim, trajnimin profesional dhe ngritjen në detyrë, dhe kushtet e punës, OJ L 39, 14.2.1976, f. 40–42.

faktor përcaktues. Kjo ndodh për shembull, kur një aktor në një film duhet të jetë burrë. Neni 2 (2) lexon:

“Kjo Direktivë do të jetë pa paragjykim ndaj të drejtës së Shteteve Anëtarë për të përjashtuar nga fusha e zbatimit të saj ato veprimtari profesionale, dhe, sipas rastit, trajnimin që shpie aty, për të cilat për shkak të natyrës apo kontekstit në të cilin kryhen, seksi i punëtorit përbën një faktor përcaktues”.

GjED-ja vendosi se përjashtimi i veprimtarive profesionale në Nenin 2 (2) duke qenë një pakësim i të drejtës individuale të përcaktuar në Direktivë, duhet të interpretohet në mënyrë të ngurtë.<sup>25</sup>

Përjashtimi i dytë në Direktivë ka të bëjë me mbrojtjen e grave, veçanërisht në lidhje me barrën dhe lejen e lindjes (Neni 2 (3)). Ky përjashtim i lejon dispozitat kombëtare t’u garantojnë grave të drejta specifike për shkak të barrës dhe lejes së lindjes, të tilla si leja e lindjes.

Përjashtimi i fundit lidhet me veprimin pozitiv (Neni 2 (4)):

“Kjo Direktivë do të jetë pa paragjykim ndaj masave që nxisin mundësi të barabarta për burrat dhe gratë, në veçanti duke hequr pabarazitë ekzistuese, të cilat ndikojnë në mundësitë e grave në fusha që përmenden në Nenin 1 (1)”.

Direktiva është ndryshuar në 2002<sup>26</sup> dhe është shkrirë në një tekst të vetëm më 2006, në të ashtuquajturën Direktivë e Ndryshuar<sup>27</sup>. Sipas Nenit 34 të Direktivës së Ndryshuar që ka hyrë në fuqi që nga 15 gushti 2009, Direktiva 76/207/e KEE-së është shfuqizuar.

## Direktiva 79/7/e KEE-së për trajtimin e barabartë të burrave dhe grave në skemat statutorë të sigurisë<sup>28</sup>

Kur miratuan Direktivën 76/207/të KEE-së, SHa-të nuk mundën të binin dakord me trajtimin e barabartë të burrave dhe grave në fushën e sigurimeve shoqërore. Në dhjetor 1978, Direktiva 79/7/e KEE-së u

<sup>25</sup> GJED, 15 maj 1986, Çështja 222/84, Marguerite Johnston v Chief Constable of the Royal Ulster Constabulary [1986] ECR 1651 (Johnston), në par. 36.

<sup>26</sup> Direktiva 2002/73/e KE-së e Parlamentit Europian dhe e Këshillit e 23 shtatorit 2002 që ndryshoi Direktivën e Këshillit 76/207/e KEE-së për zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë për burrat dhe gratë për sa i takon qasjes në punësim, trajnim profesional, dhe ngritje në detyrë, dhe në kushtet e punës. Gazeta Zyrtare L 269, 05/10/2002 P.0015 - 0020.

<sup>27</sup> Direktiva 2006/54/e KE-së e Parlamentit Europian dhe e Këshillit e 5 korrikut 2006 për zbatimin e parimit të mundësive të barabarta dhe trajtimin e barabartë të burrave dhe grave në çështje punësimi dhe profesioni (ndryshuar), Gazeta Zyrtare L 204, 26/07/2006 P.0023 – 0036.

<sup>28</sup> Direktiva e Këshillit 79/7/e KEE-së e 19 dhjetorit 1978 për zbatimin progresiv të parimit të trajtimit të barabartë për burrat dhe gratë në çështje të sigurimeve shoqërore, Gazeta Zyrtare L 006, 10/01/1979 P.0024 – 0025.


miratua. E ashtuquajtura **Direktivë e Tretë për trajtimin e barabartë midis burrave dhe grave mbulon fushën e sigurimeve shoqërore të parashikuara me ligj (statutore).**

**Direktiva ndalon si diskriminimin e drejtpërdrejt ashtu edhe atë të tërthortë, për shkak seksi (Neni 4 (1)).** Personat e mbrojtur janë “popullsia që punon – duke përfshirë persona të vetëpunësuar, punëtorë dhe persona të vetëpunësuar, veprimtaria e të cilëve ndërpritet për shkaqe sëmundjesh, aksidentesh apo papunësi jo me dashjen e tyre dhe persona që kërkojnë punësim – dhe punëtorë të dalë në pension ose të bërë invalidë, si dhe persona të vetëpunësuar” (Neni 2).

Sipas Nenit 3, Direktiva zbatohet për:

“ (a) skemat statutore, të cilat sigurojnë mbrojtje nga rreziqet e mëposhtme:

- sëmundje,
- invaliditet,
- moshë e vjetër,
- aksidente në punë dhe sëmundje profesionale,
- papunësi;

**(b) ndihmë shoqërore,** për aq sa ajo synon të plotësojë apo zëvendësojë skemat që përmenden në (a)”.  


Kjo Direktivë nuk zbatohet për dispozitat në lidhje me përfitimet e të mbijetuarve as për ato që kanë të bëjnë me përfitimet familjare, me përjashtim të rastit të përfitimeve familjare që jepen për të shtuar përfitimet që kërkohen, si pasojë e rreziqeve të sipërpërmendura.

Kjo Direktivë e Tretë përmban një listë të gjatë përjashtimesh. Neni 4 (2) i referohet mbrojtjes së grave për shkaqe lindje. Përjashtime të tjera listohen në Nenin 7. Ato lidhen ndër të tjera me përcaktimin e moshave të ndryshme të daljes në pension për burrat dhe gratë, për pensionet e vjetërsisë dhe të dispozitave të daljes në pension, apo me përfitime të caktuara që lidhen me faktin se personi në fjalë ka rritur fëmijë dhe mund ta ketë ndërprerë punën për atë qëllim.

Në fushën e skemave statutore, disa raste mjaft komplekse të sjella përpara GjED-së rrotulloheshin rreth çështjes nëse një skemë është statutore apo profesionale dhe cilat mund të jenë pasojat në rast se ka një lidhje të ngushtë midis skemës statutore dhe skemës profesionale. Kjo është veçanërisht e rëndësishme, për faktin se disa përjashtime

lejohen sipas Direktivës për Skemën Statutore, por jo sipas Direktivës për Skemat Profesionale.

### Direktiva 86/378/e KEE-së për trajtimin e barabartë të burrave dhe grave në skemat e sigurimeve profesionale<sup>29</sup>

Sipas Nenit 2 të Direktivës “**skema profesionale e sigurimeve shoqërore do të thotë skema që nuk drejtohen nga Direktiva 79/7/e KEE-së**”. Ky nen nuk zbatohet për kontratat individuale.

Kategoritë e personave që mbrohen nga kjo Direktivë janë të njëjta sikundër ato që mbrohen nga Direktiva 79/7/e KEE-së. E njëjta gjë vlen edhe për rreziqet e mbuluara.

Direktiva përmban përjashtime të rëndësishme: detyrimi i mos-diskriminimit nuk zbatohet për pensionet e të mbijetuarve, diferencat në moshën e daljes në pension, dhe përdorimin e faktorëve të ndryshëm aktuarialë të përlllogaritjes. Megjithatë, meqenëse GjED-ja e interpretoi konceptin e pagës në Nenin 141 të KE-së si të tillë që përfshin skemat profesionale të sigurimeve shoqërore, rëndësia e këtyre përjashtimeve, për rrjedhojë, ishte disi e kufizuar.

Sipas Nenit 34 të Direktivës së Ndryshuar, që hyri në fuqi më 15 gusht 2009, Direktiva 86/378/e KEE-së u shfuqizua.

### Direktiva 86/613/e KEE-së për trajtimin e barabartë të burrave dhe grave, të angazhuar me një veprimtari, përfshirë në bujqësi, në cilësinë e të vetë-punësuarve.<sup>30</sup>

Sipas Nenit 1 të Direktivës, qëllimi i kësaj Direktive është të sigurojë, në përputhje me dispozitat e mëposhtme, zbatimin në ShA të **parimit të trajtimit të barabartë si midis burrave dhe grave të angazhuar në një veprimtari në cilësinë e të vetë-punësuarve, ashtu dhe të atyre që kontribuojnë në ndjekjen e një veprimtarie të tillë, për sa i takon atyre aspekteve që nuk mbulohen nga Direktivat 76/207/e KEE-së dhe 79/7/e KEE-së.**

Neni pasues 2 i kësaj Direktive mbulon punëtorët e vetëpunësuar, që do të thotë, të gjithë personat që ndjekin një veprimtari fitimprurëse për

<sup>29</sup> Direktiva e Këshillit 86/378/e KEE-së e 24 korrikut 1986 për zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë për burrat dhe gratë në skemat profesionale të sigurimeve shoqërore, OJ L 225, 12.8.1986, f. 40–42.

<sup>30</sup> Direktiva e Këshillit 86/613/e KEE-së e 11 dhjetorit 1986 për zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë midis burrave dhe grave të angazhuar në një veprimtari, përfshirë bujqësinë, në cilësinë e të vetëpunësuarve, dhe për mbrojtjen e grave të vetëpunësuarra gjatë barrës dhe lehonisë, Gazeta Zyrtare L 359, 19/12/1986 P. 0056 – 0058.

Ilogari të vet, sipas kushteve të përcaktuara nga ligji i vendit, duke përfshirë fermerë dhe anëtarë të profesioneve shoqërore, dhe bashkëshortët e tyre, duke mos qenë të punësuar apo partnerë.

Megjithatë, në përgjithësi, kjo Direktivë deri tani ka luajtur vetëm një rol të vogël në praktikë për shkak të faktit se detyrimet që përmban janë disi të papërcaktuara.

## Direktiva e Punëtoreve Shtatzëna 92/85/e KEE-së <sup>31</sup>

**Direktiva përcakton nivelet minimale të të drejtave të lindjes, duke përfshirë lejen dhe pagën,** të cilat SHA-të duhet t'i sigurojnë për punëtoret shtatzëna dhe punëtoret që kanë pak kohë që kanë lindur apo që kanë fëmijë në gji. Qëllimi kryesor i saj është të zbatojë masa për të nxitur përmirësime në sigurinë dhe shëndetin në punë të këtyre personave.

Neni 8 parashikon që SHA-të duhet të marrin të gjitha masat e nevojshme për të siguruar që punëtorët sipas kuptimit të Nenit 2 të kenë të drejtë për një periudhë të vazhdueshme **leje lindje prej të paktën 14 javësh**. Gjatë kësaj periudhe, të drejtat e tyre të punësimit duhet të sigurohen; në veçanti, ata kanë të drejtë të kthehen në të njëjtën apo në një punë ekuivalente, me kushte pune jo më pak të favorshme.

Për më tepër, **gratë shtatzëna gëzojnë mbrojtje shëndetësore dhe mbrojtjen e sigurisë;** ato nuk mund të detyrohen të kryejnë punë nate, dhe **janë të mbrojtura ndaj largimit nga puna** qysh nga fillimi i barrës deri në fund të lejes së lindjes (Neni 10).

Komisioni Europian botoi propozimin për të ndryshuar Direktivën e Grave Shtatzëna në tetor 2008.<sup>32</sup> Qëllimi i Komisionit është të kontribuojë për një jetë të baraspeshuar, midis jetës dhe punës, nëpërmes përmirësimit të mbrojtjeve që u ofrohen grave shtatzëna dhe punëmarrëseve që kanë pak kohë që kanë lindur apo që kanë fëmijë në gji.

31. Direktiva e Këshillit 92/85/e KEE-së e 19 tetorit 1992, për futjen e masave për nxitjen e përmirësimeve në sigurinë dhe shëndetin në punë të punëtoreve shtatzëna dhe punëtoreve që kanë pak kohë që kanë lindur, apo që kanë fëmijë në gji (Direktiva e dhjetë e veçantë, sipas kuptimit të Nenit 16 (1) të Direktivës 89/391/të KEE-së), OJ L 348, 28.11.1992, f. 1–8.

32. COM (2008) Propozimi final 637 për një Direktivë të Parlamentit Europian dhe të Këshillit, e cila ndryshon Direktivën e Këshillit 92/85/të KEE-së për futjen e masave për nxitjen e përmirësimeve në sigurinë dhe shëndetin në punë të grave shtatzëna dhe punëtoreve, që kanë pak kohë që kanë lindur, apo që ushqejnë fëmijë në gji.

## Direktiva e Lejes Prindërore 96/34/e KE-së<sup>33</sup>

**Pajtimi i jetës familjare/private është, sipas GjED-së, “rrjedhojë e natyrshme e barazisë gjinore”** dhe një mjet për arritjen e barazisë gjinore jo vetëm me ligj por edhe në realitetin e jetës së përditshme.<sup>34</sup> Si pasojë, ndonëse nuk është miratuar si një direktivë e posaçme e barazisë gjinore, Direktiva e Lejes Prindërore 96/34/e KE-së luan një rol të rëndësishëm në trajtimin e barazisë gjinore.

**Direktiva parashikon që çdo prind, qoftë nga lindja apo birësimi, ka të drejtë për leje lindje pa pagesë deri në tre muaj, për t’u kujdesur për një fëmijë deri në moshën tetë vjeç. Kjo e drejtë është e dallueshme nga leja e lindjes.** E drejta është e patransferueshme kështu që secili prej të dy prindërve ka një periudhë të veçantë prej tre muajsh, të cilën ata nuk mund ta mbledhin apo ta këmbejnë me njeri tjetrin.

## Direktiva e Barrës së Provës 97/80/e KE-së<sup>35</sup>

Direktiva zbatohet për:

- 1** situata që mbulohen nga Neni 141 (ish-Neni 119) i Traktatit të KE-së dhe nga Direktivat 75/117/të KEE-së (parimi i pagës së barabarte), 76/207/i KEE-së (qasje në punësim, trajnim profesional dhe ngritje në detyrë) dhe, për aq sa i takon diskriminimit mbështetur në seks, 92/85/e KEE-së (mbrojtja e grave shtatzëna dhe atyre që kanë lindur kohët e fundit ose që ushqejnë fëmijë me gji) dhe 96/34/të KE-së (leje prindërore).
- 2** Çdo procedurë civile apo administrative që ka të bëjë me sektorin publik apo privat, me përjashtim të procedurave jashtë-gjyqësore.

Direktiva nuk zbatohet për procedurat penale, kur nuk parashikohet ndryshe nga ShA-të.

ShA-të to marrin masa të tilla sipas nevojës në përputhje me sistemet e tyre kombëtare gjyqësore për të siguruar që, në rastet kur ankimeset të parashtrajnë, përpara një gjykata apo një autoriteti tjetër kompetent, fakte prej të cilave mund të prezumohet se ekziston diskriminim, **i takon të paditurit të provojë se nuk ka pasur ndonjë shkelje të parimit**

<sup>33</sup> Direktiva e Këshillit 96/34/e KE-së e 3 qershorit 1996, për marrëveshjen kuadër për lejen prindërore të përfunduar nga UNICEF, CEEP dhe ETUC, OJ L 145, 19.6.1996, f. 4–9.

<sup>34</sup> GjED, 17 qershor 1998, Çështja-243/95, Hill dhe Stapleton v Komisionerëve të të Ardhurave dhe Departamentit të Financës [1998] ECR I-3739 (Hill).

<sup>35</sup> Direktiva e Këshillit 97/80/e KE-së e 15 dhjetorit 1997 për barrën e provës në çështje diskriminimi, mbështetur në seks, OJ L 14, 20.1.1998, f. 6–8.

të **barazisë**. Shtetet Anëtare nuk pengohen që të përfshijnë rregulla dëshmuese, të cilat janë më të favorshme për paditësin.

Masat e marra nga Shtetet Anëtare në përputhje me Direktivën, së bashku me dispozitat që janë ndërkohë në fuqi, duhet të sillen në vëmendjen e të gjithë personave në fjalë.

### Direktiva 2004/113/e KE-së për trajtimin e barabartë të burrave dhe grave në qasjen dhe furnizimin e mallrave dhe shërbimeve<sup>36</sup>

Në 2004, gama e zbatimit të trajtimit të barabartë u zgjerua me miratimin e Direktivës 2004/113/të KE-së, duke zbatuar parimin e trajtimit të barabartë midis burrave dhe grave në qasjen dhe furnizim me mallra dhe shërbime. **Kjo është direktiva e parë që trajton çështje të barazisë gjinore jashtë fushës së punësimit.** Parashtrësia e kësaj Direktive pranon se diskriminimi i mbështetur në seks, duke përfshirë ngacmimin dhe ngacmimin seksual, ndodh gjithashtu edhe në fusha jashtë tregut të punës dhe mund të jetë njëloj dëmtes, duke vepruar si pengesë për integrimin e suksesshëm të burrave dhe grave në jetën ekonomike dhe sociale.

Sipas Nenit 3 (1), Direktiva zbatohet për të gjithë personat që ofrojnë mallra dhe shërbime, të cilat janë në dispozicion të publikut, pavarësisht personit në fjalë, si në sektorin publik ashtu edhe privat, duke përfshirë dhe organet publike, dhe të cilat ofrohen jashtë fushës së jetës private dhe familjare, dhe për transaksionet e kryera në këtë kontekst. Direktiva nuk zbatohet për përmbajtjen e medias dhe reklamave apo të arsimit (Neni 3 (3)).

Parimi i trajtimit të barabartë do të thotë se nuk duhet të ketë diskriminim të drejtpërdrejt apo të tërthortë, mbështetur në seks, duke përfshirë edhe trajtimin më pak të favorshëm të grave për shkaqe barre dhe lindje. Dispozita më të favorshme për mbrojtjen e grave për sa i përket barrës dhe lindjes nuk bien ndesh me parimin e trajtimit të barabartë. Direktiva më tej ndalon ngacmimin dhe ngacmimin seksual dhe udhëzimet për diskriminim (Neni 4). Veprimi pozitiv lejohet sipas Nenit 6 të Direktivës.

<sup>36</sup> Direktiva e Këshillit 2004/113/e KE-së e 13 dhjetorit 2004, e cila zbaton parimin e trajtimit të barabartë midis burrave dhe grave në qasje dhe furnizim me mallra dhe shërbime, Official Journal L 373, 21/12/2004 P. 0037 – 0043.

Megjithatë, Direktiva lejon përjashtime të ndryshme të parimit të trajtimit të barabartë, edhe në raste të diskriminimit të drejtpërdrejt për shkak të seksit. Neni 4 (5) parashikon që Direktiva nuk duhet të përjashtojë dallime në trajtim, kur ofrimi i mallrave apo shërbimeve ekskluzivisht nga njeri seks përligjet nga një qëllim i ligjshëm, dhe kur mjetet e arritjes së qëllimit janë të përshtatshme dhe të nevojshme. Në këtë mënyrë, direktiva nuk ka një sistem të mbyllur në rast diskriminimi të drejtpërdrejt sikundër kanë direktivat e tjera të barazisë së sekseve, kështu që si rrjedhojë, ofron më pak mbrojtje ndaj diskriminimit të drejtpërdrejtë për shkak seksi.

Direktiva po ashtu përmban dispozita të posaçme në lidhje me faktorët aktuarialë në kontratat e sigurimeve. Kontratat e sigurimeve shpesh ofrohen me kushte të ndryshme për burrat dhe gratë, si në lidhje me primet ashtu dhe me përfitimet, sidomos, në skemat private të pensioneve. Këto dallime mbështeten në faktin se, mesatarisht, gratë jetojnë më gjatë se burrat dhe shoqëritë e sigurimeve si pasojë kanë një rrezik më të madh financiar në sigurimin e grave, krahasuar me sigurimin e burrave. Si rrjedhojë, Neni 5 (1) parashikon:

“Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë që në të gjitha kontratat e reja të sigurimeve, të nënshkruara të paktën që pas 21 dhjetorit 2007, përdorimi i seksit si një faktor në përlllogaritjen e primeve dhe përfitimeve për qëllimet e sigurimit dhe shërbimet financiare që lidhen me to, nuk duhet të rezultojnë në dallime në primet dhe përfitimet e individëve”.

Gjithsesi, ShA-të kanë mundësi të shmangen nga kjo dispozitë (Neni 5 (2)). Por, sido që të jetë, kostot që lidhen me barrën dhe lindjen mund të mos rezultojnë në dallime në prime dhe përfitime individuale (Neni 5 (3)).

### Direktiva e Riformuluar 2006/54/e KE-së <sup>37</sup>

Në 2006, u miratua Direktiva e re 2006/54/e KE-së, e cila bashkon dispozitat ekzistuese të direktivave të ndryshme të barazisë së sekseve, duke përfshirë edhe disa raste nga praktika gjyqësore të eGjED-së.

**Qëllimi i kësaj Direktive është të sqarojë dhe bashkojë në një tekst të vetëm dispozitat për punësimin, duke përfshirë ngritjen në detyrë dhe trajnimin profesional, si edhe kushtet e punës, bashkë me pagën dhe skemat profesionale të sigurimeve shoqërore. Ajo shfuqizon kështu Direktivat 75/117/të KEE-së, 76/207/të KEE-së,**

<sup>37</sup> Direktiva e 2006/54/e KE-së e Parlamentit Europian dhe e Këshillit e 5 korrikut, për zbatimin e parimit të mundësive të barabarta për burrat dhe gratë në çështje të punësimit dhe profesionit (e ribërë), Official Journal L 204, 26/07/2006 P. 0023 – 0036.

86/378/të KEE-së dhe 97/80/të KE-së. Pothuaj të gjitha nenet e Direktivës së Riformuluar u korrespondojnë neneve ekzistues në njëërën apo më shumë prej direktivave të sipër përmendura.

Direktiva e Riformuluar ndahet në katër tituj.

**1** Titulli i parë përfshin dispozitat e përgjithshme dhe bën një përshkrim të qëllimit të Direktivës dhe përkufizimet e koncepteve të ndryshme si, diskriminimi i drejtpërdrejt dhe i tërthortë, ngacmimi dhe ngacmimi seksual.

**2** Titulli i dytë përfshin dispozita për pagë të barabartë dhe për trajtim të barabartë në lidhje me qasje në punësim, trajnim profesional dhe ngritje në detyrë dhe në kushtet e punës.

**3** Në titullin e tretë, bashkohen dispozitat për dënimet, barrën e provës, viktimizimin, nxitjen e trajtimit të barabartë nëpërmes organeve të barazisë, dialogut shoqëror dhe dialogut me OJQ. Ky titull gjithashtu përfshin dispozita të përgjithshme, për shembull, për parandalimin e diskriminimit, përfshirjen e këndvështrimit gjinor dhe përhapjen e informacionit.

**4** Titulli i katërt përmban dispozitat e fundit (shfuqizimi i direktivave të tjera dhe hyrja në fuqi) dhe përcakton detyrimet raportuese si edhe afatet kohore për zbatim nga ShA-të.

## 2.2.4. LIDHJA E TË DREJTËS SË BE-SË PËR BARAZINË GJINORE ME SHQIPËRINË

**Kriteret e Kopenhagenit kërkojnë që vendet që aspirojnë anëtarësim në BE të kenë institucione që, ndër të tjera, garantojnë demokracinë, shtetin ligjor, të drejtat e njeriut, respektin dhe mbrojtjen e pakicave.<sup>38</sup>**

Meqenëse e drejta e BE-së dhe praktikat ligjore të GjED-së vendosin standarde dhe mbrojtje në fusha të politikave shoqërore, të ndihmës ekonomike, të arsimit dhe të gjinisë, ato vendosin qëllime të rëndësishme për vendet që punojnë për të plotësuar standardet e hyrjes në Bashkimin Europian.

<sup>38</sup> Acquis communautaire është trupi i të drejtës dhe politikave të BE-së, i cili përbën Legjislacionin Bazë, legjislacionin dytësor (si Direktiva, rregullore, etj), vendimet, deklaratat dhe juridiksionin e GjED-së. Aspektet e barazisë gjinore të acquis communautaire janë paraqitur në kapitujt e të drejtës së BE-së dhe juridiksionin e GjED-së.

Në çështjen *Costa kundër Enel* dhe *Van Gend en Loos kundër Nederlandse Administratie der Belastingen* vendimet e Gjykatës Europiane të Drejtësisë shpallën *përparësinë e të drejtës së Bashkimit Europian* ndaj ligjit të vendit, duke përfshirë kushtetutën kombëtare, dhe ua deleguan përgjegjësinë për zbatimin e të drejtës së Bashkimit Europian gjykatave kombëtare. Në këtë mënyrë, GjED-ja vendosi Doktrinën e Efektit të Drejtpërdrejtë të të Drejtës së Bashkimit Europian dhe i fuqizoi gjykatat kombëtare, duke përfshirë edhe gjykatat kushtetuese kombëtare, që të zbatonin dhe bënë të detyrueshëm të drejtën e Bashkimit Europian. Autorët kanë argumentuar se nëpërmes këtyre doktrinave dhe një aktivizimi të ngjashëm gjyqësor, GjED-ja ka shpënë përpara integrimin, edhe kur përpjekjet për integrim janë ndalur në nivele të tjera.

Këto doktrina gjithashtu janë pasuruar nga aftësia e GjED-së për të çuar përpara integrimin dhe respektimin nga qeveritë e të drejtave themelore, të drejta që janë të rëndësishme për përparimin e të drejtave të njeriut dhe demokracisë. Shqyrtimi i kategorive të së drejtës së GjED-së, tregon gamën e ndikimit të gjykatës në të drejtat bazë njerëzore dhe demokratike: kulturë, shtetësi, arsim, çështje penale, politike sociale, sa për të përmendur disa syresh. Prandaj, sa më shumë që gjykatat e vendit të ndjekin GjED-në, aq më shumë do të mishërohen të drejtat e njeriut dhe demokracia në traditën ligjore të vendeve të veçanta.

Është thënë se ligji është edhe instrument edhe objekt ndryshimi. Ligji është objekt ndryshimi sepse vendet që hyjnë në BE duhet të kryejnë tranzicionin nga një sistem ligjor socialist, ku ligji dhe shteti janë një i vetëm, në një sistem ku shteti respekton rregullat e përcaktuara në ligje. Nga ana tjetër, ligji është instrumenti i ndryshimit, sepse ndryshimi duhet të udhëhiqet dhe të mbahet brenda kufijve të të drejtave dhe detyrimeve që përmban ligji.

Në Shqipëri, në të ardhmen, legjislacioni do të jetë pjesërisht vetëm zbatim i të drejtës së BE-së – ndër të tjera, i Direktiva të sipërpërmendura të Barazisë Gjinore – ose të paktën do të synojë të mos bjerë ndesh me parimet e të drejtës së BE-së. Gjyqësorit do t'i duhet – siç ndodh normalisht në ShA-të – t'i zbatojë këto akte ligjore në përputhje me interpretimin e GjED-së. Nga një këndvështrim ligjor, kjo nuk është e detyrueshme. Por, gjykatat në vendet aspirantë për BE, bëjnë mirë të ndjekin parimet e parashikuara në të drejtën e BE-së dhe të GjED-së, sepse integrimi europian është një qëllim i përbashkët për vendin, të cilin edhe partnerët e qeverisë e kanë përcaktuar si përparësi të vendit. Vendet që presin të hyjnë në BE, duhet të tregojnë gatishmërinë e tyre për të hyrë në Bashkimin Europian dhe të thellojnë integrimin e vendit, duke ndjekur precedentët e GjED-së.

## 2.3. LEGJISLACIONI SHQIPTAR

Objektivi i këtij kapitulli është të japë një ide të përgjithshme të ligjeve më të rëndësishme kombëtare që lidhen me barazinë gjinore në Shqipëri. Kështu, paraqitja fillon me Kushtetutën<sup>39</sup> e Republikës së Shqipërisë dhe disa nga nenet e saj, dhe më pas me rolin dhe vendin e Konventave të ratifikuara në kuadrin ligjor shqiptar, si edhe me legjislacionin përkatës shqiptar që ka të bëjë me barazinë gjinore. Në përgjithësi, mund të thuhet, se legjislacioni është në përputhje me CEDAW-n dhe standarde të tjera ndërkombëtare.

Një nga shqetësimet kryesore në Shqipëri, sot, duket se është hendeku midis barazisë de jure dhe de facto në lidhje me punësimin, qasjen në biznes dhe shërbimet e kredisë, shëndetësisë dhe ato sociale. Kështu që ndërsa është e mundur të padisësh një institucion për diskriminim, këto tre drejta ekzistojnë de jure sepse çështje të tilla aktualisht nuk çohen në gjykatat e vendit.

### 2.3.1. KUSHTETUTA

Kushtetuta është ligji më i lartë i cili mishëron politikat dhe vlerat më të thella të Shtetit shqiptar. **Neni 3 i Kushtetutës thotë se: “Të drejtat dhe liritë e njeriut janë baza e këtij Shteti, i cili ka për detyrë t’i respektojë dhe mbrojtë ato”.** Parimi i barazisë dhe mos-diskriminimit gjendet në Nenin 18, i cili thotë se:

- 1 Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit.
- 2 Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si *gjinia*, raca, feja, etniciteti, gjuha, besimet politike fetare apo filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale apo përkatësie prindërore.
- 3 Askush nuk mund të diskriminohet për shkaqe të përmendura në paragrafin 2, në rast se nuk ekzistojnë shkaqe ligjore të arsyeshme dhe objektive”.

Neni 18/2 ka parashikuar “masa veprimi pozitiv”, kur ka shkaqe të arsyeshme dhe objektive për këtë. Një diskriminim i tillë mund të diktohet për shkak të faktorëve të ndryshëm që mbizotërojnë në realitetin njerëzor. Ka disa faktorë ekonomikë, shoqërorë dhe kulturorë që e pengojnë barazinë të bëhet barazi absolute.

<sup>39</sup> Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë ( Ligji 8417/ 21.10 1998.

Një listë të drejtash dhe lirish themelore të njeriut është përfshirë në Pjesën e dytë të Kushtetutës shqiptare. Kjo pjesë është e ndarë në katër kapituj:

- ➔ Kapitulli i parë trajton parimet e përgjithshme të të drejtave dhe lirive themelore, të tilla si pandashmëria, patjetërsueshmëria dhe padhunueshmëria. Dispozitat e këtij kapitulli qëndrojnë në themel të të gjithë rendit juridik dhe janë të vlefshme edhe për të huajt, edhe për personat pa shtetësi;
- ➔ Kapitulli i dytë përmban garanci kushtetuese dhe mbrojtje për të drejtat dhe liritë personale;
- ➔ Kapitulli i tretë përmban të drejtat dhe liritë politike dhe
- ➔ Kapitulli i katërt përqendrohet në të drejtat dhe liritë ekonomike, shoqërore dhe kulturore.

Kushtetuta shqiptare, *përgjithësisht*, nuk e përfshin kategorinë e gjinisë në fjalorin e saj. Përemrat e përmendur përgjithësisht janë: të gjithë, askush; gjithkush, çdo person, gjithkush, etj. Megjithatë, në Nenin 54/1 përmendet kategoria e gjinisë: “1. Fëmijët, të rinjtë, gratë shtatzëna, dhe nënat e reja kanë të drejtën e një mbrojtje të veçantë nga shteti”. Kështu, në këtë nen, vetë Kushtetuta ka shpallur mbrojtjen e veçantë nga shteti për fëmijët, të rinjtë, gratë shtatzëna dhe nënat e reja.

### 2.3.2. KONVENTAT

Shqipëria ka ratifikuar një numër të konsiderueshëm instrumentesh ndërkombëtare në lidhje me mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Sipas Nenit 5 të KSh, Republika e Shqipërisë zbaton të drejtën ndërkombëtare të detyrueshme për të<sup>40</sup>. Neni vijues 116/1 i KSh-së thotë se marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara kanë përparësi ndaj ligjeve të vendit, si ligjet dhe aktet normative të Këshillit të Ministrave: “Çdo marrëveshje ndërkombëtare, që është ratifikuar, ka epërsi ndaj ligjeve të vendit që nuk pajtohen me të” (Neni 122/2 i KSh-së). **Marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara përbëjnë pjesë të sistemit të brendshëm juridik pasi botohen në Fletoren Zyrtare.** Ato janë të zbatueshme në mënyrë të drejtpërdrejtë me përjashtim të rasteve kur këto norma nuk janë të vetë-zbatueshme dhe kur zbatimi i tyre kërkon nxjerrjen e një ligji tjetër. Për sa i përket legjislacionit shqiptar, një ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit të tij në Fletoren Zyrtare.

<sup>40</sup> “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë” (KSh) Ligji nr. 8417/21.10.1998.

Shqipëria është palë në pjesën më të madhe të konventave përkatëse ndërkombëtare dhe instrumenteve rajonale të të drejtave të njeriut. Kjo do të thotë se Shqipëria është e detyruar të zbatojë standarde ndërkombëtare dhe rregulla për mbrojtjen e të drejtave njerëzore/të grave. Kuadri ligjor që mbështet barazinë gjinore, veprimet kundër dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje përfshin, midis të tjerash<sup>41</sup>, ratifikimin e Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut<sup>42</sup> dhe Protokollet e saj<sup>43</sup>, CEDAW<sup>44</sup> si edhe Protokollin e saj Shtesë<sup>45</sup>. *Shqipëria pranoi Marrëveshjen e Stabilizimit dhe Asociimit me BE-në* në qershor 2006, që është një hap i suksesshëm drejt arritjes së qëllimit të saj për t'u bërë një ShA i BE-së. Që nga dhjetori 2006, është në fuqi një Marrëveshje e Përkohshme<sup>46</sup>.

Barazia gjinore është një e drejtë themelore dhe një vlerë e përbashkët e vendeve të BE-së. Me synimin e integritimit eventual në BE, barazia gjinore është një kusht i domosdoshëm për hyrjen e Shqipërisë në të dhe kërkohet për plotësimin e objektivave të MSA-së për punësimin dhe kohezionin social, të cilat janë pjesë e *acquis communautaire*.

Qeveria, duke ratifikuar instrumentet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, është e detyruar të raportojë periodikisht për ligjin e vendit<sup>47</sup> dhe praktikatat që lidhen me instrumente të tilla.

Teksti zyrtar i CEDAW-t u botua për herë të parë në botimin Nr. 33 (i konsideruar ekstra – për aktet e pabotuara) të Fletores Zyrtare në 15 tetor 2008. Si pasojë, tani CEDAW është zyrtarisht pjesë e sistemit juridik të vendit. Shqipëria ka miratuar raportin e parë dhe të dytë periodik në kuadër të CEDAW-t<sup>48</sup>, si edhe ka miratuar raportin e 3-të periodik kombëtar në kontekst të CEDAW-t<sup>49</sup>, që do të shqyrtohet nga Komiteti i CEDAW-t në sesionin e tij të 46<sup>te</sup> në korrik 2010.

Vendet që e kanë ratifikuar apo kanë hyrë në Konventë janë ligjërisht të detyruara që dispozitat e kësaj konvente t'i vënë në praktikë dhe të shkojnë përtej barazisë “de jure” dhe të sigurojnë barazi rezultatesh – barazi që ndihet nga gruaja dhe burri i zakonshëm.

Është me shumë rëndësi që të gjithë qytetarët, dhe në veçanti, juristët, avokatët, prokurorët, gjykatësit dhe punonjësit publikë t'i njohin instrumentet ndërkombëtare. Megjithatë, vetëm njohja e tyre nuk është e mjaftueshme në rast se ata nuk i zbatojnë këto instrumente gjatë kryerjes së punës së tyre. Në këtë kuadër, është me dobi të përmendim disa nga mënyrat se si duhet përdorur CEDAW:

<sup>41</sup> “Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të diskriminimit racor”, miratuar me Ligjin Nr. 7768/9.11.1993; “Konventa Ndërkombëtare për të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore” miratuar me Ligjin Nr.7510, date 8.8.1991; “Konventa ndërkombëtare për të drejtat Civile dhe Politike” miratuar me Ligjin 7510, date 8.8. 1991; Konventa e ONP (ILO Convention) përkatësisht me Nr.105; 111;138; 81; 135;142; 181.

<sup>42</sup> Ligji nr.8137/31.7.1996

<sup>43</sup> Protokollin nr. 1; 2; 4; 6; 5; 11;7 i KEDNj miratuar kjo e fundit me Ligjin nr.8137/31.7.1996

<sup>44</sup> Shqipëria i është përmbajtur Konventës CEDAW miratuar me Ligjin Nr. 7767/9.11.1993

<sup>45</sup> Shqipëria i është përmbajtur Protokollit Shtesë të CEDAW-t (miratuar me Ligjin nr.9052/17.4.2003)

<sup>46</sup> [http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key\\_documents/2007/nov/albania\\_accession\\_partnership\\_en.pdf](http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2007/nov/albania_accession_partnership_en.pdf)

<sup>47</sup> Për të gjetur raportet shkoni në: [www.un.org/womenwatch/dawcedaw/reports.htm](http://www.un.org/womenwatch/dawcedaw/reports.htm).

<sup>48</sup> Raporti për Shqipërinë daton në 23 maj 2002 dhe konsiderohet një raport i kombinuar i parë dhe i dytë – Nr. reference. CEDAW/C/ALB/1-2 dhe u shqyrtua nga Komiteti i CEDAW-t në sesionin e tij të 28të në janar 2003 )

<sup>49</sup> Vendim i Këshillit të Ministrave (VKM) 1082/23.7.2008

- ➔ **Zbatim i drejtpërdrejtë i dispozitave të vetë-zbatueshme të CEDAW-t.** Kjo do të thotë se rregullat e CEDAW-t janë rregullat kryesore, që duhen ndjekur gjatë gjykimit të çështjeve gjyqësore. Zbatimi i drejtpërdrejtë i CEDAW-t bën të mundur të hidhet poshtë një ligj kombëtar i një rendi më të ulët (shih Nenin 122/2 të KSh-së);
- ➔ **Interpretimi i ligjeve shqiptare në dritën e standardeve të CEDAW-t;**
- ➔ **Referimi tek CEDAW me qëllim që të mbështetet një zgjidhje e bazuar në të drejtën e vendit.** Një çështje zgjidhet vetëm në bazë të së drejtës së vendit, duke iu referuar edhe CEDAW-t për të theksuar natyrën themelore të parimit apo të drejtës, të njohur ndërkohë edhe nga e drejta e vendit.
- ➔ **Standardet e CEDAW-t janë të rëndësishme për përcaktimin nga një gjykatës të një parimi** (shih natyrën e vendimeve Unifikuese të Gjykatës së Lartë si vendime të Kolegjeve të Bashkuara) mbështetur tek CEDAW. Ka një opsion dhe praktikë, e cila është gati duke u kristalizuar, në lidhje me rëndësinë e precedentit juridik si burim drejtësie, edhe në vende që zbatojnë të drejtën kontinentale (sisteme të mbyllura apo të kodifikuara).

### 2.3.3. LIGJET

Të gjitha aktet normative në Shqipëri duhet të përputhen me dispozitat kushtetuese, në veçanti, me parimet e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Pas miratimit të Kushtetutës, u bë një rishikim i plotë i kuadrit legjislativ me qëllim për ta bërë të gjithë kuadrin ligjor shqiptar në përputhje me Kushtetutën. Një përparësi tjetër e degëve legjislative dhe ekzekutive të pushtetit ishte shoshitja e të gjitha ligjeve të reja dhe amendamenteve të ligjeve ekzistuese në dritën e standardeve ndërkombëtare dhe evropiane. Në këtë punë shumë të madhe dhe të rëndësishme, Shqipëria është mbështetur fuqimisht nga partnerët, organizatat dhe ekspertët ndërkombëtarë.

Ligji “Për barazinë gjinore në shoqëri”<sup>50</sup> (LBGj) luan një rol të posaçëm në këtë drejtim:

- ➔ Ky ligj rregullon çështjet themelore të problemeve të barazisë gjinore, duke kërkuar trajtimin e barabartë të grave dhe burrave dhe mundësi dhe shanse të barabarta në ushtrimin e të drejtave në të gjitha fushat e jetës shoqërore<sup>51</sup>.

<sup>50</sup> Ligji Nr. 9970, 28/7/2008

<sup>51</sup> Struktura e Ligjit: Pjesa I: Dispozita të Përgjithshme; Pjesa II: Organet përgjegjëse për barazinë gjinore dhe mbrojtja dhe trajtimin e barabartë gjinor në marrëdhëniet e punës, arsim dhe trajnim, në media; Pjesa VII Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve dhe Sanksionet.

- ➔ LBGj-ja e përkufizon “barazinë gjinore” si pjesëmarrje e barabartë e femrave dhe meshkujve në të gjitha fushat e jetës, si pozitë e barabartë midis grave dhe burrave, mundësi dhe shanse të barabarta për të gëzuar të drejta dhe për të plotësuar detyrime në shoqëri dhe pasur përfitime të barabarta nga arritjet dhe zhvillimet e tyre.
- ➔ Ligi e përkufizon “diskriminimin me bazë gjininë” (Neni 4/3) si dallime, përjashtime, apo kufizime mbështetur në gjininë, të cilat synojnë apo rezultojnë në dëmtim, mos-njohje, mos-gëzim dhe mos-ushtrim në mënyrë të barabartë, nga të dy gjinitë, të të drejtave njerëzore dhe lirive themelore në fushat politike, ekonomike, sociale, kulturore, dhe civile, sikundër janë parashikuar në Kushtetutë dhe në legjislacion.
- ➔ Edhe pse ky ligj përputhet me ligje të tjera, si Kodi i Punës, Kodi Zgjedhor, Ligji për Arsimin e lartë, etj., ai nuk i rregullon këto fusha me hollësi. Si i tillë, LBGj-ja përcakton vetëm standardet e barazisë gjinore.
- ➔ Ai i plotëson këto ligje, të cilat përmbajnë procedurat për arritjen e standardit (d.m.th. dispozitat e Kodit Zgjedhor duhet të zbatohen si plotësuese të LBGj-së në lidhje me kuotat). Si rrjedhojë, LBGj-ja duhet të zbatohet së bashku me ligjet e tjera. Ai nuk i përjashton aktet e ligjeve plotësuese.

Në Kodin e Procedurave Administrative<sup>52</sup> mos-diskriminimi është një prej parimeve themelore. Ky kod përcakton se organet e administratës publike duhet të udhëhiqen nga parimi i barazisë. Askush nuk duhet të diskriminohet për shkak të seksit, racës, etnisë, bindjeve filozofike apo fetare, gjendjes ekonomike, arsimore apo prindërore (Neni 11). Aktet administrative, të cilat me qëllim mbrojtjen e interesave publikë apo të drejtave të të tjerëve, i kufizojnë të drejtat themelore të individëve sikurse parashikohen nga Kushtetuta, marrëveshjet ndërkombëtare, ligjet, duhet që në çdo rast të respektojnë parimin e proporcionalitetit dhe nuk duhet të shkelin thelbin e të drejtave dhe lirive.

Kodi i Punës<sup>53</sup> e ndalon diskriminimin në fushën e punësimit dhe ushtrimit të profesioneve. Neni 16 i LBGj-së kërkon që punëdhënësit të marrin masa për të siguruar mos-diskriminimin dhe shanse të barabarta për punësim për burrat dhe gratë në të gjitha pozicionet dhe sektorët. **Shkelja e parimit të barazisë është e dënueshme me një gjobë prej pesëdhjetë pagash mujore.**

<sup>52</sup> Kodi i Procedurave Administrative, Ligji Nr.8485/12.5.1999

<sup>53</sup> “Kodi i Punës”, Ligji Nr. 7961/12.7.1995, ndryshuar.

Kodi i Punës e përkufizon diskriminimin si dallim, përjashtim apo preferencë mbështetur në seks, që shkel të drejtën e individit për qasje të barabartë në punësim dhe trajtim si edhe rastet kur dallime, përjashtime apo preferenca të tilla mund të mos konsiderohen diskriminim. Dallimet, përjashtimet apo preferencat e kërkuara për një punë të caktuar mund të mos konsiderohen diskriminim. Masat e mbrojtjes së posaçme për punëdhënësit në këtë Kod, me një Vendim të Këshillit të Ministrave (VKM) apo me kontrata kolektive, nuk duhet të konsiderohen si diskriminim.

Kodi i Punës mishëron ndër të tjera parimet e mëposhtme të rëndësishme të barazisë në punë dhe në marrëdhëniet e punësimit:

- ➔ *Barazi në shpërblim* (Neni 115): “I njëjti shpërblim si për gra edhe për burra që kryejnë një punë me vlerë të barabartë”;
- ➔ *Ndalim të punës së detyruar*, për të gjithë, pa përjashtim;
- ➔ *Mbrojtje dhe parandalim i shkeljes së personalitetit dhe dinjitetit të punëmarrësve*, duke përfshirë parandalimin e ngacmimit seksual (Neni 32) si një detyrim të punëdhënësve. Kodi i Punës përcakton si ngacmim seksual çdo lloj ngacmimi që ndikon në mënyrë të ndjeshme në gjendjen psikologjike të punëmarrësit për shkak të seksit. Akte të tilla janë të dënueshme me gjoba deri në tridhjetë herë pagën minimale mujore të ngacmuesit.
- ➔ Me synimin për të mbrojtur punësimin e grave, Kodi i Punës (Neni 105a) *ndalon testet e barrës përpara punësimit*, kur këto i kërkon punëdhënësi, me përjashtim të rasteve kur puna është e tillë që mund të ketë ndikim negativ në barrë, ose që mund të dëmtojë jetën e nënës dhe/ ose të fëmijës. Neni 16, pika 3 e LBGj-së përcakton se punëdhënësit duhet t’i punësojnë individët pa dallim gjinie në një post apo post vakant, në të gjitha nivelet e hierarkisë profesionale.
- ➔ Në përputhje me Nenin 30, punëdhënësi duhet të provojë në rastet e *zgjdhjes së kontratës së punës* se shkak i largimit nga puna “Nuk ka qenë shtatzania apo lindja e një fëmije”.
- ➔ *Gjatë marrëdhënieve të punës, punëdhënësi* nuk duhet të mbledhë informata që lidhen me punëmarrësin, si informacione për orientimin seksual, gjendjen martesore apo familjare, gjendjen e shtatzanisë, dhe të tjera (Neni 33), me përjashtim të atyre rasteve kur këto informata kanë të bëjnë me aftësinë profesionale të punëmarrësve apo kur kjo është e nevojshme për zbatimin e kontratës. Në një rast të tillë, dënimi ka të bëjë me një gjobë deri në tridhjetë herë sa paga minimale mujore.

Kapitulli 10/B i Kodit të Punës, që titullohet “Mbrojtja e Veçantë për Gratë”, përmban masat ligjore që marrin parasysh rolin e posaçëm të gruas-nënë në shoqëri. Ia vlen të përmendet: ndalimi i punës së rrezikshme për gratë shtatzëna dhe nënat e reja (Neni 104); leja e lindjes (Neni 105 i Kodit të Punës dhe Ligji Nr. 7703/11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore”); leja e adoptimeve (Neni 106 i Kodit të Punës dhe Ligji Nr. 7703/11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore”); pavlefshmëria e zgjidhjes së kontratës nga punëdhënësi në periudhën e lejes së lindjes apo lejes së adoptimit (Neni 107); ndalimi i punës së natës për gratë shtatzëna (Neni 108)<sup>54</sup>; etj.

**Fryma afirmative mund të shihet në pjesë të tjera të Kodit të Punës:** E drejta e grave shtatzëna për pushime 20 minutëshe të paguara çdo tre orë; ndalimi i mbajtjes së peshave mbi 20 kg për gratë<sup>55</sup>; e drejta e lejes së paguar (12 deri në 15 ditë në vit) për t’u kujdesur për fëmijët në ngarkim si një e drejtë jo-diskriminuese e nënës dhe babait të fëmijës (Neni 132); etj.

Ligji për “Nxitjen e Punësimit” 7995, datë 20.9.1995 (i ndryshuar), synon të nxisë punësimin dhe kualifikimin profesional nëpërmes politikave dhe mbështetjes për punësim të plotë, produktiv dhe të zgjedhur lirisht. Ligji parashikon arritjen e objektivave nëpërmes programeve dhe projekteve aktive të tregut të punës; formimin profesional; rikualifikimin profesional dhe forma të tjera të mbështetjes së njerëzve me paaftësi, dhe një sistem mbështetje të ndihmës ekonomike për të papunët. Ndryshimet e bëra në ligjin “Për nxitjen e punësimit” në vitin 2006 me Ligjin Nr. 9547/01.06.2006, e harmonizuan këtë me standardet e Konventës 168 (1988) të ONP e cila është ratifikuar me ligjin Nr.9547, datë 1.6.2006 “Për ratifikimin e Konventës Nr. 168 të ONP-së për nxitjen e punësimin dhe parandalimin e papunësisë”. Neni 2 përfshin si punëkërkues të veçantë; nënat me shumë fëmijë, personat mbi 50 vjeç, të rinjtë nën 18 vjeç, të papunët afatgjatë, personat që vijnë nga familje nën kufirin e varfërisë, viktimat e trafikut, persona që përfitojnë nga programet e ndihmës ekonomike, persona që dalin të papunë për shkak të reformave, ristrukturimit dhe privatizimit të fabrikave dhe institucioneve, vajzat-nëna të papuna, femrat që kanë zgjidhur martesën dhe me probleme sociale, persona që kthehen nga emigracioni me probleme ekonomike, persona të porsa diplomuar që janë të paorientuar në tregun e punës, persona që janë liruar nga burgu, persona me paaftësi, Romët, jetimët që e kanë

<sup>54</sup> Puna e natës për gratë shtatzëna është e ndaluar. Por Këshilli i Ministrave ka parashikuar rastet kur puna e natës lejohet për gratë, në përgjithësi.

<sup>55</sup> Në rastin e punës së vështirë, Këshilli i Ministrave përcakton rregulla të veçanta për kohëzgjatjen dhe kushtet e punës së rëndë apo të rrezikshme për të miturit nën 16 vjeç dhe për gratë shtatzëna. Shih VKM Nr.207, datë 9.5.2002 “Për përcaktimin e punëve të rënda dhe të rrezikshme”.

fituar këtë status<sup>56</sup>. Në nenet në vijim, të këtij ligji, theksohet përparësia që i duhet dhënë kategorisë “grup i veçantë” kur plotësohen vendet e lira të punës nga zyra e punësimit.

Kodi i Familjes<sup>57</sup> i jep përparësi parimit të barazisë morale dhe ligjore të bashkëshortëve (Neni 1) dhe për herë të parë parashikon se bashkëshortja e dhunuar mund të kërkojë largimin e bashkëshortit dhunues nga shtëpia bashkëshortore nëpërmjet një urdhri të gjykatës (Neni 62) për një kohë deri në tre vjet.

Kodi i Familjes rregullon lidhjen e martesës, duke parashikuar kushte dhe ndalime të njëjta si për gratë edhe për burrat<sup>58</sup>, për pavlefshmërinë dhe mbarimin e martesës dhe pasojat e saj, të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga martesa, marrëdhëniet personale dhe të pasurore midis bashkëshortëve, çështjet e amësisë dhe atësisë, birësimit, kujdestarisë dhe të tjerat. Nga një analizë e përgjithshme e dispozitave të Kodit të Familjes, mund të konstatohet lehtësisht se në të gjitha dimensionet e tij, ai thekson parimet e reciprocitetit në të drejta dhe detyrime; barazinë e bashkëshortëve në lidhje me njeri tjetrin, fëmijët, martesën dhe familjen; mos-diskriminimin për shkaqe të qenit burrë ose grua. Neni 50 i Kodit të Familjes shprehimisht përcakton se “me martesë, burri dhe gruaja përftojnë të njëjtat të drejta dhe marrin përsipër të njëjtat detyrime”. Statusi martesor u jep bashkëshortëve disa të drejta dhe detyrime me karakter **personal/jo pasuror** si detyrimi dhe e drejta për **besnikëri**; detyrimi dhe e drejta për mbështetje morale, ajo e mbiemrit, mbiemrit për fëmijët e tyre, detyrimin dhe të drejtën për një jetë të përbashkët, shtetësi, përfaqësim dhe të tjera.

Midis të drejtave-detyrimeve me karakter **pasuror**, mund të përmendim: Detyrimin për ndihmë materiale; kontributet e bashkëshortëve për të plotësuar detyrimet që rrjedhin nga martesa e tyre (sasia e kontributeve të tyre mund të përcaktohet në kontratë nëse kemi një regjim pasuror me kontratë, ose në mungesë të kontratës sasia e kontributeve të tyre varet nga kushtet dhe mundësitë e bashkëshortëve).

Por, ka disa përjashtime nga parimet e barazisë dhe reciprocitetit në **Kodin e Familjes**. Kështu, kur bashkëshortët nuk arrijnë të bien dakord për mbiemrin e fëmijës/fëmijëve të tyre, atëherë sipas Neni 52 të Kodit të Familjes, fëmija/fëmijët duhet të mbajnë mbiemrin e të atit. Sipas Neni 54 të Kodit të Familjes, bashkëshortët”...do të kontribuojnë për nevojat e familjes në përputhje me kushtet dhe mundësitë e tyre”. Kjo do të thotë se kur ata nuk i kanë kushtet dhe mundësitë, kontributet e tyre po ashtu do të jenë të pabarabartë. Nëna e mitur e një fëmije të lindur jashtë martese ka të drejtë të kërkojë njohje zyrtare të fëmijës së saj nëpërmjet një vendimi gjykatë. Kjo e drejtë nuk i është njohur atit të mitur (nën 18 vjeç). Në rastin konkret kjo e drejtë më shumë

<sup>56</sup> Në bazë dhe për zbatimin e Ligjit Nr. 7995/20.9.1995 “Për nxitjen e punësimit”, Këshilli i Ministrave nxori Vendimin (VKM) Nr. 632/18.9.2003 “Për programin e nxitjes së punësimit të grave që kërkojnë punë”. Punëdhënësit që punësojnë gra dhe, në veçanti, gra nga kategori të tilla si Romët, gra më të mëdha se 35 vjeçe, gra të divorcuara me probleme sociale, gra të dhunuara dhe gra me paaftësi, do të mbështeten financiarisht nga shteti. Një dispozitë tjetër e rëndësishme është Urdhri Nr. 394/23.02.2004 i Ministrisë të Punës dhe Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, “Për tarifën e Sistemit të Trajnimit Profesional”. Ky urdhër përcakton tarifën e regjistrimit të cilat për kategoritë e mëposhtme: pjesëmarrës nga komuniteti Rom, gra dhe vajza të trafikuar, gra të dhunuara dhe të tjera, do të jetë falas për kurse të kualifikimit profesional, të ofruara nga Qendra Publike e Trajnimit Profesional, me synim trajnimin dhe rritjen e kapaciteteve profesionale të grupeve të synuara, duke krijuar mundësi më të mëdha për të plotësimitin e kërkesave bashkëkohore të tregut aktual të punës.

<sup>57</sup> Kodi i Familjes, Ligji Nr. 9062/ 8.5.2003

<sup>58</sup> Vetëm gruaja dhe burri që kanë mbushur moshën 18 vjeç mund të lidhin martesë. Në këtë mënyrë, Kodi i Familjes ka unifikuar moshën e martesës e cila ka qenë e ndryshme në legjislacionin e mëparshëm (femra 16, përkundrejt mashkullit 18).

se është një e drejtë për nënën e mitur, i dedikohet fëmijës dhe mbrojtjes së interesit të tij. Në procesin e lindjes së një fëmije jashtë martesë nëna është gruaja që e lind fëmijën (përfshijë rastin e teknikave mjekësore të asistuar të cilat jo gjithnjë përputhen me sa më sipër) ndërsa për atin nuk ekziston as prezumimi si në rastin e martesës.

Me qëllimin për të garantuar plotësimin e të drejtave dhe detyrimeve që rrjedhin nga martesë, Kodi i Familjes ka parashikuar masa mbrojtëse. Si rrjedhojë, Kodi i Familjes ka parashikuar (Nenet 58-64) ndërhyrjen e një autoriteti publik (gjykatës) kur njeri prej bashkëshortëve nuk është i gatshëm të plotësojë lirisht detyrimet e veta. Në raste të tilla<sup>59</sup>, Gjykata ndërhyr me kërkesën e bashkëshortit tjetër. Sipas ligjit, parashikohen disa masa urgjente<sup>60</sup>. Këto masa, duke pasur një karakter urgjent, nuk mund të vendosen për një periudhë më të gjatë se tre vjet.

Në përputhje me Nenin 253 të **Kodit Penal**<sup>61</sup> shkelja e barazisë së qytetarëve për shkaqe seksi është e dënueshme me ligj. Kur punonjësit e shtetit apo punonjësit civilë, gjatë ushtrimit të detyrave të tyre zyrtare, mbajnë qëndrime të ndryshme, që rezultojnë në privilegje të padrejta apo refuzim të një të drejte apo përfitimi që rrjedh nga ligji, ata do të dënohen me gjoba apo burgim deri në pesë vjet.

Ligji “Për statusin e nëpunësit civil”<sup>62</sup> përcakton **rregulla** të barabarta në lidhje me kushtet dhe procedurat e punësimit në shërbimin civil, fillimin dhe mbarimin e marrëdhënieve të punës, zhvillimin e karrierave, garantimin e të drejtave, dhe përcaktimin e detyrimeve të nëpunësve civilë me synimin për të përcaktuar një shërbim civil të qëndrueshëm, profesional dhe të efektshëm. Ky ligj nuk përmban ndonjë dispozitë në lidhje me diskriminimin, por ai nënvizon kërkesat për futjen në shërbimin civil, ndërsa **punësimet konkrete bëhen nëpërmes konkurrencës së hapur të mbështetur në meritë**.

Neni 3/3 i **Kodit Zgjedhor**<sup>63</sup> përcakton se “**çdo qytetar shqiptar, që ka arritur moshën 18 vjeç, qoftë dhe në ditën e zgjedhjeve, pavarësisht nga raca, etnia, gjinia, gjuha, pikëpamjet politike, gjendja fetare apo**

<sup>59</sup> Çështje të tilla janë: autorizimi nga gjykata i njërit prej bashkëshortëve për të ndërmarrë veprime ligjore në interes të familjes, kur bashkëshorti tjetër e kundërshton një akt të tillë, ose kur ai ose ajo nuk është në gjendje ta bëjë këtë (Neni 58); përfaqësimi i njërit bashkëshort nga bashkëshorti tjetër, kur i pari nuk është në gjendje të shprehë vullnetin e vet (Neni 59); plotësimi nga njëri bashkëshort i nevojave urgjente të familjes si mbajtja e familjes, arsimimi i fëmijëve, mbrojtja e interesit të familjes, dhe zgjidhja e situatave të tjera me karakter urgjent (Neni 60); rastet kur njeri nga bashkëshortët duket qartë se nuk i plotëson detyrimet e veta dhe rrezikon interesat e familjes, etj.

<sup>60</sup> Disa nga këto masa janë: “Sekuestrimi e të mirave të bashkëshortit të larguar në masën e duhur” (Neni 56/2); “Autorizimi nga gjykata për të kryer një veprim juridik, për të cilin nevojitet miratimi i bashkëshortit tjetër”. (Neni 58); “Autorizimi nga gjykata për të përfaqësuar bashkëshortin tjetër në akte ligjore, që lidhen me regjimin pasuror martesor” (59); “Largimi nga shtëpia i bashkëshortit dhunues” (62).

<sup>61</sup> Kodi Penal, Ligji Nr. 7895, i 27.1.1995 (ndryshuar)

<sup>62</sup> Ligji “Për statusin e nëpunësit civilë” (8579/11.11.1999) (ndryshuar)

<sup>63</sup> Kodi Zgjedhor, Ligji Nr. 10 019/29.12.2008.

ekonomike, **ka të drejtë të zgjedhë dhe të zgjidhet** në përputhje me rregullat e parashikuara në këtë Kod”. Në përputhje me LBGj-në, Kodi Zgjedhor ka përfshirë aspektin e **kuotave prej 30%** (që gjendet në LBGj) në listat vendore dhe kombëtare të partive, si edhe në disa organe të caktuara administrative që mbikëqyrin zgjedhjet (pra - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) dhe Komisionet e Administrimit të Zonave Zgjedhore (KZAZ)). Sipas Nenit 15 të LBGj-së, *partia politike do të paguajë një gjobë prej deri në 1/10 të fondeve shtetërore të dhëna për fushatën zgjedhore, deri sa të ndreqet shkelja.*

Radha e renditjes (ose një renditje formale që pengon përdorim e kuotave në fund të listës) është e qenësishme që një kuotë ose masë e posaçme të jetë e efektshme.

Konkretisht, Kodi Zgjedhor shqiptar (Ligji Nr. 10019/29.12.2008) deklaron se: “Për çdo zonë zgjedhore, të paktën tridhjetë për qind e listës shumë-emërore dhe ose një prej tri emrave të parë duhet të jetë prej secilës gjini. Për sa i përket Kodit Zgjedhor, mosrespektimi i një prej kushteve që lidhen me përbërjen e listave shumë-emërore mund të shpjerë në refuzim të listës nga KQZ-ja (Neni 67 i Kodit Zgjedhor).

Për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore, “një në çdo tre emra në listë duhet të jetë nga secila gjini.” (Neni 67/5/6). Për organet lokale, rregulli i përcaktuar në Kodin Zgjedhor përfshin: *“Për zgjedhjet e organeve të pushtetit vendor, një në tri emra të listës duhet të jetë nga secila gjini”*. Sanksioni për mospërmblidhjen e këtij detyrimi të vendosur nga Kodi Zgjedhor është gjobë prej 30,000 Lekë shqiptare për çdo zonë zgjedhore, në ngarkim të subjektit zgjedhor (Neni 175).

Gjoha është e njëjtë si për partitë e mëdha ashtu edhe ato të vogla. Kjo masë merret nga KQZ-ja. Në lidhje me organet që administrojnë zgjedhjet, Kodi Zgjedhor parashikon këtë në lidhje me KQZ-në: “Kuvendi i Shqipërisë zgjedh anëtarët e KQZ-së në përputhje me këtë procedurë: a) dy anëtarë propozohen nga partia që ka numrin më të madh të vendeve nga partitë e shumicës parlamentare, dhe dy anëtarë nga partia e opozitës parlamentare, e cila ka numrin më të madh të vendeve në Kuvendin e Shqipërisë).....Subjektet propozues të germës (a) zgjedhin një kandidat nga secila gjini” (Neni 14/(a)/(b)). Në lidhje me KZAZ-në: (d) “30% e anëtarëve të propozuar përkatësisht nga partia më e madhe e shumicës dhe nga partia më e madhe e opozitës në shkallë vendi, duhet të jenë nga secila gjini”. (Neni 29/(d)).

Në lidhje me të drejtën e arsimit ka një numër ligjesh si: Ligji “Për Arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë” (9741/21.5.2007, i ndryshuar); “Për Arsimin para universitar” (7952/21.6.1995, i ndryshuar); “Për arsimin dhe trajnimin profesional në Republikën e Shqipërisë” (8872/29.3.2002),

etj. Nenet 24-25 të LBGj-së përqendrohen tek çështjet e trajtimit dhe mbrojtjes së barabartë ndaj diskriminimit gjinor në arsim dhe në media. Ligji ndalon diskriminimin për shkaqe gjinie ndaj personave nga, apo në institucione arsimore në të gjitha nivelet, publike apo private, përmes ndalimit shprehimisht të rasteve që përbëjnë diskriminim. Sipas këtij ligji, rastet e mëposhtme përbëjnë diskriminim: Vendosja e normave kufizuese mbështetur në dallimet gjinore dhe kur nuk krijohen mjediset e nevojshme arsimore në institucionet shtetërore apo private, të cilat ofrojnë arsimim apo shërbime të tjera trajnuese apo kualifikuese; sigurimi i mundësive të ndryshme, të pajustificuara objektivisht, për burrat dhe gratë, për zgjedhjen e një fushe të caktuar studimi, trajnimi dhe diplomimi dhe për kohëzgjatjen e studimeve.

Të drejta të barabarta për **kujdes shëndetësor** sigurohen me ligje të tilla si ai “Për shëndetin riprodhues”<sup>64</sup>, “Për ndërprerjen e shtatzënisë”<sup>65</sup>, “Për sigurimin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”<sup>66</sup>, etj.

Ligji “Për Shëndetin Riprodhues” parashikon se: **asnjë grua nuk mund të detyrohet të mbetet shtatzënë; dhe se gruaja ka të drejtë për një lindje të sigurt dhe për mënjanimin e shtatzënisë së padëshiruar, e cila mund t’i rrezikojë shëndetin.** Jeta e saj nuk duhet të ekspozohet ndaj asnjë rreziku të shoqëruar me shtatzëninë, lindjen dhe pengesa të tjera që lidhen me pabarazinë gjinore; çdo grua ka të drejtë për mbrojtjen e shëndetit gjatë barrës, ndihmë në lindje dhe përfitime nga metoda dhe praktika që minimizojnë rrezikun ndaj shëndetit të saj apo shëndetit të fetusit, të porsalindurit, dhe fëmijës. Nëna dhe fëmija kanë të drejtë për kujdes shëndetësor dhe mbështetje të posaçme. Gratë shtatzëna përfitojnë *pa pagesë* një periudhë ndjekje të shtatzënisë, pas lindjes, dhe në veçanti, ekzaminimin e detyruar para dhe pas lindjes; gratë shtatzëna kanë të drejtë të bëjnë të gjitha ekzaminimet e detyruar që i këshillon mjeku pa pagesë dhe të marrin broshura personale të ndjekjes së barrës pa pagesë. Ligji mbron të drejtat riprodhuese të çdo individi dhe të çiftit dhe siguron që të drejtat e çdo individi të mbrohen në përputhje me ligjet dhe politikat e vendit dhe standardet ndërkombëtare. Shpesh ky ligj trajton gratë në veçanti, *si një entitet i posaçëm në këtë kontekst*. Kështu, çdo grua, e lirë dhe e përjashtuar nga çdo lloj forme diskriminimi, detyrimi dhe dhune, ka të drejtë të kontrollojë dhe vendosë lirisht për të gjitha çështjet që lidhen me seksualitetin dhe shëndetin riprodhues të saj.

*Ligji thekson parimin e barazisë midis burrave dhe grave.* Ai nënvizon respektin e ndërsjellë midis burrave dhe grave në marrëdhënie seksuale dhe riprodhim. Kjo nënkupton respektimin e integritetit të dy partnerëve, garantimin e të drejtave riprodhuese të të dy individëve në vendimmarrje

<sup>64</sup> Ligji Nr. 8876/04.04.2002 “Për shëndetin riprodhues”

<sup>65</sup> Ligji Nr. 8045/7.12.1995 “Për ndërprerjen e shtatzënisë”

<sup>66</sup> Ligji Nr. 7870/13.10.1994 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”

për riprodhim, mbështetur në dëshirat e tyre, pa asnjë diskriminim, shtypje apo dhunë. Edhe burri edhe gruaja kanë të drejtë të ruajnë qelizat e tyre seksuale. Ligji i kushton vëmendje të veçantë mbrojtjes së amësisë së sigurt dhe trajton teknikat e riprodhimit mjekësor të asistuar.

Ligji “Për ndërprerjen e shtatzënisë” garanton respektimin e çdo qenie njerëzore që nga lindja dhe të drejtën e shërbimeve të informimit dhe këshillimit për gratë para ndërprerjes së shtatzënisë. Më tej, ai përmban rregulla dhe procedura për ndërprerjen e shtatzënisë dhe sigurimin e shërbimit shëndetësor për ndërprerjen e shtatzënisë dhe trajtimin e çdo komplikimi të mundshëm pas abortit. Ndërprerja e shtatzënisë sipas këtij ligji lejohet – me pëlqimin e gruas –vetëm në kushte specifike:

- ➔ Kur shëndeti i gruas dhe/ose shëndeti i fëmijës është në rrezik, si edhe për arsye sociale.
- ➔ Ndërprerja e shtatzënisë për shkaqe mjekësore lejohet deri në javën e 22-të të shtatzënisë, me kusht që një komision prej tre mjekësh pas vizitës dhe konsultimeve vendos se vazhdimi i shtatzënisë dhe, ose lindja e foshnjës vë në rrezik jetën apo shëndetin e nënës. Në rastet kur gruaja e kupton se shtatzënia i shkakton asaj probleme psiko-sociale, ndërprerja e vullnetshme e shtatzënisë lejohet deri në javën e 12-të.
- ➔ Ndërprerja e shtatzënisë për shkaqe shoqërore lejohet deri në javën e 22-të, me kusht që një komision prej tre specialistësh, i përbërë nga mjekë, punonjës socialë dhe ekspertë ligjorë, pas ekzaminimit dhe konsultimeve, të vlerësojë se shtatzënia është pasojë e përdhunimit apo e ndonjë krimi tjetër seksual, si edhe në raste kur verifikohen shkaqe të tjera shoqërore.

Ministri i Shëndetësisë nxjerr udhëzimin për trajtimin e këtyre rasteve, si edhe për përbërjen e komisionit. Kur komisioni përcakton se fetusi ka keq-formime të papajtueshme me jetën, apo sëmundje të tjera që e bëjnë atë të paaftë, për të cilat trajtimi është i pasigurt, ai vendon ndërprerjen e shtatzënisë në çdo kohë. Ligji në këtë rast parashikon vetëm të drejtën e grave për të vendosur për ndërprerjen e shtatzënisë, si subjekti kryesor dhe i vetëm.

Ligji “Për parandalimin dhe kontrollin e HIV/AIDS” (9952/14.7.2008) përcakton kuptimin e diskriminimit në këto situata. Sipas këtij ligji “‘diskriminimi’ është një akt tjetërsimi, izolimi, keqtrajtimi, turpi, paragjykimi, apo kufizimi i të drejtave të një personi tjetër për shkak të dijes, apo dyshimit se personi është infektuar me HIV, apo ka marrëdhënie të ngushta me një person të infektuar me HIV apo të dyshuar me HIV”. Neni 12 i ligjit thekson të drejtën e të gjithë personave të kenë qasje në informacion, edukim dhe komunikim për parandalimin dhe kontrollin

e HIV/AIDS dhe përparësinë që u jepet grave shtatzëna dhe të rinjve. Me qëllim që të parandalojë dhe kontrollojë transmetimin nga nëna tek fëmija, ligji përcakton detyrën e institucioneve shëndetësore për të dhënë këshillime dhe bërë teste të HIV për gratë shtatzëna, me pëlqimin e tyre dhe mbështetur në informimin e tyre. Institucionet shëndetësore janë të detyruara të marrin të gjitha masat e nevojshme për parandalimin e transmetimit të infeksionit me HIV nga nëna tek fëmija. Gratë shtatzëna me HIV kanë përparësi në qasjen në informacion për të parandaluar transmetimin e këtij virusi nga nëna tek fëmija.

Legjislacioni shqiptar nuk bën dallim midis *grave në zonat rurale* dhe *grave në zonat urbane*. Por mbështetur në rolin që luan CEDAW, mund të themi se çdo individ apo autoritet mund të kërkojë zbatimin e drejtpërdrejtë të normave të CEDAW-t me qëllimin e mbrojtjes së të drejtave të një kategorie të tillë.

Disa nga parimet themelore në bazë të të cilave vepron skema e *ndihmës dhe shërbimeve shoqërore* deri tek Ligji “Për Ndihmën dhe Shërbimet Shoqërore” Nr. 9355/10.03.2005 janë: Respektimi dhe garantimi i vlerave personale dhe personalitetit të individit; barazia e shanseve; mos-diskriminimi (Neni 3). Përfituesit e shërbimeve shoqërore janë: fëmijët, të rinjtë deri në moshën 25 vjeç, të moshuarit, të paaftët, gratë, vajzat në nevojë dhe të gjithë ata që janë në rrezik të futjes në një grup në nevojë. Shërbimet shoqërore do t’i jepen çdo individ në nevojë, pavarësisht gjinisë, origjinës etnike, fesë, moshës, paaftësisë, apo faktorëve të tjerë. Çdo person në nevojë ka të drejtë të marrë të njëjtën ndihmë apo shërbime si edhe qytetarët e tjerë, me qëllim që ata ta jetojnë jetën e tyre me dinjitet si edhe qytetarët e tjerë. Diskriminimi që lidhet me përfitimet nga këto shërbime do të parandalohet dhe luftohet.

*Sistemi i sigurimeve shoqërore* në Shqipëri është ngritur në 1993 me ligjin Nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”. Sistemi i pensioneve është i mbështetur në modelin PAYGO, model, i cili mbështetet në parimin e kontributeve. Sistemi ka elementë solidariteti të tilla si: midis brezave dhe midis gjinive. Përfitimet e skemës së sigurimeve shoqërore përcaktohen me ligj: moshë e vjetërsisë, përfitimi i të mbijetuarit dhe i lejes së lindjes.

*Përfitimet e vjetërsisë*: Skema parashikon tre lloje pensionesh: a) pension vjetërsie, b) pension paaftësie, c) pension për të mbijetuarin. Kushtet e kualifikimit për pension vjetërsie janë: të kesh arritur moshën e daljes në pension, siç e parashikon ligji, të kesh plotësuar periudhën e sigurimeve (numrin e viteve të sigurimeve) të kërkuara me ligj. Një person ka të drejtë të marrë pension të plotë vjetërsie pasi ai ose ajo: kanë arritur moshën e pensionit (60 vjeç për gratë dhe 65 për burrat) dhe kanë plotësuar 35 vjet sigurime. Në kuadër të reformës së moshës së pensionit dhe për të amortizuar pasojat e saj, u fut në zbatim e drejta për pension të reduktuar para arritjes së moshës së pensionit; në këtë rast, pensioni i plotë reduktohet me 0.6% për çdo muaj pensioni përpara moshës së ligjshme të pensionit. Një person ka të drejtë të marrë pension të reduktuar vjetërsie pasi ai /ajo ka plotësuar moshën e pensionit prej jo më pak

se: 57 për gratë dhe 62 për burrat, dhe një periudhë sigurimesh jo më pak se 35 vjet. Pensioni i reduktuar është pjesë e pensionit të plotë dhe mbetet i tillë gjatë gjithë periudhës së përfitimit. Një person ka të drejtë për pension të pjesshëm vjetërsie pasi ai/ajo ka plotësuar: minimumi 15 vjet vite sigurim pensioni; një person i siguruar me më pak se 35 dhe më shumë se 15 vjet sigurime, do të ketë të drejtë të marrë pension të pjesshëm vjetërsie kur ai/ajo arrin moshën e pensionit. Ky pension përlogaritet si pjesë e pensionit të plotë.

Kushtet për *përfitim mbijetese* janë: Personi i vdekur duhet t'i ketë plotësuar kushtet e të drejtës për pension vjetërsie/paafhtësie; personat që varen nga ai/ajo do të kenë të drejtë për pension mbijetese, që është pjesë e pensionit që do të kish të drejtë të merrte personi i vdekur:

- 50% për të venë/burrë ose grua, kur ai/ajo ka një fëmijë jo më të madh se 8 vjeç ose ai/ajo nuk është në gjendje të punojë apo është 50/60 vjeç
- 25% për një jetim, kur ai/ajo është më pak se 18 apo 25 vjeç, në rast se ndjek studime universitare.

Sipas Nenit 40 të ligjit, një e ve ka të drejtë të marrë përfitim mbijetese kur ajo: -është në moshën 50 vjeç; apo është një person i paafte fizikisht; apo kur ajo kujdeset deri në tetë vjet për një fëmijë të personit të vdekur në ngarkim të saj.

Sipas Nenit 27 të ligjit, *përfitimi i lindjes* do t'i paguhet një gruaje në lidhje me barrën dhe lindjen, me kusht që ajo të ketë përfutuar 12 muaj sigurimesh shoqërore për secilën lindje. Periudha e përfitimit është 365 ditë kalendarike, duke përfshirë minimumin 35 ditë para dhe 42 ditë pas lindjes. Për gruan që gjatë shtatzënisë do të ketë më shumë se një fëmijë, periudha e përfitimit është 390 ditë kalendarike, duke përfshirë minimumin 60 ditë para dhe 42 ditë pas lindjes së fëmijës. Shkalla e përfitimit të lindjes për gratë e siguruar është: 80% e mesatares ditore në bazë të vlerësimit vjetor të vitit të fundit – për periudhën para lindjes dhe për 150 ditë kalendarike, - pas lindjes; 50% të mesatares ditore të bazës së vlerësimit vjetor të vitit të fundit kalendarik për pjesën tjetër të periudhës. Masa e përfitimit të lindjes për gratë ekonomikisht aktive është e barabartë me shkallën fikse bazë të pensionit të vjetërsisë.

Kur një fëmijë deri në një vjeç birësohet, nëna birësuese, që ka jo më pak se 12 muaj sigurime, do të ketë një përfitim lindje duke filluar nga dita që është bërë birësimi, por jo më parë ditës së 42-të të lindjes, por me kusht që maksimumi të jetë deri në 330 ditë që nga lindja e fëmijës. Periudha minimale e përfitimit, për nënën birësuese, do të jetë 28 ditë. Kur një fëmijë birësohet gjatë lejes së lindjes, nëna e vërtetë do të ketë një periudhë përfitimi deri në ditën që ndodh birësimi, por jo më pak se 42 ditë pas lindjes së fëmijës.

Përfitimi i pagesës së lindjes do të jepet për të paguar humbjen e pagës së një personi të siguruar, e cila duhet të ndryshojë punë për shkak shtatzënie, në përputhje me një vendim të Komisionit të Ekspertizës Mjekësore, me kusht që të jenë paguar një vit kontribute, përpara

lindjes së të drejtës për përfitim. Masa e një përfitimi të tillë është e barabartë me dallimin midis pagave të mëparshme dhe të tanishme, me kusht që të jetë 50% e mesatares ditore të bazës së vlerësimit vjetor të vitit të fundit kalendarik.

Ligji “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” Nr.9669/18.12.2006 i cili ka hyrë në fuqi në qershor 2007, përbën një nga iniciativat më të suksesshme për përafrimin e legjislacionit shqiptar me standarde ndërkombëtare në fushën e legjislacionit për dhunën në familje. **Ky ligj është pjesë e qenësishme e kuadrit mos-diskriminues të legjislacionit shqiptar, të hartuar në vazhden e akteve të detyrueshme ndërkombëtare si CEDAW, apo akte të tjera të miratuara nga Këshilli i Evropës dhe Bashkimi Europian.** Ky ligj përcakton autoritetet publike që kanë për detyrë përgjegjësi të caktuara ligjore për trajtimin e rasteve të dhunës në familje si edhe për t’i pajisur viktimat me mjete të tjera civile për trajtimin e dhunës në familje.

Ky ligj mund të përdoret paralelisht me ligje të tjera si Kodi Penal dhe Kodi i Procedurave Penale, Kodi i Familjes, Kodi Civil, etj. Ligji për herë të parë jep:

- ➔ Një përkufizim të dhunës në familje<sup>67</sup> dhe
- ➔ Përcakton rrethin e personave që mund të gëzojnë mbrojtje ligjore;
- ➔ Ligji u ofron qytetarëve një ide të qartë të përgjegjësive individuale dhe kolektive të autoriteteve administrative si edhe të dokumenteve që ata mund të lëshojnë;
- ➔ Ligji i jep të drejtë gjykatës të lëshojë urdhra mbrojtje, një lloj paralajmërimi për autorin të qëndrojë larg viktimës (në disa drejtime), gjë që i ofron viktimës një kohë qetësie dhe i dërgon një mesazh të qartë autorit se dhuna në familje është një çështje publike, një akt i paligjshëm dhe një sjellje e dënueshme.

Gama e këtij ligji është:


- ➔ Ta paraqesë dhe reduktojë dhunën në familje në të gjitha format e saj përmes masave të duhura ligjore;
- ➔ T’u garantojë mbrojtje ligjore të gjithë anëtarëve të familjes që janë viktimë të dhunës në familje, duke u kushtuar vëmendje të posaçme fëmijëve, të moshuarve dhe personave të paaftë.

<sup>67</sup> “Neni 3: Përkufizime” të Ligjit për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” (Nr 9669/18.10.2006). 1. “Dhuna” është një veprim apo mosveprim i një personi ndaj një tjetri, duke rezultuar në dhunimin e integritetit fizik, moral, psikologjik, seksual, social dhe ekonomik. 2. “Dhuna në familje” është një akt dhunë sipas pikës një të këtij neni midis personave që janë ose që kanë qenë në marrëdhënie familjare.



# 3

**NJË SHQYRTIM I SHKURTËR I JURISPRUDENCËS SË  
BARAZISË GJINORE**





## NJË SHQYRTIM I SHKURTËR I JURISPRUDENCËS SË BARAZISË GJINORE

# 3

### 3.1. PARIMET, ÇËSHTJET DHE REKOMANDIMET E KOMITETIT TË CEDAW-T

#### 3.3.1. Rekomandime të Përgjithshme

Neni 21 (1) i jep Komitetit të CEDAW-t të drejtën të hartojë rekomandime të përgjithshme, përmes të cilave ai interpreton kuptimin e neneve të Konventës për Shtetet Palë.

Disa prej tyre janë veçanërisht interesante për gjyqësorin:

#### Rekomandimi i Përgjithshëm Nr. 10

Me rastin e dhjetë vjetorit të miratimit të Konventës, Komiteti rekomandoi që Shtetet Palë të shihnin mundësinë, ndër të tjera, të ndër marrjes së programeve që përfshijnë *konferenca dhe seminare* për ta bërë të njohur Konventën për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave.

#### Rekomandimi i Përgjithshëm Nr. 12

Ky rekomandim, duke pasur parasysh se Nenet 2, 5, 11, 12 dhe 16 të Konventës kërkon që Shtetet Palë të veprojnë për *të mbrojtur gratë ndaj dhunës të çdo lloji që ndodh në familje, në vendin e punës ose në çdo fushë tjetër të jetës shoqërore*, i referohet dhunës ndaj grave në përgjithësi dhe kërkon që Shtetet Anëtare të përfshijnë në raportet e tyre të dhëna për

- 1 legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e grave nga rastet e të gjitha llojeve të dhunës në jetën e përditshme (duke përfshirë dhunën seksuale, abuzimet në familje, ngacmimet seksuale në vendin e punës, etj);
- 2 masat e tjera të miratuara për ta çrrënjësuar këtë dhunë;
- 3 ekzistencën e shërbimeve të mbështetjes për gratë që janë viktime të agresionit apo abuzimeve;
- 4 të dhënat statistikore për shkallën e dhunës së të gjitha llojeve ndaj grave dhe për gratë që janë viktime të dhunës.

### Rekomandimi i Përgjithshëm Nr 13.

Duke sjellë ndër mend Konventën Nr. 100 të Organizatës Ndërkombëtare të Punës për Pagë të Barabartë për Burrat dhe Gratë për Punë me Vlerë të Barabartë, që është ratifikuar nga shumica e Shteteve Palë të Konventës për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave, Komiteti i CEDAW-t rekomandon të merret parasysh studimi, zhvillimi dhe miratimi i *sistemeve të vlerësimit të punës, mbështetur në kritere neutrale ndaj gjinisë*, që do të lehtësonin krahasimin e vlerës së atyre punëve me natyrë të ndryshme, ku gratë mbizotërojnë aktualisht, me ato punë ku aktualisht mbizotërojnë burrat.

### Rekomandimi i Përgjithshëm Nr 18

Komiteti i CEDAW-t rekomandon që Shtetet Palë të japin informacion për *gratë e paafja* në raportet e tyre periodike, dhe për masat e marra për të zgjidhur situatën e tyre të veçantë, duke përfshirë masat e posaçme për të siguruar që ato të kenë qasje të njëjtë në arsim dhe punësim, shërbimet shëndetësore dhe sigurimet shoqërore dhe për të siguruar që ato të mund të marrin pjesë në të gjitha fushat e jetës sociale dhe kulturore.

### Rekomandimi i Përgjithshëm Nr. 19

CEDAW nuk i mbulon shprehimisht disa çështje të rëndësishme që lidhen me mbrojtjen e të drejtave të njeriut të grave, si eliminimi i *dhunës ndaj grave*. Vetëm nëpërmes Rekomandimit të Përgjithshëm Nr. 19 Komiteti i CEDAW-t e futi çështjen e dhunës ndaj grave në gamën e Konventës duke deklaruar se përkufizimi i diskriminimit ndaj grave në Nenin 1 të CEDAW-t përfshin dhunën e mbështetur në gjini. Ky Rekomandim i Përgjithshëm përçon idenë se Shtetet Palë mund të mbajnë përgjegjësi në rast se “ato nuk veprojnë me kujdesin e duhur për parandalimin e shkeljeve të të drejtave apo për dënimin e akteve të dhunës”.

### Rekomandimi i Përgjithshëm Nr. 21

→ Ky rekomandim i referohet *barazisë në marrëdhëniet martesore dhe familjare*.

Në lidhje me Nenin 9 të CEDAW-t, Komiteti tërheq vëmendjen ndaj faktit se nënshtetësia është rëndësishme për pjesëmarrjen e plotë në shoqëri. Në përgjithësi, Shtetet i japin nënshtetësi atyre që janë të lindur në atë vend. Nënshtetësia gjithashtu mund të përftohet për shkak vendosjeje në një vend apo të jepet për shkaqe humanitare, të tilla si mungesa e shtetësisë. Duke mos pasur statusin, shtetasit ose qytetarët janë të privuar nga e drejta për të votuar apo për të kandiduar për poste publike dhe mund t'u mohohet qasje në përfitimet publike dhe zgjedhjen e vendbanimit. Shtetësia duhet të jetë e mundur të ndryshohet nga një

grua e në moshë madhore dhe nuk duhet hequr në mënyrë arbitrare për shkak të martesës apo mbarimit të martesës apo sepse burri apo babai i saj ndryshojnë nënshtetësinë.

Për më tepër, në lidhje me Nenin 15 të CEDAW-t, Komiteti thekson:

- ➔ Kur një grua nuk mund të hyjë aspak në një marrëdhënie kontraktore, apo nuk mund të ketë qasje në kredi financiare, apo mund ta bëjë këtë vetëm me pajtimin apo garancinë e burrit apo të një të afërmi mashkull, asaj i mohohet autonomia ligjore. Çdo kufizim i tillë e pengon atë nga *mbajtja e pronës* si pronare e vetme dhe e përjashton atë nga menaxhimi ligjor i biznesit të saj apo që të hyjë në ndonjë formë tjetër kontrate. Kufizime të tilla cenojnë seriozisht aftësinë e gruas për të siguruar jetën e saj apo të atyre që varen prej saj.
- ➔ E drejta e gruas *për të ngritur padi* ose qasja e saj në këshillimet ligjore dhe mundësia e saj për të gjetur zgjidhje në gjykata, në disa vende, është e kufizuar me ligj. Në vende të tjera, statusi i saj si dëshmitare apo dëshmia e saj shihet me më pak respekt apo peshë krahasuar me atë të një burri. Ligje apo zakone të tilla e kufizojnë në të vërtetë të drejtën e gruas për të ndjekur apo mbajtur pjesën e saj të barabartë në pronë dhe ia ulin asaj statusin si një anëtare e përgjegjshme dhe e vyer e komunitetit të saj. Kur vendet e kufizojnë zotësinë ligjore të gruas me ligjet e tyre, apo kur i lejojnë individët apo institucionet të bëjnë të njëjtën gjë, në këtë mënyrë u mohojnë grave të drejtat për të qenë të barabartë me burrat dhe e kufizojnë mundësinë e gruas për t'u kujdesur për vete dhe për ata që varen prej saj.
- ➔ Banesa e përhershme është një koncept i vendeve me të drejtë zakonore, që i referohet vendit në të cilin një person synon të banojë dhe juridiksionit të të cilit ai ose ajo duhet t'i nënshtrohet. Një fëmijë, normalisht, banesën e përhershme e merr nga prindërit e vet, por në moshë të rritur, kjo fjalë tregon vendin në të cilin një person normalisht banon, dhe ku ky synon të banojë përherë. Sikundër në rastin e shtetësisë, shqyrtimi i raporteve të Shteteve Palë tregon se një grua jo gjithmonë lejohet me ligj *të zgjedhë vendbanimin e përhershëm*. Sikundër shtetësia, vendbanimi i përhershëm, duhet të jetë i mundur të ndryshohet me dëshirë nga një grua në moshë madhore, pavarësisht statusit të saj martesor. Çdo kufizim i së drejtës së një gruaje për të zgjedhur vendbanimin e saj të përhershëm në bazë të barabartë me një burrë mund t'ia kufizojë asaj qasjen në gjykata në vendin ku ajo banon, apo ta pengojë atë të hyjë dhe të dalë lirisht nga vendi, me të drejtën e saj.
- ➔ *Gratë emigrante* të cilat jetojnë dhe punojnë përkohësisht në një vend tjetër duhet të lejohen të kenë të njëjtat të drejta si burrat për të pasur bashkëshortët, partnerët dhe fëmijët me vete.

Duke iu referuar Nenit 16 të CEDAW-t, Komiteti komenton:

- ➔ Meqenëse veprimtari të tilla janë të vyera për mbijetesën e shoqërisë, nuk mund të ketë përligje për zbatimin e ligjeve apo zakoneve diskriminuese ndaj tyre. Raportet e Shteteve Palë tregojnë se ka ende vende, ku barazia *de jure* nuk ekziston. Gratë janë, për rrjedhojë, të penguar të kenë *qasje të barabartë në burime* dhe të gëzojnë barazi statusi në familje dhe shoqëri. Edhe kur barazia *de jure* ekziston, të gjitha shoqëritë u caktojnë grave role të ndryshme, të cilat shihen si inferiore. Në këtë mënyrë, shkelet

parimi i drejtësisë dhe barazisë, i ngërthyer veçanërisht në Nenin 16 si dhe në Nenet 2, 5 dhe 24 të Konventës.

- ➔ Forma dhe koncepti i familjes mund të ndryshojnë nga një Shtet në Shtetin tjetër, madje edhe midis rajoneve brenda një Shteti. Pavarësisht nga forma që merr, dhe pavarësisht nga sistemi ligjor, feja, zakonet apo traditat e një vendi, *trajtimi i grave në familje*, si me ligj dhe privatisht, duhet të pajtohet me parimet e barazisë dhe drejtësisë për të gjithë njerëzit, siç kërkon Neni 2 i Konventës.
- ➔ Raportet e Shteteve Palë tregojnë se *poligamia* ushtrohet në një numër vendesh. Martesa poligame dhunon të drejtën e gruas për të qenë e barabartë me burrin dhe mund të ketë pasoja kaq serioze emocionale dhe financiare për të dhe për ata që janë në varësi të saj, sa që martesa të tilla duhet të mos inkurajohen, por të ndalohen. Komiteti konstaton me shqetësim se disa Shtete Palë, kushtetutat e të cilëve garantojnë të drejta të barabarta, lejojnë martesat poligame në përputhje me të drejtën personale apo zakonore. Kjo gjë shkel të drejtat kushtetuese të grave dhe dispozitat e Neni 5 (a) të Konventës.
- ➔ Te 16 (1) (a) dhe (b)
  - *E drejta e gruas për të zgjedhur bashkëshortin dhe lidhur martesë* është qendrore për jetën dhe dinjitetin e saj dhe barazinë e saj si qenie njerëzore. Një shqyrtim i raporteve të Shteteve Anëtare, nxjerr në pah se ka vende të cilat, në bazë të zakonit, besimeve fetare apo origjinës etnike të grupeve të caktuara njerëzish, lejojnë martesa të detyruara apo rimartesa. Vende të tjera lejojnë që martesa e një gruaje të bëhet me shkuesi, përkundrajt pagesës apo ngritjes në status, dhe në disa të tjera, varfëria e grave i detyron ato të martohen me shtetas të huaj për të pasur siguri financiare. Në varësi nga kufizimet e arsyeshme mbështetur për shembull në moshën e re të gruas, apo lidhjet e një gjaku me partnerin e saj, e drejta e gruas për të zgjedhur kur, në se, dhe me kë do të martohet duhet të mbrohet dhe zbatohet me ligj.
- ➔ Te Neni 16 (1) (c)
  - Një shqyrtim i raporteve të Shteteve Palë vë në dukje se, shumë vende, në sistemet e tyre ligjore, parashikojnë të drejtat dhe përgjegjësitë e partnerëve të martuar më shumë duke u mbështetur në zbatimin e parimeve të së drejtës zakonore, feve dhe zakoneve, se sa duke zbatuar parimet që përmban Konventa. Këto ndryshime në ligj dhe praktikë, që kanë të bëjnë me martesën, kanë pasoja të gjithanshme për gratë, duke ua ngushtuar atyre gjithmonë të drejtat e tyre për status dhe përgjegjësi të barabartë në martesë. Kufizime të tilla shpesh rezultojnë me dhënien e statusit të *kryetarit të familjes* dhe vendimmarrësin kryesor burrit, duke shkelur kështu dispozitat e Konventës.
  - Për më tepër, përgjithësisht, një *bashkimi de facto* nuk i jepet aspak mbrojtje ligjore. Gratë që jetojnë në marrëdhënie të tilla duhet të kenë status të barabartë me burrin si në jetën familjare, ashtu dhe në ndarjen e të ardhurave dhe pronave të mbrojtura me ligj. Gra të tilla duhet të kenë të drejta dhe përgjegjësi të njëjta me burrat për kujdesin dhe rritjen e fëmijëve dhe anëtarëve të familjes që varen prej tyre.

➔ Te Neni 16 (1) (d) dhe (f)

- Sikundër parashikohet në Nenin 5 (b), shumica e Shteteve e pranojnë përgjegjësinë e përbashkët të prindërve për *kujdesin, mbrojtjen dhe mbajtjen e fëmijëve*. Parimi se “interesat më të mira të fëmijëve duhet të jenë konsiderata kryesore” është përfshirë në Konventën për të Drejtat e Fëmijës (Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme 44/25, Aneksi) dhe duket se tani është e pranuar në shkallë botërore. Megjithatë, në praktikë, disa vende nuk e respektojnë parimin e dhënies së statusit të njëjtë prindërve të fëmijëve, sidomos kur nuk janë të martuar. Fëmijët e bashkimeve të tilla jo gjithnjë gëzojnë statusin e fëmijëve të lindur nga martesat, ndërsa kur nënat janë të divorcuara apo jetojnë të ndara, shumë prej baballarëve nuk ndajnë përgjegjësinë e kujdesit, mbrojtjes dhe mbajtjes së fëmijëve të tyre.
- Të drejtat dhe përgjegjësitë e përbashkëta, të shpallura në Konventë, duhet të bëhen të detyrueshme me ligj dhe, sipas rastit, përmes koncepteve të qarta ligjore lidhur me kujdestarinë, tutorinë, mbrojtjen gjyqësore dhe birësimin. Shtetet Palë duhet të sigurojnë që, sipas ligjeve të tyre, të dy prindërit, pavarësisht statusit të tyre martesor dhe pavarësisht nëse jetojnë apo jo me fëmijët e tyre, duhet të ndajnë të drejtat dhe përgjegjësi të barabarta për fëmijët e tyre.

➔ Te Neni 16 (1) (e)

- Përgjegjësitë që kanë gratë për të lindur dhe rritur fëmijë ndikojnë në të drejtën e tyre për të pasur *qasje në arsim, punësim dhe veprimtari të tjera të lidhura me zhvillimin e tyre personal*. Ato gjithashtu u vendosin grave një barrë pune të pabarabartë. Numri i fëmijëve dhe diferenca në kohë në lindjen e tyre po ashtu kanë një ndikim të ngjashëm në jetën e grave dhe gjithashtu ndikojnë në shëndetin e tyre fizik dhe mendor, si edhe në atë të fëmijëve të tyre. Për këtë arsye, gratë kanë të drejtë të vendosin për numrin e fëmijëve dhe për kohën se kur duan që t’i kenë ata.
- Disa raporte tregojnë praktika shtrënguese të cilat kanë pasoja serioze për gratë siç janë *shtatzënia e detyruar, abortet apo sterilizimet*. Vendimet për të pasur apo jo fëmijë, të cilat do të ishte e preferueshme të merreshin në konsultime me bashkëshortin apo partnerin, megjithatë nuk duhet të kufizohen nga bashkëshorti, prindi, partneri apo Qeveria. Me qëllimin për të marrë një vendim të informuar për masat e sigurta dhe të besueshme kontraceptive, gratë duhet të kenë informacion për masat kontraceptive dhe përdorimin e tyre, dhe qasje të garantuar në edukimin seksual dhe shërbimet e planifikimit familjar, sikundër parashikohet në Nenin 10 (h) të Konventës.

➔ Te Neni 16 (1) (g): Një familje e qëndrueshme është një familje që mbështetet në parimet e barazisë, drejtësisë dhe plotësimin individual të secilit anëtar. Secili partner duhet, pra, të ketë të drejtë *të zgjedhë një profesion* apo punësim që i përshtatet më mirë aftësive të tij apo të saj, kualifikimeve dhe aspiratave, sikundër parashikohet në Nenin 11 (a) dhe (c) të Konventës. Për më tepër, secili partner duhet të ketë të drejtë të mbajë emrin e tij apo të saj, duke ruajtur individualitetin dhe identitetin në komunitet, që e dallojnë atë person nga anëtarë të tjerë të shoqërisë. Kur një grua është e detyruar

me ligj apo zakon të ndryshojë emrin e saj me martesë apo me prishjen e saj, asaj i mohohen këto të drejta.

➔ Te Neni 16 (1) (h)

- Të drejtat e parashikuara në këtë Nen përputhen dhe plotësojnë ato të Nenit 15 (2) ku Shteteve i vihet detyrimi për t'u dhënë grave të drejta të barabarta dhe për të bërë dhe përfunduar kontrata dhe administruar prona.
- Neni 15 (l) u garanton grave barazi me burrat para ligjit. E drejta për të zotëruar, gëzuar dhe hequr dorë nga prona është qendrore në të drejtën e gruas për të gëzuar pavarësi financiare dhe në shumë vende është e rëndësishme në lidhje me aftësinë e saj për të fituar bukën e gojën dhe për të siguruar strehim dhe ushqim për vete dhe familjen e saj.
- Në vende që po kryejnë programin e *reformës agrare* apo shpërndarjen e tokës midis grupeve me origjina të ndryshme etnike, e drejta e grave, pavarësisht statusit të tyre martesor, për të pasur një tokë të tillë të rishpërndarë në kushte të barabarta me burrat, duhet të respektohet me kujdes.
- Në shumicën e vendeve, një përqindje e madhe grash janë *të vetme apo të divorcuara* dhe shumë prej tyre e kanë vetë gjithë përgjegjësinë për të mbajtur familjen. Çdo diskriminim në ndarjen e pronës, i cili mbështetet në premisën se vetëm burri është përgjigjes për mbajtjen e grave dhe fëmijëve të familjes së tij dhe se ai mundet dhe to ta kryejë me nder përgjegjësinë për këtë, është dukshëm jo realiste. Si rrjedhojë, çdo ligj apo zakon që u jep burrave të drejtën e një pjese më të madhe të pronës në fund të një martesë apo të një marrëdhënie de facto, apo me vdekjen e një të afërmi, është diskriminuese dhe do të ketë një ndikim serioz në mundësinë praktike të gruas për të divorcuar të shoqin, për të mbajtur veten apo familjen e saj dhe për të jetuar me dinjitet si një person i pavarur.
- Të gjitha këto të drejta duhen garantuar, pavarësisht statusit martesor të gruas.
- Ka vende që nuk e njohin të drejtën e grave për të zotëruar një pjesë të barabartë të pronës me të shoqin gjatë një martese apo një marrëdhënie de facto edhe kur martesa apo marrëdhënia merr fund. Shumë vende e njohin atë të drejtë, por mundësia praktike e grave për ta ushtruar atë, mund të kufizohet nga precedentët ligjorë apo nga zakoni.
- Edhe kur grave u janë dhënë këto të drejta ligjore dhe kur gjykatat i bëjnë ato të zbatueshme, prona e zotëruar nga një grua gjatë martesës apo pas divorcit, mund të administrohet nga një burrë. Në shumë Shtete, duke përfshirë ato ku ka një regjim komunitar pronësie, nuk ka kërkesë ligjore që gruaja të konsultohet kur prona e zotëruar nga palët gjatë martesës apo marrëdhënies de facto shitet apo hiqet nga dora në një mënyrë tjetër. Kjo gjë kufizon mundësinë e gruas për të kontrolluar sistemin e pronës apo të ardhurat që nxirren prej saj.
- Në disa vende, me *ndarjen e pronës martesore*, i vihet një theks më i madh kontributeve financiare në pronën e përfutur gjatë një martese, duke e pakësuar rëndësinë e kontributeve të tjera siç është rritja e fëmijëve, kujdesi për të afërmit e moshuar. Shpesh kontribute të tilla me natyrë jo financiare

të gruas i japin mundësi burrit që të fitojë të ardhura dhe të shtojë pasurinë. Kontributeve financiare dhe jo financiare duhet t'u jepet e njëjta peshë.

- Në shumë vende, pasuria e grumbulluar gjatë një marrëdhënie de facto nuk trajtohet me ligj në të njëjtën mënyrë si pasuria e përfutur gjatë martesës. Gjithmonë, në rast se marrëdhënia prishet, gruaja merr një pjesë shumë më të vogël se partneri i saj. Ligjet e pronësisë dhe zakonet që diskriminojnë në këtë mënyrë gratë e martuara apo të pamartuara, me fëmijë apo jo, duhen hedhur poshtë dhe jo inkurajuar.
- Raportet e Shteteve Palë duhet të përfshijnë komente për dispozitat ligjore apo zakonore që lidhen me *të drejtat e trashëgimisë* meqenëse ato ndikojnë në statusin e grave, sikurse parashikohet në Konventë dhe në Rezolutën 884D (XXXIV) të Këshillit Ekonomik dhe Social, në të cilën Këshilli rekomandon që Shtetet të sigurojnë që burrat dhe gratë, që kanë marrëdhënie të njëjta me një person të vdekur, të kenë të drejtë të përfitojnë pjesë të barabarta nga prona e tij dhe në renditje të barabartë në rendin e trashëgimtarëve. Kjo dispozitë nuk është zbatuar përgjithësisht.
- Ka shumë vende ku ligji dhe praktika e trashëgimisë dhe pronës rezultojnë në diskriminim serioz ndaj grave. Si rrjedhojë e këtij trajtimi të pabarabartë, gratë marrin një pjesë më të vogël të pronës së burrit apo babait pas vdekjes së tyre, krahasuar me burrat e ve dhe bijtë. Në disa raste, grave u jepen të drejta të kufizuara dhe të kontrolluara dhe marrin të ardhura vetëm nga prona e të vdekurit. Shpesh të drejtat e trashëgimisë për të vetë nuk pasqyrojnë parimet e pronësisë së barabartë të përfutur gjatë martesës. Dispozita të tilla shkelin Konventën dhe duhen hequr.

#### ➔ Te Neni 16 (2)

- Në Deklaratën e Vjenës dhe Programin për Veprim 12 të miratuar në Konferencën Botërore për të Drejtat e Njeriut, të mbajtur në Vjenë nga 14 deri në 25 qershor 1993, Shtetet nxiten të shfuqizojnë ligjet dhe rregulloret ekzistuese dhe të heqin dorë nga zakone dhe praktika, të cilat diskriminojnë dhe i shkaktojnë dëm *fëmijës vajzë*. Neni 16 (2) dhe dispozitat e Konventës për të Drejtat e Fëmijës i ndalojnë Shtetet Palë të lejojnë apo të bëjnë të vlefshme një martesë të lidhur midis personave që nuk kanë arritur moshën e pjekurisë. Në kuadër të Konventës për të Drejtat e Fëmijës, “një fëmijë, do të thotë çdo qenie njerëzore që është nën moshën tetëmbëdhjetë vjeçare, me përjashtim të rasteve kur sipas ligjit që zbatohet për fëmijën, mosha e pjekurisë arrihet më shpejt”. Pavarësisht këtij përkufizimi, dhe duke pasur ndërmend dispozitat e Deklaratës së Vjenës, Komiteti mendon se mosha minimale për martesë duhet të jetë 18 vjeç, si për burrat edhe për gratë. Kur burrat dhe gratë martohen, ato marrin përsipër përgjegjësi të mëdha. Si rrjedhojë, martesat nuk duhet të lejohet pa arritur pjekurinë dhe aftësinë për të vepruar. Sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë, kur minorenët, sidomos vajzat, martohen dhe bëjnë fëmijë, shëndeti i tyre mund të dëmtohet dhe arsimimi i tyre të pengohet. Si pasojë, autonomia e tyre ekonomike kufizohet.
- Kjo gjë, jo vetëm i ndikon gratë personalisht, por kufizon edhe zhvillimin e

aftësive dhe pavarësinë e tyre dhe i pakëson mundësitë e tyre për ripunësim, duke ndikuar kështu keq në familjet e tyre dhe në komunitete.

- Disa vende parashikojnë moshë të ndryshme për *martesë për burrat dhe gratë*. Si rrjedhojë, dispozita të tilla prezumojnë padrejtësisht se gratë kanë një shkallë të ndryshme zhvillimi intelektual nga burrat, apo se stadi i tyre i zhvillimit fizik dhe intelektual në martesë është jo material, prandaj, këto dispozita duhen hequr. Në vende të tjera, fejesa e vajzave apo sipërmarrjet nga ana e anëtarëve të familjes në emër të tyre lejohen. Masa të tilla shkelin jo vetëm Konventën, por edhe të drejtën e grave për të zgjedhur lirisht partnerin.
- Shtetet palë duhet gjithashtu të kërkojnë regjistrimin e të gjitha martesave qofshin të bëra në mënyrë civile apo sipas zakonit apo të drejtës fetare. Shteti në këtë mënyrë mund të sigurojë respektimin e Konventës dhe të vendosë barazi midis partnerëve, një moshë minimale për martesë, ndalimin e bigamisë dhe poligamisë dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.

## Rekomandimi i Përgjithshëm Nr. 24

Ky rekomandim lidhet me *çështje të kujdesit shëndetësor*. Komiteti nënvizon se detyrimi për të mbrojtur të drejtat që lidhen me shëndetin e grave kërkon që Shtetet Palë, përfaqësuesit e tyre dhe zyrtarët të ndërmarrin veprime për të parandaluar dhe vendosur sanksione për shkelje të të drejtave nga persona dhe organizata private. Meqenëse dhuna e mbështetur në gjininë është një çështje kritike shëndetësore për gratë, Shtetet Palë duhet të sigurojnë:

- ➔ Miratimin dhe zbatimin e efektshëm të ligjeve dhe formulimin e politikave, duke përfshirë protokollet e kujdesit shëndetësor dhe procedurat spitalore, *për të trajtuar dhunën* ndaj grave dhe abuzimin e vajzave fëmijë dhe sigurimin e shërbimeve të duhura shëndetësore;
- ➔ Trajnim të ndjeshëm ndaj gjinisë, për të bërë të mundur që punonjësit e kujdesit shëndetësor të zbulojnë dhe menaxhojnë pasojat në shëndet të dhunës me bazë gjininë;
- ➔ Procedura të drejta dhe mbrojtëse për dëgjimin e ankesave dhe vendosjen e sanksioneve të duhura për profesionistët e kujdesit shëndetësor, që janë fajtorë për *abuzime seksuale* me pacientet gra;
- ➔ Miratimin dhe zbatimin efektiv të ligjeve që ndalojnë gjymtimin gjenital femëror dhe martesat e vajzave fëmijë.

Detyra për të plotësuar të drejtat vendos detyrimin ndaj Shteteve Palë për marrjen e masave të duhura legjislative, juridike, administrative, buxhetore, ekonomike dhe masa të tjera deri në shkallën maksimale që lejojnë burimet e tyre, për të siguruar që gratë të realizojnë të drejtat e tyre për kujdes shëndetësor.

Shtetet palë duhet gjithashtu të raportojnë për masat e marra për të siguruar *qasje* në shërbime të *kujdesit shëndetësor cilësor*, për shembull, duke i bërë ato të pranueshme për gratë. Shërbime të pranueshme janë ato të cilat jepen në një mënyrë të tillë, që sigurojnë miratimin e plotë të informuar të një gruaje, respektimin e dinjitetit të saj, garantimin e konfidencialitetit dhe që

janë të ndjeshme ndaj nevojave dhe perspektivave të saj. Shtetet Palë nuk duhet të lejojnë forma shtrëngimi, siç janë sterilizimi jo konsensual, testim i detyruar për sëmundje seksualisht të trasmetueshme apo testim të detyruara të shtatzënisë si kusht punësimi, që shkelin të drejtat e grave për miratim të informuar dhe dinjitet.

### 3.3.2. Çështje ankesash individuale

Sipas Protokollit Shtesë, Komiteti i CEDAW-t nisi të merret me komunikimet që vinin nga gra të veçanta apo nga grupe grash, që e shihnin veten si viktime të diskriminimit i cili shkelte të drejtat e tyre sipas CEDAW-t.

Komiteti ka trajtuar vlerat e një komunikimi, ndër të tjera, në vendimet e mëposhtme:<sup>68</sup>

#### A.T. kundër Hungarisë

Në 2005, Komiteti i CEDAW-t duhej të trajtonte një çështje të dhunës në familje. A.T. pretendonte se, për katër vjet, ajo kish vuajtur dhunë të rëndë dhe sistematike dhe kërcënime serioze për jetën nga i shoqi. Asnjë masë e tillë si, urdhër ndalimi, madje as strehëza, nuk ekzistonin për të sipas ligjit hungarez. Për më tepër, Gjykatat hungareze kishin vendosur që burri kish të drejtë të përdorte vazhdimisht apartamentin e përbashkët dhe në sytë e tyre, autori nuk pritej që të ishte ai që duhej të zgjidhte mosmarrëveshjen. Procedurat penale kishin nisur kundër burrit të dhunshëm, por sanksionet e vendosura ishin minimale.

Komiteti konstatoi në favor të autores, sipas Nenit 2:

Komiteti konstaton se Shteti Palë ka pranuar se, mjetet e ndjekura nga autorja nuk ishin në gjendje të siguronin mbrojtje të menjëhershme për të ndaj keqtrajtimit nga ish partneri i saj, dhe për më tepër, se masat ligjore dhe institucionale në Shtetin Palë nuk janë ende të gatshme të sigurojnë mbrojtjen dhe mbështetjen, që pritej ndërkombëtarisht, e madhe, gjithëpërfshirëse dhe e efektshme për viktimat e dhunës në familje. ... Komiteti më tej konstaton se vlerësimi i përgjithshëm i Shtetit Palë është se rastet e dhunës në familje nuk kanë përparësi të madhe në procedurat gjyqësore. Komiteti është i mendimit se përshkrimi i dhënë për procedurat e ndjekura në rastin konkret, si procedurat civile ashtu edhe penale, përputhen me këtë vlerësim të përgjithshëm... Komiteti është i shqetësuar për mbizotërimin e dhunës ndaj grave dhe vajzave, përfshirë dhunën në familje. Ai është veçanërisht i shqetësuar se nuk është ndërmarrë ndonjë ligj i posaçëm për të luftuar dhunën në familje dhe ngacmimet seksuale dhe se,

<sup>68</sup> See all on: <http://www.un.org/womenwatch/daw/cedaw/protocol/dec-views.htm>.

nuk ekzistojnë urdhra përjashtimi apo strehëza për mbrojtjen e menjëhershme të grave viktime të dhunës në familje. Duke pasur parasysh këtë, Komiteti vjen në përfundimin se, detyrimi i Shtetit Palë i përcaktuar në Nenin 2 (a), (b) dhe (e) të Konventës përfshijnë parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna ndaj grave, detyrim që në rastin konkret mbetet i paplotësuar dhe përbën një shkelje të të drejtave njerëzore dhe lirive themelore të autores”.

Pasi e përcaktoi këtë si një shkelje të Konventës CEDAW, Komiteti i bëri rekomandim Shtetit Palë në lidhje me A.T.-në si edhe rekomandime me karakter më të përgjithshëm. Komiteti i CEDAW-t e nxiti Shtetin Palë në lidhje me A.T. të merrte “masa të menjëhershme dhe efektive për të garantuar integritetin fizik dhe mendor të A.T-së dhe familjes së saj” dhe së dyti, të siguronte “që A.T.-së t’i jepej një shtëpi e sigurt ku të jetonte me fëmijët e saj, të merrte mbështetjen e duhur për mbajtjen e fëmijëve dhe ndihmë ligjore dhe dëmshpërblimet përkatëse për dëmin fizik dhe mendor, që ajo kish pësuar dhe për gravitetin e shkeljeve të të drejtave të saj”. Rekomandimet e një karakteri më të gjerë kërkonin që Hungaria të ndërmernte veprime për një numër çështjesh, siç ishin hetimi “i menjëhershëm, në thellësi, në mënyrë të paanshme dhe serioz i të gjitha akuzave të dhunës në familje dhe t’i vinte autorët përpara drejtësisë në përputhje me standardet ndërkombëtare” (para 9.6).

### A.S. kundër Hungarisë

Në çështjen e dytë të vendosur me objektivitet, përsëri Hungaria u gjet se kish shkelur të drejtat e një gruaje (Rome), e cila ishte *sterilizuar* gjatë një operacioni urgjent për t’i hequr fetusin e vdekur. Kur ish pranuar në spital, asaj i kishin dhënë një shënim të shkruar pjesërisht me dorë: duke nënshkruar atë shënim, ajo kish miratuar të dy operacionet; pesëmbëdhjetë minuta më pas, ishin kryer operacionet. Komiteti i CEDAW-t konstatoi, në dritën e Rekomandimit të tij të Përgjithshëm Nr. 24 për Shëndetin e Grave (para. 20) se, Neni 12 i Konventës CEDAW shprehimisht e ndalon sterilizimin jo-konsensual. Procedura e parashikuar në këtë rast nuk përputhej me kërkesat e miratimit të informuar, që nevojitet në rastet e sterilizimit. Më tej, Komiteti konstatoi se të drejtat e A.S.-së, sipas Neni 10 (h) dhe 16 (l) (e) të Konventës CEDAW, ishin shkelur, meqenëse personeli i spitalit nuk i kish dhënë asaj këshillat dhe informacionin e duhur për planifikimin familjar dhe sepse sterilizimi i kish hequr asaj aftësinë natyrale të riprodhimit.

## Dung Thi Thuy Nguyen kundër Holandës

Në rastin e tretë të vendosur mbi këtë bazë, Komiteti erdhi në përfundim se Holanda nuk e kish shkelur Nenin 11 (a), (b) të Konventës CEDAW, duke mos u garantuar pagë të plotë gjatë *lejes së lindjes* grave të vetëpunësuar. Legjislacioni i Holandës për lejen e lindjes, i cili vendos një tavan për përfitimet e lindjes së grave, që janë njëherazi punëdhënëse dhe të vetëpunësuar (në këtë rast bashkëshortja bashkëpunëtore), hynin në diskrecionin e Shteteve Palë për të krijuar një sistem përfitimesh të lejes së lindjes për plotësimin e kërkesave të Konventës.

## Şahide Goekce dhe Fatma Yildirim kundër Austrisë

Këto dy raste të dy grave, që ishin emigrante të ardhura nga Turqia në Austri, ishin raste të lidhura me njeri tjetrin, që u sollën nga organizata *kundër dhunës në familje* në emër të grave që ishin vrarë nga burrat e tyre. Në të dy rastet, edhe pse policia kish ndërhyrë vazhdimisht në përgjigje të akuzave për abuzim dhe kërcënime, dhe ndaj viktimave ishin dhënë disa urdhra mbrojtjeje, të gjitha përpjekjet që autorët të ndaloheshin apo procedoheshin ishin hedhur poshtë nga përfaqësuesit e shtetit. Kërkuesit argumentonin se Austria nuk kish marrë masa të mjaftueshme për të mbrojtur jetën dhe sigurinë e viktimave, nuk kish proceduar në mënyrën e duhur ndaj atyre që kishin shkelur të drejtën për të mos pësuar dhunë me bazë gjininë, dhe përgjithësisht kish dështuar në mbrojtjen e sigurisë së grave. Komiteti konstatoi se, ndonëse Austria kish një sistem të pranueshëm për të trajtuar dhunën dhe abuzimet, ajo nuk arriti të sigurote që individët e përfshirë në sistem të vepronin në mënyrë të tillë që në fakt të mund t'i mbronin viktimat e veçanta. Si rrjedhojë, Austria ishte në shkelje të disa dispozitave të Konventës. Komiteti rekomandoi që Austria të përmirësonte zbatimin dhe monitorimin nga ana e saj të legjislacionit për dhunën në familje, të forconte programet e trajnimit, dhe të merrte hapat e nevojshme për përmirësimin e zbatimit të ligjit përkatës, duke përfshirë edhe procedimin e autorëve të dhunës në familje.

Në këtë çështje, ka disa veçori që meritojnë vëmendje:

- 1 Në rastin e parë, thuhet se Shteti Palë ka një nga modelet më të mira, gjithëpërfshirëse ligjore për trajtimin e dhunës në familje, por se në këtë rast, zbatimi i këtyre ligjeve ishte i papërshtatshëm për të siguruar mbrojtjen e viktimave prej dhunës. Megjithëse ligji lejon arrestimet për shkak të kërcënimeve dhe apelimit, në rastin e pushimit nga Prokurori të çështjes për ndalimin e autorit/ mos dhënien e arrestit, gabimi i ligjit është se për shembull, ai

nuk parashikon ndërhyrje të tjera si, këshillim i përkohshëm, i detyruar i autorëve gjatë kohës që dëgjoen ankesat. Kjo gjë mund të kish hedhur dritë mbi gjendjen e rrezikshme mendore të tyre. Pavarësisht kërkesave që policia i kish bërë Prokurorit për t'i dhënë miratim për arrestimin e autorit, Prokurori nuk e dha këtë miratim dhe më në fund e mbylli çështjen në ngarkim të tij.

2

Shpesh dhuna në familje shihet nga prizmi i ngushtë i të drejtës penale. Këto raste tregojnë se për shkak të mentalitetit të tyre, përfaqësuesit vazhdojnë ta trajtojnë dhunën ndaj grave jo si një krim serioz, pavarësisht se ai përbën një vepër penale sipas të drejtës penale, por si një problem social apo familjar.

### 3.3.3. Çështja Juarez dhe Procedura e Hetimit

Një hetim i një *shkelje të pretenduar të rëndë ose sistematike i të drejtave të njeriut* rezultoi në një raport që përmban rekomandime drejtuar Shteteve përkatëse Palë. Ai nuk kërkon shterimin e procedurave të vendit dhe është më pak formal se procedura e ankimeve individuale. Procesi fillon kur Komiteti merr “informacion të besueshëm, që tregon shkelje të rënda ose sistematike nga një Shtet Palë i të drejtave të përcaktuara në Konventë” dhe e fton Shtetin Palë të “paraqesë vëzhgimet e tij në lidhje me informacionin në fjalë” (Neni 8 i Protokollit Opcional).

Deri tani, Komiteti i CEDAW-t ka kryer një procedurë hetimi:

Hetimi i *Ciudad Juarez* kish të bënte me rrëmbimin, përdhunimin dhe vrasjen e grave, që vazhduan në mënyrë sistematike për rreth një dekadë në Ciudad Juarez, në shtetin e Cihuahuas, në Meksikën e Veriut. Ciudad Juarez është një derë e hapur për emigracionin, si legal ashtu dhe ilegal, si edhe emigracionin e brendshëm nga rajone të tjera të Meksikës, dhe të jashtëm nga vende të tjera. Kjo gjë ka krijuar një mjedis të rrezikshëm për gra të reja të pambrojtura që vinin të punonin në “maquilas”. Maquilas janë fabrika montimi, zakonisht të vendosura në parqe industriale në periferi të një qyteti, që prodhojnë për eksport, kryesisht në ShBA. Vrasjet ndodhën në numër shumë të madh. Viktimat kishin të njëjtën përshkrim: të gjitha të reja, tërheqëse, kryesisht të varfra, që punonin në dyqane apo në maquillas, apo që ishin akoma studente. Ndërsa këto krime ishin denoncuar vazhdimisht nga organizatat e shoqërisë civile, fillimisht ishin injoruar nga autoritetet.

Hetimi i CEDAW-t dhe raporti në 2005 ishin një hap në procesin e njohjes së plotë të çështjes së rrëmbimit, përdhunimit dhe vrasjes së grave në Ciudad Juarez si probleme dhe përgjegjësi serioze të Shtetit, në përgjithësi, në të gjithë nivelet e tij.

### 3.3.4. Zbatimi i CEDAW-t nga Gjykatat Kombëtare<sup>69</sup>

#### E drejta e Punës

Rina Bajracharya dhe të tjerët *kundër* Sekretariatit të HMG të Këshillit të Ministrave, Gjykata e Lartë e Nepalit<sup>70</sup>.

Një rregull sipas të cilit ndihmëset e avionëve *duhet të dalin në pension në moshën 30 vjeç*, ndërsa i gjithë ekuipazhi tjetër (përfshi edhe stjuardesat) duhet të dalin në moshën 55, është diskriminues dhe shkel CEDAW-n dhe parimet e Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut. Nenet kushtetuese që parashikojnë mbrojtjen e veçantë të grave nuk duhet të kuptohen se e lejojnë trajtimin e pabarabartë të grave.

Van Gorkom *kundër* Prokurorit të Përgjithshëm, Gjykata e Lartë, Wellington<sup>71</sup>

Vendimet për *pagesën e shpenzimeve të lëvizjes* nuk mund të diskriminojnë në mënyrë të ligjshme midis mësuesve të martuar meshkuj dhe mësueseve të martuara femra. Në këtë çështje shumë të hershme, Gjykata iu referua Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut dhe Deklaratës për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave dhe ra dakord se, “Ato mund të konsiderohen...se përfaqësojnë një politikë legjislative, që mund të ndikojë tek gjykatat në interpretimin e të drejtës statutores”.

Vasanth R. *kundër* Unionit të Indisë, Gjykata e Lartë e Madrasës<sup>72</sup>

Duke cituar Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut dhe përkufizimin e diskriminimit tek CEDAW, gjykata vendosi se është diskriminuese *të përjashtohen gratë me ligj nga puna natën* kur ato punojnë në të njëjtën fabrikë gjatë ditës.

Vishaka & Ors *kundër*. Shtetit të Rajasthan & Ors, Gjykata e Lartë, Indi, 13 gusht 1997.

Duke u mbështetur në Nenet 11 dhe 24 të CEDAW-t dhe Rekomandimet e Përgjithshme Nr. 22, 23 dhe 24 të Komitetit të CEDAW-t, gjykata vendosi se garancia e barazisë gjinore përfshin “*mbrojtjen nga ngacmimi*

<sup>69</sup> Shih [http://www.iwraw-ap.org/protocol/womens\\_cases.htm](http://www.iwraw-ap.org/protocol/womens_cases.htm). Për të ndihmua avokatët në përdorimin e traktateve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut gjatë proceseve gjyqësore, IWRAW Asia Pacific ka përgatitur një numër çështjesh që përdorin dhe interpretojnë traktate ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Këto janë zgjedhur mbështetur në lidhjen e tyre me çështje të barazisë gjinore. Gjithashtu, të gjitha kanë rezultate pozitive për të drejtat dhe barazinë e grave.

<sup>70</sup> Urdhër gjykate Nr. 2812 i vitit 2054BS, Trup i posaçëm gjyqësor.

<sup>71</sup> 1 NZLR 535; 1977 NZLR çLEXIS 609, 10 Feb 1977.

<sup>72</sup> W.P. No.4604 to 4606/1999. (Tek Labour Law Journal, September 2001, f.849-872.)

*seksual* dhe të drejtën e punës me dinjitet” dhe përdori CEDAW-n për të hartuar udhëzimet parandaluese.

## E drejta e Familjes

Patricia Molu *kundër* Cidie Molu, Gjykata e Lartë, Port Vila, Vanuatu, 15 maj 1998<sup>73</sup>.

Gjykata e hodhi poshtë prezumimin e të drejtës zakonore se *babai ka të drejtën e kujdestarisë së fëmijëve të tij* dhe vendosi se Shteti është i detyruar, sipas Konventës së të Drejtave të Fëmijës, dhe duhet t’i japë kujdestarinë nënës ose babait mbështetur në interesin më të lartë të fëmijës.

Muojekwo & Ors *kundër* Ejikeme & Ors, Gjykata e Apelit, Nigeri, 9 dhjetor 1999.

Zakone që i mohojnë anëtareve femra të familjes *trashëgiminë e pasurisë* duhet të hiqen, sepse ato “nuk përputhen me parimet e të drejtës natyrore, barazisë dhe arsyes” dhe sepse Neni 5 i CEDAW-t kërkon që ato të eliminohen.

Mst Humaira *kundër* Malik Moazzam Ghayas Khokhar & Ors, Gjykata e Lartë, Pakistan, 18 shkurt 1999.

Një grua ka të drejtë të lidhë *martesë me dëshirën e saj të lirë*, ndërsa autoritetet e policisë nuk duhet të ndërhyjnë në këtë të drejtë; çdo ndërhyrje do të përbëjë një shkelje të Nenit 16 të CEDAW-t.

Muller dhe Engelhard *kundër* Namibisë, Komiteti i të Drejtave të Njeriut<sup>74</sup>

Diktimi i zgjedhjes së një çifti të martuar të marrë mbiemrin e gruas me kushte më strikte dhe më të rënda se sa zgjedhja e tij për të marrë mbiemrin e burrit është diskriminuese. Për më tepër, “argumenti i traditës së vjetër nuk mund të mbahet si një justifikim i përgjithshëm për një trajtim të ndryshëm të burrave dhe grave, që bie ndesh me Konventën”. Rattigan & Ors *kundër* Krye Punonjësit të Emigracionit & Ors<sup>75</sup>

Refuzimi për t’i dhënë *leje banimi* bashkëshortëve të huaj të shtetaseve femra, shkel të drejtat dhe liritë e grave për lëvizje dhe privaci në shtëpi. Për marrjen e këtij vendimi, u konsultua Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, Neni 17, edhe pse e drejta e familjes nuk përfshihet në kushtetutën kombëtare.

<sup>73</sup> Në një Përmbledhje të Çështjeve për të Drejtat e Njeriut të Grave [Asia Pacific]. Red. Forster, Christine, Imrana Jalal, Vedna Jivan and Madhu Mehra. Asia Pacific Forum on Women, Law and Development. 2003, f.76-8.

<sup>74</sup> Komunikimi Nr.919/2000, 26 mars 2002.

<sup>75</sup> ICHRL 12, 13 qershor 1994

## Dhuna ndaj Grave

Apparel Export Promotion Council *kundër* A.K Chopra, Gjykata e Lartë, Indi, 20 janar 1999.

Duke shkelur të drejtat themelore të barazisë, jetës dhe lirisë, ngacmimi seksual përfshin veprime që cenojnë moralitetin, mirësjelljen dhe modestinë e viktimës; kontakti fizik nuk është i nevojshëm. CEDAW *dikton detyrime për ligjet e ndjeshme ndaj gjinisë*.

Kryetari, Bordi i Hekurudhave dhe të tjerët *kundër* Znj. Chandrima Das dhe të tjerëve, Gjykata e Lartë e Indisë, 28 janar 2000.<sup>76</sup>

Duke konfirmuar detyrën e tyre për t'u mbështetur në standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut (konkretisht CEDAW dhe Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut) për interpretimin e kushtetutës kombëtare, Gjykata vendosi se *përdhunimi* është një shkelje e të drejtës për të jetuar me dinjitet njerëzor dhe se gratë që nuk kanë shtetësinë e këtij shteti kanë të drejtë për të marrë një zgjidhje për një shkelje të tillë.

Fernandes *kundër* Brazil, Komisioni Ndër-Amerikan i të Drejtave të Njeriut, Organizata e Shteteve Amerikane.<sup>77</sup>

Duke mos marrë masa të efektshme për parandalimin dhe dënimin e *dhunës në familje* ndaj grave, Shteti ka shkelur të drejtat e grave për drejtësi, gjykim të ndershëm dhe mbrojtje ligjore sipas Konventës Amerikanë për të Drejtat e Njeriut dhe nuk i ka plotësuar detyrat e tij, sipas Konventës së Belém do Pará (për dhunën në familje).

Regina *kundër* Ewanchuk, Gjykata e Lartë, Kanada, 14 tetor 1998, 25 shkurt 1999.

Në një rast përdhunimi, sjellja e ankimueses nuk duhet gjykuar sipas stereotipeve dhe miteve rreth pëlqimit të grave për të bërë seks. Të bësh këtë, do të thotë të mohosh autonominë seksuale të grave dhe ky është një krim ndaj dinjitetit njerëzor dhe barazisë, të cilat mbrohen nga CEDAW. S *kundër* Bechu, Gjykata Magjistrale, Levuka, Fixhi, 2 dhjetor 1999.

Në këtë çështje *përdhunimi*, gjykata vendosi se burrat duhet të kenë dijeni për CEDAW-n dhe se “mendimi se gratë janë inferiore ndaj burrave apo pjesë e pronës së tyre private është i vjetëruar dhe i papranueshëm”.

<sup>76</sup> Në In A Digest of Case Law on the Human Rights of Women [Asia Pacific]. Red. Forster, Christine, Imrana Jalal, Vedna Jivan and Madhu Mehra. Asia Pacific Forum on Women, Law and Development. 2003, f.51-3.

<sup>77</sup> Raport Nr.54/01, Çështja 12.051, 16 prill 2001.

## 3.2. JURISPRUDENCA GJINORE E GJYKATËS EUROPIANE TË TË DREJTAVE TË NJERIUT

Parimi i trajtimit të barabartë ka qenë relativisht i një rëndësie të vogël në çështjet ligjore të Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut (GjEDNj). Neni 14, që përmban klauzolën e mos-diskriminimit, shpesh është përshkruar si një dispozitë pa dhëmbë, e cila i ofron pak një individ paditës.<sup>78</sup>

Në dekadat e para të ekzistencës së saj, gjykata e ka zbatuar rrallë këtë dispozitë. Në shumicën e çështjeve, së pari, ajo ka shqyrtuar ankesat rreth të drejtave substantive të mbrojtura nga Konventa, pas të cilave, një ankesë për trajtim të pabarabartë, shpesh është konsideruar me rëndësi të pamjaftueshme për të përlligjur një shqyrtim të veçantë. Për më tepër, Gjykata ka konstatuar shkëlqje vetëm për ato çështje në të cilat diskriminimi pretendohet se mbështetet në “shkaqe dyshimesh” kryesisht Gjykata ka konstatuar se diskriminimi përlligje objektivisht dhe në mënyrë të arsyeshme apo se situata nuk ishte e njëjtë dhe nuk paraqiste asnjë diskriminim.

Zbatimi i Nenit 14 është bërë më i shpeshtë gjatë kohëve të fundit. Deri tani, nuk ekziston ndonjë çështje në lidhje me Nenin 1, Protokollin 12.

### 3.2.1. Diskriminim i Drejtpërdrejtë dhe i Tërthortë; Diskriminim Formal dhe Substantiv

Meqenëse ndalimi i diskriminimit në Nenin 14 nuk kufizohet me një numër shterues të listuar shkaqesh, në parim, nuk ka nevojë të përdoret koncepti i diskriminimit të tërthortë: është e mundur të kundërshtohet çdo lloj pabarazie në trajtim, pavarësisht se në çfarë shkaqesh mbështetet. Megjithatë, mund të jetë me dobi për ankimuesin ta përdorë këtë koncept, meqenëse *Gjykata i shqyrton disa çështje diskriminimi më strikt se disa të tjera*. Një shkëlqje e dispozitës të barazisë do të jetë për shembull më e lehtë të konstatohet kur paditësi është në gjendje të tregojë se diskriminimi i pretenduar mbështetet në një *shkak dyshimi*, si gjinia (rast ku do të përdoret një tekst strikt) se sa në ato raste kur është e qartë se klasifikimi mbështetet në shkaqe neutrale si koha e punës, kundërshtohet drejtpërdrejt.

Fillimisht, Gjykata nuk dukej se e pranonte konceptin e *diskriminimit të tërthortë*<sup>79</sup>, por çështje të kohëve të fundit tregojnë një përjasje të ndryshme nga ana e saj. Sipas Gjykatës, në çështjen *Hoogendijk*: “Kur një politikë apo masë e përgjithshme ka pasoja paragjyquese disproporcionale ndaj një grupi të caktuar, nuk përjashtohet se kjo gjë mund të shihet si

<sup>78</sup> W. Kewening, *Der Grundsatz der Nichtdiskriminierung im Völkerrecht der internationalen Handelsbeziehungen*, 1972, f. 106.

<sup>79</sup> ECHR 25 May 1985, *Abdulaziz*, seria A, vëll. 94, para 85.

diskriminuese, pavarësisht se ajo nuk synon, apo nuk drejtohet konkretisht ndaj atij grupi”.<sup>80</sup> Në përgjithësi, dhe shumë përpara këtij vendimi, përkufizimi i diskriminimit, i përdorur nga vetë GjEDNJ-ja ishte i gjerë dhe nocioni i saj *lato sensu* i diskriminimit të drejtpërdrejtë mund të thuhet se përfshinte diskriminimin e tërthortë.

Përveç dallimit midis diskriminimit të drejtpërdrejt dhe të tërthortë, doktrina e barazisë gjithashtu bën dallimin edhe midis *diskriminimit formal dhe substantiv*. Në Çështjen *Thlimmenos*<sup>81</sup>, Gjykata megjithatë ka pranuar shprehimisht se jo vetëm diskriminimi formal (trajtim i pabarabartë i çështjeve të barabarta), por edhe diskriminimi substantiv (trajtim i barabartë i çështjeve të pabarabarta) futen në gamën e Nenit 14.

### 3.2.2. Çështje të Diskriminimit në Bazë Seksi

Të gjitha çështjet që argumentojnë diskriminim me bazë seks, të përcaktuar në bazë të meritave<sup>82</sup> kanë të bëjnë me pretendime për një trajtim të ndryshëm të pajustificuar, edhe pse gratë dhe burrat janë të ndryshëm si biologjikisht edhe shoqërisht, nga pikëpamja shoqërore, nga këndvështrimi i pushtetit. Vetëm njeri prej shqetësimeve ka të bëjë me diskriminimin e drejtpërdrejt<sup>83</sup>, ndonëse sot pjesa më e madhe e rasteve të diskriminimit në bazë seks, marrin formën e diskriminimit të tërthortë.<sup>84</sup> Së fundi, pjesa më e madhe e kundërshtimeve në lidhje me diskriminimin në bazë seks, janë ngritur nga burrat, pavarësisht se diskriminimi në bazë seks/gjinie prek shumë më tepër gratë.

<sup>80</sup> Hoogendijk v Holandës (2005) 40 EHRR SE22 at 207. Shih po ashtu, Zarb Adami v Maltës (2006) 44 EHRR 3 në paras 78 and 82\*3 (diskriminim i tërthortë në bazë seks) dhe D.H. dhe të tjerë v Republikës Çeke, Kërkesa Nr. 57325/00, Vendimi i 2007, në paragrafët 179-80 dhe 187-95 (diskriminim i tërthortë racor).

<sup>81</sup> ECHR 6 prill 2000, European Human Rights Cases 2000/45. Çështja Thlimmenos kishte të bënte me një dispozitë legjislative, që parashikonte se personat e dënur më parë për një krim, nuk mund të caktoheshin si llogaritarë të certifikuar. Kërkuesi argumentoi se kjo dispozitë legjislative nuk e respektonte sa duhet shumëllojshmërinë në shkallën dhe karakterin e veprave. Ai vetë kish qenë dënur për shkak se kish refuzuar të vishte uniformë ushtarake, gjë që ai nuk e konsideronte se kish lidhje me standardet e tij profesionale dhe etike, që duhej të plotësonte si llogaritar i certifikuar dhe, si pasojë, përbënte diskriminim substantiv që nuk mund të pajtohej me Nenin 14.

<sup>82</sup> Çështje në të cilat diskriminimi është argumentuar shprehimisht janë: Abdulaziz, Cabales and Balkandali kundër UK, ; (1985), Abdulaziz, seria A, vëll. 94, para 85, Schuler-Zgraggen kundër Switzerland (1993), Series A Nr. 263; Burghartz kundër Switzerland (1994), Seria A Nr. 280-B; Karlheinz Schmidt kundër Germany (1994), Seria A No.291-B; Van Raalte kundër Netherlands (1997), Raporte 1997-I; Petrovic kundër Austria ; (1998), Raporte 1998-I; Unal Tekeli kundër Turkey (2004), Raporte 2004-X; Willis kundër UK (2002), Raportet 2002-IV; Wessels-Bergervoet kundër Netherlands (2002), Raportet 2002-IV; Stec and others kundër UK, (2006) Reports 2006-I; Barrow kundër UK (2006), Reports 2006-; Walker kundër UK (2006), Raportet 2006-; Pearson kundër UK (2006), Reports 2006-; Zarb Adami kundër Malta , (2006), Raportet 2006; Runkee and White kundër UK (2007), Aplikimi Nr 42949/98, 53134/99. Çështje ku shkaku nuk është deklaruar shprehimisht, por ka të bëjë me seksin: Rasmussen kundër Denmark, (1984) Seria A, Nr 87; Mizzi kundër Malta (2006), Raportet 2006-Ka edhe disa çështje të tjera që lidhen me Nenin 14, veçanërisht atë që kanë të bëjnë me diskriminimin në lidhje me statusin martesor, illegjitimitetin, p.sh., Marckx kundër Belgium (1979), Seria A Nr. 31.

<sup>83</sup> Zarb Adami kundër Malta është i vetmi vendim për diskriminim të tërthortë në bazë seks.

<sup>84</sup> Pikërisht në fushën e barazisë gjinore është zhvilluar diskriminimi i tërthortë në të drejtën e BE-së.

Së pari Gjykata e shpjegoi përfaqshen e saj ndaj pretendimeve për diskriminim në bazë seksi tek çështja Abdulaziz, Cabales and Balkandali kundër UK. Ajo vendosi se “barazia e sekseve është ... një prej qëllimeve madhorë të Shteteve Anëtare të Këshillit të Europës” dhe se “shkaqe me shumë peshë duhet të paraqiteshin përpara se ndryshimi në trajtim për shkaqe seksi të mund të konsiderohej si i pajtueshëm me Konventën”.<sup>85</sup>

Prandaj, Gjykata miratoi “përfaqshen e njëjtësisë” ndaj barazisë së sekseve dhe vendosi që të përdorte një shqyrtim shumë të ngurtë. Megjithatë, niveli i shqyrtimit nuk ka qenë gjithmonë i ngurtë. Në tre llojet e çështjeve, Gjykata ka bërë vetëm një shqyrtim të lehtë, duke u lënë shteteve një gamë të madhe vlerësimi.

Rasmussen kundër Danimarkës dhe Petrovic kundër Austrisë, që kanë të bëjnë me *role të ndryshme në familje* të grave dhe burrave, hyjnë në kategorinë e parë.<sup>86</sup> Rasmussen kundër Danimarkës kundërshtoi periudhat e kufizimit [parashkrimin e së drejtës] për nisjen e procedurave të atësisë, të cilat zbatoheshin vetëm për baballarët e prezumuar (por jo për nënat). Qeveria synonte të përligjte trajtimin e ndryshëm me “faktin” se “zakonisht interesi i nënës përputhej me ato të fëmijës”, ndërsa në rastin e babait ekzistonte “rreziku se ai mund t’i përdorte ato [procedurat e atësisë] si një kërcënim kundër nënës”.<sup>87</sup> Petroviç kundërshtoi të mospasurin mundësi për baballarët për të marrë leje prindërore, gjë që qeveria e përligjte me “faktin” se në kohën në fjalë, rolin parësor të kujdesit për fëmijët e vegjël e kishin nënat. Në të dy rastet, Gjykata procedoi pa dëshirë, duke u nisur nga prezumimi i ngjashmërisë së situatave dhe pastaj i dha qeverisë një gamë të gjerë vlerësimi për të parë nëse “dallimet në situata, që ndryshe janë analoge” përbëjnë një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm për një trajtim të ndryshëm. Në të dy rastet, Gjykata vendosi se shteti nuk e kish kaluar cakun e vet, duke marrë parasysh se në kohën në fjalë, nuk kishte terren të përbashkët midis Shteteve Anëtare për sa i përket çështjeve në fjalë.

Kategoria e dytë e çështjeve, që përbëheshin nga Stec dhe të tjerë kundër Mbretërië së Bashkuar [MB], Barrow kundër MB, Walker kundër MB, and Pearson kundër MB, kanë të bëjnë me kundërshtime ndaj kërkesave për moshë të ndryshme për gëzimin e përfitimeve shoqërore të lidhura me *moshën e pensionit shtetëror*. Tek Stec dhe të tjerë kundër MB, paditësit, dy burra dhe dy gra, kundërshtonin legjislacionin që vendoste kushte ndërprerje apo kufizuese në lidhje me pagesën e të ardhurave të reduktuara. (REA) (zëvendësim për fitimet e një dëmtimi industrial), duke iu referuar moshave që përdorehin për skemën e pensionit statutor të vjetërsisë (60 vjeç për

<sup>85</sup> Abdulaziz, seria A, vëll. I. 94, para 78.

<sup>86</sup> Ka një çështje tjetër që lidhet me rolet e ndryshme në familje: Mizzi kundër Maltës. Ajo lidhet me kufizimet e vendosura ndaj baballarëve të supozuar në nisjen e procedurave, që nuk zbatohen edhe për nënat. Ndryshe nga çështja Rasmussen, Gjykata konstatoi shkelje.

<sup>87</sup> GJEDNj 28 nëntor 1984, Seria A, vëll. 87, para. 3.

gratë dhe 65 vjeç për burrat). Qeveria argumentonte se ishte e ligjshme të ndalonte pagesat REA njerëzve që nuk punonin më, edhe kur ata nuk vuanin nga dëmtim apo sëmundje të lidhur me punën, dhe se përdorimi i moshës së pensionit si një pikë ndërprerje, e bënte skemën të lehtë për të kuptuar dhe administruar. Në lidhje me pensionet e ndryshme shtetërore, ajo argumentoi se çështja hynte në cakun e saj të vlerësimit, meqë kish të bënte me gjykime komplekse sociale dhe ekonomike, të cilat shtetet janë në pozitë më të mirë për t'i bërë. Gjykata së pari theksoi se, trajtimi i ndryshëm mund të mos justifikohet thjesht sipas Nenit 14, por mund edhe të kërkohet kur bëhet fjalë për pabarazi faktike. Atëherë, gjykata përsëriti “formulën e arsyeve shumë bindëse”. Së fundi, gjykata theksoi se shtetet përgjithësisht kanë një cak të gjerë vlerësimi kur vjen puna tek “masat e përgjithshme të strategjisë ekonomike dhe shoqërore”.<sup>88</sup> Gjithsesi, Gjykata nuk deklaroi qartë se si këto tri parime (konfliktuese) duheshin zbatuar në çështjen në fjalë: nëse paditësit duheshin konsideruar sikur ishin në të njëjtën situatë apo në situata të ndryshme, dhe se si doktrina e caktit të vlerësimit duhej të përputhej me parimin e shqyrtimit të ngurtë të çështjeve të diskriminimit në bazë seksi.

Eventualisht, Gjykata u nis nga prezumimi i situatave analoge dhe pastaj e vlerësoi justifikimin me butësi, në dritën e një caku më të gjerë vlerësimi, që zbatohet për çështjet e ekonomisë dhe koherencës administrative. Ajo mori gjithashtu parasysh gjykimin e Gjykatës Europiane të drejtësisë, i cili thoshte se, diskriminimi për të cilin po diskutohet, hynte në përjashtimin e Nenit 7(1)(a) të Direktivës 79/7/KEE, 30, meqë “lidhjet objektivist dhe domosdoshmërisht me ndryshimin midis moshës së pensionit për burrat dhe gratë”.<sup>89</sup> Si rrjedhojë, ajo konstatoi se politikat e kundërshtuara ishin të justifikuar në mënyrë të arsyeshme dhe objektivist. Pastaj Gjykata vlerësoi nëse ndryshimi bazë në skemën e pensioneve shtetërore mund të justifikohet. Në dritën e “justifikimit fillestar për masën, si një masë që korrigjonte pabarazinë midis sekseve,” në natyrën më të ngadaltë në ndryshimin e jetës së grave punëtore, mungesa e standardeve të përbashkëta midis Shteteve Anëtare, dhe fakti se moshë e pensionit bënte pjesë në një nga përjashtimet e Direktivës së KE-së, Gjykata pranoi cakun e gjerë të vlerësimit dhe deklaroi se ndryshimi ishte i përligjur.

Kategoria e tretë, që përbëhet nga Runkee dhe White kundër MB, ka të bëjë me kundërshtimin e *mobimit të pensionit një burri të ve*, pension i cili do t'i ishte dhënë një gruajë në kushte të njëjta. Qeveria parashtroi se një ndryshim i tillë në trajtim ishte i përligjur, meqenëse historikisht gra të veja me moshë më të madhe, si grup, përballeshin me vështirësi financiare dhe pabarazi për shkak të rolit tradicional të gruas së martuar për t'u kujdesur më shumë për burrin dhe familjen në shtëpi, se sa për të punuar dhe fituar para. Gjykata, pa e hequr formalisht “përjasjen e

<sup>88</sup> [Stec dhe të tjerë kundër MB](#), para 52.

<sup>89</sup> [Case C-196/98, Hepple v Chief Adjudication Officer \[2000\] ECR I-3701](#), në para 45.

njëjtësisë” pranoi se historikisht kish pasur dallime midis pozitave ekonomike të grave dhe burrave, të cilat kjo masë synonte t’i trajtonte, dhe theksoi se shtetet kanë një cak të gjerë vlerësimi kur vjen puna te masat e përgjithshme të politikës sociale dhe ekonomike, dhe në këtë mënyrë, për të vendosur nëse masa nuk përligjej më. Në dritën e këtyre arsyeve, nuk u konstatua ndonjë diskriminim. Megjithatë, në çështjen e kohëve të fundit Thorne *kundër* Mbretërisë së Bashkuar<sup>90</sup>, Gjykata konstatoi një shkelje në këtë çështje, në lidhje me ankesën e paditësit se, si i ve, atij i ishte refuzuar përfitimi i vejushave, konkretisht pagesa e të Vejave dhe Pagesa e Nënës së Ve.

Për pjesën tjetër të çështjeve, Gjykata përdori shqyrtimin e thelluar.

Lloji i parë i çështjeve në këtë kategori ka të bëjë me dispozitat diskriminuese për *mbiemrin*. *Burghartz kundërshtoi* mungesën e një opsioni për burrat për t’ia shtuar mbiemrat e tyre mbiemrit të familjes (mbiemri i gruas) kur ky opsion ekzistonte për gratë.<sup>91</sup> Qeveria argumentoi se ndryshimi ishte i justifikuar sepse dispozita automatike (default) ishte që palët të merrnin mbiemrat e burrit si mbiemrin e tyre. *Unal Tekeli* e kundërshtoi ndalimin që gratë të përdornin mbiemrat e tyre si mbiemër, kur ky opsion ishte i mundshëm për burrat. Qeveria u orvat ta justifikonte qëndrimin e saj me faktin se ishte e nevojshme të pasqyrohej uniteti i familjes përmes emrit të burrit. Në të dy rastet, Gjykata ju referua natyrës së Konventës si një instrument i gjallë dhe vendosi se Neni 14 ndalon dispozita diskriminuese në lidhje me mbiemrin.<sup>92</sup>

Kategoria e dytë përbëhet nga çështja që pretendon diskriminim të tërthortë. Tek Çështja *Zarb Adami kundër* Maltës, paditësi, pretendonte se ai ish trajtuar ndryshe nga gratë, të cilat, edhe pse i plotësonin kërkesat ligjore, u kërkohej të plotësonin *shërbim në juri* në një numër më të vogël se burrat, që për mendimin e tij, shkaktohej nga mënyra se si i hartonin listat e anëtarëve të jurisë. Qeveria argumentoi se, ndryshimi në trajtim, varej nga një numër faktorësh me natyrë kulturore, sociale dhe ekonomike, duke përfshirë faktin se anëtarët e jurisë zgjidheshin nga popullsia aktive në ekonomi dhe në profesione, se përjashtimi nga shërbimi mund të kërkohej për arsye familjare, dhe se, avokatët e mbrojtjes, mund të kishin pasur një tendencë për të kundërshtuar anëtarët femra të jurisë. Gjykata, së pari, kujtoi se një politikë apo një masë që ka pasoja jo të barabarta mbi një grup njerëzish mund të konsiderohet diskriminuese edhe kur nuk drejtohet konkretisht ndaj atij grupi, dhe se duheshin paraqitur arsye shumë bindëse, para se të lejohej një ndryshim në trajtim në bazë seksi që të ishte i pajtueshëm me Konventën. Ajo shprehu mendimin se arsyet e nxjerra nga qeveria, nuk ishin mjaftueshmërisht bindëse: faktorët e dytë dhe të tretë nuk shpjegonin numrin shumë të ulët të grave të regjistruara në listën e anëtarëve të jurisë dhe se, gjithsesi, faktet e parashtruara nuk përbënin një justifikim të vlefshëm.<sup>93</sup>

<sup>90</sup> Thorne *kundër* MB, kërkesa nr. 28091/02, Vendimi i 13 janarit 2009, Shih po ashtu çështjen Blackgrove *kundër* MB, kërkesa nr. 2895/07, Vendimi i 28 prillit 2009; dhe çështje të tjera.

<sup>91</sup> ECtHR, 22 Feb. 1994, *Burghartz kundër* Switzerland, Series A No 280-B. Kur vinte puna për të zgjedhur një mbiemër, gratë lejoheshin të kishin mundësinë për të shtuar mbiemrin e tyre tek mbiemri i familjes, vetëm sepse zgjedhja automatike e mbiemrit, sipas ligjit në diskutim, ishte mbiemri i burrit. Bashkëshortët mund të merrnin emrin e gruas, vetëm po të tregonin një interesim të ligjshëm. Gjykata i njohu si burrin edhe gruan si viktimë, duke konstatuar se kjo çështje u takonte të dy bashkëshortëve.

<sup>92</sup> Tek *Unal Tekeli*, Gjykata citoi një numër instrumentesh ndërkombëtare ligjorë të OKB-së dhe të Këshillit të Europës për të mbështetur qëndrimin e saj, dhe iu referua faktit se Turqia ishte i vetmi Shtet Anëtar i cili i mbante dispozitat diskriminuese për mbiemrin. *Unal Tekeli v Turqisë*, No. 29865/96, Gjykimi i 16 nëntorit 2004.

<sup>93</sup> *Zarb Adami kundër* Maltës gjykimi i 20 qershorit 2006: Si rrjedhojë, Gjykata konstatoi se kishte pasur një shkelje të Nenit 14, i lexuar bashkë me Nenin 4 § 3 (d).

Pjesa tjetër e çështjeve mund të klasifikoheshin sipas ndryshimeve midis grave dhe burrave, që u paraqitën si justifikim. Tek çështja Abdulaziz, Cabales dhe Balkandali kundër MB<sup>94</sup>, Schuler-Zraggen kundër Svicrës<sup>95</sup>, Wessels-Bergervoet kundër Holandës<sup>96</sup>, dhe Willis kundër MB<sup>97</sup>, modelet e ndryshme të punës së grave dhe burrave u paraqitën si një justifikim. Abdulaziz, Cabales dhe Balkandali kundër MB-së, kish të bënte me një kundërshtim të rregullave të emigracionit, të cilat vendosnin kufizime më të ashpra për emigrantet femra se sa për emigrantët meshkuj, të vendosur në Mbretërinë e Bashkuar për të marrë leje hyrjeje dhe qëndrimi në atë vend për burrat dhe të fejuarit e tyre jo shtetas. Qeveria u orvat ta përligjte këtë ndryshim me arsyen e ndikimit të ndryshëm të burrave emigrantë në tregun e brendshëm të punës, që ajo përpiqej të mbronte, në dritën e asaj që ajo e përshkroi si një fakt statistikor se, burrat në moshë pune, kishin më të ngjarë të kërkonin punësim se sa gratë. Ajo gjithashtu u mbështet shumë në cakun e vlerësimit në fushën e kontrollit të emigracionit dhe të çështjeve socio - ekonomike. Megjithatë, Gjykata refuzoi t'i lejonte shtetit një cak të gjerë vendosje. Ajo konstatoi se edhe nëse kishte ndryshime midis burrave dhe grave në lidhje me ndikimin e tyre në tregun e brendshëm,<sup>98</sup> këto ndryshime nuk ishin aq të rëndësishme sa të përligjinin ndryshimin në trajtimin mbështetur në seks.

Willis kundër MB, Wessels-Bergervoet kundër Holandës dhe Schuler-Zraggen kundër Zvicrës kish të bënte me mohimin e diskriminimit të përfitimeve sociale në bazë të prezumimeve rreth ndryshimeve në modelet e punës të grave dhe burrave. Wessels-Bergervoet kishte të bënte me një kundërshtim të uljes në masën e pensionit të një gruaje, për shkak të statusit të siguar të burrit të saj, që qeveria u orvat ta justifikonte me “faktin” se, në kohën në fjalë, burrat ishin kryesisht fituesit e të ardhurave. Willis kundërshtonte mosdhënien e një pagese prej të veje apo një nëne të ve një burri, kur një gruaje në kushte të ngjashme do t'i ishin dhënë pagesa të tilla, të cilat qeveria kërkonte t'i përligjte me “faktin” se gratë kishin më të ngjarë të ishin të varura financiarisht nga burrat. Schuler-Zraggen kish të bënte me mohimin e një pensioni invaliditeti një gruaje, me shkakun se gratë me fëmijë të vegjël nuk punonin. Gjykata ndërmori një shqyrtim të ngurtë dhe pa se arsyet e nxjerra nuk ishin aq “me peshë”, edhe pse prezumimet mbi të cilat mbështeteshin ishin të vërteta.<sup>99</sup>

<sup>94</sup> Abdulaziz, Cabales and Balkandali v UK ECtHR, Ser. A, No. 94 (28 May 1985).

<sup>95</sup> Schuler-Zraggen v Switzerland, Judgment of 24 June 1993, A 263.

<sup>96</sup> Wessels-Bergervoet kundër Holandës (dec.), no. 34462/97, 3 October 2000.

<sup>97</sup> Willis v Mbretërisë së Bashkuar App. No. 36042/97, Judgment of 11 June 2002.

<sup>98</sup> E ndërsa Gjykata e pranoi se në kohën përkatëse, kishte mesatarisht më shumë burra se gra në moshë pune që ishin ekonomikisht aktivë, çka ishte e vërtetë edhe për emigrantët, ajo nënvizoi se kjo nuk do të thoshte se në të vërtetë ekzistonte një dallim, duke pasur parasysh faktin se kishte më shumë gra se burra emigrante në MB përpara se të futej ligji i diskutuar, dhe në dritën e disa burrave “ekonomikisht aktivë” që më shumë se kërkonin, në fakt krijonin punë.

<sup>99</sup> Shih gjithashtu Pauger kundër Austria, Komiteti i të Drejtave të Njeriut, Komunikimi Nr.415/1990, 26 mars 1992. Duke u dhënë të vejava pension të plotë, pavarësisht nga të ardhurat, dhe duke u dhënë burrave të ve vetëm pensione të pjesshme, ligjet e pensionit shpjen në diskriminim. Për shkak se një trajtim i tillë i pabarabartë mbështetet në stereotipe rreth gjinisë dhe nuk ka një justifikim të arsyeshëm, kjo përbën një shkelje të Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike.

Tek Van Raalte kundër Holandës<sup>100</sup> dhe Karlheinz Schmidt kundër Gjermanisë<sup>101</sup>, qeveria paraqiti ndryshimet biologjike si një justifikim. Van Raalte kish të bënte me një kundërshtim ndaj vendosjes së një moshe më të vjetër për *burrat pa fëmijë* në lidhje me detyrën për të paguar kontribute për kujdesin ndaj fëmijëve, kur gratë në të njëjtën kategori përjashtoheshin, gjë që qeveria u përpoq ta përligjë me shkakun e aftësive të ndryshme riprodhuese të grave dhe burrave. Karlheinz Schmidt kundër Gjermanisë kundërshtoi vendosjen e taksës për të paguar *një pagesë për shërbimin e zjarrit* vetëm për burrat, që qeveria u orvat ta justifikonte në bazë të nevojës për të mbrojtur gratë për shkak të “tipareve të tyre fizike dhe mendore”. Gjykata vendosi se ndryshimet ishin tej-përgjithësuar dhe gjithsesi nuk lidheshin me çështjet në diskutim: vendosja e një takse në çështjen Van Raalte nuk lidhej me të drejtën për përfitime, ndërsa detyrimi ishte me natyrë financiare tek Karlheinz Schmidt. Si rrjedhojë ajo konstatoi një shkelje të Konventës në të dy rastet.

Tek Weller kundër Hungary,<sup>102</sup> kërkuesit, një baba dhe dy djemtë binjakë, ishin shtetas hungarezë që ishin lindur në 1974 dhe 2005, respektivisht, dhe jetojnë në Budapest. Duke u mbështetur në Nenin 14, të marrë së bashku me Nenin 8 (e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare). Kërkuesit u ankuan se ju ishin mohuar *përfitimet e lindjes* në 2005, për faktin se nëna e fëmijëve nuk kish të drejtë për shkak të shtetësisë së saj. GjEDNj-ja mendoi unanimisht se bëhej fjalë për një shkelje, në lidhje me të gjithë kërkuesit, të Nenit 14, të marrë së bashku me Nenin 8 të Konventës, sepse ajo konstatoi se nuk kish asnjë justifikim për t’i mohuar babait natyror, një shtetas hungarez, dhe të gjithë familjes së tij, përfitimet e lindjes, që synonin të mbështesin fëmijët e porsalindur, me justifikimin se nëna e fëmijëve nuk kish shtetësinë hungareze.

Tek Brauer kundër Gjermanisë<sup>103</sup>, Gjykata nuk gjeti dot asnjë bazë me të cilën sot të mund të justifikohet diskriminimi i mbështetur në *lindjen jashtë martese*. Në fakt, duke pasur parasysh kontekstin evolues evropian në këtë sferë, si dhe rëndësinë e dhënë barazisë midis fëmijëve të lindur brenda dhe jashtë martese nga Shtetet Anëtare të Këshillit të Europës, të nënvizuar nga Konventa Europiane për Statusin Ligjor të Fëmijëve të Lindur Jashtë Martese të vitit 1975, aspekti i mbrojtjes të “pritshmërisë së ligjshme” të të vdekurve dhe familjeve të tyre, duhej të varej nga trajtimi imperativ i barabartë midis fëmijëve të lindur jashtë dhe brenda martese. Si rrjedhojë, kishte një shkelje të Nenit 14 të KEDNj-së e marrë bashkë me Nenin 8.

<sup>100</sup> Van Raalte v Holandës (1997).

<sup>101</sup> Karlheinz Schmidt kundër Gjermanisë, vendimi i 18 korrikut 1994, Seria A nr. 291-B.

<sup>102</sup> Weller kundër Hungary, Kërkesa Nr. 44399/05, Vendimi i 31 marsit 2009.

<sup>103</sup> Brauer kundër Gjermanisë, Kërkesa Nr. 3545/04, Vendimi i 28 majit 2009.

### 3.2.3. Dhuna në familje si shkelje e Nenit 14

Në çështjen e vendosur kohët e fundit *Opuz kundër Turqisë*<sup>104</sup> kërkuësja pretendonte se autoritetet turke nuk kishin mbrojtur të drejtën e jetës së nënës dhe se kishin qenë neglizhentë përpara dhunës së përsëritur, kërcënimeve me vdekje dhe lëndimeve, të cilave ajo vetë iu ish nënshtruar. Ajo u mbështet tek Nenet 2 (e drejta e jetës), 3 (ndalimi i torturës dhe trajtimit çnjerëzor apo degradues), 6 (e drejta për një gjykim të ndershëm brenda një kohe të arsyeshme) dhe 13 (e drejta për një zgjidhje të efektshme). Ajo u ankua më tej për mungesën e mbrojtjes së grave ndaj dhunës në familje sipas të drejtës së brendshme turke, në shkelje të Nenit 14 (ndalimi i diskriminimit).

Gjykata mori parasysh se, në rastin e kërkuësës, dhuna e tejshtme, në fakt, sulmi vdekjeprurës, kishte qenë jo vetëm i mundur por edhe i parashikueshëm, duke pasur parasysh historinë e sjelljes së dhunshme të H.O., dhe biografinë kriminale në lidhje me të shoqen dhe nënën e saj, si dhe kërcënimet e tij të vazhdueshme për shëndetin dhe sigurinë e tyre. Si kërkuësja ashtu edhe e ëma, kishin vuajtur lëndime fizike në shumë raste dhe i ishin nënshtruar trysnisë psikologjike dhe kërcënimeve të vazhdueshme me vdekje, që rezultuan në dhimbje dhe frikë. Dhuna ish përshkallëzuar në një shkallë të tillë sa që H.O.-ja kish përdorur armë vdekjeprurëse si thikë dhe armë automatike. Nëna e kërkuësës ishte bërë shënjestër e dhunës si pasojë e përfshirjes së saj të hamendësuar në marrëdhënien e çiftit; edhe fëmijët e çiftit mund të konsideroheshin si viktima për shkak të efekteve psikologjike të dhunës së vazhdueshme në shtëpi. Në lidhje me vrasjen e nënës së kërkuësës, H.O. e kish planifikuar sulmin, meqenëse mbante me vete një thikë dhe pushkë dhe ishte sjellë rreth shtëpisë së viktimës përpara sulmit.

Në lidhje me Nenin 14, së pari, Gjykata shqyrtoi dispozitat që lidheshin me diskriminimin ndaj grave dhe dhunën, sipas disa prej instrumenteve të specializuara të të drejtave të njeriut, në veçanti sipas *CEDAW-t* dhe Konventës Belem do Para, si edhe dokumentet përkatës dhe vendimet e organeve ligjore ndërkombëtare, si Komisioni i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut, dhe Komisioni Ndër-Amerikan. Nga rregullat dhe parimet e të Drejtës ndërkombëtare, të pranuar nga shumica e Shteteve, doli se mosveprimi i Shtetit - edhe kur ishte i paqëllimshëm-për të mbrojtur gratë nga dhuna në familje, shkelte të drejtën e grave për mbrojtje të barabartë nga ligji.

Sipas raporteve të paraqitura nga kërkuësja, të përgatitura nga dy organizata kryesore jo qeveritare, Diyarbakır Bar Association dhe

<sup>104</sup> *Opuz kundër Turqisë*, Kërkesa Nr 33401/02, Vendimi i 9 qershorit 2009.

Amnesty International, dhe të pakontestuara nga Qeveria, numri më i madh i viktimave të raportuara të dhunës në familje ishte në Diyarbakır, ku kërkuesja pat jetuar në periudhën në fjalë. Të gjitha këto viktima ishin gra, shumica e madhe e të cilave ishin me origjinë kurde, analfabete, apo me një shkallë të ulët arsimit dhe, përgjithësisht, pa ndonjë burim të pavarur të ardhurash.

Në fakt, raportet sugjeronin se, dhuna në familje, ish lejuar nga autoritetet dhe se, mjetet rregulluese të vëna në dukje nga Qeveria, nuk kishin funksionuar në mënyrë të efektshme. Studimet treguan se pavarësisht Ligjit Nr. 4320, kur viktimat raportonin në polici rastet e dhunës, oficerët e policisë nuk i hetonin ankesat e tyre, por kërkonin të merrnin rolin e ndërmjetësit, duke u përpjekur t'i bindnin viktimat të ktheheshin në shtëpi dhe t'i tërhiqnin ankesat. Vonesat ishin të shpeshta në dhënien e urdhër ndalimeve sipas Ligjit Nr. 4320, duke pasur parasysh qëndrimin negativ të oficerëve të policisë dhe se, gjykatat i trajtonin urdhër ndalimet si një formë veprimi për divorc. Për më tepër, autorët e dhunës në familje nuk merrnin dënime zbindëse; gjykatat i zbusnin dënimet me shkakun e zakoneve, traditave dhe nderit.

Si rrjedhojë, Gjykata arriti në përfundimin se kërkuesja kish qenë në gjendje të tregonte se dhuna në familje prekte kryesisht gratë dhe se pasiviteti i përgjithshëm dhe diskriminues i gjyqësorit në Turqi krijonte një klimë që shpinte në dhunë në familje. Duke mbajtur parasysh këtë, dhuna e pësuar nga kërkuesja dhe nëna e saj, mund të shihet si dhunë me bazë gjinore, e cila përbente një formë diskriminimi ndaj grave. Pavarësisht reformave të kryera nga Qeveria vitet e fundit, mosreagimi i përgjithshëm i sistemit gjyqësor dhe mosndëshkimi i dhunuesve, siç u pa në çështjen e kërkueses, tregonte se kishte një angazhim të pamjaftueshëm për të marrë veprimet e duhura për trajtimin e dhunës në familje. Si pasojë, Gjykata erdhi në përfundimin se kish pasur një shkelje të Nenit 14, në lidhje me Nenet 2 dhe 3 të KEDNj-së.

### 3.2.4. Të Drejtat e Njeriut dhe Barazia e Grave kundër të Drejtave Fetare

Tek *D. kundër Francës*, Komisioni European për të Drejtat e Njeriut shqyrtoi ankesën e një anëtari të përkushtuar të besimit hebraik, sipas të cilit urdhri i Gjykatës franceze të Apelit kish shkelur lirinë e tij të ndërgjegjes dhe besimit, sipas Nenit 9 të KEDNj-së.<sup>105</sup> Gjykata kish urdhëruar ankimesin t'i paguante dëmshpërblim ish gruas së tij për refuzimin që ai pat treguar, si pasojë e zgjidhjes së martesës mes tyre, për t'i dërguar një letër për hedhjen poshtë të martesës (ghet) siç kërkohet sipas të drejtës hebraike, për të përfunduar procedurën e zgjidhjes fetare të martesës me qëllim që t'u jepej mundësi bashkëshortëve të rimartoheshin. Komisioni shpalli se nuk kishte ndonjë shkelje të Nenit 9. Argumenti i përdorur nga Komisioni ishte se, refuzimi për të dorëzuar letrën e hedhjes poshtë

<sup>105</sup> *D. kundër Francës*, Decisions and Reports, Nr 35-39 (shkurt 1984) 199.

të martesës, nuk ishte shfaqje e besimit apo praktikës fetare. Me këtë vendim, Komisioni pranoi deklarin e Gjykatës franceze të Apelit sipas të cilit “Sipas ligjit hebraik, është e zakonshme që të dorëzohet një letër për marjen fund të martesës pasi është shpallur divorci, dhe asnjë burri me besim të vërtetë fetar nuk do t’i shkonte ndërmend të vononte dërgimin e kësaj letre ish gruas së tij”.

Në çështjen e 1993 *Senay Karaduman kundër Turqisë*, Komisioni Europian la në fuqi vendimin e gjykatave turke për ndalimin e mbajtjes së shamive islamike në mjediset e universitetit: “Komisioni është i mendimit se duke zgjedhur të ndjekë studimet e larta në një universitet laik, studenti apo studentja i nënshtrohet rregullave të universitetit, të cilat mund t’ia kufizojnë lirinë studentëve për të shfaqur fenë në lidhje me vendin dhe mënyrën e synuar, me qëllimin për të siguruar bashkëzistencën harmonike midis studentëve dhe besimeve të ndryshme. Veçanërisht në vendet ku shumica e madhe e popullsisë është e një besimi të caktuar, manifestime pa kufizim të respektit dhe simboleve të asaj feje, për sa i përket vendit dhe mënyrës së shprehjes, mund të përbëjnë trysni ndaj studentëve të tjerë, që nuk e praktikojnë atë fe, apo ndaj atyre që ndjekin një besim tjetër”.<sup>106</sup>

Në çështjen e vitit 2004 të *Leyla Sahin kundër Turqisë*,<sup>107</sup> problemi i të drejtave të grave për barazi ishte një çështje substanciale për këtë vendim. GjEDNj -ja nuk e ndryshoi ndalimin nga Turqia të mbajtjes së shamive islamike në mjediset e Universitetit. Gjykata vendosi unanimisht se kishte ndërhyrje në të drejtën e myslimanëve të shfaqnin fenë e tyre, por kjo ndërhyrje parashihej me ligj dhe, e mbështetur në parimin e laicizmit dhe barazisë së grave dhe burrave, ishte e ligjshme. Në çështjen *Leyla Sahin kundër Turqisë*, Gjykata për herë të parë shpalli se parimi i barazisë gjinore ishte “një nga parimet kyç që përshkonin Konventën”.<sup>108</sup> Gjykata nuk e diskutoi shprehimisht kuptimin e barazisë gjinore dhe se si veprimet e kërkueses kërcënonin të drejtat e grave, apo se si parimi mund të përligjte ndalimin e një gruaje në moshë madhore të ndiqte atë që dukej se ishte një praktikë e përqafuar lirisht dhe me rëndësi personale.<sup>109</sup> Gjithashtu ajo nuk hetoi pasojat që do të kishte ky ndalim për kërkuesen<sup>110</sup> dhe për mijëra gra të tjera në Turqi, të cilat nuk do të mundeshin të kishin qasje në arsimim.<sup>111</sup> Në këtë mënyrë, dukej sikur Gjykata e përjashtoi Leylan dhe gra të tjera që mbanin “shaminë e fesë islame” nga kategoria e grave, të drejtat dhe barazia e të cilave duhej mbrojtur.

<sup>106</sup> *Senay Karaduman kundër Turkey*, Vendim, Nr16278/90, 3 maj 1993.

<sup>107</sup> *Leyla Sahin kundër Turkey*, kërkesa Nr. 44774/98, Vendimi i 29 qershorit 2004.

<sup>108</sup> Në para 107 të Vendimit.

<sup>109</sup> Kërkesja pretendonte se atë nuk e kishin detyruar të mbante shami, por se ajo e konsideronte këtë si detyrë fetare. Ajo ishte shumë e bindur për të mbajtur vello, sa që e shpuri çështjen në GjEDNj dhe shkoi në Vjenë për të studiuar. Për më tepër, ajo deklaroi shprehimisht se nuk synonte të ushtronte ndonjë ndikim tek gratë e tjera për të mbajtur shami.

<sup>110</sup> Ndalimi jo vetëm e pengoi atë që të studionte në Turqi, por mund ta ketë penguar edhe të jetojë në Turqi, meqenëse ajo nuk do të kish mundësi të ushtronte mjekësinë aty. Kjo gjë pati një ndikim negativ jo vetëm në jetën e saj, por edhe në shoqërinë turke.

<sup>111</sup> Sikurse u vu në dukje nga Human Rights Watch, vendimi i mohon arsimin dhe shanse për karrierë një numri të madh grash turke të cilat mbajnë shami: shih Human Rights Watch, Memorandum to the Turkish Government on Human Rights Watch’s Concerns with Regard to Academic Freedom in Higher Education, and Access to Higher Education for Women Who Wear the Headscarf, 29 qershor 2004, gjendet në: [http://hrw.org/backgrounder/eca/turkey/2004/headscarf\\_memo.pdf](http://hrw.org/backgrounder/eca/turkey/2004/headscarf_memo.pdf); Human Rights Watch, Turkey: Headscarf Vendimi mohon arsimimin dhe karrierën e grave, 16 nëntor. 2005, gjendet në: <http://hrw.org/english/docs/2005/11/16/turkey12038.htm>. Ky gjykim gjithashtu mund të armiqësojë myslimanët, gjë që mund të shpjerë në një rritje të fundamentalizmit, me pasojat negative për gratë myslimane.

Tek çështja Dahlab kundër Zvicrës,<sup>112</sup> Gjykata konstatoi se mbajtja e shamisë së kokës binte ndesh me parimin e barazisë, edhe pse kërkuesja, mësuese e shkollës fillore, e cila u ndalua të mbante shami në kokë gjatë mësimdhënies, argumentoi se ndalimi i saj të mbante shami në kokë dhe “shenja të tjera të dukshme fetare” përbënin diskriminim në bazë seksi. Ajo pretendonte se një burrë i fesë myslimane mund të jepte mësim në shkollë pa iu nënshtruar asnjë forme ndalimi, ndërsa një grua që ka besim të njëjtë, duhet të përmbahej nga ushtrimi i fesë së saj me qëllim që të kish mundësi të jepte mësim.

Gjykata shpalli se masa nuk i drejtohej asaj si anëtare e seksit femër, por se masa e marrë ndiqte qëllimin e ligjshëm të sigurimit të neutralitetit, dhe se ajo masë mund të zbatohet kollaj edhe për “një burrë... i cili vishte tesha që e bënin atë lehtësisht të dallueshëm si një anëtar të një besimit të ndryshëm”, kështu që nuk konstatoi ndonjë shkelje.

### 3.2.5. Barazia Gjinore dhe e Drejta e Familjes

Tek çështja Marckx kundër Belgjikës,<sup>113</sup> GjEDNj-ja shpalli se, një ligj i paligjshëm, që e lejon një familje të formohet vetëm përmes një akti formal njohje nga ana e nënës, dhe që ia kufizon asaj zotësinë që t'i japë apo t'i dhurojë *pronë* fëmijës, është diskriminues dhe shkel të drejtën e respektimit të së drejtës së familjes dhe të drejtës së gëzimit paqësor të pasurive të garantuara nga KEDNj-ja.

Tek X kundër Mbretërisë së Bashkuar, GjEDNj-ja deklaroi se, e drejta e jetës familjare sipas KEDNj-së, nuk i jep burrit të drejtën të këshillohet apo të pengojë të shoqen për të abortuar; pengimi i tij për të ndërhyrë në abortin e të shoqes është i nevojshëm për mbrojtjen e të drejtave të saj.<sup>114</sup>

Tek Christine Goodwin kundër Mbretërisë së Bashkuar,<sup>115</sup> GjEDNj-ja shpalli se mohimi i njohjes ligjore të *ndryshimit të gjinisë së një transeksuali* shkel si të drejtën për të pasur jetën e vet private, ashtu edhe të drejtën për t'u martuar dhe pasur një familje, sipas Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut. Që një qeveri të ndërhyjë në të drejtën e një individi për respektimin e jetës së vet private, duhet që faktorët e interesit publik të mbizotërojnë ndaj interesit individual.

Për më tepër, tek Dudgeon kundër Mbretërisë së Bashkuar,<sup>116</sup> GjEDNj-ja vendosi se e drejta penale, që ndalon *sjelljen homoseksuale*, ndërhyr në të drejtën e respektimit të jetës private, e cila përfshin jetën seksuale, të garantuar nga Neni 8(1) i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut. Çdo ndërhyrje e qeverisë në aspektet më intime të jetës private, duhet të përliqet me arsye veçanërisht serioze.

<sup>112</sup> Dahlab kundër Switzerland, Kërkesa Nr. 42393/98, Vendim i 15 shkurtit 2001.

<sup>113</sup> GjEDNj Marckx kundër Belgium, Kërkesa Nr. 8416/78, Seria A, Nr. 31, 13 qershor 1979, vendimi i 13 majit 1980.

<sup>114</sup> GjEDNj X. kundër Mbretërisë së Bashkuar, Kërkesa Nr. 8416/78, Vendimi i 13 majit 1980.

<sup>115</sup> GjEDNj Christine Godwin kundër Mbretërisë së Bashkuar, Kërkesa Nr. 28957/95, Gjykimi, Strasbourg, 11 korrik 2002.

<sup>116</sup> GjEDNj Dudgeon kundër Mbretërisë së Bashkuar, gjykimi i 22 Tetorit 1981, kërkesa No 7525/76, Seria A, Nr.45, 23 shtator 1981.

## 3.3. JURISPRUDENCA E GJYKATËS EUROPIANE TË DREJTËSISË PËR BARAZINË GJINORE

### 3.3.1. Paga e barabartë

Tek Defrenne I,<sup>117</sup> Gjykata duhej të shqyrtonte marrëdhënien midis konceptit të pagesës në Nenin 119 të KE-së dhe sistemet e sigurimeve shoqërore. Znj. Defrenne punonte si stjuardesë dhe kur mbushi 40 vjeçe, në përputhje me Nenin 5 të kontratës së saj të punës, e cila parashikonte se gratë duhet të pushojnë së qeni anëtarë të ekuipazhit kur mbushin moshën 40 vjeç, kontrata e saj u ndërpre. Ajo bëri një kërkesë në Gjykatën e Shtetit belg, për anulimin e Dekretin mbretëror të 3 nëntorit 1969, i cili përcaktonte disa rregulla specifike në lidhje me pensionet e vjetërsisë dhe pensionet e mbijetesës dhe pensionet e të mbijetuarve të punonjësve të punësuar. Në mbështetje të kërkesës së saj, ajo pretendoi se kishte një shkelje të nenit 14 të Dekretit mbretëror Nr. 40 të 24 tetorit 1967, sipas të cilit një grua që punon mund të paraqiste një ankesë për pagë të barabartë sipas Nenit 119 të Traktatit të KEE-së. GjED-ja vendosi se edhe pse konsiderata në formën e përfitimeve të sigurimeve shoqërore nuk është e huaj për konceptin e pagesës, ky koncept nuk përfshin këto skema apo përfitime të sigurimeve shoqërore, në veçanti, pensionet e daljes në pension, të cilat rregullohen drejtpërdrejt nga legjislacioni pa asnjë element marrëveshje sipas sipërmarrjes apo degës profesionale në fjalë, dhe që zbatohen, me detyrim, për të gjitha kategoritë e punonjësve. Këto skema përgjithësisht janë çështje të politikës së përgjithshme shoqërore.

Ndërkohë, GjED-ja gjithashtu u përball me çështje që kishin të bënin me pensionet. Pas një periudhe pasigurie në lidhje me çështjen nëse dhe deri në ç'shikallë pensionet e punës mbulohen nga parimi i pagës së barabartë, GjED-ja vendosi në vendimin e famshëm Barber, duke u mbështetur në atë që kish thënë ndërkohë tek çështja Defrenne I, se Neni 119 i KE-së nuk vlen për skemat të cilat janë:

- 1 rrjedhojë ose e një marrëveshje midis punëmarrësve apo punëdhënësve apo të një vendimi të njëanshëm të punëdhënësit;
- 2 të financuara plotësisht nga punëdhënëse ose si nga punëdhënësi ashtu dhe nga punëmarrësi; dhe
- 3 ku lidhja me këto skema vjen nga marrëdhënia e punësimit me një punëdhënës të caktuar.

Gjykimi tek Barber dhe praktika gjyqësore që pasoi, patën si rrjedhojë, ndër të tjera, se aspekte të caktuara të Direktivës së Skemës Profesionale, binin ndesh me Nenin 119 të KE-së dhe duhej të ndryshoheshin.

<sup>117</sup> ECJ 13 January 1971, Case 80/70 Defrenne kundër. Belgian State [1971] (Defrenne I) ECR 445.

Një çështje e rëndësishme në rastet e pagës së barabartë është gjithnjë nëse puna e kryer nga një punëmarrëse femër është e barabartë me punën e kryer nga një punëmarrës mashkull. Në këtë drejtim, GjED-ja ka vendosur që Neni 110 i KE-së të përdoret gjithashtu edhe për “*punë me vlerë të barabartë*”. Për sa i takon krahasimit të pagës që merr punëmarrësi femër dhe mashkull, GjED-ja theksoi në çështjen *Barber* nevojën për transparencë të vërtetë, duke lejuar një shqyrtim të efektshëm. Kjo gjë arrihet vetëm nëse parimi i pagës së barabartë respektohet në secilin prej elementëve të shpërblimit që u jepet burrave dhe grave. Krahasime gjithëpërfshirëse apo globale të të gjitha konsideratave të dhëna burrave dhe grave nuk lejohen.<sup>118</sup> Kjo nënkupton se shpesh krahasimi duhet të bëhet midis punës së kryer dhe pagës së marrë nga punëtorët meshkuj dhe femra.

Tek Defrenne II faktet ishin të njëjta si në çështjen Defrenne I, por këtu kemi të bëjmë me një aspekt tjetër që lidhet me pagë të barabartë për punë të barabartë. Znj. Defrenne bëri padi përpara një gjykata për kompensim për humbjen që kish pësuar në drejtim të pagës, shpërblimit për përfundimin e kontratës dhe pensionit në krahasim me anëtarët meshkuj të ekuipazhit që kryenin detyra të njëjta. Gjykata belge e referoi çështjen në GjED për dy arsye. Së pari, nëse Neni 119 i Traktatit të Romës ka efekt të drejtpërdrejt dhe u jep të drejtë punëtorëve të nisin procedurat përpara një gjykate të vendit për të siguruar respektimin e tij, dhe në rast se po, nga cila datë. Së dyti, Gjykata shtroi pyetjen nëse Neni 119 zbatohet drejtpërdrejt në Shtetet Anëtare, apo nëse duhet miratuar me ligjet e vendit, dhe kështu nëse vetëm institucionet e vendit ishin kompetente për këtë çështje. GjED-ja vuri në dukje se *Neni 119 kish zbatim të drejtpërdrejtë* dhe se ndalimet vlenin jo vetëm për diskriminimin në bazë seksi, që rridhte nga kontratat individuale, por edhe nga marrëveshjet kolektive dhe legjislacioni.<sup>119</sup>

Në 1979, Znj. Smith pretendonte se për shkak të seksionit 1 (1) dhe (2) të Aktit të Pagës së Barabartë të 1970, paga e saj duhet të ishte e njëjtë me *pagën e profesorit* të saj, Z. McCullough. Gjykata në Londër e referoi çështjen në GjED për një vendim paraprak. Gjykata theksoi në vendimin e saj<sup>120</sup> se Shtetet Anëtare ishin të detyruara të siguronin zbatimin e parimit të pagës së barabartë për punë të barabartë sipas Nenit 119 të Traktatit të Romës, dhe se dispozita kish efekt të drejtpërdrejt në raste diskriminimi të drejtpërdrejt dhe të hapur pa pasur nevojë të mëtejshme për masa të tjera më të hollësishme zbatuese nga Komuniteti apo Shtetet

<sup>118</sup> GjED 17 maj 1990, C-262/88 Douglas Harvey Barber kundër Guardian Royal Exchange Group [1990] (Barber), ECR 1990, I-1889, tek paras 33-34.

<sup>119</sup> GjED, 8 prill 1976, Case 43/75 Gabrielle Defrenne kundër Société Anonyme Belge de Navigation Aérienne Sabena [1976] ECR 455 (Defrenne II), në paragrafët 21-22.

<sup>120</sup> GjED Çështja 129/79, Macarthy Ltd kundër Wendy Smith, [1980] ECR 1275.

Anëtare. Diskriminimi i drejtpërdrejtë dhe i hapur mund të përcaktohet vetëm mbi bazën e kriterit të pagës së barabartë për punë të barabartë të përcaktuar në Nenin 110, dhe nëse ka pasur dallime në pagë për gratë dhe burrat që kanë kryer të njëjtën punë. Meqë çështja ka qenë cilësore dhe ka pasur të bëjë me natyrën e shërbimeve në fjalë, ajo nuk u kufizua nga kërkesa e njëkohshmërisë. Megjithatë, Gjykata vuri në dukje se mund të kishte dallime të tjera në pagesë midis dy punonjësve që bënin të njëjtën punë por në kohë të ndryshme, që shkaktohen nga faktorë që nuk lidhen me seksin. Kriteret për vlerësimin e çështjeve të tilla duhen vendosur nga gjykata e vendit.

Gjykata vendosi se parimi që burrat dhe gratë duhet të marrin pagë të barabartë për punë të barabartë sipas Nenin 119 nuk kufizohet për situata ku burrat dhe gratë janë të punësuar njëkohësisht për punë të barabartë tek i njëjti punëdhënës. Gjykata vazhdoi të deklarojë se parimi i Pagës së Barabartë që përcaktohet në Nenin 119 zbatohet për ato raste ku është përcaktuar se, duke pasur parasysh mirë natyrën e shërbimeve të saj, një grua ka marrë një pagesë më të vogël se sa një burrë që është punësuar aty përpara kohës së punësimit të gruas dhe që ka bërë të njëjtën punë për punëdhënësin.

Në çështjen Rummler,<sup>121</sup> GjED-ja hetoi *kashtet e shpërblimit* në industrinë e shtypshkronjave e cila ishte rregulluar përmes një marrëveshjeje kuadër posaërisht për punonjësit e industrisë së shtypshkronjave në territorin e Republikës Federale të Gjermanisë, duke përfshirë këtu edhe Berlinin perëndimor (Lohnrahmentarifvertrag für die gewerblichen Arbeitnehmer der Druckindustrie im Gebiet der Bundesrepublik Deutschland, einschließlich Berlin-West) të 6 korrikut 1984. Kjo marrëveshje parashikonte shtatë grupime pagash të cilat përcaktoheshin sipas aftësive të kërkuara për punën që duhej bërë, të tilla si shkalla e njohurive, përqendrimi, kërkesa për forcë fizike (muskulore) apo përpjekja dhe përgjegjësia. Çështja u dërgua në GjED për të përcaktuar nëse ky kriter klasifikimi ishte në përputhje me Direktivën e Këshillit 75/117/të KEE-së të 10 shkurtit 1975 për përafrimin e legjislacionit të Shteteve Anëtare në lidhje me zbatimin e parimit të pagës së barabartë për burrat dhe gratë, dhe në veçanti, me Nenin 1 (1) i cili parashikonte se një sistem klasifikimi duhej të mbështetej në të njëjtat kritere si për burrat dhe për gratë dhe, si i tillë, të përjashtonte diskriminimin për shkaqe seksi. Gjykata konstatoi se përdorimi i një kriteri objektivist të matshëm nga ana sasiore, mbështetur në përpjekjen fizike, siç ishte kriteri i përpjekjes muskulore, ishte në përputhje me parimin e mosdiskriminimit. Fakti që një kriter lidhej me një punë të kryer kryesisht nga burrat nuk e bënte sistemin e klasifikimit drejtpërsëdrejtë diskriminues. Megjithatë, me qëllimin që sistemi të mos ishte diskriminues, duhej t'i kushtohej kujdes

<sup>121</sup> GjED Çështja 237/85 Gisela Rummler kundër Dato-Druck GmbH [1986] ECR 2101.

punëve që kërkonin aftësi ku gratë kanë prirje të posaçme. Për më tepër që kriteret që përcaktonin klasifikimin e shkallëve të pagës të mos ishin diskriminues, duhet të sigurohej se puna objektivisht e njëjtë të tërheqë të njëjtën shkallë pagesë qoftë nëse kryhet nga një burrë apo nga një grua.

Gjykata vuri në dukje se duke vendos *një shkallë progresive page mbështetur në shkallën e punës dhe kërkesës për punë muskulore* mund të ketë si pasojë vendosjen e punëtoreve gra, që nuk mund të kryejnë një punë që i tejkalon aftësitë e tyre fizike, në dizavantazh. Ky dallim në trajtim megjithatë mund të justifikohet objektivisht me natyrën e aftësive që kërkohej për ta bërë punën, me synimin e sigurimit që shkalla e pagesës t'i korrespondojë përpjekjeve që kërkohej për bërjen e punës dhe për plotësimin e nevojave reale të kësaj sipërmarrje.

Parimi i pagesës së barabartë zbatohet për punë të barabartë por gjithashtu, *a fortiori, edhe për punë me vlerë më të lartë*. GjED-ja e përqafoi këtë pikëpamje në Çështjen Murphy,<sup>122</sup> duke deklaruar se ndryshe, punëdhënësi do ta kishte të lehtë t'i bënte bisht parimit të pagës së barabartë, përmes caktimit të më shumë detyrave apo të detyrave më të rënda punëtorëve të një seksi të caktuar, të cilët në këtë mënyrë mund të paguheshin me paga më të ulëta.

Tek Bötel,<sup>123</sup> GjED-ja deklaroi se kompensimi që merrnin punëmarrësit gjermanë për humbjen e të ardhurave kur *merrnin pjesë në seanca trajnimit* për një komitet të stafit, ishte “pagë”, meqenëse kjo përbënte një përfitim të paguar nga punëdhënësi për shkak të ekzistencës së marrëdhënies së punësimi. GjED-ja tek çështja Bötel shpalli se dispozitat gjermane të parashikuara me statut për kohën jashtë pune, të cilat nuk i kompensonin punëtorët, që punonin me kohë të pjesshme, për kohën e shpenzuar për trajnim jashtë orëve të zakonshme të punës, tërthorazi i diskriminonin gratë dhe binin ndesh me Nenin 119 të Traktatit të KEE-së, kur nuk ishin objektivisht të përligjura. Si rrjedhojë, Bötel ia la çështjen e justifikimit gjykatave kombëtare.

Në 1999, GjED-ja duhej të vendoste për Çështjen austriake Angestelltenbetriebsrat der Wiener Gebietskrankenkasse kundër Wiener Gebietskrankenkasse<sup>124</sup>: *Psikologë të diplomuar austriakë të punësuar si psikoterapistë, pretendonin se marrëveshjet kolektive që përcaktonin pagat minimale për ta dhe për mjekët që merrreshin me psikoterapi,*

<sup>122</sup> GjED, 4 shkurt 1988, Çështja 157/86 *Mary Murphy kundër An Bord Telecom Eireann* [1988] ECR 673 (Murphy), në paragrafët 9-10.

<sup>123</sup> GjED, 4 qershor 1992, Çështja C-360/90 *Arbeiterwohlfahrt der Stadt Berlin e.V. kundër Monika Bötel* [1992] ECR I-3589 (Bötel).

<sup>124</sup> GjED, 11 maj 1999, Çështja C-309/97 *Angestelltenbetriebsrat der Wiener Gebietskrankenkasse kundër Wiener Gebietskrankenkasse* [2002] ECR I-2865.

ishin tërthorazi diskriminuese, duke iu mundësuar mjekëve, shumica e të cilëve ishin burra, të merrnin shpërblime më të larta për punë të krahasueshme.

GjED-ja shpalli se, për të përcaktuar që puna e bërë nga njerëz të ndryshëm është “punë e njëjtë”, për qëllimet e Nenit 119 të Traktatit të KE-së, është e nevojshme të vendoset nëse këta njerëz janë në situata të krahasueshme. Këtu, faktorë të tillë si, natyra e punës dhe kërkesat për trajnim duhet të jenë me rëndësi.

Megjithëse puna mund të duket e njëjtë, në rast se kryhet nga njerëz me kualifikime profesionale dhe trajnime të ndryshme, atëherë lind nevoja të shihen detyrat që mund t'i jenë dhënë secilit grup, kërkesat për trajnim për kryerjen e këtyre detyra të tjera, plus dhe kushtet e punës në të cilat ato kryhen.

Në këtë rast, psikologët dhe mjekët e punësuar si psikologë mbështeten në njohuri dhe aftësi të ndryshme, të cilat janë përfutur në situata të ndryshme. Për më tepër, mjekët janë gjithashtu të kualifikuar të kryejnë detyra të tjera në këtë fushë, të cilat psikologët nuk i kryejnë dot. Si rrjedhojë, në këtë rast, të dy grupet e personave nuk mund të konsiderohen se janë në një situatë të krahasueshme.

### 3.3.2. Seksi si faktor përcaktues i veprimtarive profesionale

Duke qenë se qasja në punësim është një e drejtë themelore, të cilën Traktati ia jep në bazë individuale çdo punëmarrësi të Komunitetit, ekzistenca e një mjeti me natyrë gjyqësore në rastin e një vendimi të autoritetit kombëtar, që refuzon përfitimin e asaj të drejte, është esenciale me qëllim mbrojtjen e efektshme të kësaj të drejte të individit. Sikundër shpalli Gjykata në vendimin e saj për çështjen Johnston,<sup>125</sup> kjo kërkesë pasqyron një parim të përgjithshëm të së drejtës së Komunitetit, i cili thekson traditat kushtetuese të përbashkëta për Shtetet Palë dhe që përfshihet në Nenet 6 dhe 13 të KEDNj. Marguerite Johnston-it iu hoq, sipas ligjit të Irlandës së Veriut, çdo mundësi për të bërë të zbatueshme të drejtat e saj sipas Direktivës 76/207/të KEE-së, pasi Shefi i Policisë refuzoi t'i ripërtërinte kontratën e punës mbështetur në faktin se gratë oficerë të policisë ndaloheshin të mbanin armë zjarri. Gjykatat e Mbretërisë së Bashkuar u spostuan qëllimisht nga dëgjimi i ankimit të saj nëpërmjet një certifikate të lëshuar nga Sekretari i Shtetit. GjED-ja i gjykoj këto dispozita si të pafavorshme.

Në Çështjen Komisioni kundër Francës 318/86,<sup>126</sup> GjED-ja duhet të vendoste për një mosmarrëveshje që kish të bënte me *sistemin e rekrutimit*

<sup>125</sup> GjED 15 maj 1986, Çështja 222/84 Marguerite Johnston kundër Constable of the Royal Ulster Constabulary [1986] ECR 1651 (Johnston).

<sup>126</sup> GjED 30 qershor 1988, Case 318/86 Commission of the European Communities kundër French Republic [1988] ECR 3559.

*në shërbimin civil* në Francë. Është diçka e zakonshme, sipas legjislacionit francez, që i vetmi kriter për rekrutim është dhënia e pikëve një kandidati pas hyrjes në një konkurs me një konkurrues, i hapur si për burrat edhe për gratë. Megjithatë, dispozitat franceze, që përcaktojnë rregullat e parashikuara me ligj për shërbimin publik shtetëror, parashikojnë se për korpuset të ndryshme zyrtarësh, mund të organizohet rekrutim i veçantë për burrat dhe për gratë. Këto procedura rekrutimi u karakterizuan nga fakti se çdo vendim, që urdhëron mbajtjen e një konkursi, përcakton përqindjen e posteve që do t'u jepen përkatësisht burrave dhe grave. GjED-ja deklaroi se, përjashtimi i parashikuar në Nenin 2 ( 2 ) të Direktivës 76/207/të KEE-së, mund të ketë të bëjë vetëm me veprimtari të posaçme profesionale. Këto veprimtari duhet të jenë mjaftueshëm transparente, me qëllim që të lejojnë mbikëqyrjen efektive të Komisionit dhe në parim, duhet të jenë në gjendje t'i përshtaten zhvillimeve shoqërore. Këto kërkesa nuk plotësohen nga praktika e përcaktimit të përqindjes së posteve që do t'u jepen përkatësisht burrave dhe grave, në rastin e çdo konkurrimi të mbajtur për punësimin e zyrtarëve në një korpus, ku vetëm disa veprimtari përligjin rekursin e përjashtimit dhe kur asnjë dispozitë legjislative nuk përcakton ndonjë kriter objektiv për fiksimin e këtyre përqindjeve. Një praktikë e tillë e bën të pamundur ushtrimin e ndonjë forme mbikëqyrjeje, jo vetëm nga Komisioni dhe gjykatat, por edhe nga personat që preken negativisht nga masat diskriminuese.

Sipas GjED-së, në çështjen *Sirdar*,<sup>127</sup> *përjashtimi i grave nga disa njësi ushtarake* të Marinës Mbretërore hynte në gamën e përjashtimit të Direktivës 76/207/të KEE-së për trajtim të barabartë.

Nga ana tjetër, Gjermania e shkeli Direktivën, duke përfshuar qëndrimin se, përbërja e të gjitha njësive të forcave të armatosura në Bundeswehr, duhet të mbetet ekskluzivisht mashkullore. Gjykata konstatoi në çështjen *Kreil*<sup>128</sup> se, largimi nga ajo që parashikon Neni 2 (2) i Direktivës 76/207/të KEE-së për trajtimin e barabartë, mund të zbatohet për veprimtari specifike dhe se një përjashtim i tillë, nuk justifikohet me natyrën specifike të posteve në fjalë apo nga konteksti i posaçëm në të cilin kryhen veprimtaritë në fjalë.

Disa vjet më pas, në GjED<sup>129</sup> u soll çështja e *Z. Dory*: *Z. Dory* kërkonte të përjashtohet nga thirrja për të shkuar në ushtri dhe nga shërbimi i detyruar ushtarak. Në mbështetje të kësaj kërkesë, ai parashittoi se *ligji gjerman për shërbimin e detyruar ushtarak* binte ndesh me të drejtën e Komunitetit, duke cituar çështjen *Kreil*, ku Gjykata kish deklaruar se,

<sup>127</sup> GjED, 26 tetor 1999, Çështja C-273/97 *Angela Maria Sirdar kundër Army Board and Secretary of State for Defence* [1999] ECR I-07403 (Sirdar).

<sup>128</sup> GjED, 11 janar 2000, Çështja C-285/98 *Tanja Kreil kundër Bundesrepublik Deutschland* [2000] ECR I-69 (Kreil).

<sup>129</sup> GjED, 11 mars 2003, Çështja C-186/01 *Alexander Dory kundër Bundesrepublik Deutschland* [2003] ECR I-2479.

gratë nuk duhej të përjashtoheshin nga të pasurit qasje në të gjitha postet në forcat e armatosura gjermane. Autoritetet gjermane e hodhën poshtë kërkesën e tij, duke deklaruar se vendimi në rastin Kreil kish të bënte vetëm me qasjen vullnetare të grave në karriera në forcat e armatosura, dhe jo me çështjen e shërbimit të detyruar ushtarak, dhe se detyrimi për të kryer një shërbim të tillë ishte vetëm kompetencë e Shteteve Palë. GjED-ja ishte e mendimit se, e drejta e Komunitetit nuk e përjashton që shërbimi i detyruar ushtarak t'u rezervohet burrave. Sigurisht, vendimet e ShA-ve për organizimin e forcave të tyre të armatosura nuk mund të përjashtohen krejtësisht nga zbatimi i të drejtës së Komunitetit, sidomos kur bëhet fjalë për respektimin e parimit të trajtimit të barabartë të burrave dhe grave në lidhje me punësimin, duke përfshirë edhe qasjen në poste ushtarake. Por, nga kjo nuk del se e drejta e Komunitetit i drejton zgjedhjet e SHA-ve për organizimin ushtarak të mbrojtjes së territoreve të tyre, apo të interesave të tyre kryesore, siç është vendimi për të siguruar mbrojtjen e tyre pjesërisht përmes shërbimit të detyruar ushtarak.

Sipas GjED-së, tek çështja Hofmann,<sup>130</sup> Neni 2 (3) i Direktivës 76/207/ të KEE-së njih legjitimitetin, nga pikëpamja e parimit të trajtimit të barabartë, të

- 1 mbrojtjes së *gjendjes biologjike* të gruas gjatë dhe pas shtatzënisë dhe
- 2 të mbrojtjes së *marrëdhënies së veçantë midis një gruaje dhe fëmijës së saj* gjatë një periudhe që vjen pas shtatzënisë dhe lindjes së fëmijës.

Këto të drejta kanë për qëllim të sigurojnë zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë për burrat dhe gratë, në lidhje me qasjen në punësim dhe me kushtet e punës. Si pasojë, sikundër vuri në dukje GjED-ja në çështjen Thibault,<sup>131</sup> ushtrimi i këtyre të drejtave, nuk mund të bëhet subjekt i një trajtimi të pabarabartë në lidhje me qasjen e tyre në punësim apo në kushtet e punës. Në këtë prizëm, rezultati i synuar nga Direktiva 76/207/e KEE-së është barazi substantive, jo formale.

### 3.3.3. Dispozita në lidhje me mbrojtjen e grave

#### Shtatzënia

Gjatë kohës që ishte shtatzënë, Znj. Dekker kërkoi punë si instruktore në një qendër trajnimi për të rinj tek Stichting Vormingscentrum voor Jong Volwassenen (VJV). VJV e konsideroi Znj. Dekker si *kandidaten më të*

<sup>130</sup> GjED, 12 korrik 1984, Çështja 184/83 Hofmann kundër Barmer Ersatzkasse [1984] ECR 3047.

<sup>131</sup> GjED, 30 prill 1998 Çështja 136/95 Caisse nationale d' assurance vieillesse des travailleurs salariés (CNAVTS) kundër Evelyne Thibault [1998] ECR I-2011 (Thibault), në parag 24-26.

*mirë për atë punë*, por, meqë komiteti përzgjedhës ishte informuar nga Znj. Dekker se ajo ishte shtatzënë, VJV-ja refuzoi ta punësonte atë.

VJV-ja e përligji vendimin e saj me arsyen se, në rast se Znj. Dekker do të punësohej, ata duhet t'i paguanin asaj përqindjen e pagës sipas përcaktimit të ligjit holandez (dikur rreth 80-100 %) gjatë kohës që ajo ishte me leje lindje. VJV-ja mendonte se meqenëse Znj. Dekker e kish informuar shoqërinë për barrën e saj në fazën e kërkesës për punë, potencialisht, ata nuk do të mund të merrnin ndonjë kosto të pagës së lejes së lindjes së Znj. Dekker nga shoqëria e tyre e sigurimeve. Si rrjedhojë, VJV-ja nuk do të mund të punësonte një zëvendësuese për Znj. Dekker dhe do të kishte mungesë stafi.

GjED-ja<sup>132</sup> bëri të ditur se, një punëdhënës që vepron në mënyrën siç veproi VJV-ja, ishte në shkelje të Direktivës së Trajtimit të Barabartë. Gjykata ishte e mendimit se, një punëdhënës ishte në shkelje të drejtpërdrejt të parimit të trajtimit të barabartë të mishëruar në Nenet 2(1) dhe 3(1) të Direktivës së Këshillit 76/207/të KEE-së, duke refuzuar të bëjë një kontratë punësimi me një kandidatë femër, të cilën ai e konsideron të përshtatshme për punën, kur një refuzim i tillë mbështetet në pasojat e mundshme negative që mund të ketë për të punësimi i një gruaje shtatzënë, si rrjedhojë e rregullave të papërshtatshmërisë për punë, të miratuara nga autoritetet publike, të cilat e asimilojnë paaftësinë për të punuar për shkak barre dhe lehonie në paaftësinë për të punuar për shkak sëmundje.

Më tej, GjED-ja shpalli se zbatimi i Direktivës së Trajtimit të Barabartë nuk do të ndryshonte kur, në rrethanat e përshkruara më sipër, asnjë mashkull nuk kish bërë kërkesë për atë post. Në rast se një gruaje i refuzohet punësimi për shkaqe që lidhen me seksin e saj, për shembull, shtatzëni, ai është gjithnjë diskriminues.<sup>133</sup>

Problemi specifik i *sëmundjeve të lidhura me shtatzëninë* u shqyrtua në çështjen Hertz.<sup>134</sup> Kontrata e punës e Znj. Hertz nisi në korrik 1982. Ajo mbeti shtatzënë dhe mori lejen e lindjes deri në fund të 1983. Nga qershori 1984 deri në qershor 1985, ajo mori gjithsej 100 ditë leje sëmundje. Nuk u vu në diskutim se kjo sëmundje erdhi si pasojë e shtatzënisë dhe lindjes dhe lehonisë. Ajo u pushua në qershor 1985, meqenëse ishte "Një praktikë

<sup>132</sup> GjED, 8 nëntor 1990, Çështja C-177/88, Dekker kundër Stichting Vormingscentrum voor Jong Volwassenen [1990] I-3941 (Dekker).

<sup>133</sup> Çështje të tjera, GjED, 5 maj 1994, Çështja C-421/92, Habermann-Beltermann kundër Arbeiterwohlfahrt, Bezirksverband Ndb/OpferV [1994] ECR I-1657; dhe GjED, 14 korrik 1994, Çështja C-32/93, Webb kundër EMO Air Cargo (UK) Ltd [1994] ECR I-3567, konfirmoi përkatësisht se, një kontratë punësimi nuk mund t'i bëhet bisht për shkak të ndalimit sipas ligjit të vendit, të punës së natës gjatë shtatzënisë dhe se, një grua e punësuar për një periudhë të papërcaktuar, e cila hiqet nga puna për shkak se shtatzënia do ta pengojë atë të përmbushë një pjesë të asaj kontrate, ka pësuar diskriminim të drejtpërdrejt.

<sup>134</sup> GjED, 8 nëntor 1990, Çështja C-179/88, Handels-Og Kontorfunktionærernes Forbund I Danmark (që vepron në emër të Hertz) kundër Dansk Arbejdsgiverforening [1990] ECR I-3941.

normale për të hequr punëtorët nga puna për mungesa të shpeshta për shkak sëmundje” nga ana e punëdhënësit.

Gjykata e pranoi këtë mendim, duke qenë se, periudha të tilla leje sëmundje, mund të shpinin në pushimin e një burri në të njëjtat rrethana. Duke iu referuar Neni 2(3) të Direktivës 76/207/ të KEE-së, gjykata deklaroi se “aisiguronte mbrojtje gjatë lejes së lindjes, por se Direktiva nuk parashikon rastin e një sëmundje që i atribuohet shtatzënisë apo lehonisë, dhe se, “Në rastin e një sëmundje që shfaqet pas lejes së lindjes, nuk ka arsye të bëhet dallim midis një sëmundje që i atribuohet shtatzënisë apo lehonisë nga çdo lloj sëmundje tjetër. Si rrjedhojë, një gjendje e tillë patologjike mbulohet nga rregullat e përgjithshme që zbatohen në rastin e sëmundjes”.<sup>135</sup> Prandaj u mendua se duhet të zbatohen rregullat e përgjithshme që lidhen me pushime nga puna për shkak sëmundjeje dhe se pushimi nuk ishte diskriminues.<sup>136</sup>

Neni 2(3) i Direktivës 76/207/ së KEE-së, lejon që legjislacioni i vendit të largohet nga parimi i mos-diskriminimit aty ku legjislacioni ka të bëjë me “mbrojtjen” e grave, veçanërisht për sa i takon shtatzënisë dhe lindjes. Nuk ka dyshim se, ndalimi punës së natës për gratë shtatzëna, bën pjesë në gamën e një përjashtimi të tillë. Por, a del nga kjo se një punëdhënës mund të mbështetet në një legjislacion të tillë si shkak për të mos punësuar (dhe, me arsyetim paralel, si shkak për largimin nga puna) të një gruaje shtatzënë, puna e të cilës e kërkon që ajo të punojë natën? Ky është problemi qendror i referencës gjermane<sup>137</sup>: më 23 mars 1992, Gabriele Habermann-Beltermann, një infermiere u caktua nga Arbeiterwohlfahrt (organizata e sigurimeve shoqërore të punëmarrësve) në një post si kujdestare nate në një shtëpi për të moshuar. Për arsye familjare, ajo kish mundësi të punonte vetëm natën, kështu që kontrata e përcaktonte se ajo ishte punësuar për punë nate. Znj. Habermann-Beltermann u largua nga puna si e sëmurë nga data 29 prill 1992, ndërsa një raport mjekësor i datës 29 maj, thoshte se ajo kish mbetur shtatzënë qysh nga 11 marsi 1992.

Kur punëdhënësit e mësuan këtë, ata i shkruan Znj. Habermann-Beltermann, me mendimin se kontrata e punës ishte e pavlefshme për shkak se, sipas ligjit gjerman për mbrojtjen e nënave, ndalohet të punësosh në punë nate gra shtatzëna apo gra që kanë fëmijë në gji.

Gjykata gjermane e referoi çështjen në GjED. GjED-ja tha se prishja e një kontrate pa afat fiks, për shkak të shtatzënisë së një gruaje, nuk mund të justifikohet me shkakun se një ndalim ligjor, i vendosur për shkak të shtatzënisë, e pengon përkohësisht punëmarrësen të kryejë punë nate.

<sup>135</sup> GjED, 8 nëntor 1990, Çështja C-179/88, Handels-Og Kontorfunktionaerernes Forbund I Danmark (që vepron në emër të Hertz) kundër Dansk Arbejdsgiverforening [1990] ECR I-3941, para 16.

<sup>136</sup> Ky arsyetim u la në fuqi në GjED, 29 maj 1997, Çështja C-400/95 Handes-Og Kontorfunktionaerernes Forbund, që vepron në emër të Larsson kundër Dansk Handel & Service, që vepron në emër të Fotx Supermarked A/S, I-2757. Në çështjen Larsson, GjED-ja duhet të shqyrtonte ligjshmërinë e pushimit nga puna për një sëmundje që lidhej me shtatzëninë. Znj. Larsson e filloi punën në mars 1990. Në gusht 1991, ajo mësoi se ishte shtatzënë. Për shkak të shtatzënisë, ajo mungoi nga puna si e sëmurë nga data 7 gusht deri në 24 gusht, dhe përsëri nga 4 nëntori 1991, deri në 15 mars 1992. Më pas, ajo mori lejen e lindjes të parashikuar me ligj, sipas ligjit danez (24 javë). Në 2 prill 1992, ajo lindi fëmijën. Leja e lindjes i mbaronte më 18 shtator 1992. Pastaj ajo mori lejen vjetore deri në 16 tetor 1992. Por, si rezultat i sëmundjes që lidhej me shtatzëninë, ajo nuk u kthye në punë. Në 10 nëntor 1992, ajo u pushua nga puna, duke filluar që nga fundi i dhjetorit 1992, për shkak të “periudhës së gjatë të mungesës dhe faktit se ka shumë pak të ngjarë që në të ardhmen - për shkak të shëndetit – të jeni në gjendje të kryeni punën në mënyrë të kënaqshme”. Çështja iu referua Gjykatës Europiane për një vendim paraprak në lidhje me faktin nëse kjo gjë binte ndesh me Direktivën e Trajtimit të Barabartë 76/207/të KEE-së. GjED-ja konstatoi se nuk binte ndesh.

<sup>137</sup> GjED, 5 maj 1994, Çështja C-421/92, Habermann-Beltermann kundër Arbeiterwohlfahrt, Bezirksverband Ndb/Opf eV [1994] ECR I-1657.

Në Spanjë Maria Luisa Jiménez Melgar pretendonte se ishte pushuar nga puna pa të drejtë nga këshilli i qytetit për shkak se një seri kontratash me afat nuk ishin ripërtëritë kur punëdhënësi e kish mësuar se ajo ishte shtatzënë. Punëdhënësi e kundërshtonte atë, duke thënë se nuk ishte e qartë se ajo ish pushuar për shkak të shtatzënisë, meqenëse i ishte ofruar një kontratë tjetër, për një punë tjetër. Megjithëse, mosripërtëritja e një kontrate me afat, nuk mund të konsiderohej si pushim nga puna, GjED-ja<sup>138</sup>konstatoi se megjithatë, *mosripërtëritja për shkak shtatzënie* përbente diskriminim të paligjshëm.

Një çështje nga Gjermania ka theksuar *të drejtën e privatësisë së një punëmarrëseje femër* në lidhje me shtatzëninë. Wiebke Busch punonte si infermiere në klinikë dhe, pas lindjes së fëmijës së saj të parë në qershor 2000, ajo mori miratimin e punëdhënësit të saj për të marrë tre vjet leje prindërore. Në prill 2001, ajo u lejua të kthehej në punë, pa e mbaruar lejen e saj prindërore. Një ditë më pas, ajo e informoi klinikën se ishte shtatë muaj me barrë, dhe se leja e lindjes duhej t'i rifillonte muajin e ardhshëm. Punëdhënësi e tërhoqi miratimin që i kish dhënë Znj. Busch të kthehej në punë, me arsyen se ajo e kish mbajtur qëllimisht të fshehtë faktin se ishte shtatzënë, me qëllim që të përfitonte pagesën më të lartë të lejes së lindjes, krahasuar me lejen prindërore që paguhej më pak. Ai gjithashtu tha se me ligj ajo nuk mund të kryente disa detyra në rast se ishte shtatzënë. GED-ja<sup>139</sup> konstatoi se i gjithë diskriminimi që lidhej me shtatzëninë është i paligjshëm dhe, si rrjedhojë, një punëmarrëse nuk është e detyruar të bëjë të ditur barrën, pavarësisht nga pasojat financiare apo shëndetësore apo të sigurisë që sjell për punëdhënësin.

Në vendimin në çështjen Mayr kundër Flöckner, GjED-ja<sup>140</sup> e zgjeroi konceptin e diskriminimit me bazë seksi sipas Direktivës 76/207/së KEE-së për të mbuluar trajtimin e pafavorshëm të një gruaje kur ajo mungon gjatë kohës që i nënshtrohet *trajtimin IVF (fekondimi in vitro)*. Sabine Mayr punonte si kameriere në Flöckner's Konditorei në Salzburg dhe ishte duke iu nënshtruar trajtimin IVF. Në një fazë kyç të procesit, ajo mori një javë leje sëmundje që të bënte ri-transplantimin e vezëve të fekunduara, por punëdhënësi e hoqi nga puna duke e njoftuar me një letër, posa që ajo u largua e sëmurë. Ajo pretendoi se kjo binte ndesh me Direktivën e Punëmarrëseve Shtatzëna 92/85/të KE-së. GjED-ja nuk e pranoi këtë: Mayr ishte duke u orvatur të mbetej shtatzënë, kur punëdhënësi i saj e pushoi nga puna, por meqë në atë kohë veza e fekunduar ishte ende në vitro, nga pikëpamja ligjore, ajo nuk ishte shtatzënë. Ajo Direktivë nuk e mbrojti atë.

<sup>138</sup> ECJ 4 October 2001 Case C-438/99 *Maria Luisa Jiménez Melgar kundër Ayuntamiento de Los Barrios* [2001] ECR I-6915 .

<sup>139</sup> Case 27 February 2003 C-320/01 *Wiebke Busch kundër Klinikum Neustadt GmbH & Co Betriebs-KG* [2003] I-2041.

<sup>140</sup> GjED, 26 shkurt 2008, Çështja C-506/06 *Sabine Mayr kundër Bäckerei und Konditorei Gerhard Flöckner OHG* [2008], ECR I-1017 .

Por ajo u mbrojt nga Direktiva e Trajtimit të Barabartë. Sikundër GjED-ja kish vendosur në të kaluarën (para daljes së Direktivës së Punëmarrësve Shtatzëna) se, pushimi nga puna për shkak të shtatzënisë, ishte diskriminim i palejuar, meqenëse vetëm gratë mund t'i nënshtroheshin një trajtimi të tillë të pafavorshëm – shih çështjen C-177/88 Dekker – po ashtu, pushimi, kryesisht për shkak të trajtimit IVF ishte gjithashtu diskriminim: vetëm një grua mund të mungonte nga puna për shkak të një trajtimi të tillë.

## Lindja

Në çështjen *Hofmann kundër Barmer Ersatzkasse* – siç përmendet më sipër – GjED-ja<sup>141</sup> e hodhi poshtë pretendimin e një babai të një fëmije të paligjshëm në Gjermani për pagesë të sigurimeve shoqërore gjatë një periudhe lejeje të papaguar për t'u kujdesur për fëmijën, kur një nënë do të kish pasur të drejtë të paguhej, duke thënë se Direktiva 92/85/e KEE-së nuk merrej me ndarjen e përgjegjësive familjare, por me mbrojtjen biologjike të nënës.

Në çështjen *Stoeckel*, GjED-ja vendosi kundër Francës në rastin e procedurave penale kundër Alfred Stoeckel,<sup>142</sup> duke e kritikuar fort ndalimin e *punës së natës për gratë* si diçka që ishte kundër Direktivës 76/207/të KEE-së. Për shkak të faktit se e drejta e komunitetit ka përparësi, dhe ligji francez nuk e respektoi atë në këtë fushë, vendimi në çështjen *Stoeckel* në fakt e bënte rregulloren franceze të pavlefshme. Kështu çdo individ mund të kërkojë që një gjykatës francez të hedhë poshtë Nenin e Kodit të Punës, i cili nuk përputhet me të drejtën e Komunitetit.

Gjatë 1988, *Joan Gillespie*<sup>143</sup> dhe të tjera morën *leje lindje*. Sipas një marrëveshje kolektive të Manualit të Këshillit të Përgjithshëm (Irlanda e Veriut), ato morën gjatë asaj periudhe këto përfitime: pagesë të plotë javore gjatë katër javëve të para, nëntë të dhjetat e pagesës së plotë javore për dy javë më pas dhe një gjysmë të pagës së plotë javore për 12 javë. Këto kushte ishin më të favorshme se ato të përcaktuara nga legjislacioni përkatës i përgjithshëm.

Në nëntor 1988, negociatat brenda shërbimeve shëndetësore rezultuan në rritje pagash, duke filluar që nga data 1 prill 1988. Megjithatë, paditëset në procedurat kryesore nuk ishin në gjendje të merrnin atë rritje për shkak të metodës së përlogaritjes të përfitimit të pagueshëm gjatë lejes së lindjes, sikundër përcaktohej në Manualin e Këshillit të Përgjithshëm.

<sup>141</sup> GjED, 12 dhjetor 1994 Çështja 184/83 Ulrich Hofmann dërkundër Barmer Ersatzklasse [1984] ECR 3047.

<sup>142</sup> GjED 25 korrik 1991, Çështja C-345/89 Procedura penale kundër Alfred Stoeckel [1991] ECR I-4047.

<sup>143</sup> GjED 13 shkurt 1996, Çështja C-342/93 Joan Gillespie dhe të tjerët kundër Bordeve të Shërbimeve të Shëndetësisë dhe shërbimeve sociale veriore dhe Bordit të Shërbimeve të Shëndetësisë dhe Shërbimeve Shoqërore jugore. (Irlandë e Veriut, MB) [1996] ECR I-475.

Në 1989, paditëset nisën procedurat në gjykatë, duke pretenduar se ishin diskriminuar për shkaqe seksi, sepse gjatë lejes së lindjes, paga e tyre ishte reduktuar, dhe, për shkak të metodës së përlogaritjes së përfitimeve me para në dorë, të cilët u takonin atyre gjatë asaj periudhe, ato nuk i kishin marrë përfitimet e rritjes së pagës para asaj date. Gjykata Industriale e hodhi poshtë kërkesën e tyre dhe paditëset e apeluan çështjen në Gjykatën e Apelit të Irlandës së Veriut.

Gjykata e Apelit shqyrtoi zgjidhjen e mosmarrëveshjes përpara se të kërkonte një interpretim të Nenit 119 të Traktatit, si edhe të Direktivave 75/117/të KEE-së dhe 76/207/të KEE-së; si rrjedhojë, ajo i ndaloi procedurat dhe e referoi çështjen në GjED.

Së pari, GjED-ja vendosi se, përfitimet e lejes së lindjes hyjnë në rubrikën e pagesës, siç përshkruhet nga Neni 119 i Traktatit dhe Direktiva 75/117/e KEE-së, meqenëse përfitimi i paguar nga një punëdhënës një gruaje me leje lindje, mbështetet në marrëdhënien e punësimit sipas legjislacionit apo marrëveshjeve kolektive.

Çështja konkrete është unike, sepse gratë që marrin përfitime të plota gjatë lejes së lindjes nuk krahasohen me ato të një burri ose të një gruaje që aktualisht punon. Direktiva të ndryshme të BE-së në fakt nuk e përmendin se sa duhet të jenë këto përfitime, kështu që i lihet legjislaturave kombëtare të përcaktojnë sasinë e përfitimit, që duhet paguar gjatë lejes së lindjes, duke marrë parasysh kohëzgjatjen e një leje të tillë dhe ekzistencën e përfitimeve të tjera shoqërore. I vetmi parim, që përcakton Traktati apo Direktivat, është se, gjithsesi, sasia e pagueshme nuk mund të jetë aq e ulët sa të minojë qëllimin e lejes së lindjes, pra, mbrojtjen e grave përpara dhe pas lindjes. Në rastin konkret, nuk ka asgjë që të sugjerojë se sasia e përfitimit të dhënë ka qenë e tillë që të minonte objektivin e mbrojtjes së lejes së lindjes.

Gratë me leje lindje duhet të marrin çdo ngritje page të bërë përpara apo gjatë kësaj periudhe. Parimi i mosdiskriminimit, pra, kërkon që një grua, që është ende e lidhur me punëdhënësin e saj me një kontratë pune ose me një marrëdhënie pune, duhet që, gjatë lejes së lindjes, sikundër çdo punonjës tjetër, të përfitojë nga çdo ngritje page, edhe nëse ngritja është e një date më të hershme dhe që t'i jepet asaj qysh nga fillimi i periudhës së mbuluar nga pagesa e referencës deri në fundin e lejes së lindjes. Mohimi i një rritje të tillë një gruaje me leje lindje e diskriminon atë thjesht në cilësinë e saj si punëmarrëse, duke qenë se, po të mos kish mbetur shtatzënë, ajo do ta kish përfituar ngritjen e pagës.

Së fundi, GjED-ja sqaroi se, rasti konkret mbulohet nga Neni 119 i Traktatit dhe Direktiva 75/117/e KEE-së, dhe jo (pra, nuk mbulohet) nga Direktiva 76/207/e KEE-së.

Tek çështja Hill dhe Stapleton, GjED-ja<sup>144</sup> vendosi se, kur një sistem kredie në rritje, që mbështetet në kriterin e kohës reale të punës, ku 98% e atyre që ndajnë punën janë gra, i trajton ish *ndarëset e punës* të cilat janë kthyer në punë me orë të plota në një mënyrë më pak të favorshme se sa punëtorët që kanë punuar përherë me orë të plota, përbën diskriminim për shkaqe seksikur një trajtim i tillë i pafavorshëm nuk mund të justifikohet objektivisht.

Qëllimi i ndarjes së punës, i cili u fut në Shërbimin Civil Irlandez në 1984, ishte që t'u jepte mundësi dy punonjësve civilë të ndanin një punë me orë të plota në mënyrë të barabartë, në mënyrë të tillë që të dy punëmarrësit të përfitonin njëlloj, ndërsa kostoja e vendit të punës për administratën kombëtare të mbetej e njëjtë. Ndarësit e punës punojnë gjysmën e numrit të orëve të punëtorëve me kohë të plotë dhe paguhen me të njëjtën tarifë për orë. Shkalla e rritjeve vjetore të pagës për ata që ndajnë kohën e punës, është paralele me atë të punëmarrësve me kohë të plotë, ku çdo pikë në shkallën e ndarësve të punës përfaqëson 50% të pikës korresponduese në shkallën e orëve të plota. 98% e atyre që ndajnë punën në Shërbimin Civil irlandez janë gra. Sipas Gjykatës Kombëtare referuese, cilido që ndan punën mund të përfitojë të njëjtën përvojë si edhe një punëtor me orë të plota.

Kur Znj. Hill dhe Znj. Stapleton kaluan nga sistemi i ndarjes së punës, në punë me orë të plota, fillimisht ato u përfshinë në të njëjtën pikë në shkallën rritëse të punëve me orë të plota, si ajo që kishin pasur në shkallën e ndarësve të punës. Më pas të dyja u riklasifikuan në një pikë më të ulët në shkallën e orëve të plota, me shkakun se dy vjet në shkallën e ndarjes së punës përfaqësonin një vit në shkallën e orëve të plota. Pyetja e shtruar para Gjykatës së Drejtësisë nga Gjykata e Punës në Irlandë doli nga vendimi i Znj. Hill dhe Znj. Stapleton për ta kundërshtuar riklasifikimin e tyre.

Gjykata e Drejtësisë ishte e mendimit se, punëmarrësit që kalojnë nga ndarja e punës, ku punonin 50 për qind orë të plota dhe paguheshin 50% të pagës së orëve të plota, në punë me orë të plota, kishin të drejtë të prisnin që, si numri i orëve që punonin ashtu dhe niveli i pagës së tyre, të rriteshin me 50%, në të njëjtën mënyrë si do të prisnin punëtorët që kalonin nga puna me orë të plota në punë të ndarë, që këta faktorë të reduktoheshin me 50%, kur nuk justifikohet një dallim në trajtim. Një zhvillim i tillë nuk ndodhi në këtë rast, me rezultatin që, meqë ish ndarësit e punës paguheshin më pak se dyfishi i pagës së punës së ndarë, tarifa e tyre për orë si punëmarrës me orë të plota do të reduktohet.

Si rrjedhojë, në kategorinë e punëmarrësve me orë të plota, ka trajtim të pabarabartë në lidhje me pagën e punëmarrësve që më parë e ndanin punën, të cilët pësojnë rënie në shkallën e pagës përkundrejt vendit që kanë pasur më parë.

<sup>144</sup> GjED 17 qershor 1998 C-243/95 Hill & Stapleton kundër Komisionerëve të të Ardhurave dhe Departamentit të Financës, ECR, I-3739.

Me këtë konstatim, Gjykata vuri në dukje se, përdorimi i kriterit të kohës aktuale, të punuar gjatë periudhës së ndarjes së punës, nuk merr parasysh, ndër të tjera, faktin se ndarja e punës është një kategori unike pune, duke qenë se nuk përfshin ndërprerjen e shërbimit, apo faktin se, një person që ndan punën, mund të përfitojë të njëjtën përvojë si edhe një punëtor me orë të plota. Për më tepër, në pagën e përgjithshme të punëmarrësve që kryejnë të njëjtat funksione, futet një pabarazi në mënyrë prapavepruese për sa i takon cilësisë dhe sasisë së punës konkrete të kryer.

Në një rast të tillë, zbatimi i dispozitave të llojit që kundërshtohen këtu në këtë gjykatë, rezultojnë në diskriminim ndaj punëtoreve femra, i cili duhet trajtuar se bie ndesh me Nenin 119 të Traktatit.

Gjykata e Drejtësisë erdhi në përfundim se do të ishte ndryshe vetëm nëse dallimi në trajtim, që u konstatua se ekzistonte midis dy kategorive të punëtorëve, justifikohet me faktorë objektive, të palidhur me ndonjë diskriminim për shkak seksi. Ajo shtoi se është në dorën e gjykatave kombëtare të vendosin nëse faktorë të tillë objektivë ekzistojnë vërtet.

Në çështjen *Boyle*,<sup>145</sup> GjED-ja bëri të ditur të drejtat e grave shtatzëna në lidhje me *lejen e sëmundjes, lejen vjetore dhe rritjen e të drejtave të pensionit*. Punëmarrësit e Komisionit të Shanseve të Barabarta i bënë kërkesë një gjykatë për t'u deklaruar nëse disa klauzola të caktuara të kontratave të tyre të punësimit ishin të pavlefshme ose të pazbatueshme në atë shkallë që i diskriminonin punëmarrëset femra dhe në këtë mënyrë binin ndesh me dispozitat e Komunitetit, respektivisht, për pagën e barabartë, trajtimin e barabartë në lidhje me kushtet e punës, dhe përmirësimet në sigurinë dhe shëndetin në punë të grave shtatzëna dhe punëmarrëseve, që kishin lindur fëmijë kohët e fundit, ose që i kishin ata në gji. Gjykata vendosi t'i shtynte procedurat dhe ia referoi disa pyetje GjED-së në lidhje me pajtueshmërinë me të drejtën e Komunitetit të klauzolave që kontestoheshin.

Disa klauzola të kontratave të punësimit në fjalë, në lidhje me pagën dhe të drejtën e lejes së lindjes, ishin më të favorshme për punëmarrëset në fjalë, se sa dispozitat minimale të përcaktuara nga ligji britanik. Megjithatë, e drejta e përfitimit nga këto klauzola varej nga kushte të caktuara.

Në gjykimin e saj, Gjykata i shqyrtoi me radhë të pesë klauzolat e kontestuar në dritën e së drejtës së Komunitetit.

Gjykata shqyrtoi se një klauzolë në një kontratë punësimi, që e kushtëzonte zbatimin e një skeme lindje më të favorshme se sa skema statutore,

<sup>145</sup> GjED 27 tetor 1998 C-411/96 Margaret Boyle dhe të tjerë kundër Komisionit të Mjundësisve të Barabarta [1998] ECR I-6401.

me kthimin në punë të gruas shtatzënë pas lindjes së fëmijës, në rast mosplotësimi të së cilës, asaj i kërkohet të shlyejë diferencën midis pagesës së lejes kontraktuale dhe pagesave statutoire në lidhje me atë leje, nuk përbënte diskriminim në bazë seksi.

Më pas, Gjykata u shpreh se e drejta e periudhës minimale të lejes së lindjes prej 14 javësh, të parashikuar nga direktiva, është diçka që mund të mos përdoret nga punëmarrëset (me përjashtim të dy javëve të detyruara të lejes së lindjes). Megjithatë, kur një grua sëmuret gjatë periudhës së lejes statutoire dhe e vë veten në kushtet (më të favorshme) e lejes së sëmundjes, dhe kur leja e sëmundjes mbaron përpara se të përfundojë periudha e lejes së lindjes, periudha e lejes së sëmundjes nuk e prek kohëzgjatjen e lejes së lindjes, e cila vazhdon deri në fund të periudhës prej 14 javësh të përcaktuar fillimisht.

Kufizimi i mbledhjes së lejes vjetore për periudhën deri në 14 javë të lejes së lindjes, nuk bie ndesh me të drejtën e Komunitetit. Përkundrazi, bie ndesh me të drejtën e Komunitetit të kufizosh, në kuadër të skemës profesionale të financuar plotësisht nga punëdhënësi, mbledhjen e të drejtave të pensionit gjatë 14 javëve të lejes së lindjes për periudhën gjatë të cilës gruaja merr pagë.

Së fundi, ndonëse një kontratë punësimi mund të parashikojë një periudhe suplementare leje lindje të papaguar, ajo nuk mund që, pa shkelur të drejtën e Komunitetit, të kufizojë periudhën gjatë të cilës të drejtat e pensionit mund t'i shtohen periudhës së lejes së paguar.

Në çështjen Abdoulaye,<sup>146</sup> ankimesit ishin punëmarrës meshkuj që punonin për Renault, të cilët pretendonin se një marrëveshje, e cila parashikonte një pagesë prej 7,500 frangash franceze për gratë shtatzëna me fillimin e lejes së lindjes, binte ndesh me Nenin 119 të Traktatit të KE-së dhe dispozitën korresponduese të së drejtës kombëtare franceze, e cila e ndalonte diskriminimin midis burrave dhe grave për çështje page. Ankimesit argumentonin se *pagesa për leje lindje*, që u jepej ekskluzivisht grave, ishte diskriminuese ndaj burrave dhe se, ngjarja shoqërore e pasjes së një fëmije, e prekte të gjithë familjen, duke përfshirë babanë, i cili si rrjedhojë nuk duhej të përjashtohej nga marrja e pagesës së lindjes së fëmijës.

Të paditurit pretendonin se dispozita e marrëveshjes përbënte “diskriminim të ligjshëm” sipas të Drejtës së Komunitetit, sepse diskriminimi që shkaktonte synonte të rikthente barazinë në shoqëri; dhe se dispozita ishte hartuar për të balancuar disavantazhin e pësuar nga gratë kur janë të detyruara të largohen përkohësisht nga puna për shkak të barrës. Një mungesë që, siç pretendonin të paditurit, ndikonte keq në ecurinë e grave në karrierë.

<sup>146</sup> GJED 16 shtator 1999, Çështja C-218/98 *Abdoulaye kundër Renault*, [1999] ECR I-5723.

Gjykata ia referoi pyetjet paraprake GjED-së. GjED-ja parashtroi se Neni 119 i Traktatit të KE-së nuk e ndalonte dhënien e një shume të përgjithshme punëmarrëseve femra (por jo punëmarrësve meshkuj), që marrin lejen e lindjes, kur kjo pagesë synon të kompensojë disavantazhin me të cilin përballen punëmarrëset femra si pasojë e të qenit larg punës.

Gjykata deklaroi se, gratë që marrin leje lindje, nuk do të propozohen për ngritje në detyrë për shkak të mungesës së tyre dhe se, pas kthimit në punë, periudhës së shërbimit do t'i hiqet koha që gruaja ka qenë e larguar. Për më tepër, gratë shtatzëna mund të mos jenë në gjendje të kërkojnë rritje page të lidhur me kryerjen e punës dhe nuk mund të marrin pjesë në trajnime gjatë shtatzënisë. Së fundi, për shkak të përparimeve shkencore gjatë mungesës së saj, një grua që kthehet në punë pas lejes së lindjes mund të shohë se natyra e punës së saj ka ndryshuar dhe çdo përshtatje për të mund të bëhet e vështirë. Si pasojë, Gjykata vendosi se trajtimi i ndryshëm ishte i përligjur.

Në Çështjen C-220/02 *Österreichischer Gewerkschaftsbund*,<sup>147</sup> GjED-ja konfirmoi qasjen e saj ndaj mosdiskriminimit dhe barazisë. Çështja kish të bënte me përlllogaritjen e *një pagese për mbyllje kontrate*, të cilën punëmarrësit kanë të drejtë ta marrin në kushte të caktuara. Sasia e pagesës varet, ndër të tjera, nga kohëzgjatja e punës së punëmarrësit. Për këto qëllime, u mor parasysh kohëzgjatja e shërbimit ushtarak apo shërbimit ekuivalent civil – të kryer nga pjesa më e madhe e burrave - ndryshe nga periudhat e lejes prindërore, të cilat merren kryesisht nga gratë.

Në vend që të përqendrohej në diskriminimin potencial dhe testimin e ngurtë të justifikimeve, Gjykata iu kthye deklaratës së saj të zakonshme, pra se, mos-diskriminimi është një shprehje e posaçme e parimit të përgjithshëm të barazisë dhe se, me këtë, nënkuptohet që punëmarrësit meshkuj dhe femra, të cilët përfitojnë nga parimi, janë në situata të krahasueshme. Pastaj, Gjykata konstatoi se burrat në shërbimin ushtarak apo civil dhe gratë me leje prindërore nuk janë në situata të krahasueshme. Shërbimi ushtarak apo civil i korrespondon një detyrimi qytetar dhe vendoset në interesin publik/kolektiv. Leja prindërore është një çështje që i përket punëmarrësit dhe familjes së tij.

Në Çështjen C-356/03 *Mayer*,<sup>148</sup> Gjykata vendosi se periudhat e lejes statutore të lindjes duheshin marrë parasysh në përlllogaritjen e të drejtave të ankimueseve për *një të ardhur vjetore* sipas skemës së pensioneve profesionale. Kjo çështje u vendos sipas Direktivës 86/378/të KEE-së, të ndryshuar me Direktivën 96/97/të KEE-së.

<sup>147</sup> GjED 8 qershor 2004, Çështja C-220/02 *Österreichischer Gewerkschaftsbund kundër Wirtschaftskammer* [2004] ECR I-5907.

<sup>148</sup> GjED, 13 janar 2005, C-356/03 *Mayer kundër Versorgungsanstalt des Bundes und der Länder* [2005] ECR I-295.

### 3.3.4. Masat e Veprimit Pozitiv

Në çështjen Kalanke,<sup>149</sup> dhe më pas në çështjen Marschall,<sup>150</sup> Gjykata e Luksemburgut duhet të vendoste nëse disa masa për veprime pozitive të miratuara me qëllimin e përmirësimit të gjendjes profesionale të grave ishin të pajtueshme me parimin e barazisë midis burrave dhe grave.

Ish Neni 2(4) i Direktivës së Këshillit 76/207/së KEE-së parashikonte se direktiva nuk duhej të kishte paragjykime për masat që nxisin mundësi të barabarta për burrat dhe gratë, në veçanti, përmes heqjes së pabarazive ekzistuese, të cilat ndikojnë në shanset e grave. Në çështjen shumë të debatuar<sup>151</sup> Kalanke, GjED-ja përcaktoi se për aq sa kjo dispozitë përbënte një përjashtim nga parimi i barazisë, duhej të interpretohej në mënyrë të ngurtë, dhe se ajo ishte hartuar posaçërisht dhe vetëm për të lejuar masa të cilat, ndonëse dukej sikur bëheshin shkak për diskriminim në bazë seksi, në fakt, synonin të eliminonin apo pakësonin rastet konkrete të pabarazisë midis burrave dhe grave, të cilat mund të ekzistonin në të vërtetë në jetën shoqërore. Në këtë mënyrë, ajo lejonte masa kombëtare, të cilat lidheshin me qasjen në punësim, duke përfshirë ngritjen në detyrë, që u jepte një avantazh konkret grave, me qëllim përmirësimin e aftësive të tyre për të konkurruar në tregun e punës dhe për të ndjekur një karrierë në bazë të barabartë me burrat. Megjithatë, në çështjen Kalanke, GjED-ja vendosi se Direktiva e Këshillit 76/207/KEE-së i përjashtonte rregullat kombëtare, që i jepnin *përparësi automatikisht ngritjes në përgjegjësi të grave*, në ata sektorë ku kish më pak gra në nivele postesh përkatëse. Gjykata shqyrtoi se një rregull kombëtar, që u garantonte grave përparësi absolute dhe pa kushte për emërimet dhe ngritje në detyrë, *nuk ishte një masë që lejohet nga drejta e Komunitetit*, meqenëse e tejkalonte cakun e nxitjes së shanseve të barabarta, duke e zëvendësuar atë me “barazi në përfaqësimi”, e cila duhej të arrihej vetëm përmes sigurimit të një barazie të tillë.

Pas pasigurisë rreth legjitimitetit të sistemeve të kuotave dhe masave të tjera të veprimeve pozitive në favor të grave në punë, të krijuara nga vendimi në çështjen Kalanke, Komisioni Europian miratoi një

<sup>149</sup> GjED 17 tetor 1995, Çështja C-450/93, Eckhard Kalanke *kundër* Freie Hansestadt Bremen, [1995] ECR I-03051.

<sup>150</sup> GjED 11 nëntor 1997, Çështja C-409/95, Hellmut Marschall *kundër* Land Nordrhein-Westfalen, [1997] ECR I-06363.

<sup>151</sup> Në terma të përgjithshme, mund të deklarohet se pjesa më e madhe e kritikëve u mbështetën në mungesën e një argumentimi të fortë ligjor në vendim. Në këtë drejtim, shih: Brems, E., Case C-450/93, Kalanke *kundër* Freie Hansestadt Bremen, 17 tetor, 1995, Columbia Journal of European Law, (1996), pp. 172-179; Lanquentin, M. T., De l'égalité de chances. A propos de l'arrêt Kalanke, CJCE 17 tetor 1995, DS, nr. 5, (1996), f. 494-501; Moore, S., Asgjë pozitive nga Gjykata e Drejtësisë, European Law Review, 21, (1996), f. 156-161; Prechal, S., Çështja C-450/93, Kalanke *kundër* Freie Hansestadt Bremen, [1995] ECR I-3051, Common Market Law Review, 33, (1996), pp. 1245-1259; Senden, L., Çështja C-450/93, Kalanke *kundër* Freie Hansestadt Bremen, [1995] ECR I-3051, Maastricht Journal of European and Comparative Law, 3, (1996), f. 146-164; and Zuleeg, M., Barazia gjinore dhe veprimi afirmativ sipas të drejtës së BE-së, Columbia Journal of European Law, vëll. 5, (1998/1999), f. 319-328.

Komunikatë,<sup>152</sup> e cila synonte të zbuste efektin e atij gjykimi, duke propozuar një amendament në Direktivën 76/207/të KEE-së, për të pasqyruar gjendjen juridike pas Kalanke-s, dhe për të sqaruar me saktësi se, pavarësisht nga kuotat e ngurta, e drejta e Komunitetit autorizonte masa të tjera të veprimit pozitiv.

Më pas, qëndrimi i GjED-së në lidhje me masat e veprimit pozitiv u zbut në çështjen Marschall<sup>153</sup>. Në këtë çështje, Gjykata konstaton se, edhe kur kandidatët janë njëloj të kualifikuar si kandidatë, duhet një garanci se kandidaturat do t'i nënshtrohen *një vlerësimi objektiv*, i cili do të marrë parasysh të gjitha kriteret specifike të secilit prej kandidatëve të veçantë dhe do të bëjë të pavlefshme përparësinë e dhënë kandidatëve femra, kur një apo më shumë nga këta kriteret e kthejnë balancën në favor të një kandidati mashkull. Së fundi, për sa u përket kriterëve që kthejnë balancë në favor të një kandidati mashkull, Gjykata vë në dukje se kriteret të tilla “nuk duhet të jenë të tilla sa që të diskriminojnë kandidatet femra”.<sup>154</sup>

Kjo përjasje kufizuese ndaj masave të veprimit pozitiv që nënkupton një sistem strikt të kuotave, u përforcua nga vendimi i GjED-së në çështjen Badeck.<sup>155</sup> Në këtë çështje, GjED-ja argumenton se rregullat kombëtare, që përcaktojnë përparësinë e ngritjes në detyrë të kandidatëve femra, qasje në punë të përkohshme dhe vende trajnimi në sektorë ku gratë janë të nënpërfaqësuar, me kusht që të kenë kualifikime të barabarta, kur ky rregull është provuar i nevojshëm për sigurimin e respektimit të objektivave të planit të avancimit të grave, përputhen me të drejtën e Komunitetit.

Rregullorja kombëtare në diskutim në çështjen Badeck siguronte që të gjitha gratë e kualifikuara të përfshiheshin në listën përfundimtare të kandidatëve për t'u intervistuar si edhe inkurajonte praninë e grave në organet përfaqësuese të punëmarrësve dhe organeve administrative dhe mbikëqyrëse. GjED-ja konstatoi se të gjitha këto rregulla ishin të vlefshme vetëm kur nuk kundërshtoheshin arsyet e peshës më të madhe dhe kur kandidaturat i nënshtroheshin një *vlerësimi objektiv*, që merrte parasysh

<sup>152</sup> Komunikim nga Komisioni në Parlamentin Europian dhe Këshilli për interpretimin e vendimit të Gjykatës së Drejtësisë në 17 tetor 1995, në Çështjen C-450/93, Kalanke kundër Freie Hansestadt Bremen, COM/96/0088 FINAL.

<sup>153</sup> Ky vendim është komentuar gjerësisht në: Brems, E., Çështja C-409/95, Hellmut Marschall kundër Land Nordrhein-Westfalen, Columbia Journal of European Law, Vëll. 4, (1998), f. 668-674; Cabral, P., A step closer to substantive equality, European Law Review, 23, (1998), f. 481-487; Mertus, J. A., Marschall kundër Land Nordrhein-Westfalen. Çështja n. C-409/95, American Journal of International Law, vëll. 92, nr. 2, prill, 1998, f. 296-300; More, G., Çështja C-409/95, Hellmut Marschall kundër Land Nordrhein-Westfalen, [1997] ECR I-6363, Common Market Law Review, 36, (1999), f. 443-452.

<sup>154</sup> GjED-ja ka vënë në dukje se përdorimi i disa kriterëve si gjendja civile, “statusi i siguresit të bukës”, apo vjetërsia në shoqëri (kur nuk është më e udhës të kryesh detyrat e vendit të punës) përbën diskriminim të tërthortë për shkak seksi.

<sup>155</sup> GjED-ja 28 mars 2000 Çështja C-158/97, Georg Badeck dhe të Tjerë, ndërhyrës: Hessische Ministerpräsident and Landesanwalt beim Staatsgerichtshof des Landes Hessen, [2000] RGJE f. I-01875; ECJ 1 mars 2004 Çështja C-407/98, dhe Çështja C-342/01, María Paz Merino Gómez kundër Continental Industrias del Caucho SA, [2004] ECR f. I-2605.

kushtet specifike personale të të gjithë kandidatëve, ashtu siç ishte vërtet. Nga pikëpamja e Gjykatës Europiane të Drejtësisë, legjislacioni kombëtar në diskutim zgjodhi atë që njihet përgjithësisht si “*kuota e rezultatit fleksibël*”. Ky sistem parashikonte një vlerësim të përshtatshmërisë së kandidatëve, aftësisë dhe punës profesionale (kualifikimet) në lidhje me kërkesat e postit që duhej zënë apo detyrën që do të jepej. Rrjedhimisht, GjED-ja vlerësoi se rregulli i përparësisë, i futur nga rregullat kombëtare në diskutim, nuk ishte absolut dhe i pakushtëzuar, sepse kriteret e përzgjedhjes në këtë rast, ndonëse të formuluar me terma neutrale për sa i takon seksit, duke qenë kështu në gjendje të ishin edhe në të mirë të burrave, në përgjithësi favorizonin gratë.<sup>156</sup> Prandaj, për mendimin e GjED-së, rregullat kombëtare në diskutim synonin dukshëm të shpinin në një barazi, më shumë substantive se formale, duke i pakësuar pabarazitë, që mund të ndodhin në praktikë në jetën shoqërore.<sup>157</sup>

Është e qartë se, vendimi i GjED-së në çështjen Badeck, konsolidon linjën e arsytimit të nisur në çështjet Kalanke dhe Marschall. Gjithsesi, argumentimi i Gjykatës në çështjen Badeck gjithashtu e zgjeron gamën e zbatimit të masave të veprimit pozitiv. Në rastin e Badeck-ut, Gjykata theksoi nevojën që masat e veprimit pozitiv të përfshinin një klauzolë fleksibiliteti, me qëllim që të parandalohej një trajtim i palejueshëm diskriminues i punëmarrësve meshkuj. Përveç kësaj, vazhdon të ekzistojë kërkesa për një vlerësim objektiv të kandidaturave, që merr parasysh situatat specifike personale të të gjithë kandidatëve. Megjithatë, janë bërë përparime në lidhje me një masë që vendos një qasje preferenciale të grave në poste në sektorin publik. Sipas Badeck-ut, parimi i trajtimit të barabartë midis burrave dhe grave, i përcaktuar në Direktivën 76/207/të KEE-së, nuk përjashton një rregull kombëtar për shërbimin publik, i cili, në profesione të trajnuara, ku gratë janë të nënpërfaqësuar dhe për të cilat shteti nuk ka monopolin e trajnimeve, u jep grave të paktën gjysmën e vendeve të trajnimit. Gjykata mendon se ky rregull synon të eliminojë shkaqet e shanseve të reduktuara të grave për qasje në punësim dhe karrierë, dhe për më tepër përbëhet nga masa për orientimin dhe trajnimin profesional, që lejohen nga Direktiva 76/207/e KEE-së. Gjykata merr parasysh se, një vështrim i përgjithshëm i ofertës për trajnime, tregon se asnjë kandidat mashkull nuk është përfundimisht i përjashtuar nga

<sup>156</sup> Legjislacioni gjerman në diskutim në Badeck përcaktoi se kur u vlerësuan kualifikimet, duhet të ishin marrë parasysh aftësitë dhe përvoja që ishin përfutur gjatë kujdesit për fëmijët apo për personat që kërkonin kujdes në sektorin familjar (puna në familje), për aq sa ishin me rendësi për përshtatshmërinë, performancën dhe aftësinë e aplikantëve. Vjetërsia, mosha dhe data e ngritjes së fundit në detyrë mund të merreshin parasysh vetëm për aq sa ato ishin me rendësi. Statusi familjar apo të ardhurat e partnerit mund të mos merreshin parasysh. Puna e pjesshme, lejet dhe vonesa në kryerjen e trajnimeve si rrjedhojë e kujdesit për fëmijët apo për personat nën varësi, të vërtetuara nga një mjek si një kujdes që duhej ofruar, nuk duhet të ketë një ndikim negativ në vlerësimin e shërbimit dhe as të ndikojë në përparimin në punë.

<sup>157</sup> Gjykata gjithashtu mori parasysh se legjislacioni parashikonte detyrimin për t’i trajtuar me preference gratë ndaj disa grupeve të individëve të tillës si: ish punonjës, që ishin larguar nga shërbimi për shkak të punëve në familje, persona që, për shkaqe të punëve në familje, punonin me orë të pjesshme dhe tani dëshironin të kalonin në punë me orë të plota, ushtarë vullnetarë të përkohshëm, persona shumë të paftë dhe persona të papunë afatgjatë.

trajnimi. Kështu mendohet se dispozita në diskutim thjesht përmirëson shanset e kandidatëve femra në sektorin publik. Për çudi, GjED-ja këtu po pranon një kuotë të ngurtë për qasje në pozicione trajnuese, për aq kohë sa kjo gjë të mos shpjerë në një ngurtësi absolute.

---

Për më tepër, në përputhje me opinionin e Avokatit të Përgjithshëm, GjED-ja mendon se Direktiva 76/207/e KEE-së nuk përjashton një rregull kombëtar, i cili garanton, kur kandidatët meshkuj dhe femra kanë kualifikime të njëjta, që gratë e kualifikuara të thirren për intervista, në sektorë ku ato janë të nënpërfaqësuar, meqenëse dispozita në diskutim, në procedurat kryesore nuk nënkupton një përpykje për të arritur rezultatin përfundimtar – caktimin në punë apo ngritjen në detyrë – por u jep grave të kualifikuara mundësi të tjera për të lehtësuar hyrjen e tyre në jetën e punës dhe në karrierë. Pastaj, GjED-ja thekson nevojën e “një vlerësimi objektiv të kandidaturave”, duke vënë në dukje se dispozita e brendshme gjithashtu parashikon se, duhet bërë një shqyrtim paraprak i kandidaturave dhe se, vetëm kandidatët e kualifikuar, të cilët i plotësojnë të gjitha kushtet e kërkuara apo të përcaktuara, duhet të thirren për intervistë.

---

Së fundi, GjED-ja vjen në përfundim se, është në përputhje me të drejtën e Komunitetit një rregull kombëtar që rekomandon se, kur bëhen emërimet për në organet përfaqësuese të punëmarrësve dhe organet administrative dhe mbikëqyrëse, të paktën gjysma e anëtarëve të jenë gra. Gjykata vlerëson se, meqenëse dispozita nuk është urdhëruese dhe detyruese, por vetëm programatike, ajo lejon në një farë mase, të merren parasysh edhe kritere të tjera.

Atëherë mund të thuhet se, legjislacioni rajonal gjerman i vlerësuar në çështjen Badeck, ofron një katalog të gjerë masash të veprimit pozitiv në favor të grave, të cilat konsiderohen në përputhje me parimin e trajtimit të barabartë dhe me mundësitë e barabarta për gratë dhe burrat.

Në lidhje me hyrjen në fuqi të dispozitave të reja substantive të barazisë, që përmban Traktati i Amsterdimit (Neni 141 TKE-së), është me rëndësi të përmendet çështja Abrahamsson.<sup>158</sup> Në këtë vendim, GjED-ja vendos se Direktiva 76/207/e KEE-së dhe Neni 141(4) i TKE-së e përjashtojnë legjislacionin e brendshëm, sipas të cilit një kandidat për një post, i cili i takon seksit të nënpërfaqësuar dhe ka kualifikime të mjaftueshme për atë post, duhet të zgjidhet ndaj një kandidati të seksit të kundërt, që ndryshe do të ishte emëruar, madje edhe kur diferenca midis meritave përkatëse të kandidatëve nuk është aq e madhe sa të çojë në një shkelje të kërkesës për objektivitet në bërjen e emërimeve. Mendimi i Gjykatës është se, një metodë e tillë për zgjedhje, nuk lejohet nga e drejta e Komunitetit, meqenëse për zgjedhja e një kandidati nga ata që janë mjaftueshmërisht të kualifikuar, në fund të fundit, mbështetet thjesht në faktin e përkatësisë

<sup>158</sup> GjED 6 korrik 2000 Çështja C-407/98, Katarina Abrahamsson dhe Leif Anderson kundër Elisabet Fogelqvist, [2000] ECR I-5539 31.

në seksin e nënpërfaqësuar, dhe kjo ndodh edhe kur meritat e kandidatit të përzgjedhur janë më të vogla se ato të kandidatit të seksit të kundërt. Më tej, mendohet që, edhe pse Neni 141(4) i TKE-së i lejon Shtetet Palë të ruajnë apo miratojnë masa që parashikojnë përfitime të posaçme, me synimin e parandalimit apo kompensimit të disavantazheve në karriera profesionale, për të siguruar barazinë e plotë midis burrave dhe grave në jetën profesionale, nga kjo nuk mund të nxirret përfundimi se ai lejon një metodë përzgjedhje, e cila duket se është *dispropocionale me qëllimin e ndjekur*. Sipas mendimit të GjED-së, natyra dispropocionale e një mase të veprimit pozitiv, vazhdon të ekzistojnë edhe kur ajo synon të përdoret vetëm për një numër të kufizuar postesh të nivelit të lartë.

Pavarësisht faktit se vendimi i GjED-së në çështjen Abrahamsson kryesisht rithekson doktrinën e mëparshme të rasteve Kalanke dhe Marschall, rëndësia e kësaj çështje është se është hera e parë që GjED-ja po merret me interpretimin e gamës dhe kuptimit të paragrafit 4 të Nenit 141 të TKE-së. Për më tepër, është gjithashtu hera e parë që Gjykata e Drejtësisë përmend shprehimisht kujdesin që i duhet kushtuar parimit të proporcionalitetit në lidhje me masat e veprimit pozitiv.

Në botën akademike, disa shpresonin se GjED-ja do ta hidhte poshtë praktikën e saj të mëparshme gjyqësore dhe, posa që dispozita e re e Takati të hynte në fuqi, shumica e kufizimeve për përdorimin e masave të veprimit pozitiv do të zhdukeshin, meqenëse Neni 141(4) nuk përmend ndonjë nga kufizimet e përcaktuara në praktikën e mëparshme të GjED-së. Megjithatë, GjED-ja ndoqi një qasje më konservative dhe vazhdoi në linjën e Kalanke-s dhe Marschall-it

Një çështje tjetër rreth interpretimit të përjashtimit të së drejtës për një trajtim të barabartë midis burrave dhe grave, të përcaktuar me Nenin 141(1) të TKE-së dhe Direktivën 76/207/të KEE-së, që i referohet GjED-së për vendim paraprak, është çështja *Lommers*.<sup>159</sup> Këtu, GjED-ja trajtoi vendet në kopshtet e fëmijëve të subvencionuara, të vëna në dispozicion nga Ministria Holandeze e bujqësisë për stafin e saj. Me synimin për të trajtuar nënpërfaqësimin e madh të grave në të dhe në një kontekst të karakterizuar nga mungesa e provuar e vendeve të nevojshme, të përballeshme të kujdesit për fëmijët, ajo *rezervoi vende në kopshte të subvencionuara vetëm për fëmijët e zyrtaeve të saj femra*, ndërsa zyrtarët meshkuj kishin qasje në to vetëm në raste emergjence, që do të përcaktoheshin nga punëdhënësi. Në këto kushte, masa e Ministrisë holandeze u konsiderua se ishte pjesë e konceptit të kufizuar të barazisë së shanseve, për sa kohë që grave nuk iu rezervoheshin vende punësimi, por vetëm mundësia për të gëzuar disa kushte të caktuara pune me synim lehtësimin e ndjekjes dhe ecjes përpara në karrierë.

<sup>159</sup> GjED 19 mars 2002 C-476/99, H. Lommers *kundër* Minister van Landbouw, Natuurbeheer en Visserij, [2002], ECR I-02891.

Në përcaktimin e gamës së çdo forme largimi nga një e drejtë e tillë, siç është trajtimi i barabartë i burrave dhe grave, i përcaktuar nga Direktiva, Gjykata kujtonte se duhej të bëhej kujdesi i duhur për parimin e proporcionalitetit, i cili kërkon që përjashtimet të mbeten brenda kufijve të asaj që është e përshtatshme dhe e nevojshme për arritjen e qëllimit të vendosur dhe se, parimi i trajtimit të barabartë duhet të pajtohet, për aq sa është e mundur, me kërkesat e qëllimit që duhet realizuar. Gjykata vuri në dukje se masa e Ministrisë Holandeze, *a priori*, mund të ndihmojë për përjetësimin e një ndarjeje tradicionale të roleve midis burrave dhe grave, duke argumentuar se, nxitja e barazisë së mundësive midis burrave dhe grave, e siguar me futjen e një mase të tillë, që është në të mirën e nënave që punojnë, mund të arrihej edhe po të zgjerohej gama e saj, duke përfshirë në të edhe baballarët që punojnë. Megjithatë, Gjykata së fundi erdhi në përfundimin se, masa në diskutim, hynte në gamën e përjashtimit të veprimit pozitiv, që përmbante Direktiva 76/207/e KEE-së, duke marrë parasysh mungesën e ofertës në numrin e vendeve në çerdhe që ekzistonin, sipas masës në diskutim, faktin që shërbimet e çerdheve të fëmijëve nuk ishin monopol publik, por se ishin të disponueshme në treg, si dhe mundësinë që një punëdhënës kishte për t'u plotësuar kërkesat zyrtareve meshkuj në raste emergjencash. Në përfundim, masa e Ministrisë Holandeze u konsiderua se ishte në përputhje me parimin e proporcionalitetit, për aq sa përjashtimi në favor të zyrtarëve meshkuj, ishte ndërtuar në mënyrë të tillë që t'i lejonte ata që kujdeseshin vetë për fëmijët e tyre, të kishin qasje në vendet e çerdheve në të njëjtat kushte si edhe zyrtaret femra. Për më tepër, në lidhje me zyrtarët meshkuj, Gjykata u shpreh se argumenti që gratë kishin më shumë të ngjarë t'i ndërprisnin karrierat me qëllim që të kujdeseshin për fëmijët e tyre të vegjël, sot nuk kishte më të njëjtën rëndësi.

Vendimi i GjED-së në çështjen Lommers fut një tendencë të re në lidhje me interpretimin e parimit të barazisë nga GjED-ja, pra, një përjasje më të moderuar në konceptin e veprimit pozitiv, të mbështetur fort në pajtueshmërinë me parimin e proporcionalitetit. Ky vendim nënkupton gjithashtu një ndryshim në praktikën e Gjykatës Europiane të Drejtësisë në lidhje me masat shoqërore, të marra nga Shtetet Anëtare, për të përmirësuar gjendjen e grave në tregun e punës. Në çështjen Lommers, GjED-ja e hodhi poshtë praktikën e saj të mëparshme të çështjes Hofmann.<sup>160</sup>Në këtë rast, GjED-ja vendosi se, Direktiva 76/207/e KEE-së, u lë liri vendosje Shteteve Palë në lidhje me masat shoqërore që ato marrin me qëllim që të kompensojnë disavantazhet që kanë gratë, në krahasim me burrat, në lidhje me mbajtjen e vendit të punës. Masa të tilla u panë të lidhura ngushtë me sistemin e përgjithshëm të mbrojtjes sociale në Shtetet të ndryshme Anëtare. Si rrjedhojë, Shtetet Anëtare duhet të kishin një cak të arsyeshëm lirie për të zgjedhur për sa i përket si natyrës së masave mbrojtëse, ashtu dhe masave të hollësishme për zbatimin e tyre. Ky cak është ngushtuar nga vendimi i GjED-së tek Lommers.

Që tani e tutje, duke marrë parasysh se, nga këndvështrimi i GjED-së, argumenti që gratë i ndërprisnin karrierat e tyre më shpesh se burrat për t'u kujdesur për fëmijët, nuk është më aq e fortë, këto lloj masash duhen të jenë në përputhje me parimin e proporcionalitetit.

<sup>160</sup> GjED 12 korrik 19984 Çështja 184/83 Ulrich Hofmann kundër Barmer Ersatzkasse, [1984] RGJE I-03047.

Së fundi, çështja e fundit ku GjED-ja është përballur me interpretimin e dispozitave të Komunitetit, në lidhje me masat e veprimit pozitiv në favor të punëmarrëseve femra, është çështja *Briheche*.<sup>161</sup> Në këtë çështje, GjED-ja është marrë me një pyetje paraprake të ngritur nga një Gjykatë franceze në lidhje me pajtueshmërinë me të drejtën e Komunitetit të një dispozite kombëtare, e cila u rezervon *grave të veja përjashtim nga kufizimi i moshës (45 vjeç) për qasje në punësim në sektorin publik*, të cilat nuk janë rimartuar, duke i përjashtuar burrat e ve që nuk janë rimartuar. GjED-ja deklaroi se kjo dispozitë kombëtare formalisht bie ndesh me ndalimin e diskriminimit për shkakë seksi, sipas të drejtës së Komunitetit. Gjithsesi, Gjykata e Drejtësisë vlerësoi nëse një dispozitë e tillë mund të ishte në përputhje me rregullat e Komunitetit, të cilat lejojnë përjashtime nga trajtimi i barabartë për burrat dhe gratë, për masa që synojnë arritjen e barazisë substantive nëpërmes uljes *de facto* të pabarazive në karrierat profesionale të grave. Në arsyetimin e vet, GjED-ja i kthehet përsëri praktikës së mëparshme, të konsoliduar, dhe shprehet se një dispozitë si kjo që po diskutohet mund të mbulohet nga ai përjashtim. Me këtë qëllim në mendje, GjED-ja heton nëse, gjatë zbatimit të dispozitës së vendit, i është kushtuar vëmendja e duhur *parimit të proporcionalitetit*, i cili kërkon që largimi nga të drejtat themelore, duhet të mbetet brenda kufijve të asaj që është e përshtatshme dhe e nevojshme, me synim arritjen e qëllimit të synuar dhe se, parimi i trajtimit të barabartë duhet të pajtohet sa më shumë të jetë e mundur me kërkesat e qëllimit të ndjekur në këtë mënyrë. GjED-ja vjen në përfundimin se dispozita në diskutim *automatikisht dhe në mënyrë të pakushtëzuar i jep përparësi kandidatëve të disa kategorive të caktuara të grave*, duke iu rezervuar atyre mundësinë e përjashtimit nga kufiri i moshës për të pasur qasje në punësim në sektorin publik, por duke i përjashtuar burrat që gjenden në të njëjtën situatë. Nga ky vlerësim, del se një dispozitë e tillë nuk lejohet sipas Direktivës 76/207/të KEE-së dhe Nenit 141(4) të TKE-së.

---

Tek *Briheche*, GjED-ja duket se propagandon përfshirjen e një “klauzole shpëtimi”, e cila lejon që çështje si kjo e *Z. Briheche* të përfshihen në gamën e përjashtimit të kufirit të moshës për të pasur qasje në punësim në sektorin publik, në vend që të diktojë eliminimin e masës që synon të privilegjojë gratë e veja.

---

<sup>161</sup> GjED 30 shtator 2004 Çështja C-319/03, *Serge Briheche kundër Ministre de l'Intérieur, Ministre de l'Éducation nationale and Ministre de la Justice*, [2004] ECR I-8807.

### 3.3.3. Konflikti midis ILO-s dhe të Drejtës së Bashkimit European

Në Çështjen C-203/03 *Komisioni kundër Austrisë*<sup>162</sup>, GjED-ja ka përpunuar më tej detyrimet e Shteteve Anëtarë për të eliminuar pabarazitë e krijuara nga detyrimet e ILO-s për vendosjen e masave mbrojtëse, të ndaluara sipas të drejtës së Komunitetit. Çështja kish të bënte me ndalimin e punësimit të grave në (i) punë me presion të lartë atmosferik (ii) punë zhytëse dhe (iii) punë nën tokë në industrinë e minierave. Ndalimi i përgjithshëm i punësimit të grave në punë zhytëse u gjet si jo proporcional, ndërsa ndalimi i punës në presion të lartë atmosferik, edhe pse parashikonte një numër të kufizuar përjashtimesh, gjithashtu u dënua meqenëse përjashtonte një vlerësim individual. Ndalimi i punësimit të grave në industrinë minerare nëntokësore, si i tillë, ishte në shkelje të Nenit 2 (3) të Direktivës 76/207/së KEE-së. Gjithsesi, u pa se kjo përligjej për shkak të Nenit 307 të Traktatit të KE-së, në lidhje me pasojat e detyrimeve që rridhnin nga marrëveshjet ndërkombëtare. Sipas këtij Neni, Austria e kish për detyrë të denonconte Konventën e ILO-s, me qëllim që të eliminonte çdo lloj mospërputhshmërie me detyrimet e saj ndaj Komunitetit. Megjithatë, Gjykata pranoi se kjo mund të bëhej vetëm në rastin tjetër që do të paraqitej për ta hedhur poshtë, që ndodhi në 2007. Në rastin e saj të mëparshëm për ta bërë këtë, në maj 1997, nuk ishte shumë e qartë nëse detyrimet që rridhnin nga konventat e ILO-s ishin të papajtueshme me Direktivën 76/207.

## 3.4. DISA ÇËSHTJE PËR BARAZINË GJINORE NGA SHTETE ANËTARE TË BE-SË QË VENDOSËN PRECEDENT

### 3.4.1. Spanja

Me Vendimi Nr. 12/2008, Gjykata Kushtetuese e Spanjës e quajti të vlefshme kushtetutshmërinë e kontestuar të së ashtuquajturës “*kuotë elektorale gjinore*”, të artikuluar në Ligjin organik 3/2007. Ky Akt ndryshoi Ligjin e Përgjithshëm të Regjimit të Zgjedhjeve, i cili përcaktonte se listat zgjedhore (për të gjitha llojet e zgjedhjeve, kombëtare, rajonale, lokale, etj) duhet ta ekuilibrojnë përbërjen sipas gjinisë. “Ekuilibrojnë” do të thotë të ketë, të paktën, 40 % të kandidatëve të secilit seks në të gjithë listat. Kështu, ky proporcion duhet të respektohet në secilin segment prej pesë kandidatësh brenda të njëjtës liste. Në mungesë të një dispozite të tillë, një parti politike që zgjedh 20 kandidatë brenda të njëjtës liste, për shembull, mund të caktojë 10 kandidatë të një gjinie për 10 vendet e para (ku ka më shumë mundësi për t'u zgjedhur) dhe pastaj të zgjedhë anëtarë të gjinisë tjetër për 10 vendet e mbetura. Megjithatë, është bërë e zakonshme që partitë të përdorin “listat zinxhir”: gra-burra-gra-burra, etj.

<sup>162</sup> GjED 1 shkurt 2005 Rasti C-203/03 *Commission kundër Austria* [2005] ECR I-935.

Në këtë proces, paditësit argumentuan se kuota e gjinisë elektorale shkelte disa seksione të kushtetutës spanjolle. Vendimi në mënyrë të heshtur vjen në përfundimin se kuotat elektorale nuk kërkojnë “një veprim pozitiv” apo “diskriminim pozitiv”. Gjykata e përligji legjitimitetin e ligjit, mbështetur në Nenin 9.2 të Kushtetutës, i cili i detyron partitë politike të veprojnë në mënyrë konkrete. Duke e lënë të papërcaktuar natyrën juridike të këtij veprimi, mund të argumentohet se Gjykata e kushtetutëzoi përdorimin e partive politike, si një mjet për arritjen e barazisë efektive midis burrave dhe grave. Ligji organik i kontestuar nuk i ndalon burra dhe gra të caktuara të kandidojnë, as nuk përjashton njeri nga parlamenti. Përkundrazi, ai rregullon mënyrën në të cilën partitë politike mund të hartojnë listat e tyre elektorale.

### 3.4.2. Gjermania

Qysh më 1957, Gjykata Kushtetuese Gjermane vendosi se, e ashtuquajtura “Zusammenveranlagung”, pra, *vlerësimi i përbashkët i individëve të martuar* sipas ligjit të taksave, ishte jo kushtetues. Kjo politikë, që rezultoi në taksa veçanërisht të larta për fitimet individuale të grave, u konstatua si jo kushtetues për shkak se politika synonte, si qëllim të vetin, të parandalonte gratë që të merreshin me veprimtari biznesi në konkurrencë me burrat.<sup>163</sup>

Në 1959, “Stichentscheid” (autoriteti vendimtar) i babait u konstatua se ishte jo kushtetues. Gjykatës iu kërkua të merrte këtë vendim pasi Parlamenti së fundi kish përcaktuar se *autoriteti prindëror* nuk ishte më i babait. Parlamenti, megjithatë, kish ruajtur një përjashtim për këtë parim në situata krize, ku mendohej se duhet të ishte në fuqi autoriteti vendimtar i babait.<sup>164</sup>

Në 1963, “Höfeordnung”, pra, rregulla të vjetëruara që lidheshin me administrimin dhe organizimin e *fermave familjare*, disa pjesë të të cilave u jepnin përparësi trashëgimtarëve meshkuj në çështje pronësie, u deklaruan jo kushtetuese.<sup>165</sup>

Në 1963, Gjykata sqaroi se, mosnjohja e vlerës së shërbimit të kryer nga nënat, *gratë shtëpiake*, dhe ndihmëset e tyre në shtëpi, në sistemin e *sigurimeve shoqërore*, përbënte një shkelje të statusit të barabartë të grave dhe burrave para ligjit.<sup>166</sup>

Në 1967, u vendos që, në lidhje me *kujdesin dhe mbajtjen e të afërmeve të tyre*, gratë dhe burrat, që shërbenin në administratën publike, duhej të trajtoheshin në mënyrë të barabartë.<sup>167</sup>

<sup>163</sup> BVerfGE 6, 56.

<sup>164</sup> BVerfGE 10, 59.

<sup>165</sup> BVerfGE 15, 337.

<sup>166</sup> BVerfGE 17, 1 (38 dhe në vijim); BVerfGE 17, 62.

<sup>167</sup> BVerfGE 21, 329 (353).

Në 1974, u përcaktua se rregulli që u jepte *shtetësi* fëmijëve të baballarëve gjermanë, por jo të nënave gjermane, ishte jo kushtetues.<sup>168</sup>

Gjykata Kushtetuese Federale Gjermane filloi të ushtronte një ndikim vendimtar në luftën e vërtetë për barazi në vitet 70-të dhe 80-të. Në një vendim të vitit 1974, Gjykata vendosi se: “Ideja që babai është kryetari apo ligjërisht pika qendrore e familjes është zëvendësuar nga partneriteti midis burrave dhe grave”.<sup>169</sup> Në një vendim të vitit 1978, Gjykata vendosi se: “Modeli i gruas që e përcaktonte atë si kujdestaren e familjes dhe të zonjën e shtëpisë ka ndryshuar tërësisht”.<sup>170</sup> Gjykata deklaroi në një vendim të 1979 se: “Fakti që gratë janë zonja shtëpie nuk hyn në dallimet midis sekseve”.<sup>171</sup>

Ndarja e *roleve midis sekseve*, që deri në atë pikë shihej si e natyrshme, më pas u pa jo më shumë se një traditë dhe trashëgimi, që nuk mund të përligjej në dritën e Nenit 3(2) të së Drejtës Bazë.

E drejta për mbështetje afirmative për gratë, për të zgjidhur disavantazhe të kaluara, u përcaktua shprehimisht për herë të parë në 1994, nëpërmes shtimit të fjalisë së dytë në paragrafin “Status të Barabartë Përpara Ligjit” në Nenin 3 të së Drejtës Bazë. Pas amendamentit të 1994, Neni 3(2) tani lexon: “Burrat dhe gratë do të kenë të drejta të barabarta. Shteti do të nxisë zbatimin konkret të të drejtave të barabarta për gratë dhe burrat dhe do të ndërmarrë hapat për të eliminuar dizavantazhet që ekzistojnë tani”.

Në 1991, u vendos plotësisht barazia në lidhje me *emrin martesor*. Qysh atëherë, të dy partnerët në një martesë kanë mundësi të zgjedhin emrin e tyre. Për më tepër, kur partnerët nuk bien dakord se cilin emër të mbajnë, emri i burrit nuk përdoret automatikisht.<sup>172</sup>

Qysh nga 1992, kohës së shpenzuar për rritjen e fëmijëve, i është dhënë një vlerë si një kontribut i ligjshëm në sigurimet publike të pensionit.<sup>173</sup>

Fillimisht, dallimet biologjike midis grave dhe burrave kanë qenë në qendër të debatit dhe nga kjo diferencë biologjike, kanë rrjedhur aftësitë dhe funksionet e ndryshme të tyre. Kujdesi dhe rritja e fëmijëve nuk janë trajtuar si të drejta dhe detyrime të të dy prindërve, por kryesisht si një preokupim i nënës. Ky qëndrim ka formësuar praktikën gjyqësore, e cila e ka karakterizuar rolin e gruas si ai i ndihmës në familje.

<sup>168</sup> BVerfGE 37, 217 (250).

<sup>169</sup> BVerfGE 37, 217 (251).

<sup>170</sup> BVerfGE 48, 327 (338).

<sup>171</sup> BVerfGE 52, 369 (376).

<sup>172</sup> BVerfGE 84, 9 (20).

<sup>173</sup> BVerfGE 87, 1.

Shumë dallime të dukshme, të cilat kanë qenë në disfavor të grave, u zhdukën nga rendi ligjor qysh në vitet 70-të. Më pas, lufta erdhi dhe u përqendrua në dhënien e privilegjeve grave si kompensim për dizavantazhet që kishin pasur, apo tek rregulloret mbrojtëse, të cilat në të vërtetë patën pasojë të pafavorshme për gratë. Një shembull i përpjekjes së parë në këtë drejtim (kompensimi për dizavantazhet e pësuar) është vendimi i vitit 1998 i Gjykatës Kushtetuese Federale, në të cilin Gjykata vendoste se, viktimat gra të të ashtuquajturit “Zölibatsklausel” (rregulli në fuqi deri në 1953, që i ndalonte gratë e martuara të mbanin poste në administratën publike) mund ta mbyllnin këtë boshllëk në biografinë e tyre të shërbimit publik, dhe si pasojë të ripërftonin privilegjet e humbura, si pasojë e kohëzgjatjes së reduktuar (në lidhje me përfitimet e pensionit publik).<sup>174</sup> Një shembull i përpjekjes së dytë (korrigjimi i rregullave dizavantazhuese, mbrojtëse) përfshin vendimin e Gjykatës Kushtetuese Federale të vitit 1992, në lidhje me *Nachtarbeitsverbot* (ndalimi i punës së natës për gratë). Në këtë vendim, Gjykata vendosi:

Ndalimi i punës së natës për gratë aktualisht mbron shumë gra, të cilat merren gjithë kohën me kujdesin për fëmijët dhe punët e shtëpisë, nga puna e natës e cila mund t’u kërcënonte shëndetin. Kjo mbrojtje, megjithatë, është e lidhur me dizavantazhe të mëdha. Si pasojë gratë janë në pozitë inferiore për sa i përket kërkimeve të tyre për punësim. Gratë që punojnë nuk janë në gjendje të kontrollojnë lirisht orët e punës së tyre. Për shembull, gratë nuk mund të marrin paga për punë jashtë orarit gjatë punës së natës. E gjithë kjo, mund të ketë si pasojë që, në një shkallë më të madhe se burrat, përkrah punës së tyre jashtë shtëpisë, gratë të kenë edhe barrën e kujdesit të fëmijëve dhe të punëve të shtëpisë, duke riafirmuar kështu, si rrjedhojë, ndarjen tradicionale të roleve midis seksëve. Në këtë drejtim, ndalimi i punës së natës për gratë krijon pengesa për eliminimin e dizavantazheve sociale nga të cilat gratë vuajnë.<sup>175</sup>

Në 1995, Gjykata Kushtetuese Federale paraqiti një koncept radikal të barazisë në lidhje me shërbimet e mbrojtjes nga zjarri në Baden-Württemberg.<sup>176</sup> Ka të ngjarë që ky vendim në fakt të ketë hapur një epokë të re në jurisprudencën e barazisë duke futur “barazinë e detyrimeve”. Në vendimin e saj, Gjykata Kushtetuese Federale vendosi që mungesa e grave në të kaluarën në shërbimet e mbrojtjes nga zjarri të Bundesländerin (Shteteve federale) e vjetër (Gjermano perëndimore) shkelte *të drejtat e barabarta të grave, sepse gratë trajtoheshin si një gjini më e dobët, pa marrë aspak parasysh individualitetin e tyre.*

<sup>174</sup> BVerfGE 98, 1.

<sup>175</sup> BVerfGE 85,191 (209).

<sup>176</sup> BVerfGE 92, 91.

Ndikimi i jurisprudencës së GjED-së në lidhje me çështjen e barazisë gjinore nuk duhet të nënvlerësohet. Një gamë e gjerë çështjesh si Marschall, Kalanke, Badeck, Hofmann, Kreil, Habermann- Beltermann, etj, ishin çështje që ishin dërguar në GjED nga gjykatat gjermane dhe që ndihmuan për zhvillimin e çështjeve gjinore në të gjithë gjyqësorin.

### 3.4.3. Italia

Në 1990, Gjykata Kushtetuese Italiane vendosi që Neni 1 i Aktit Nr. 585 të 14 korrikut 1967, i cili i trajton nënat që punojnë, apo që kanë dalë në pension, në mënyrë më pak të favorshme se sa baballarët që punojnë apo që kanë dalë në pension për sa i takon të drejtës së tyre për të marrë përfitimet familjare, që u takojnë punëmarrësve në bujqësi, shkel dispozitën e Kushtetutës Italiane që garanton të drejta të barabarta për burrat dhe gratë. Gjykata vuri në dukje se Neni 1 nënkupton përparësinë e babait brenda familjes dhe bie ndesh me kërkesën ligjore të barazisë midis burrit dhe gruas në të gjitha çështjet që lidhen me marrëdhëniet familjare dhe bashkëshortore.<sup>177</sup>

Pavarësisht nga parimi i barazisë të parashikuar në Kushtetutën Italiane,<sup>178</sup> përfaqësimi i grave në poste institucionale në politikë mbetet i kufizuar në Itali. Kjo ishte arsyeja për futjen e ligjeve në mesin e viteve 90-të<sup>179</sup>, të cilët parashikonin se të dy sekset duhet të jenë të pranishëm në listat elektorale, në nivele të ndryshme, në një shkallë prej jo më pak se 30%. Pavarësisht nga rezultatet (rritje e madhe e pranisë së grave) e arritura nga zbatimimi i tyre, këto nene u shfuqizuan nga Gjykata Kushtetuese. Në gusht të vitit 1995, Gjykata i deklaroi ata të paligjshëm sepse binin ndesh me parimin e barazisë.


<sup>177</sup> Foro Italiano, 1991;(Part 1):2946-7.

<sup>178</sup> Neni 3: "Të gjithë qytetarët gëzojnë dinjitet të barabartë në shoqëri përpara ligjit, pavarësisht nga diferencat e seksit, racës, gjuhës, fesë dhe opinionëve politike." I njëjti nen përcakton themelet juridike për zbatimin e veprimeve pozitive: "Është detyrë e Republikës të zhdukë pengesat ekonomike dhe shoqërore, të cilat kufizojnë lirinë dhe barazinë e qytetarëve, pengojnë zhvillimin e plotë të individit dhe pjesëmarrjen e vërtetë të të gjithë punonjësve në organizimin politik, ekonomik dhe social të vendit". Parimi i barazisë midis burrave dhe grave ripohohet në Nenin 51.

<sup>179</sup> Ligji 277/93 për zgjedhjet në Dhomën e Përfaqësuesve, Ligji 81/93 për zgjedhjet lokale, Ligji 43/95 për zgjedhjet rajonale.

# 4

**JURISPRUDENCA E BARAZISË GJINORE NË SHQIPËRI**



## JURISPRUDENCA E BARAZISË GJINORE NË SHQIPËRI

# 4

### 4.1. ZBATIMI I KONVENTËS CEDAW NË SHQIPËRI

Deri tani asnjë gjykatë shqiptare nuk i është referuar Konventës CEDAW për të motivuar një gjykim. Megjithatë, siç është trajtuar më sipër, Kushtetuta shqiptare është e hapur për zbatimin e traktateve ndërkombëtare, të cilët janë ratifikuar.

Gjykata Kushtetuese shqiptare u referohet vazhdimisht konventave ndërkombëtare si KEDNj-ja. Kur merr vendime për çështje të kthimit të pronave, ajo rregullisht i interpreton normat shqiptare në dritën e Nenit 1 të Protokollit Shtesë të KEDNj-së dhe të interpretimit të tij nga ana e GjEDNj-së.<sup>180</sup>

Në një çështje *prone* në Gjykatën e Lartë të Shqipërisë,<sup>181</sup> Gjykata vendosi që titullare e së drejtës së pronësisë së një objekti të dhuruar është vetëm bashkëshortja, e cila përfiton nga një dhurim edhe kur dhurues është bashkëshorti i saj, duke interpretuar Nenin 87 të Kodit Civil të vitit 1982, i cili lejonte tjetërsimin e pronës së paluajtshme vetëm me miratimin e të dy bashkëshortëve, në dritën e një dispozite më të re, e cila parashikon që objektet e përfutuara nga dhurimi gjatë martesës bëhen pjesë e pasurisë personale të bashkëshortit përfitues. Kështu Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë me vendim unifikues nënvizuan:

“Në rastin e një dhurimi të objekteve personale të bashkëshortit dhurues apo të objekteve në bashkëpronësi, objekti/prona e dhuruar do t’i transferohet pronës personale të bashkëshortit përfitues, dhe, në këto rrethana, ky objekt nuk është më pjesë e pronës së përbashkët të bashkëshortëve.

Në rast se objekti i kontratës së dhurimit është transferimi i të drejtës së pronësisë, bashkëshorti tjetër përfiton me cilësinë e pronës vetjake të gjithë pronën, e cila është transferuar në pronësinë e këtij të fundit. Në rast se objekt i dhurimit janë objekte që janë pjesë e pronës së përbashkët të bashkëshortëve, objekti i dhurimit do të konsiderohet si pjesë ideale e pronësisë në bashkëpronësi,

<sup>180</sup> Vendimi i Gjykatës Kushtetuese, J 30/05, 1 dhjetor 2005.

<sup>181</sup> Gjykata e Lartë e Shqipërisë, Vendim Unifikues i Kolegjeve të Bashkuara të GjL, Vendimi 3/2006.

e cila pasi i shtohet kontrata e dhurimit në pjesën ekzistuese të pronës së bashkëshortit përfitues, bëhet pronë ekskluzive e këtij të fundit.

Titullar i së drejtës së pronësisë së objektit të dhuruar është vetëm bashkëshorti, që përfiton nga dhurimi. Objekti/prona e përftuar nuk është pjesë e bashkëpronësisë martesore, dhe si e tillë, bashkëshorti pronar mund ta tjetërsojë atë tek një subjekt tjetër vetë, duke mos pasur nevojë të marrë miratimin e bashkëshortit tjetër.”

Për më tepër, ideja e *veprimeve pozitive* si edhe *mbrojtja e grupeve të posaçme* është e mirëpritur në juridiksionin shqiptar. Kështu, Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë e ka konsideruar një vendim si jo diskriminues, nëpërmjet të cilit një gruaje iu dha një hapësirë e tepërt banese për merita të veçanta për vendin.<sup>182</sup> Gjykata deklaroi se kur fondet për një banesë janë pronë e shtetit dhe administrohen nga ky i fundit, e drejta për të përdorur një hapësirë të tepërt banimi është një nder i veçantë, që qeveria dhe shteti u bën personave apo kategorive të caktuara të personave për merita të posaçme shërbimi ndaj popullit dhe atdheut.

Në 18 dhjetor 2006, Kuvendi miratoi Ligjin Nr. 9660 “Për masat kundër dhunës në marrëdhëniet familjare”. Që në fazat e para të zbatimit efektiv të ligjit, në gjykatë janë sjellë një numër i madh kërkesash *për urdbra mbrojtës*. Një shembull është gjykimi vijues, i dhënë nga Gjykata e Shkallës së Parë, Tiranë<sup>183</sup>:

K.GJ. është 42 vjeçe. Ajo është lindur në Tiranë, ku edhe jeton. Ajo ka diplomë të shkollës së mesme dhe punon si rrobaqepëse. I shoqi është pijanec dhe shpesh e dhunon atë. Ai ka arsim të mesëm dhe është i papunë. Ata kanë vetëm një fëmijë.

K.GJ. ka pasur mosmarrëveshje qysh në fillim të martesës. Dhuna e ushtruar ndaj K.Gj-së ka qenë sistematike dhe arsyeja që ajo e denoncoi dhunën në polici ishte intensiteti në rritje dhe serioziteti i dhunës që duhej të duronte.

K.GJ. tregon rastet e fundit të dhunës fizike dhe psikologjike të ushtruar ndaj saj nga i shoqi “Disa ditë më parë, erdhi në shtëpi i dehur, më goditi dhe më mbylli me kyç në shtëpi. U detyrova të rrija e mbyllur në shtëpi disa ditë dhe nuk mund të shkoja as në punë. Në datën 04.04.09, nisi të më kërcënonte, duke më thënë se do më vriste dhe shkoi e mori thikën. Në atë moment, u ndjeva e kërcënuar dhe u largova nga shtëpia. Shkova në shtëpinë e prindërve.

<sup>182</sup> Vendimi i Gjykatës Kushtetuese, Nr. 9/92, 2 nëntor 1992.

<sup>183</sup> Vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë të Tiranës, Nr. 4061, datë 14.05.2009.

Pas denoncimit të K.Gj-së në polici, Komisarjati i Policisë nr. 4, Drejtoria e Policisë së Tiranës, paraqiti nëpërmjet një note zyrtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor të Tiranës kërkesën e paditëses K.Gj. kundër Q.Gj-së për “Lëshimin e një urdhri të menjëhershëm mbrojtjeje”. Kërkesa u pranua nga gjykata.

Në sesionin e datës 14.05.2009, ankimesja i kërkoj Gjykatës që ta vazhdonte urdhrin e mbrojtjes, meqenëse ajo vazhdonte të ndihej e kërcënuar dhe e pasigurt.

I padituri në këtë çështje, nëpërmjet avokatit të tij mbrojtës, kërkoj hedhjen poshtë të kërkesës, meqë ishte shtruar në spital për shkak të një tronditje të fortë psikike.

Pas shqyrtimin të çështjes mbështetur në përshkrimin e rrethanave dhe të fakteve të paraqitura nga paditësja, mbështetur në bindjen e saj të brendshme, Gjykata vlerësoi se padija është mbështetur në ligj: “Nenet 1, 3, 20 dhe të tjerë të Ligjit Nr. 9669, datë 18.12.2006” dhe, rrjedhimisht, pranoi kërkesën e paditëses, duke verifikuar urdhrin e mbrojtjes së menjëhershme për paditësen. Me aktgjykimin Nr. 4061, datë 14.05.2009, Gjykata e Rrethit Gjyqësor të Tiranës, vendosi si më poshtë:

- 1. Verifikim i urdhrin për mbrojtje të menjëhershme të dhënë me Aktgjykimin Nr. 7855, datë 24.04.2009 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor të Tiranës.
- 2. Lëshimin e urdhrin për mbrojtje të menjëhershme për ankimesen K. Gj si vijon:
- I padituri Q.Gj urdhërohet menjëherë të mos ushtrojë akte të dhunshme ndaj paditëses K. Gj. dhe djalit të tyre A. Gj.
- I padituri Q. Gj., urdhërohet menjëherë të mos kanosë paditësen K. Gj. dhe djalin e tyre A.Gj.
- I padituri Q. Gj. urdhërohet menjëherë të mos ngacmojë, dëmtojë, apo ndryshe kontaktojë ankimesen K. Gj. dhe djalin e tyre A. Gj.
- I padituri Q. Gj. urdhërohet menjëherë të largohet nga shtëpia e ndodhur në adresën: Rr “Ferit Xhajko”, pall 67/1, Shk. 2, Ap. 16 për një periudhë deri në një vit.
- I padituri Q. Gj. urdhërohet menjëherë të mos i afrohet ankimeses K. Gj. dhe djalit të tyre A. Gj. në një distancë prej 500 metrash.
- I padituri Q. Gj. urdhërohet të mos shkojë në shkollën e djalit të tij A. Gj., në adresën Rr. “Dibrës”, Shkolla “Misto Mame”.
- I padituri Q. Gj. urdhërohet të mos shkojë në punën e ankimeses K. Gj., që ndodhet në adresën Rr. “Siri Kodra”.
- Hyrja dhe vizitat e të paditurit Q. Gj., në shtëpinë e ankimeses K. Gj. dhe atit të saj ndalohen.

- Kjo masë është e vlefshme për një vit, që nga data që është bërë padija.
- Mosrespektimi i këtij gjykimi është një vepër penale, sipas Nenit 320 të Kodit Penal.
- Apeli i vendimit në Gjykatën e Apelit në Tiranë lejohet jo më vonë se 15 ditë që nga njoftimi i këtij gjykimi.
- Secilës palë i jepet një kopje e këtij aktgjykimi.
- Një kopje e këtij aktgjykimi i dërgohet Komisarariatit të Policisë Nr. 4, Tiranë, për informim.
- Një kopje e këtij gjykimi i dërgohet Zyrës së Shërbimeve Shoqërore në Njësinë Lokale në Tiranë.

## 4.2. Zbatimi i Nenit 14 të KEDNj-së në Shqipëri

Deri në gusht të vitit 2009, nuk ka pasur asnjë vendim të një Gjykate shqiptare që t'i jetë referuar shprehimisht Nenit 14 të KEDNj-së në juridiksionin e vet. Megjithatë parimi i *trajtimin të barabartë dhe mosdiskriminimit është një parim kushtetues, i mishëruar në Nenin 18 të Kushtetutës Shqiptare*.

Në përputhje me juridiksionin e KEDNj-së, Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë ka vendosur një praktikë të saj ku shprehet se, “Barazia në ligj dhe përpara ligjit nuk do të thotë se zgjidhje të ngjashme zbatohen për individë apo kategori personash, që ndodhen në kushte objektivisht të ndryshme. Barazia në ligj dhe përpara ligjit nënkupton barazinë e individëve, që janë në kushte të barabarta,” dhe “vetëm në raste përjashtimore dhe për shkaqe të arsyeshme dhe objektive, mund të përliqjen trajtime të ndryshme të kategorive të caktuara, që përfitojnë nga kjo e drejtë”.<sup>184</sup>

Në një rast që trajton pavlefshmërinë e *prishjes së një kontrate pune* dhe detyrimin e punëdhënësit për të paguar kompensime, që arrijnë shumën e pagës së një viti, Gjykata e Lartë e pezulloi Çështjen dhe e çoi në Gjykatën Kushtetuese.<sup>185</sup> Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë i kërkojnë Gjykatës Kushtetuese të shprehet për mospajtueshmëri me Nenin 18 të Kushtetutës, i cili parashikon parimin e mosdiskriminimit, të disa neneve të Kodit të Punës, duke parashtruar se disa dispozita të Kodit të Punës bien ndesh me parimin e barazisë përpara ligjit sepse lejojnë diskriminimin për shkaqe sociale, krijojnë mundësi që punëdhënësit të fshehin motivin e diskriminimit dhe transferojnë barrën e provës tek punëmarrësit.

<sup>184</sup> Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, Nr. 11, datë 27.08.1993. Përmbledhje e vendimeve, viti 1992-1997, f 91; Nr. 171, datë 30.07.2002. Përmbledhje e vendimeve, viti 2002, f 184; Nr. 71, datë 02.12.1998. Përmbledhje e vendimeve, viti 1997-1999, f 206; Nr. 16, datë 17.04.2000. Përmbledhje e vendimeve, viti 2000, f 20; Nr. 34, datë 20.12.2005. Përmbledhje e vendimeve, viti 2005, f. 289.

<sup>185</sup> Vendimi i Gjykatës Kushtetuese, V 33/07, 12 shtator 2007.

Gjykata Kushtetuese vuri në dukje se dispozitat trajtonin çështje të ndryshme. Ngjashmëria/barazia e tyre qëndron vetëm në të drejtat e ngjashme për të arritur një kontratë pune dhe për ta prishur atë për arsye të parashikuara në kontratë dhe në ligj. Nga njëra anë, punëdhënësi, sipas Kodit të Punës, ka disa detyrime për të plotësuar ndërsa respekton një kontratë pune, dhe nga ana tjetër, duhet që punëmarrësi, në të njëjtin kontekst, të plotësojë disa detyrime.

Sipas Nenit 146/2 të Kodit të Punës, është e drejta e punëdhënësit të bëjë padi kundër punëmarrësit në rast se kontrata prishet pa shkaqe të arsyeshme, që do të thotë se në pozitën e paditësit, punëdhënësi ka barrën e provës për praninë apo mungesën e shkaqeve të paarsyeshme për prishjen e kontratës së punës.<sup>186</sup>

Gjykata Kushtetuese deklaroi se këto dy subjekte, edhe në kuadër të procedurës civile, janë në pozita të përcaktuara procedurale, njëri në pozitën e paditësit dhe tjetri në atë të të paditurit në një procedurë gjyqësore, ku njëra palë pretendon diçka, ndërsa pala tjetër mund të kundërshtojë këtë pretendim në përputhje me parimin e kundërshtisë.<sup>187</sup>

Do të ishte diskriminuese një dispozitë që do të bënte dallimin, nga pikëpamja e barrës së provës, midis argumenteve të ndryshëm, si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, besimi politik, statusi ekonomik apo varësia prindërore, duke e trajtuar një grup ndryshe nga një tjetër, por të gjithë brenda kategorisë së punëmarrësit,

Gjykata Kushtetuese ju referua Nenit 14 të KEDNJ-së, sipas të cilit të drejtat dhe liritë e pranuar në këtë Konventë, duhet të sigurohen pa dallime për shkaqe seksi, race, ngjyre, gjuhe, feje, opinionimi politik apo ndonjë opinionimi tjetër, origjine kombëtare apo sociale, varësie të një pakice kombëtare, pasurie, prone, lindje, apo ndonjë rrethane tjetër, dhe deklaroi se diskriminimi nuk mund të qëndrojë si një motiv në vetvete, por duhet të lidhet ngushtë me disa të drejta të tjera themelore të parashikuara në Kushtetutë.

Ky qëndrim pasqyrohet gjithashtu edhe në praktikën e GjEDNJ-së e cila ka theksuar: “Neni 14 i Konventës plotëson të drejtat e tjera themelore të parashikuara nga kjo Konventë dhe protokollet e saj. Ky nen nuk qëndron më vete meqenëse ai ndikon në ‘gëzimin e të drejtave dhe lirive’ të parashikuara në këto dispozita. Ndonëse zbatimi i Nenit 14 nuk prezumon shkeljen e këtyre dispozitave, nuk ka vend për zbatimin e tij, me përjashtim të rasteve kur faktet e çështjes janë të lidhura me respektimin e të drejtave të tjera të Konventës”.<sup>188</sup>

<sup>186</sup> Neni 12 i Kodit të Procedurave Civile të Republikës së Shqipërisë.

<sup>187</sup> Neni 18 i Kodit të Procedurave Civile të Republikës së Shqipërisë.

<sup>188</sup> Çështja e Palau Martines kundër France, gjykimi i datës 16.12.1997 i GjEDNJ

Neni 146/2 i Kodit të Punës që synon t'u japë punëmarrësve mundësi të gjykojnë elementët diskriminues në gjykatë, me qëllim që të kenë mundësi për të marrë shpërblim për prishjen e një kontrate pa shkaqe të arsyeshme. Por, në të njëjtën kohë, ligjvënësi donte t'i jepte punëmarrësit mundësi për prishjen e kontratës sipas dëshirës së tij, nëpërmes zbatimit të neneve 141, 143, 144 të Kodit të Punës apo, në të kundërtën, punëmarrësi të mund të mbrohet në rast se kontrata prishet nga punëdhënësi, kur ky i fundit respekton kushtet dhe procedurat e prishjes së kontratës së punës. Mbështetur në të gjitha këto arsye, Gjykata Kushtetuese hodhi poshtë kërkesën e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

## ANEKSI I BIBLIOGRAFIA E ZGJEDHUR

- Barnard, C.*, The Changing Scope of the Fundamental Principle of Equality? 46 McGill Law Journal, 2001, 955.
- Barnard, C., and Hepple, B.*, Substantive Equality, Cambridge Law Journal, 2000, 59, 562 s.
- Besson, Samantha*, Gender Discrimination under EU and ECHR Law: Never Shall the Twain Meet?, Human Rights Law Review 2008.
- Burri, Susanne, and Prechal, Sacha*, EU Gender Equality Law, 2008.
- Burrows, N., Robinson, M.*, An Assessment of the Recast of Community Equality Law, European Law Journal, 2007, 13/2, 186s.
- Costello, C., Davies, G.*, The case law of the Court of Justice in the field of sex equality since 2000, Common Market Law Review, 2006, 43, 1567s.
- Fredman, S.*, Changing the Norm: Positive Duties in Equal Treatment Legislation, Maastricht Journal of European and Comparative Law, 2005, 12 MJ 4, 369s.
- Frangakis, N.*, The Prohibition of Discrimination in the Case-Law of the European Court of Human Rights, and Protocol No. 12 to the European Convention of Human Rights, in M. Gavouneli and V. Kyriakopoulos (red), Olympia II: Human Rights in the 21st Century, 2002, 153 s.
- Gerards, Janneke*, The Application of Article 14 ECHR by the European Court of Human Rights, in Niessen and Chopin, The Development of Legal Instruments to Combat Racism in a Diverse Europe, 2004.
- Holtmaat, Rikki*, European Women and the CEDAW-Convention – The Way Forward, 2002.
- Masselot, A.*, The State of Gender Equality in the European Union, European Law Journal, 2007, Vol 13/2, 152s.
- Radacic, Ivana*, Gender Equality Jurisprudence: An Occasional Series, European Journal of International Law 2008.

*Ramos Martin*, Nuria Elena, Positive Action Measures in European Union Equality Law, 2006.

*Schokkenbroek*, Jeroen, A New European Standard against Discrimination: Negotiating Protocol No. 12 To the European Convention on Human Rights, in Niessen and Chopin, The Development of Legal Instruments to Combat Racism in a Diverse Europe, 2004.

*Schöpp-Schilling*, Hanna, The Nature and the Scope of the Convention, tek ibid, The Circle of Empowerment – Twenty-Five Years of the UN Committee On the Elimination of Discrimination Against Women.

## LINKET

CEDAW

<http://www.un.org/womenwatch/daw/cedaw/>

BE

[http://ec.europa.eu/employment\\_social/gender\\_equality/index\\_en.html](http://ec.europa.eu/employment_social/gender_equality/index_en.html)

<http://ec.europa.eu/social/main.jsp?catId=418&langId=en>

<http://eur-lex.europa.eu/en/index.htm>

KEDNj

[http://www.echr.coe.int/echr/Homepage\\_EN](http://www.echr.coe.int/echr/Homepage_EN)

<http://cmiskp.echr.coe.int/tkp197/search.asp?skin=hudoc-en>

Baza e të dhënave për praktikën e GjEDNj-së:

[http://sim.law.uu.nl/SIM/CaseLaw/Hof.nsf/Hof+doc/\\$Searchform?SearchView](http://sim.law.uu.nl/SIM/CaseLaw/Hof.nsf/Hof+doc/$Searchform?SearchView)

Aneksi 3 – Indeks i Juridiksionit të GjED-së dhe GjEDNJ-së rreth Barazisë Gjinore						
Gjykata	Numri i Çështjes	Emri	Data	Regjistri	Dispozita (t) përkatëse	Fjalë(t) kyç/përmbledhje
GjED	80/70	Defrenne I	25.05.1971	445	Neni 119 i KEE-së, tani Neni 141 i Traktatit të KE-së	<b>Koncepti i pagës</b> , siç përcaktohet në Nenin 119 të Traktatit të KEE-së, nuk përfshin skemat e sigurimeve shoqërore apo përfitimet që përcaktohen drejtpërdrejt nga legjislacioni, pa asnjë element marrëveshje brenda sipërmarrjes apo degës profesionale në fjalë, që janë të detyrueshme të zbatohen për kategoritë e përgjithshme apo të cilat, brenda kuadrit të një sistemi të tillë të përgjithshëm të vendosur me ligj, kanë të bëjnë me kategori të caktuara punëmarrësish të veçantë.
GjED	43/75	Defrenne II	08.04.1976	455	Neni 119 i KEE-së, tani Neni 141 i Traktatit të KE-së	<b>Neni 119 i KEE-së ka qëllim jo vetëm ekonomik, por edhe shoqëror.</b> Parimi që burrat dhe gratë duhet të marrin pagë të barabartë, i përcaktuar në nenin 119, është një prej themeleve të së drejtës së Komunitetit. Ky mund të përdoret në gjykatat e vendit. Këto gjykata kanë për detyrë të sigurojnë mbrojtjen e të drejtave që ajo dispozitë u jep individëve, sidomos, të atyre formave të diskriminimit që e kanë origjinën drejtpërdrejt në dispozita legjislative, apo marrëveshje kolektive pune, si edhe kur burrat dhe gratë marrin pagë të pabarabartë për punë të barabartë, që kryhet në të njëjtën ndërmarrje apo shërbim, qoftë private apo publike.
GjED	129/79	Macarthys	27.03.1980	1275	Neni 119 i KEE-së; Direktiva e Këshillit 75/117/e KEE-së	Neni 119 i Traktatit të KEE-së kërkonte që burrat dhe gratë të merrnin <b>pagë të barabartë për punë të barabartë</b> dhe kjo vlenete jo vetëm në ato raste kur burrat dhe gratë bënin punë të barabartë për të njëjtin punëdhënës, në të njëjtën kohë. Qysh kur gjykata ka vendosur, se <b>Neni 119 zbatohet drejtpërdrejt</b> në të gjitha shtetet anëtare, <b>Neni 1 i Direktivës</b> duhet gjithashtu të zbatohet drejtpërdrejt, ndryshe qëllimi i Nenit 119 do të prishet.

Gjykata	Numri i Çështjes	Emri	Data	Regjistri	Dispozita (t) përkatëse	Fjalë(t) kyç/përmbledhje
GjED	12/81	Garland	09.02.1982	I-359	Neni 141 i Traktatit të KE-së; Neni 1 Direktiva 75/117/e KEE-së; Neni 1, Direktiva 76/207/e KEE-së	<b>Përfitimet e udhëtimit përbëjnë “pagë”:</b> diskriminim i punëmarrësve femra, të cilat kur janë në pension nuk vazhdojnë më të gëzojnë lehtësi udhëtimi për bashkëshortët e tyre dhe fëmijët në ngarkim, përkundrejt punëmarrësve meshkuj, që i gëzojnë ato.
GjED	184/83	Hofmann	12.07.1984	3047	Neni 1, 2 (3), (4), 5 (1) Direktiva 76/207/e KEE-së	Direktiva 76/207 pranon legjitimitetin, nga pikëpamja parimore, e trajtimit të barabartë, mbrojtjes së nevojave të gruas në dy drejtime: <b>mbrojtja e gjendjes së saj biologjike</b> gjatë barrës dhe deri në atë kohë që funksionet e saj psikologjike dhe mendore të jenë kthyer në gjendje normale dhe së dyti, <b>mbrojtje të marrëdhënies së veçantë midis një gruaje dhe fëmijës së saj</b> . Nenet 1, 2 dhe 5 (1) Direktiva 76/207 duhen interpretuar se do të thonë se, pas mbarimit të periudhës mbrojtëse, një Shtet Anëtar duhet t’i japë një nëne një periudhë leje lindje, të cilën shteti e inkurajon atë ta marrë, duke i paguar asaj një pagesë. Direktiva nuk i detyron ShA-të që si alternativë, një leje të tillë t’ua japë baballarëve, edhe në ato raste kur partnerët vendosin kështu.

GjED	170/84	Bilka Kaufhaus	13.05.1986	1607	Neni 119 i KEE-së, tani Neni 141 i Traktatit të KE-së	<p>Neni 110 i Traktati shkelet nga një sipërmarrje, e cila i përjashton punëmarrësit me orë të pjesshme nga skema e pensioneve profesionale, kur ai përjashtim mbështetet në faktorë të justifikuar objektivisht, të palidhur me ndonjë diskriminim për shkaqe seksi. Neni 119 i Traktatit të KE-së është shkelur nga një sipërmarrje, e cila i përjashton <b>punëmarrësit me orë të pjesshme</b> nga skema e pensioneve profesionale, kur ai përjashtim <b>ndikon tek një numër shumë më i madh</b> <b>grash se burrash</b>, në rast se kjo sipërmarrje nuk provon se ai përjashtim mbështetet në faktorë të justifikuar objektivisht, të palidhur me ndonjë diskriminim për shkaqe seksi. Neni 119 nuk ka si efekt që t'i kërkojë një punëmarrësi të organizojë skemat e tij të pensioneve profesionale në mënyrë të tillë, që të marrë parasysh vështirësitë e veçanta me të cilat përballen personat me detyrime familjare për të plotësuar kushtet për marrjen e një pensioni të tillë.</p>
GjED	222/84	Johnston	15.05.1986	1651	Neni 2 dhe 6 Direktiva 76/207/e KEE-së	<p>Parimi i një kontrolli të efektshëm gjyqësor, të përcaktuar në Nenin 6 të Direktivës 76/207, nuk lejon që një certifikatë e lëshuar nga një autoritet kombëtar të deklarojë se janë plotësuar kushtet për përjashtimin nga parimi i trajtimit të barabartë të burrave dhe grave, për qëllimin e mbrojtjes së sigurisë publike për t'u trajtuar si dëshmi përfundimtare, që të përjashtojë ushtrimin e çdo lloji të drejte për shqyrtim nga gjykatat. Dispozita që përmban Neni 6, sipas të cilit të gjithë personat, që e konsiderojnë veten të dëmtuar <b>nga diskriminimi midis burrave dhe grave, duhet të kenë mundësi për zgjidhje të efektshme gjyqësore</b>, mund të përdoret nga individët kundër një ShA-je, i cili nuk ka siguruar që ai të zbatohet plotësisht në rendin e tij të brendshëm juridik. Meqenëse Neni 2 (2) dhe (3), Direktiva 76/207 autorizon përjashtimet nga e drejta për trajtim të barabartë, në lidhje me qasje në punësim dhe në kushtet e punës, ajo duhet të interpretohet në mënyrë strikte dhe në përputhje me parimin e proporcionalitetit.</p>

Gjykata	Numri i Çështjes	Emri	Data	Regjistri	Dispozita (t) përkatëse	Fjalë(t) kyç/përmbledhje
GjED	237/85	Rummler	01.07.1986	2101	Neni 11 Direktiva 75/117/e KEE-së	Në përgjithësi, Direktiva 75/117 nuk ndalon përdorimin, në një sistem të klasifikimit të vendeve të punës, sikundër përmendet në paragrafin e dytë të Nenit 1, me qëllimin e përcaktimit të shkallës së pagesës, të <b>kriterit të kërkesës muskulore</b> , apo të përpiqjes muskulore, apo atë të karakterit të rëndë të punës, kur, duke pasur parasysh natyrën e detyrave të përfshira, puna që duhet kryer në fakt kërkon përdorimin e një shkalle të caktuar force fizike në punë, për sa kohë që sistemi në tërësi, duke pasur parasysh kriteret e tjera, përjashton çdo lloj diskriminimi për shkaqe seksi.
GjED	66/86	Lawrie-Blum	03.07.1986	2121	Neni 48 i Traktatit të KEE-së	Interpretimi i <b>termit “punëtor”</b> sipas kuptimit të së drejtës së Komunitetit: ekzistenca e një marrëdhënie punësimiti, duke përfshirë mësuës, të trajnuar.
GjED	157/86	Murphy	04.02.1988	673	Neni 119 i KEE-së, tani Neni 141 i Traktatit të KE-së	Neni 119 i Traktatit të KEE-së, që zbatohet drejtpërdrejt, në kuptimin që, punëtorët në fjalë mund të mbështeten në të në procedura ligjore, dhe në kuptimin që, gjykatat kombëtare mund ta marrin parasysh si pjesë <b>përbërëse</b> të së drejtës së Komunitetit, duhet interpretuar se mbulon, përveç rastin e pagës së pabarabartë për punë të barabartë, apo për punë me vlerë të barabartë, edhe rastin kur një punëtor, që mbështetet në atë dispozitë për të përfuar pagë të barabartë sipas kuptimit të saj aty, merret me <b>punë me vlerë më të madhe</b> se ajo e personit me të cilin do të bëhet krahasimi.

GjED	318/86	Commission kundër Francës	30.06.1988	3559	Neni 2 (2) Direktiva 76/207/c KEE-së	Largimi nga parimi i trajtimit të barabartë për burrat dhe gratë, në lidhje me qasjen në punësim dhe me kushtet e punës, të parashikuar në Nenin 2 (2) të Direktivës 76/207, për veprimtari profesionale për të cilat seksi përbën një faktor përcaktues, mund të konsiderohet, në rastin e një korpusi të shërbimit civil, në lidhje me të cilin <b>rekrutimi i veçantë i kandidatëve meshkujve dhe femra</b> përgjithësisht përligjet sipas dispozitës në fjalë, se përfshin veprimtari që i korrespondojnë shkallës më të lartë të korpusit në fjalë, edhe kur disa prej këtyre veprimtarive nuk duhen kryer pa tjetër nga persona të njërit seks, duke pasur parasysh mënyrën se si duhet strukturuar karriera e zyrtarëve dhe rëndësinë që i duhet dhënë përvojës së tyre profesionale.
GjED	C-262/88	Barber	17.05.1990	I-1889	Neni i Traktatit të KEE-së, Direktivat 79/7/ e KEE-së dhe 86/378/të KEE-së	<b>Përfitimet e paguara nga një punëdhënës</b> një punëmarrësi, kur ky i fundit del i tepërt, përbëjnë një formë pagese e cila punëtorit i takon ta marrë në lidhje me punën e bërë, e cila i paguhet atij me prishjen e marrëdhënies së punësimit, për të lehtësuar përshfaqjen e tij në rrethanat e reja që rrjedhin nga humbja e punës, dhe që i siguron atij një burim të ardhurash për periudhën në të cilën ai kërkon punë të re. Përfitime të tilla të paguara në lidhje me pushim të detyruar nga puna, si rrjedhojë, bëjnë pjesë në gamën e paragrafit të dytë të Nenit 119-të Traktatit, qoftë kur paguhen sipas një kontrate punësimi, për shkak të dispozitave ligjore, qoftë në bazë vullnetare.
GjED	C-33/89	Kowalska	27.06.1990	I-2591	Neni 119 i KEE-së, tani Neni 141 i Traktatit të KE-së	Pagë e barabartë- <b>ndihma financiare për ndërprerjen e punës</b> , që nuk u paguhet punëtorëve me orë të pjesshme, me prishjen e marrëdhënies së punës- kur forca punëtore me orë të pjesshme përbëhet kryesisht prej grash – nuk lejohet, me përjashtim të rasteve kur mbështetet në faktorë të përligjur objektivisht.

Gjykata	Numri i Çështjes	Emri	Data	Regjistri	Dispozita (t) përkatëse	Fjalë(t) kyç/përmbledhje
E drejtë e GjED-së	C-177/88	Dekker	08.11.1990	I-3941	Nenet 2(1 )dhe 3(1) Direktiva 76/207/e KEE-së	Një punëdhënës është në shkallë të drejtpërdrejt të parimit të trajtimit të barabartë, të mishëruar në Nenin 2(1 ) dhe 3(1 ) të Direktivës së Këshillit 76/207/të KEE-së të 9 shkurtit 1976, në rast se refuzon të hyjë në një kontratë punësimi me një <b>kandidate femër</b> , të cilën e konsideron të përshatshme për punën, kur një refuzim i tillë mbështetet në pasojë negative të mundshme për të, në rast punësimi të një gruaje <b>shtatzënë</b> , për shkak të rregullave të miratuara nga autoritetet publike për papërshatshmërinë e saj për të punuar në atë grëndje, të cilat përfshijnë paafësinë për punë për shkak barre dhe lehonie, deri në paafësinë për punë për shkak sëmundje. Fakti që asnjë burrë nuk bëri kërkesë për atë punë nuk ka lidhje.
GjED	C-179/88	Hertz	08.11.1990	I-3979	2(3) Direktiva 76/207/e KEE-së	Pa paragjykim për dispozitat e ligjit të vendit për mbrojtjen e grave, sidomos në lidhje me shtatzëninë dhe lindjen, të miratuara në përputhje me Nenin 2(3) të Direktivës 76/207/ të KEE-së, Neni 5 (1) i asaj direktive, bashkë me Nenin 2 (1) të saj, nuk përjashtojnë <b>pushimet nga puna</b> të cilat janë pasojë e <b>mungesave për shkak sëmundje, që mund t'i atribuohen shtatzënisë apo lehonisë</b> .
GjED	C-345/89	Stoeckel	25.07.1991	I-4047	Neni. 5 Direktiva 76/207/e KEE-së	Neni 5 i Direktivës 76/207/të KEE-së është mjaftueshmërisht i saktë duke i detyruar Shtetet Palë të përrekojnë me ligj parimin se puna e natës është e ndaluar për gratë, sikundër edhe kur një detyrim i tillë mund t'i nënshtrohet përjashtimeve, aty kur puna e natës për burrat nuk është e ndaluar.

GjED	C-360/90	Bötel	04.06.1992	I-3589	Neni 119 i KEE-së, tani Neni 141 i Traktatit të KE-së, Direktiva 75/117/e KEE-së	Pagë e barabartë; <b>Kompensim për pjesëmarrje në kurse trajnimi</b> për anëtarë të këshillit të stafit, të mbajtur gjatë punëve me orë të plota; Rregulla kombëtare që kufizojnë kompensimin për punëmarrësit me orë të pjesshme deri sa orët e punës të secilit. Dallim në trajtim në lidhje me punëmarrësit me orë të plota; Anëtarë të Këshillit stafit të punësuar me orë të pjesshme, kryesisht gra; Nuk lejohet pa një justifikim objektiv.
GjED	C-421/92	Habermann-Beltermann	05.05.1994	I-1657	Nenet 2(1) dhe (3), 3(1) dhe 5(1) Direktiva 76/207/e KEE-së	Qasje në punësim dhe në kushtet e punës – Trajtim i barabartë <ul style="list-style-type: none"> <li>o Kontratë pa afat për punë nate midis një punëdhënësi dhe një gruaje shtatzënë, kur të dy palët nuk kanë pasur dijeni për shtatzëninë - E pavlefshme për shkak të <b>ndalimit me ligj të punës së natës për gratë shtatzëna</b>, apo që nuk përdoret nga punëdhënësi për shkak të një gabimi nga ana e tij – E palejueshme – Ta quash kontratën të pavlefshme apo të shfuqizuar, për shkak të paafësisë së përkohshme të punëmarrëses shtatzënë për të kryer punë nate, për të cilën ajo është angazhuar, do të binte ndesh me objektivin e mbrojtjes të personave të tillë, sipas Nenit 2(3) të Direktivës dhe do ta bënte atë dispozitë të paefektshme.</li> </ul>
GjED	C-32/93	Webb	14.07.1994	I-3567	Nenet 2(1) dhe 5(1) Direktiva 76/207/e KEE-së	Qasje në punësim dhe në kushtet e punës – Trajtim i barabartë <ul style="list-style-type: none"> <li>- <b>Pushimi</b> i një punëmarrëseje, e cila është punësuar për një periudhë të pakufizuar, si zëvendësuese e menjëhershme për një punëmarrëse tjetër gjatë lejes së lindjes së kësaj të fundit, por e cila nuk mund të veprojë <b>për shkak të shtatzënisë së saj</b> – E palejueshme</li> </ul>

Gjykata	Numri i Çështjes	Emri	Data	Regjistri	Dispozita (t) përkatëse	Fjalë(t) kyç/përmbledhje
GjED	C-450/93	Kalanke	17.10.1995	I-3051	Nenet. 2(1) dhe (4) Direktiva 76/207/e KEE-së	Neni 2(1) dhe (4) i Direktivës 76/207 i përjashton rregullat kombëtare që, në rastet kur kandidatët e seksve të kundërta, të zgjedhur për ngritje në detyrë, janë njëjloj të kualifikuar, <b>automatikisht</b> u japin <b>përparësi grave</b> në sektorë ku ato janë të nënperfëqsuara, dhe që gjykojnë se nënperfëqsimi ekziston kur gratë nuk përbëjnë të paktën gjysmën e stafit në listën e pagave individuale në grupin përkatës të personelit, apo në nivelet e funksioneve të parashikuara në organigramë.
GjED	C-317/93	Nolte	14.12.1995	I-04625	Neni 4(1) Direktiva 79/7/e KEE-së	Direktiva 79/7 për zbatimin progresiv të parimit të trajtimit të barabartë për burrat dhe gratë në çështje të sigurisë kombëtare, duhet interpretuar se do të thotë që personat në një punë që konsiderohet e pakët, për shkak se përbëhet gjithmonë prej më pak se 15 orësh pune në javë dhe gjithmonë ka një shpërblim prej deni në një të shtatën e pagës mesatare mujore, bëjnë pjesë në popullsinë që punon, sipas kuptimit të Nenet 2 të asaj direktive dhe, si rrjedhojë, futen në gamën e <i>ratione personae</i> . Fakti që të ardhurat e një personi nga punësimi nuk i imbulojnë të gjitha nevojat e tij, nuk mund ta ndalojnë atë person që, sipas të drejtës së Komunitetit, të jetë një punëmarrës apo një anëtar i popullsisë që punon. Neni 4 (1) i Direktivës 79/7, për zbatimin progresiv të parimit të trajtimit të barabartë për burrat dhe gratë në çështje të sigurisë shoqërore, duhet interpretuar se nuk i përjashton dispozitat kombëtare, sipas të cilave <b>një punësim</b> , që rregullisht përbëhet <b>prej më pak se 15 orë pune në javë</b> dhe që rregullisht ka një shpërblim prej deni në një të shtatën e pagës mesatare mujore, <b>përjashtohet nga skema statutorë e sigurimeve për vjetërsi</b> , edhe kur kjo gjë prek më shumë gratë se burrat, meqenëse legjislatura e vendit ka pasur të drejtë të arsyeshme për të marrë parasysh se legjislatiioni në fjalë ishte i nevojshëm për arritjen e një qëllimi të një politike shoqërore, të palidhur me ndonjë diskriminim për shkaqe seksi. Kjo do të ndodhë kur përjashtimi i një punësimi të tillë nga sigurimet e detyruara, që i korrespondon një parimi strukturor të një skeme sigurimesh shoqërore me kontribute, është e vetmja mënyrë për të plotësuar një kërkesë shoqërore për punë të tilla dhe është hartuar për të mënjuar rritjen e punësimit të paligjshëm dhe mjetet për t'i bërë bisht legjislatiioni shoqëror.

GjED	C-444/93	Megner	14.12.1995	I-04741	Neni 4(1) Direktiva 79/7/e KEE- së	Shih Çështjen Nolte.
GjED	C-342/93	Gillespie	13.02.1996	I-475	Neni 119 i Traktatit të KEE-së, tani Neni 141 i Traktatit të KE-së; Direktiva 75/117/e KEE-së	Paga e barabartë – <b>përfitim i paguar</b> nga një punëdhënës <b>një gruaje për leje lindje</b> , sipas legjislacionit apo marrëveshjeve kolektive, <b>hyn në përkufizimin e “pagës”</b> . Parimi i pagës së barabartë as kërkon që gratë të vazhdojnë të marrin pagë të plotë gjatë lejes së lindjes, as përcakton kritere specifike për të përcaktuar sasinë e përfimit që i paguhet atyre gjatë asaj periudhe, me kusht që sasia të mos jetë aq e vogël, sa të rrezikojë qëllimin e lejes së lindjes. Megjithatë, për aq kohë sa ato përlogariten në bazë të pagës së marrë nga një grua përpara se të fillojë lejen e lindjes, sasia e këtyre përfitimeve duhet të përfshijë rritje page që jepen që nga fillimi i periudhës së mbuluar nga paga e referencës dhe fundi i lejes së lindjes, duke filluar nga data në të cilën ato hyjnë në fuqi. Mohimi i një përfitimi të tillë një gruaje me leje lindje, do të ishte diskriminim ndaj saj thjesht në cilësinë e saj si punëmarrëse, duke qenë se, po të mos kish qenë shtatzënë, ajo do ta kishte përfutuar një rritje page të tillë.
GjED	C-400/95	Larsson	29.05.1997	I-2757	Nenet 2(1) dhe (3) dhe 5(1) Direktiva 76/207/e KEE-së	Qasje në punë dhe në kushtet e punës – Trajtim i barabartë – <b>Pushimi nga puna i një gruaje për mungesa, si rezultat i një sëmundje që i atribuohet barrës apo lehonisë – E lejueshme</b> – Duke marrë parasysh mungesat jashtë periudhave të lejes së lindjes në llogaritjen e periudhës që jep shkak për pushim nga puna, – E lejueshme – Jasthtë periudhës së lejes së lindjes, megjithatë, dhe në mungesë të një dispozite kombëtare, apo sipas rastit, <b>të së drejtës së Komunitetit që u jep grave mbrojtje të veçantë, një grua nuk mbrohet nga Direktiva nga pushimi nga puna për shkak të një periudhe mungesash, si pasojë e një sëmundje që mund t'i atribuohet shtatzënisë.</b>

Gjykata	Numri i Çështjes	Emri	Data	Regjistri	Dispozita (t) përkatëse	Fjalët(t) kyç/përmbledhje
GjED	C-409/95	Marschall	11.11.1997	I-6363	Nenet. 2(1) dhe (4) Direktiva 76/207/e KEE-së	Një rregull kombëtar, i cili, në rastin kur ka më pak gra se burrat në nivelin e postit përkatës në një sektor të shërbimit publik, dhe kur të dy kandidatët për postin, një femër dhe një mashkull, janë njëjloj të kualifikuar për nga përshatshmëria, kompetenca dhe aftësia profesionale, <b>kërkon që t'i jepet përparësi nxitjes së kandidatëve femra</b> , me përjashtim të rasteve kur arsyet që lidhen konkretisht me një kandidat mashkull e kthejnë balancën në favor të tij, nuk përjashtohet nga Neni 2(1) dhe (4) i Direktivës 76/207 për zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë për burrat dhe gratë në lidhje me qasjen në punësim, trajnim profesional dhe ngrije në detyrë, dhe në kushtet e punës, me kusht që: në çdo rast konkret rregulli të sigurojë garancinë që, kandidatët meshkuj, të cilët janë njëjloj të kualifikuar me kandidatet femra, t'i nënshtrohen një vlerësimi objektiv, që do të marrë parasysh të gjitha kriteret konkrete të kandidatëve dhe nuk do të përfillojë përparësinë që u jepet kandidatëve femra kur një apo më shumë nga këto kriteret e kthejnë balancën në favor të kandidatit mashkull, dhe kur kriteret të tilla nuk janë të tilla që të diskriminojnë kandidatet femra.
GjED	136/95	Thibault	30.04.1998	I-2011	Nenet 2(3) dhe 5(1) Direktiva 76/207/e KEE-së	Qasje në punësim dhe kushtet e punës – Trajtim i barabartë – Rregullat kombëtare, që i heqin një gruaje të <b>drejtën për një vlerësim të punës së saj</b> , për shkak të mungesës së saj nga ndërmarrja gjatë kohës që është me leje lindje – Të palejueshme.
GjED	C-243/95	Hill dhe Stapleton	17.06.1998	I-3739	Neni 119 i KEE-së, tani Neni 141 i Traktatit të KE-së; Direktiva 75/117/e KEE-së	Neni 119 i Traktatit dhe Direktiva 75/117/e KEE-së duhen interpretuar si legjislacion përjashtues i cili, kur një përqindje më e madhe punëmarrësesh femra, krahasuar me punëmarrësit meshkuj janë të angazhuar në një punë të ndarë, <b>ndarësve të punës</b> , që kthehen në punë me orë të plota, u jepet një pikë në shkallën e pagës që zbatohet për stafin me orë të plota, që është më e ulët se ajo kishim më parë këta punëtorë në shkallën e pagës që përdorej për stafin që ndante punën, për shkak të faktit se, punëdhënësi ka përdorur kriterin e shërbimit të përlogatitur me kohëzgjatjen aktuale të punës, që është punuar në një post, në një kohë kur një legjislacion i tillë justifikohet me kriteret objektive, që nuk lidhen me ndonjë diskriminim për shkaqe seksi.

GJED	C-411/96	Boyle	24.10.1998	I-6401	<p>Neni 119 i Traktatit të KEE-së, tani 141 Traktati i KEE-së; Neni 1 Direktiva 75/117/e KEE-së, Nenet 8 dhe 11 Direktiva 92/85/e KEE-së, Neni 5(1) Direktivat 76/207/e KEE-së</p>	<p>Neni 119 i Traktatit të KE-së, Neni 1 i Direktivës 75/117 dhe Neni 11 i Direktivës 92/85 nuk përjashtojnë që një kontratë punësimi, të përmbajë një kusht, sipas të cilit pagesa e lejes së lindjes, e cila i referohet Nenet 8 të Direktivës 92/85 të pagës më të lartë se pagesat statutorë për lejen e lindjes, të kushtëzohet nga angazhimi i punëmarrëses për t'u kthyer në punë të paktën një muaj pas lindjes së fëmijës, dhe që, në rast të mosbajtjes të premtimit, asaj t'i kërkohet të shlyejë diferencën midis sasisë së pagës që ajo do të kish marrë gjatë periudhës së lejes së lindjes, nga njëra anë, dhe sasisë së këtyre pagesave, nga ana tjetër, për aq kohë sa niveli i atyre pagesave të mos jetë më i ulët se të ardhurat që do të merrte punëmarrësja në fjalë sipas ligjit përkatës kombëtar të sigurimeve shoqërore, në rast shkëputje të vepimitarisë së saj për shkakë të lidhura me gjendjen e saj shëndetësore. Ndonëse Neni 8 i Direktivës 92/85 parashikon një periudhë të vazhdueshme leje lindje prej të paktën 14 javësh, duke përfshirë edhe lejen e detyruar të lindjes prej të paktën dy javësh, megjithatë, ajo e <b>lë të hapur që Shtetet Palë të përcaktojnë datën në të cilën duhet të fillojë leja e lindjes</b>. Për më tepër, në përputhje me Direktivën 76/207, çdo Shtet Anëtar e ka në dorë, brenda kufijve të përcaktuar në Nenin 8 të Direktivës 92/85, të përcaktojë periudhën e lejes së lindjes, me qëllimin për t'i dhënë mundësi punëmarrëseve femra të mungojnë nga puna gjatë periudhës në të cilën ndodhin çrregullimet, që lidhen me barrën dhe lehoninë. Ndonëse është në dorën Shteteve Anëtare t'i kushtëzojnë të drejtat për pagesë apo pagesën e duhur që përmendet në Nenin 11(2)(b) të Direktivës 92/85 me plotësimin nga punëmarrësja në fjalë të kushteve të kualifikimit për të marrë përfitime të tilla, të përcaktuara në legjislacionin e vendit, një mundësi e tillë nuk ekziston në lidhje me <b>të drejtat që kanë të bëjnë me kontratën e punësimi</b>, sipas kuptimit të Nenet 11(2)(a).</p>
------	----------	-------	------------	--------	--	--

Gjykata	Numri i Çështjes	Emri	Data	Regjistri	Dispozita (t) përkatëse	Fjalë(t) kyç/përmbledhje
GjED	C-309/97	Angestelltenbetriebsrat der Wiener Gebietskrankenkasse	11.05.1999	I-2865	Neni 119 i KEE-së, tani Neni 141 i Traktatit të KE-së; Direktiva 75/117/e KEE-së	Pagë e barabartë – Personat që bëjnë të njëjtën punë – ‘E njëjta punë’ –Do të thotë – Persona në një situatë të krahasueshme – Faktorë për t’u marrë parasysh – Personat që kryejnë detyra të njëjta, por që kanë përgatitje dhe kualifikime të ndryshme profesionale – Nuk mbulohet- Kjo nuk ndodh me dy grupe personash, siç janë psikologët dhe mjekët e punësuar si psikoterapistë, të cilët kanë marrë trajnim të ndryshëm profesional dhe që, për shkak të gamës së ndryshme të kualifikimeve që rezultojnë nga ai trajnim, në bazë të të cilit ata janë punësuar, u kërkohet të kryejnë detyra apo punë të ndryshme.
GjED	C-218/98	Abdoulaye	16.09.1999	I-5723	Neni 119 i KEE-së, tani Neni 141 i Traktatit të KE-së; Direktivat 75/117/e KEE-së 76/207/KEE-së	<b>Parimi i pagës së barabartë nuk përjashton dhënien e një shume parash vetëm për punëmarrëse femra</b> , që marrin leje lindje, ku ajo pagesë synon të kompensojë disavantazhet që kanë këto punëtores si rrjedhojë e të qenit të larguara nga puna.
GjED	C-333/97	Lewen	21.10.1999	I-7243	Neni 141 i Traktatit të KE-së	<b>Paga përfishin kompensime të posaçme të paguara nga punëdhënësi</b> : një shpërblim ex-gratia për krishtlindje quhet “pagesë” sipas kuptimit të Nenit 141 të Traktatit të KE-së. E drejta e BE-së nuk përjashton që punëdhënësi të refuzojë krejtësisht t’i paguajë një gruaje një shpërblim ex-gratia për Krishtlindje vetëm sepse ajo është larguar nga puna gjatë vitit për arsye lindje, por ai nuk përjashton refuzimin për t’ia paguar një shpërblim të tillë një gruaje me leje prindërore, ku dhënia e shpërblimit varet nga kushti i vetëm që ai u paguhet vetëm atyre punëmarrësve që janë në punësim aktiv, në të cilin jepet ai shpërblim.

GjED	C-273/97	Sirdar	26.10.1999	I-7403	Neni 2(2) Direktiva 76/207/e KEE-së	<p>Trajtimit i barabartë – Kushte pune dhe qasje në punësim – Përfshirje për shkak të sigurisë publike – Varet nga rregullat e të drejtës komunitare – Opsioni i mundshëm sipas Nenit 2(2) të Direktivës 76/207 - Gama – <b>Përfshirja dhe grave nga pjesëmarrje në British Royal Marines</b> – I leqeshëm - Kriteret</p>
GjED	C-285/98	Kreil	11.01.2000	I-69	Neni 2 Direktiva 76/207/e KEE-s	<p><b>Direktiva përfshirje</b> zbatimin e dispozitave të vendit të tilla si ato të ligjit gjerman, i cili vendos <b>një përfshirje të përgjithshme të grave nga poste ushtarake</b>, ku kërkohet përdorimi i armëve, por që u lejon atyre qasje vetëm në shërbimet mjekësore dhe ushtarake-muzikore.</p>
GjED	C-50/96	Schröder	10.02.2000	I-743	Neni 119 i KEE-së, tani Neni 141 i Traktatit të KEE-së	<p>Pagë e barabartë. <b>Qëllimi ekonomik i Neni 141 të Traktatit të KE-së është vetëm dytësor. Parimi i pagës së barabartë është shprehje e një të drejte themelore të njeriut.</b></p>
GjED	C-158/97	Badeck	28.03.2000	I-1875	Neni 2(1) dhe (4) Direktiva 76/207/e KEE-së	<p>Neni 2(1) dhe (4) i Direktivës 76/207 nuk përfshihen një rregull kombëtar i cili, në sektorë të shërbimit publik ku gratë janë të nëpërfaqësuar, u jep përparësi kandidatëve femra, ku kandidatët meshkuj dhe femra kanë <b>kualifikime të njëjta</b>, kur kjo gjëdele nevojshme për të siguruar respektimin e objektivave të planit të avancimit të grave, kur nuk kundërshtohet me arsye me peshë më të madhe ligjore, me kusht që ai rregull të garantojë që kandidatët t'i nënshtrohen <b>një vlerësimi objektiv</b>, i cili merr parasysh situatat personale specifike të të gjithë kandidatëve; parashtron se, objektivat detyruese të planit për avancimin e grave për poste të përkohshme në shërbimin akademik dhe për ndihmëse akademike, duhet të sigurojë një përfshirje minimale grash, të paktën të barabartë me përfshirjen e grave ndër të diplomuarit, mbajtësit e shkollave më të larta dhe studentëve në secilin disiplinë; që lidhet me përbërjen e organeve përfaqësuese të punëmarrësve dhe organeve administrative dhe mbikëqyrëse, rekomandon se dispozitat legjislative të miratuara për zbatimin e tij duhet të marrin parasysh objektivin që të paktën gjysma e kandidatëve në këto organe duhet të jenë gra.</p>

Gjykata	Numri i Çështjes	Emri	Data	Regjistri	Dispozita (t) përkatëse	Fjalë(t) kyç/përmbledhje
GjED	C-196/98	Hepple	23.05.2000	I-3701	Neni 7(1) (a) Direktiva 79/7/e KEE-së	<p>Znj. Hepple dhe katër persona të tjerë të pyetur kërkuan <b>dhënien e pagesës për të ardhura të ulura</b> (që tani e tutje REA), një përfitim javor në para në dorë, që u paguhet punëmarrësve apo ish punëmarrësve që kanë pësuar një ulje të të ardhurave pas një aksidenti në punë apo një sëmundje profesionale. Qëllimi i tij është t'i kompensojë ata për kufizimin e aftësisë për të fituar para. Duhet të kihet gjithashtu parasysh se <b>moshë e daljes në pension</b> në Britaninë e Madhe është 65 vjeç për burrat dhe 60 për gratë. Sipas Nenit 7(1)(a) të Direktivës 79/7, për zbatimin progresiv të parimit të trajtimit të barabartë për burrat dhe gratë në çështje të sigurimeve shoqërore, ajo direktivë duhet të jetë pa paragjykim ndaj të drejtës së Shteteve Anëtare për të përjashtuar nga gama e saj jo vetëm përcaktimin e moshës së pensionit, për qëllimet e dhënies së pensioneve të vjetërsisë dhe <b>të pensionit</b>, por edhe për pasojat e mundshme që rrjedhin prej këtyre përfitimeve. Megjithatë, mbajtja e përkohshme e moshave të ndryshme të daljes në pension sipas seksit, mund të bëjë të nevojshme miratimin më pas, pas përfundimit të periudhës së përshkruar për transpozimin e direktivës, të masave të cilat janë të pandashme prej përjashtimit nga parimi i trajtimit të barabartë për burrat dhe gratë, si edhe amendamentet e masave të tilla. T'i ndalosh një Shteti Anëtar, i cili ka moshë të ndryshme për daljen në pension, të miratojë apo të ndryshojë më pas, pas përfundimit të periudhës së parashikuar për transpozimin e direktivës, masa që lidhen me atë dallim në moshën e pensionit, do të ishte baras me bërijen praktikisht të pavlefshme të përjashtimit të lejuar nga dispozita e sipërpërmendur.</p>

GjED	C-407/98	Abrahamsson	06.07.2000	I-5539	Neni 2(1) dhe (4) Direktiva 76/207/e KEE-së	<p>Neni 2(1) dhe (4) i Direktivës së Këshillit 76/207/të KEE-së dhe Neni 141(4) i KE-së i ndalojnë legjislacionet kombëtare, sipas të cilëve që kandidat për një post publik, i cili i përket seksit të nënpërfaqësuar dhe i ka të gjitha kualifikimet e nevojshme për atë post, duhet të zgjidhet ndaj një kandidati të seksit të kundërt, i cili ndryshe do të ish caktuar në atë post, kur kjo gjë është e nevojshme për të siguruar cakimin e një kandidati të seksit të nënpërfaqësuar dhe kur diferenca midis meritave përkatëse të kandidatëve nuk është aq e madhe, sa të shkaktojë një shkelje të kërkesës për objektivitet në bërjen e emërimeve. Këto Nene gjithashtu përjashtojnë ligjet kombëtare të këtij lloji, kur bëhet fjalë për procedura për plotësimin e një numri të paracaktuar postesh apo të posteve të krijuara si pjesë e një programi specifik të një institucioni të caktuar të lartë arsimor, që lejon zbatimin e <b>masave pozitive diskriminuese</b>. Neni 2(1) dhe (4) i Direktivës 76/207 nuk përjashton një rregull të praktikës së vendit, sipas të cilit një kandidati që i takon seksit të nënpërfaqësuar mund t'i jepet preferencë ndaj një konkurrenti të seksit të kundërt, me kusht që kandidatët të kenë <b>merita të njëjta apo kryesisht të njëjta</b>, kur kandidaturat i nënshirohen një vlerësimi objektiv, i cili merr parasysh situatat specifike personale të të gjithë kandidatëve.</p>
GjED	C-438/99	Jeménez Melgar	04.10.2001	I-6915	Neni 10 Direktiva 92/85/e KEE-së	<p><b>Neni 10 i Direktivës së Këshillit 92/85/i KEE-së ka efekt të drejtpërdrejt</b> – Ndërsa ndalimi i pushimit nga puna zbatohet për të dy kontratat e punësimit, për ato me periudhë të papërcaktuar kohe dhe për ato me afat, mospërtëritja e një kontrate, kur vjen puna për një qëllim të parashikuar, nuk mund të konsiderohet si pushim nga puna i ndaluar nga ajo dispozitë. Megjithatë, kur <b>mosrinovimi i një kontrate me afat motivohet me gjendjen e shtatzënisë të punëmarrëses në fjalë</b>, ai përbën diskriminim të drejtpërdrejt për shkaqe seksuale, që bie ndesh me Nenin 2(1) dhe 3(1) të Direktivës së Këshillit 76/207/të KEE-së të 9 shkurtit 1976, për zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë për burrat dhe gratë në lidhje me qasjen në punësim, trajnim profesional, dhe kushtet e punës.</p>

Gjykata	Numri i Çështjes	Emri	Data	Regjistri	Dispozita (t) përkatëse	Fjalë(t) kyç/përmbledhje
GjED	C-476/99	Lommers	19.03.2002	I-2891	Neni 2(1) dhe (4) Direktiva 76/207/e KEE-së	Neni 2(1) dhe (4) i Direktivës së Këshillit 76/207 /i KEE-së nuk përjashton një skemë të ngritur nga një ministër për të zgjidhur problemin e <b>nënpërfaqësimit të grave në ministrinë e tij</b> , sipas të cilit, në një kontekst ku është provuar se ka mungesë të objekteve përkatëse, të përballueshme, të kujdesit për fëmijë, <b>numri i kufizuar i vendeve të subvencionuara në çerdhe, që Ministria i ve në dispozicion të stafit të saj, t'u rezervohet vetëm punonjëseve femra</b> , ndërsa punonjësit meshkuj mund të kenë qasje në to vetëm në raste emergjencash, të cilat përcaktohen nga punëmarrësi. Megjithatë, kjo është kështu veçanërisht deri në atë shkallë kur, përjashtimi në fjalë në favor të zyrtarëve meshkuj, të jetë i tillë që t'i lejojë ata që merren vetë me kujdesin e fëmijëve të tyre, të kenë qasje në ato vende në skemën e çerdheve në të njëjtat kushte si edhe zyrtaret femra.
GjED	C-320/01	Busch	27.02.2003	I-2041	Neni 2(1) i Direktivës së Këshillit 76/207/të KEE-së	Neni 2(1) i Direktivës së Këshillit 76/207/të KEE-së duhet interpretuar se e përjashton kërkesën që një punëmarrëse, e cila, me miratimin e punëdhënësit të saj, dëshiron të kthehet në punë përpara mbarimit të lejes prindërore, duhet <b>ta informojë punëdhënësin e saj se është shtatzënë</b> , në rast se, për shkak të ndalimeve legislative të caktuara, ajo nuk do të jetë në gjendje t'i kryejë të gjitha detyrat e saj.

GjED	C-186/01	Dory	11.03.2003	I-2479	Neni 2 Direktiva 76/207/e KEE-së	<p>Moszbatimi i të drejtës së Komunitetit në rastin e shërbimit të detyruar ushtarak – Trajtim i barabartë i burrave dhe grave – Shërbimi i detyruar ushtarak në Gjermani i kufizuar vetëm për burrat- Direktiva nuk zbatohet – Është në dorën e Shteteve Anëtare që të miratojnë masat e duhura për të garantuar lirinë e tyre të brendshme dhe të jashtme, për të marrë vendimet e duhura për organizimin e forcave të tyre të armatosura – Vendimi i Republikës Federale të Gjermanisë për të siguruar mbrojtjen e saj, pjesërisht përmes shërbimit të detyruar ushtarak, është shprehje e një zgjedhje të tillë e organizimit ushtarak, ku e drejta e Komunitetit si pasojë nuk zbatohet. Znj. Dory kish argumentuar se, fakti që <b>gratë kanë të drejtë të kenë qasje në postet ushtarake</b> në përputhje me Krell, <b>por përjashtohen nga detyrimi për të kryer shërbim ushtarak, në një kohë që një detyrim i tillë zbatohet për burrat, bie ndesh me parimin e barazisë</b> dhe përbën një diskriminim të paligjshëm ndaj burrave.</p>
GjED	C-256/01	Allonby	13.01.2004	I-873	Neni 141 i Traktatit të KE-së	<p>Rrjedhimisht, <b>termi punëmarrës</b>, i përdorur në Nenin 141 (1) të KE-së, nuk mund të përcaktohet duke iu referuar legjislacionit të Shteteve Anëtare, por ka një kuptim komunitar. Për më tepër, ai nuk mund të interpretohet në mënyrë kufizuese. Në rastin që një person është punëmarrës sipas kuptimit të Nenit 141 (1) të KE-së, natyra e kësaj marrëdhënie ligjore me palën tjetër në marrëdhënien e punësimit, nuk ka rëndësi në lidhje me zbatimin e këtij neni.</p>

Gjykata	Numri i Çështjes	Emri	Data	Regjistri	Dispozita (t) përkatëse	Fjalë(t) kyç/përmbledhje
GjED	C-342/01	Merino Gomez	01.03.2004	I-2605	Neni 5(1) Direktiva 76/207/e KEE-së, Neni 11(2) (a) Direktiva 92/85/e KE-së dhe Neni 7(1) Direktiva 93/104/e KE-së	Neni 7(1) Direktiva 93/104, Neni 11(2)(a) i Direktivës 92/85 dhe Neni 5(1) i Direktivës 76/207 duan të thonë se një punëmarrëse duhet të jetë në gjendje të marrë lejen e saj <b>vjetore gjatë një periudhe tjetër nga ajo e lejes së lindjes</b> , duke përfshirë edhe një rast kur periudha e lejes së lindjes, përputhet me periudhën e përgjithshme të lejes vjetore, të caktuar me marrëveshje kolektive për të gjithë forcën e punës. Në lidhje me ruajtjen e të drejtave që lidhen me kontratën e punësimit, Neni 11(2)(a) i Direktivës 92/85, duhet interpretuar se zbatohet edhe për të drejtën e një punëmarrëseje, periudha e lejes së lindjes së të cilës përputhet me periudhën e përgjithshme të lejes vjetore, të caktuar me marrëveshje kolektive për të gjithë forcën e punës, për një periudhë më të gjatë leje vjetore, siç parashikohet nga ligji i vendit, se sa minimumi i përcaktuar nga Direktiva 93/104 për aspekte të caktuara të organizimit të kohës së punës.
GjED	C-220/02	Österreichischer Gewerkschaftsbund	08.06.2004	I-5907	Neni 141 i Traktatit të KE-së; Direktiva 75/117/e KEE-së	<b>Përfitimimi për personat që kryejnë shërbimin ushtarak, ose, një alternativë tjetër, shërbimin e detyruar civil</b> , që mund të zgjatet vullnetarisht, i cili përbëhet nga marrja parasysh, për përlogaritjen e një pagese përfundimtare, që ata mund të kenë të drejtë më pas ta kërkojnë, të kohëzgjatjes së atij shërbimi, duhet parë si pjesë e pagës së tyre, sipas kuptimit të Nenit 141 të KE-së. Neni 141 i KE-së dhe Direktiva 75/117 nuk përjashtojnë përlogaritjen e një pagese përfundimtare, që të marrë parasysh, si kohëzgjatje të shërbimit, kohëzgjatjen e periudhave të shërbimit ushtarak apo shërbimin ekuivalent civil të kryer kryesisht nga burrat, por <b>jo lejen prindërore, të marrë në shumicën e rasteve nga gratë.</b>

GjED	C-319/03	Briheche	30.09.2004	I-8807	Neni 141(4) i Traktatit të KE-së; Neni 2(4) dhe 3(1) Direktiva 76/207/e KEE-së	Nenet 3(1) dhe 2(4) të Direktivës 76/207 duhen interpretuar se duan të thonë që përjashtojnë një dispozitë kombëtare, e cila u rezervon <b>grave të veja</b> , që nuk janë rimartuar dhe që janë të detyruara të punojnë, <b>përjashtimin nga kufiri i moshës për hyrje në provime konkurruese</b> , të organizuara për punësimin e punonjësve civilë, duke i përjashtuar burrat e ve, të cilët po ashtu nuk janë rimartuar dhe që janë në të njëjtën situatë.
GjED	C-356/03	Mayer	13.01.2005	I-295	Neni 6(1) (g) Direktiva 86/378, e ndryshuar me Direktivën 96/97/të KEE-së	Neni 6(1)(g) i Direktivës 86/378, i ndryshuar nga Direktiva 96/97, duhet interpretuar se do të thotë se i përjashton rregullat e vendit, sipas të cilave një grua nuk përfiton <b>të drejta për një pagesë sigurimi</b> , që është pjesë e një skeme shtesë të pensionit profesional gjatë lejes statutorie të lindjes, të paguar pjesërisht nga punëdhënësi i saj, për shkak se përfimi i këtyre të drejtave kushitëzohet nga fakti se gruaja duhet të marrë një pagë të tatueshme gjatë lejes së lindjes.
GjED	C-203/03	Commission kundër Austrisë	01.02.2005	I-935	Neni 2 dhe 3 i Direktivës 76/207/së KEE-së	Neni 2(3) i Direktivës 76/207, ndërsa lejon disa diferenca në trajtim me idenë për të mbrojtur gratë në lidhje me shtatzëninë dhe lindjen, megjithatë <b>nuk lejon që gratë të përjashtohen nga një lloj i caktuar punësimi vetëm për shkak të faktit se ato duhet të gëzojnë mbrojtje më të madhe</b> se sa burrat ndaj rreziqeve, që prekin burrat dhe gratë në mënyrë të njëjtë, dhe të cilat janë të ndryshme nga nevojat konkrete të grave për mbrojtje, sikundër ato që përmenden shprehimisht. Si rrjedhojë, as ndalimi i përgjithshëm i punësimit të grave në industrinë minerare nëntokësore dhe në punë me atmosferë të presionit të lartë, ndonëse kualifikohen për një përjashtim të tillë, as ndalimi absolut i punësimit të grave në punë zhytëse, nuk përbën një diferencë në trajtimin e lejuar sipas asaj dispozite.

Gjykata	Numri i Çështjes	Emri	Data	Regjistri	Dispozita (t) përkatëse	Fjalë(t) kyç/përmbledhje
GjED	C-300/06	Voß	06.12.2007	I-10573	Neni 141 i Traktatit të KE-së	<b>Paga përfishin shtesa për punë jashtë orarit:</b> Një rregull që kërkon që punëmarrësit të punojnë më shumë se pesë orë jashtë orarit në muaj me qëllimin për t'u kualifikuar për pagë pune jashtë orarit është në dëm të punëmarrësve me orë të pjesshme dhe mund të bjerë ndesh me Nenin 141 të Traktatit të KE-së. Paditësja, në këtë rast, një mësuese nga Gjermania, ishte punësuar me një kontratë me orë të pjesshme për të punuar 23 orë në javë, ndërsa një mësues me orë të plota punonte 26.5 orë në javë. Në rast se totali i orëve për një javë të caktuar, duke përfshirë punën jashtë orarit, arrinte në 26.5 apo më pak orë, ajo nuk do të fitonte aq sa një punëmarrës me orë të plota në lidhje me të njëjtën sasi orësh pune. Ky ndryshim në pagë do të binte ndesh me Nenin 141, në rast se prekte shumë më tepër gra se sa burra dhe nuk mund të përtigjej.
GjED	C-506/06	Mayr	26.02.2008	I-1017	Neni 10(1) Direktiva 92/85/e KEE-së; Nenet 2(1) dhe 5(1) Direktiva 76/207/e KEE-së	Direktiva 92/85 për futjen e masave për nxitjen e përmirësimeve në sigurinë dhe shëndetin në punën e grave shtatzënë dhe të punëmarrësve, që kanë lindur fëmijë kohët e fundit, apo që kanë fëmijë në gj, dhe në veçanti, për ndalimin e pushimit nga puna të grave shtatzëna, të parashikuar në Nenin 10(1) të asaj direktive, duhet interpretuar se nuk mbulon edhe një punëmarrëse femër, e cila është duke bërë <b>trajtim</b> fekondimi in vitro, kur, në datën që asaj i është dhënë njoftimi i heqjes nga puna, vezët e saj janë fekonduar nga qelizat e spermës së partnerit të saj, kështu që vezët e fekunduara in vitro ekzistojnë, por nuk i janë transferuar ende në mitër. ..... Nenet 2(1) dhe 5(1) të Direktivës 76/207 përjashtojnë pushimin të një punëtore femër, e cila është në fazë të avancuar të trajtimit të fekondimit in vitro, që do të thotë, midis shpimit follicular dhe transferimit të menjëhershëm të vezëve të fekunduara in vitro në uterusin e saj, kur përcaktohet se pushimi i saj nga puna mbështetet kryesisht në faktin se gruaja i është nënshtruar një trajtimi të tillë.

GjEDNj	Seria A Nr. A6	Belgian Linguistic	23.07.1968		Neni 14 i KEDNj-së	<b>Karakteri shtesë i parimit të mosdiskriminimit tek Neni 14 i KEDNj-së,</b> interpretim fleksibël i nevojës për një lidhje me dispozitën substantive.
GjEDNj	Kërkesa nr. 6833/74	Marckx kundër Belgjikës	13.06.1979	Series A 031	Shkelja e Nenit 8 Shkelja e Nenit 14 jo 8 Jo shkelje e Nenit P1-1 Shkelja e Nenit 14 jo P1-1	Kërkesit ankohen për dispozitën e Kodit Civil Belg në lidhje me mënyrën e përcaktimit të lidhjes amëso-re për një fëmijë të “paligjshëm” dhe pasojat e përcaktimit të një lidhje të tillë, qoftë për shkallën e marrëdhënies familjare të fëmijës, qoftë për trashëgiminë e fëmijës dhe të nënës së tij. Kërkesit vuanë në diskutim edhe nevojën që nëna të adoptonte fëmijën, në rast se dëshironte që t’i shtonte të drejtat e tij. KEDNj-ja deklaroi se një ligj për paligjshmërinë, i cili lejon krijimin e një familje veçem përmes një akti formal, njohjes së saj nga nëna, dhe që e kufizon mundësinë e nënës për t’i dhënë apo lënë trashëgimi fëmijës, është diskriminuese dhe shkel të drejtën për të respektuar jetën e familjes dhe të drejtën për të gëzuar pronat në paqe.
KEDNj	Kërkesa nr. 8416/78	X. kundër Mbretërisë së Bashkuar	13.05.1980	D.R. 19, p. 244	Neni 2 dhe 8 KEDNj	Duke supozuar se <b>e drejta e jetës i është siguruar një fetusit qysh në fillim të shtatzënisë,</b> por, kjo e drejtë varet nga një kufizim i nënkuptuar, i cili lejon që të ndërpritet shtatzënia me qëllim mbrojtjen e jetës apo shëndetit të nënës. Meqenëse vazhdimi apo ndërprerja e shtatzënisë shtrun kryesisht çështjen që lidhet me të drejtën e një gruaje për të respektuar jetën e saj private, e drejta e një <b>babai</b> të ardhshëm për të respektuar jetën e tij familjare <b>nuk mbulon edhe të drejtën për t’u konsultuar,</b> apo për të marrë të drejtën, në lidhje me çështjen e ndërprerjes së barrës nga e shoqja.
GjEDNj	Kërkesa nr. 7525/76	Dudgeon kundër Mbretërisë së Bashkuar	22.10.1981	Series A 45	Neni 8 KEDNj	

Gjykata	Numri i Çështjes	Emri	Data	Regjistri	Dispozita (t) përkatëse	Fjalë(t) kyç/përmbledhje
KEDNj	Kërkesa nr. 10180/82	D. kundër Francës	06.12.1983	D.R. 35, p. 201	I papranueshëm; Neni 9 KEDNj	Në 1975, gjykata e rrethit i dha fund martesës së bashkëshortëve D, të dy anëtarë të devotshëm të besimit hebre. Kërkesi refuzoi t'i dorëzonte ish të shoqës Guett-in, që do të përcaktonte zyrtarisht <b>divorcin</b> fetar dhe që u duhej të dyve, edhe burrit edhe gruas, në rast se donin të rimartoheshin. Refuzimi i një çifuti praktikant të jepte guett-in (letra e refuzimit) ish gruas së tij, pas divorcit, nuk përbën një shfaqje të një <b>rregulli apo praktike fetare</b> .
GjEDNj	Kërkesa nr. 8777/79	Rasmussen kundër Danimarkës	28.11.1984	Seria A nr. 87	Mosshkelje e Neni 14 në lidhje me Nenin 6 apo 8 KEDNj	<b>Procedurat për të kontestuar atësinë e një fëmije</b> të lindur në martesë. Një akti i vitit 1960, që zbatohet në rastin konkret, përcaktonte afate kohore për burrin, por jo për nënën.
GjEDNj	Kërkesa nr. 9214/80, 9473/81, 9474/81	Abdulaziz, Cabales and Balkandali kundër Mbretërisë së Bashkuar	28.05.1985	Seria A No. 94	Shkelje e Neni 8 në lidhje me 14 të KEDNj	Sipas Rregullores së Emigracionit të 1980, është më e lehtë për burrat se sa për gratë e vendosura në Mbretërinë e Bashkuar, për të marrë leje, që bashkëshortet e tyre jo shtetase të hynin apo të qëndronin në vend. Rregulloja kishte qëllimin e ligjshëm të mbrojtjes së tregut të brendshëm të punës në kohën e papunësisë së madhe – gjithësesi, <b>meqenëse avancimi i barazisë së seksve është një qëllim madhor në Shtetet Anëtare të Këshillit të Europës</b> , diferencat në trajtim për shkaqe seks, mund të konsiderohen si të pajtueshme me Konventën vetëm në rast se avancohen <b>shkaqe me shumë peshë</b> . Në dritën e statistikave, Gjykata nuk u bind se diferencat që mund të ekzistojnë midis ndikimit përkatës të burrave dhe të grave në tregun e punës ishin aq të rëndësishme sa të përligjin dallimin në trajtim.

KEDNj	Kërkesa nr. 16278/90	Senay Karaduman kundër Turqisë	03.05.1993	D.R. n° 74, p. 93	I pa pranueshëm; Neni 9 KEDNj	Fakti që një universitet laik ka rregulla për veshjen e studentëve dhe se shërbimi i tij administrativ duhet t'u nënshtrohet atyre rregullave, nuk përbën një ndërhyrje në të drejtën e lirisë së fesë dhe besimit, në këtë rast, refuzimi i një universiteti turk për t'i dhënë vërtetim një studenteje femër që nuk e respektoi rregulloren.
GjEDNj	Kërkesa nr. 14518/89	Schuler-Zgraggen kundër Zvicërës	24.06.1993	Series A no 263	Shkelje e Nenit 14 në lidhje me Nenet 6-1 KEDNj	Kërkesja kish punuar për një firmë dhe kish paguar kontribute për sigurimin federal për invaliditet, u dha një gjysmë pensioni, meqenëse kish marrë tuberkuloz. Ajo u pushua për shkak të sëmundjes dhe më pas u dha një pension i plotë. Pas një ekzaminimi mjekësor të kërkuar, për të cilin një qendër mjekësore dhe dy mjekë shkruan një raport, Bordi i Sigurimeve të Invaliditetit ia hoqën pensionin kërkuar. Ai vendosi se rrethanat e saj familjare kishin ndryshuar shumë pas lindjes së fëmijës së saj, se shëndeti i saj ishte përmirësuar, dhe se ajo ishte 60-70% e aftë të kujdesej për shtëpinë dhe fëmijën e saj. Gjykata Federale e Sigurimeve kish miratuar në tërësi prezumimin e Bordit të Apelit se gratë hiqin dorë nga puna kur lindnin fëmijë. Ai nuk ish orvatur të kontrollonte vlefshmërinë e atij Prezumimi, duke peshuar argumentet për të kundërtën. Prezumimi ishte baza e vetme për arsyetim, duke qenë kështu vendimtar, për futjen e një diferencë në trajtim vetëm për shkaqe seksi, Avancimi i barazisë së seksive është sot një qëllim madhor i Shteteve Anëtare të Këshillit të Europës dhe, përpara se një diferencë e tillë në trajtim të konsiderohet e pajtueshme me Konventën, duhen paraqitur arsye me shumë peshë. Gjykata nuk dallooi ndonjë arsye të tillë në çështjen që kish përpara. Për mungesë të një justifikimi të arsyeshëm dhe objektiv, u konstatua një shkelje e Nenit 14, të marrë së bashku me Nenin 6-1.

Gjykata	Numri i Çështjes	Emri	Data	Regjistri	Dispozita (t) përkatëse	Fjalë(t) kyc/përmbledhje
GjEDNj	Kërkesa nr. 16213/90	Burghartz kundër Zvicërës	22.02.1994	Series A 280 B	Shkelje e Nenit 14 në lidhje me Nenin 8 KEDNj	<p><b>Enrat</b> e kërkuarve përpara martesës së tyre ishin Susanna Burghartz dhe Albert Schnyder. Ata u martuan në Republikën Federale të Gjermanisë në 1984. Në përputhje me ligjin e vendit, gruaja mori emrin 'Burghartz', i cili u zgjodh si mbiemri i tyre, ndërsa burri emrin 'Schnyder Burghartz'. Meqenëse zyra zvicerane e gjendjes civile regjistroi emrin 'Schnyder' si mbiemrin e tyre të përbashkët, çifti kërkoi që ta zëvendësojë atë me mbiemrin 'Burghartz', por ajo nuk pranoi që ta lejojte burrin të merrte emrin 'Schnyder Burghartz'. Z. Dhe Znj. Burghartz ishin ankuar se autoritetet nuk ia kishin bërë të ditur Z. Burghartz të drejtën për të vënë mbiemrin e tij përpara mbiemrit të familjes së tyre, edhe pse ligji zviceran e lejonte këtë mundësi për gratë e martuara që kishin zgjedhur të mbanin mbiemrin e burrit si mbiemrin e familjes. Gjykata theksoi se avancimi i barazisë së seksive ishte sot një qëllim madhor i Shteteve Anëtare të Këshillit të Europës. Kjo do të thoshte se duheshin paraqitur arsye me shumë peshë përpara se një diferencë në trajtim për shkakun e vetëm të seksit të mund të quhej i pajtueshëm me Konventën. Diferencës në trajtim i mungonte një justifikim objektiv dhe i arsyeshëm dhe si pasojë binte ndesh me Nenin 14 të marrë së bashku me Nenin 8.</p>

GjEDNj	Kërkesa nr. 13580/88	Karlheinz Schmidt kundër Gjermanisë	18.07.1994	Series A 291 B	Shkelje e Nenit 14 në lidhje me Nenin 4-3-d KEDNj	<p>Autoritetet bashkiake të Landit të Baden-Württemberg i kërkuan kërkuesit të <b>paguante një taks për shërbimin e zjarrit</b>. Gjykatat e ndryshme për të dy saktet në këtë fushë dhe se, edhe në Baden-Württemberg, gratë pranoheshin për shërbim vullnetar në brigadat e zjarrfikësve. Pavarësisht nëse sot mund të ekzistojnë apo jo ndonjë justifikim për t'i trajtuar burrat dhe gratë ndryshe, për sa i përket shërbimit të detyruar në brigadën e zjarrfikësve, ajo që ishte përfundimisht vendimtare në këtë çështje përpara gjykatës ishte se, detyrimi për të kryer një shërbim të tillë, ishte ekskluzivisht detyrim me ligj dhe në teori. Duke pasur parasysh ekzistencën e vazhdueshme të një numri të mjaftueshëm vullnetarësh, asnjë person mashkull nuk ishte në praktikë i detyruar të shërbente në brigadën e zjarrfikësve. Kontributi financiar e kish humbur, jo me ligj por faktikisht, karakterin e tij kompensues dhe ishte bërë e vetmja detyrë reale. <b>Në vendosjen e një barre financiare të tillë, një diferencë në trajtim për shkak seksi, nuk ishte e lehtë të justifikohet.</b> Si pasojë, ishte shkelur Neni 14 in lidhje me Nenin 4-3-d të KEDNj-së.</p>
GjEDNj	Kërkesa nr. 20060/92	Van Raalte kundër Holandës	21.02.1997	Reports 1997-I, no. 29	Shkelje e Nenit 14 në lidhje me P1-1 KEDNj	<p>Akti i Përgjithshëm i Përfutimeve të Fëmijës i <b>përjashton gratë e pamartuara dhe pa fëmijë, të moshës 45 vjeç e lart, nga detyrimi për të paguar kontribute</b>. Ndërsa Shteti gëzon një cak të caktuar vlerësimi për futjen e përjashtimeve në detyrimet për kontribute, Neni 14 kërkon në parim që këto të zbatohen në mënyrë të barabartë për burrat dhe gratë. Sikundër gratë me moshë 45 vjeçe e lart mund të lindin, mund të ketë burra të moshës 45 vjeç e më të rinj, që mund të mos jenë në gjendje të lindin. Një grua e pamartuar, pa fëmijë, e moshës 45 vjeçe ose më shumë, mund të ketë të drejtë të përfitojë sipas kësaj skeme. Argumenti se mbledhja e kontributeve nga gra të pamartuara, pa fëmijë, me moshë 45 ose më shumë, do të ishte baras me vendosjen e një barre të padrejtë emocionale, dhe shumë mirë mund të vlenë edhe për burrat e pamartuar pa fëmijë, apo për çiftet pa fëmijë. <b>Diferenca në trajtim nuk u përlligj.</b> Kishte një shkelje të Nenit 14 të marrë së bashku me Nenin 1 të Protokollit Nr. 1.</p>

Gjykata	Numri i Çështjes	Emri	Data	Regjistri	Dispozita (t) përkatëse	Fjalë(t) kyç/përmbledhje
GjEDNj	Kërkesa nr. 20458/92	Petrovic kundër Austriisë	27.03.1998	Report 1998-II, no. 67	Shkelje e Nenit 14 në lidhje me Nenin 8 KEDNj	Kjo çështje ka të bëjë me <b>refuzimin</b> nga ana e autoriteteve <b>për t'i dhënë pagë për leje prindërore një babai</b> , me arsyen se pagesa ishte e mundur vetëm për nënat. Pagesa e paguar nga Shteti, kish për qëllim të nxiste jetën familjare dhe sigurisht që ndikonte në mënyrën se si ish organizuar ajo. Refuzimi i autoriteteve austriake, për t'i dhënë kërkuar pagë për leje prindërore, si rrjedhojë, nuk e kish kaluar cakun e vlerësimit, që atyre u lejohej. Si pasojë, diferenca në trajtim, për të cilin ishte bërë ankesa, nuk ishte diskriminuese sipas kuptimit të Nenit 14.
GjEDNj	Kërkesa nr. 42393/98	Dahlab	15.02.2001		Shkelje e Nenit 14 në lidhje me Nenin 9 KEDNj	Kërkuësja, <b>një mësuese e shkollës fillore, nisi të mbante në kokë në klasë shaminë e fesë islame në 1990</b> . Në 1996, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Fillor e ndaloi kërkuësen të mbante shami në kokë gjatë kryerjes së detyrave të saj profesionale, për shkak se një praktikë e tillë binte ndesh me seksionin 6 të Aktit të Arsimit Publik. Gjykata vë në dukje në këtë rast se, masa me anë të së cilës kërkuësja u ndalua, thjesht në kuadër të detyrave të saj profesionale, të mbante një shami në kokë sipas fesë islame, nuk i drejtohej asaj si anëtare e seksit femër, por ndiqte një qëllim të ligjshëm, për të siguruar neutralitetin e sistemit shtetëror të arsimit fillor. Një masë e tillë mund të përdorej edhe për një burrë, që, në rrethana të ngjashme, vishte veshje të cilat e identifikonin atë qartë si anëtar i një besimi të ndryshëm.

GJEDNJ	Kërkesa nr. 34462/97	Wessels-Bergervoet kundër Holandës	04.06.2002	Report 2002-IV	Shkelje e Nenit 14 në lidhje me 14 P1-1 KEDNJ	<p>R.E.W. Wessels-Bergervoet, një shtetase holandeze, dhe i shoqi i saj kanë banuar gjithnjë në Holandë. <b>Të shoqit të saj iu dha pension vjetërsie si person i martuar, në bazë të Aktit të Pensionit të Vjetërsisë</b> (Algemene Ouderdomswet; “AOW”), duke filluar nga 1 gushti 1984. Megjithatë, pensioni i tij u reduktua me 38%, meqenëse ai nuk ishte siguruar, sipas Aktit, për një periudhe totale prej 19 vjetësh, kur ai kish punuar në Gjermani, por ishte siguruar sipas legjislacionit gjerman të sigurimeve shoqërore. Vendimi nuk u apelua. Kërkueses iu dha një pension vjetërsie sipas AOW, qysh nga 1 marsi 1989, <b>në të njëjtat kushte si pensioni i të shoqit, i reduktuar me 38%</b>. Ajo e apeloi këtë pa sukses. Ajo e ankimoi vendimin duke thënë se e vetmja arsye për uljen e pensionit ishte se, ajo ishte martuar me një burrë, i cili nuk ishte i siguruar sipas AOW-së, për shkak të punës jashtë shtetit dhe se, një burri të martuar, në të njëjtën situatë, nuk do t’ia kishin ulur pensionin për këtë arsye. Ajo pretendonte, sidomos, se ulja e pensionit të saj është rezultat i një trajtimi diskriminues. Gjykata shpalli unanimitisht se kishte pasur një shkelje të Nenit 14 (ndalimi i diskriminimit), i marrë së bashku me Nenin 1 të Protokollit Nr. 1 (mbrojtja e pronës).</p>
--------	-------------------------	---------------------------------------	------------	-------------------	--	---

Gjykata	Numri i Çështjes	Emri	Data	Regjistri	Dispozita (t) përkatëse	Fjalë(t) kyç/përmbledhje
GjEDNj	Kërkesa nr. 36042/97	Willis kundër Mbretëris së Bashkuar	11.06.2002	Report 2002-IV	Shkelje e Nenit 14 në lidhje me Nenin P1-1 KEDNj	<p>Kevin Willis është qytetar britanik, i lindur në 1956 në Bristol. Ai u martua në dhjetor 1984 dhe çifti ka dy fëmijë, Natasha Uma, lindur më 24 mars 1989, dhe Ross Amal, lindur më 2 gusht 1990. E shoqja e tij Marlene vdiq nga kanceri më 7 qershor 1996. Ai bëri kërkesë për përfitime të barabarta me ato që do të kish pasur të drejtë të përfitone një grua e ve, burri i të cilës kish vdekur në të njëjtat rrethana si ato të Znj. Willis, pra, <b>Pagën e një Vejshë dhe Pagesën e një Nënë të Ve</b>, të pagueshëm sipas Aktit të Sigurimeve Shoqërore dhe Aktit të Përfitimeve, të vitit 1992. Gjykata erdhi në përfundimin se, diferenca në trajtim midis burrave dhe grave në lidhje me të drejtën për të marrë <b>Pagesë si një Vejshë</b>, apo si <b>Nënë e Ve</b>, nuk mbështetej në ndonjë justifikim objektiv apo të arsyeshëm dhe se, si rrjedhojë, ishte shkelje e Nenit 14 të Konventës, të marrë së bashku me Nenin 1 të Protokollit Nr. 1. Në lidhje me faktin që kërkesi nuk kish të drejtë të merrte pensionin e grave të veja, Gjykata konstatoi se, edhe në rast se kërkesi do të kish qenë grua, ai nuk do të kualifikohet për pensionin e një vejshë, sipas kushteve të përcaktuara në Aktin e 1992. Në fakt, në vejshë në vendin e kërkesit, nuk do të kualifikohet për pension të paktën deri në 2006 dhe, ndoshta, nuk do të kualifikohet asnjëherë, për shkak të efektit të kushteve të tjera statutores, të cilat kërkonin, për shembull, që një pretenduese të mos rimartohej përpara datës në të cilën e drejta e saj ndryshe do të kristalizohet.</p>

GjEDNj	Kërkesa nr. 28957/95	Christine Goodwin kundër Mbretërisë së Bashkuar	11.07.2002		Shkeje e Nenit 8 KEDNj	<p>Kërkuesi është një qytetar britanik i lindur më 1937 dhe është një mashkull i kthyer pas operacionit në femër <b>transseksuale</b>. Agjencia DSS e Kontributeve e informoi kërkuesen se ajo nuk do të kish të drejtë të merrte pension shtetëror në moshën 60, masha kur gratë kanë të drejtë të dalin në pension në Britaninë e Madhe. Gjykata konstaton se, kërkuësja <b>nuk kish mundësi të dilte në pension në moshën 60 vjeçe, sikundër punonjëset e tjera femra</b>, masha e të drejtës për pension për gratë në Mbretërinë e Bashkuar. Meqenëse Gjykata konstaton se, kërkuësja nuk ish në gjendje të <b>dilte në pension në moshën 60 vjeçe, sikundër kishin të drejtë punëmarrëset e tjera femra</b>, dhe të merrte një pension shtetëror, apo të kërkonte një biletë autobusi për të udhëtuar pa para; meqenëse nuk ka faktorë të rëndësishëm me interes publik që të peshohen përkundërt interesit të këtij individi për përfutimin e njohtes ligjore të ripërcaktimit të tij gjinor, ajo nxjerr përfundimin se peshorja e barabartë, e cila është pjesë përbërëse e Konventës, tani anon dukshëm në favor të kërkuësës. Si rrjedhojë, ka pasur një mosrespektim të së drejtës së saj të jetës private, në shkelje të Nenit 8 të Konventës.</p>
GjEDNj	Kërkesa nr. 29865/96	Ünal Tekeli kundër Turqisë	16.11.2004	Report 2004-X	Shkeje e Nenit 14 në lidhje me Nenin 8 KEDNj	<p>Pas martesës së saj në 1990, kërkuësja, e cila në atë kohë ishte një avokate që po trajnohej, mori <b>mbiemrin e të shoqit</b>. Meqenëse, në jetën profesionale, ajo njihet me mbiemrin e saj vajzëror, ajo vazhdoi të përdorte atë emër përpara mbiemrit të saj të ligjshëm, që ishte ai i të shoqit. Megjithatë, ajo nuk mund t'i përdorte të dy emrat bashkë në dokumente zyrtare. Gjykata vendosi se detyrimi që u vihej grave të martuara, në interes të bashkimit të familjes, për të mbajtur mbiemrin e burrit – edhe kur ato mund të vinin emrin e tyre vajzëror përpara tij – nuk kish justifikim objektiv dhe të arsyeshëm. Si pasojë, Gjykata deklaroi se diferenca në trajtim në fjalë binte ndesh me Nenin 14, së bashku me Nenin 8.</p>

Gjykata	Numri i Çështjes	Emri	Data	Regjistri	Dispozita (t) përkatëse	Fjalë(t) kyç/përmbledhje
GjEDNj	Kërkesa nr. 58641/00	Hoogendijk kundër Holandës	06.01.2005		Mosshkelje e Nenit 14 në lidhje me P1-2 KEDNj	<p>Në 1960, pasi iu nënshtrua dy operacioneve në gju, kërkesja hoqi dorë nga puna me orë të plota. Më 5 gush 1976, duke pasur parasysh hyrjen e shpejtë në fuqi të Aktit të Përfitimeve nga Invaliditeti në Punë (Algemene Arbeidsongeschiktheidswet; ‘AAW’), kërkesja bëri kërkesë për përfitime për shkak të paaftësisë së saj për të punuar, si pasojë e problemeve mjekësore që kishte kaluar me gjuhët qysh nga 1960. Kërkesa e saj u hodh poshtë më 8 shtator 1977 nga shoqata kompetente profesionale (bedrijfsvereniging), e cila konstatoi se, paaftësia e saj për punë, nuk e kalonte pragun e 25%, pra, nivelin minimal të paaftësisë për të përfutur të ardhura nga AAW. Gjykata konstatoi se, <b>kërkesa për të ardhura – që vlen si për burrat edhe për gratë, pavarësisht nga statusi i tyre martesor</b> – u fut në skemën AAW me qëllimin për të hequr përjashtimin diskriminues të grave të martuara nga kjo skemë, duke kërkuar që të mbaheshin kostot e skemës AAW brenda kufijve të pranueshëm. Gjykata pranon se kjo përbën një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv.</p>

GJEDNj	Kërkesa nr. 44774/98	Leyla Sahin kundër Turqisë	10.11.2005	Mosshkelje e Neneve 8, 10 ose 14 KEDNj	<p>Kërkuësja është një qytetare turke, e cila ishte lindur më 1973. Ajo ka banuar në Vjenë qysh nga 1999, kur u largua nga Stambolli për të ndjekur studimet në Fakultetin e Mjekësisë në Universitetin e Vjenës. Ajo vjen nga një familje tradicionale myslimane aktive, dhe e konsideron si detyrë të saj fetare të mbajë shaminë e kokës së fesë myslimane. Në kohën materiale, ajo ishte një studente e vitit të pestë në Fakultetin e Mjekësisë, në Universitetin e Stambollit. Në 23 shkurt, 1998, ZV/Kancelari i Universitetit nxori një qarkorë, që i udhëzonte studentët me mjekra dhe <b>studentet me shami koke të fesë islame se nuk do të pranoheshin në leksione</b>, kurse dhe kolokiume. Në mars 1998, kërkuësja nuk u pranua të futej në një provim me shkrim në një nga lëndët që studionte, sepse në kokë mbante shaminë e fesë myslimane. Kërkuësja u ankua sipas Nenit 9, se e kishin ndaluar të mbante shaminë në kokë në universitet, se kjo ishte një ndërhyrje e pajustificuar në të drejtën e saj për arsimim, sipas kuptimit të Nenit 2 të Protokollit Nr. 1 dhe shkelje e Nenit 14, të marrë së bashku me Nenin 9, duke argumentuar se ndalimi për të mbajtur shaminë e kokës së fesë myslimane, i detyronte studentët të zgjidhnin midis arsimit dhe fesë dhe i diskriminonte besimtarët nga jo besimtarët. Së fundi, ajo u mbështet tek nenet 8 dhe 10. Gjykata vendosi se nuk kishte shkelje të Neneve 8, 10 apo 14.</p>
--------	-------------------------	-------------------------------	------------	---	---

Gjykata	Numri i Çështjes	Emri	Data	Regjistri	Dispozita (t) përkatëse	Fjalë(t) kyç/përmbledhje
GjEDNj	Kërkesa nr. 26111/02	Mizzi kundër Maltës	12.01.2006	Report 2006-I	Shkelje e Nenit 14 në lidhje me Nenin 6-1 dhe 8 KEDNj	<p>Kërkuesi Maurice Mizzi, është një shtetas maltez. Kërkuesi është një biznesmen i njohur në Maltë. Në 1966, e shoqja e tij X mbeti shtatzënë. Në mars 1967, kërkuesi dhe X u ndanë dhe pushuan së jetuari së bashku dhe, në 4 korrik 1967, X lindi një vajzë, Y. Kërkuesi automatikisht u konsiderua si i ati i Y-së sipas ligjit maltez dhe u regjistrua si i ati i saj natyror. Pas një testi të ADN-së që, sipas kërkuesit, përreaktoi se ai nuk ishte i ati i Y-së, kërkuesi u orvat pa sukses të niste procedura civile për të hequr dorë nga atësia e Y-së. Sipas Kodit Civil Maltez, një burrë ka të drejtë të kundërshtojë atësinë e një fëmije të lindur në një martesë, në rast se mund të provojë si tradhtinë e të shoqes, ashtu edhe faktin që lindja i është mbajtur e fshehtë. Kushi i fundit u hoq kur ligji u ndryshua në 1993 dhe u vendos një <b>afat prej gjashtë muajsh</b> që nga dita e lindjes së foshnjës, si pikë ndarëse para se të futeshin këto procedura. Gjykata vuri në dukje se duke bërë një padi për të kontestuar atësinë e tij, kërkuesi duhet t'i nënshtrohej afateve kohore, të cilat nuk zbatoheshin në rastin a “palëve të tjera të interesuara”. Gjykata konstatoi se <b>zbatimi i ngurtë i afatit kohor</b>, së bashku me refuzimin e Gjykatës Kushtetuese për të lejuar një përjashtim, i hoqi kërkuesit të drejtën të ushtronte të drejtat e tij të garantuara nga Nenet 6 dhe 8, të cilat i kanë gëzuar dhe vazhdojnë t'i gëzojnë, përkundrazi, palët e tjera të interesuara. Nga kjo doli se kishte pasur një shkelje të Nenit 14 i lexuar bashkë me Nenet 6 § 1 dhe 8.</p>

Të gjithë kërkesit ankohen për dallime në bazë seksi në lidhje me të drejtën e tyre për të marrë **pagesën e të ardhurave të ulura (REA)** dhe **pagesën e daljes në pension (RA)**, të cilat janë pagesa që lidhen me të ardhurat që u paguhën njëzëzë të punësuar apo ish të punësuar, që kanë pësuar një kufizim të aftësisë për të fituar të ardhura për shkak të një lëndimi apo sëmundje, që lidhet me punën. Përpara 1986, ekzistonte e drejta e vazhdueshme për të marrë REA pas daljes në pension, e cila ishte e pagueshme njëkohësisht me pensionin shtetëror. Nga 1986, një numër masash legjislativë u orvatën ta hiqnin apo pakësonin REA-n që merrnin pretenduesit, që nuk ishin më në moshë pune, duke vendosur një peticion ndarëse apo kushte kufizuese, moshën 65 vjeç për burrat dhe 60 për gratë (moshat e përdorura nga skema statutoe e pensionit të vjetërsisë). Të gjithë kërkesit merrnin REA. Kur Znj. Steck arriti moshën 60 vjeç, u vendos që, duke filluar nga 31 marsi 1996, REA e saj duhet të zëvendësohet nga RA-ja, një pagesë më e ulët. Ajo u ankuar se një burrë i të njëjtës moshë, do të kish vazhduar të merrte REA. Që nga 17 maji i 1993 dhe 29 shtatori 1994, përkatësisht, Z. Lunn dhe Z. Kimber morën pensionin statutor të vjetërsisë. Kështu që REA e tyre u zëvendësua nga RA-ja. Ata u ankuar se një grua në të njëjtat kushte do të ish trajtuar sikur kish dalë në pension në kohën që, apo përpara se, të futeshin në fuqi rregulla më shtrënguese në 1989, dhe kështu do të kishin pasur të drejtë të merrte një shkallë fikse të REA-s gjatë gjithë jetës. Që nga 23 dhjetori 1968, Znj. Spencer filloi të merrte pension vjetërsie. Si rrjedhojë, REA e saj u përcaktua në një shkallë fikse për gjithë jetën. Ajo u ankuar se, po të kish qenë burrë, do të kish vazhduar të merrte një REA të pa fiksuar. Në përfundim, Gjykata konstatoi se **dallimi në trajtim në moshën e pensionit shtetëror midis burrave dhe grave në Mbretërinë e Bashkuar fillimisht synonte të korrigjonte pozitën e disavantazhuar ekonomike të grave. Ai vazhdoi të ishte i justifikuar në mënyrë të arsyeshme dhe objektive për atë arsye deri në atë kohë kur, ndryshimet shoqërore dhe ekonomike e hoqën nevojën për një trajtim të posaçëm të grave.** Vendimet e Qeverisë së Britanisë së Madhe në lidhje me kohën e saktë dhe mjete të rregullimit të pabarazisë, nuk ishin shumë të paarsyeshme. Po ashtu, vendimi për të lidhur të drejtën për të marrë REA me sistemin e pensionit ishte i justifikuar në mënyrë të arsyeshme dhe objektive, duke pasur parasysh faktin se përfundimi synonte të kompensonte aftësinë e ulur për të njëjrtë të ardhura gjatë jetës së punës së një personi. Si pasojë, nuk kish pasur një shkelje të Nenit 14, të marrë së bashku me Nenin 1 të Protokollit Nr. 1

Jo- shkelje  
e Nenit 14  
në lidhje me  
P1-2 (Pronë)  
KEDNJ

Raporte  
2006-1

12.04.2006

Stec dhe të tjerë  
kundër Mbretërisë  
së Bashkuar

Kërkesa nr.  
65731/01

GjEDNJ

Gjykata	Numri i Çështjes	Emri	Data	Regjistri	Dispozita (t) përkatëse	Fjalë(t) kyç/përmbledhje
GjEDNj	Kërkesa nr. 17209/02	Zarb Adami kundër Malta	20.06.2006		Nenet 14, në lidhje me Nenin 4 § 3 dhe Nenin 6 (e drejta për një seancë të ndershme dëgjimore) KEDNj	Kërkuësja, Maurice Zarb Adami, është një shtetase malteze. Kërkuësja u ankua se kish qenë viktimë e diskriminimit për shkak të seksit, meqenëse <b>përqindja e grave që u kërkohet të bënin shërbim në juri në Maltë ishte e papërfillshme</b> , gjatë pesë vjetëve të mëparshme vetëm 3.05% gra kishin shërbyer si anëtare të juri, përkundrajt 96.95% burrave. Gjykata si pasojë konstatoi se kish pasur një shkelje të 14, të lexuar bashkë me Nenin 4 § 3 (d).
GjEDNj	Application no 23960/02	Zeman kundër Austrisë	29.06.2006		Shkelje e Nenet 14, P1-2 (Pronë) KEDNj	Gjykata ishte e mendimit se diferenca në trajtim midis burrave dhe grave në lidhje me të drejtën për të marrë <b>pensionin e të mbijetuarit</b> , të përfutur përpara 1955, nuk mbështetet në ndonjë “justifikim objektiv dhe të arsyeshëm”.

GjEDNj	Kërkesa nr. 42735/02; 37212/02; 8374/03	Barrow kundër Mbretërisë së Bashkuar; Walker kundër Mbretërisë së Bashkuar, Pearson kundër . Mbretërisë së Bashkuar	22.08.2006	Mosshkelje e Nenit 14 ECHR	<p>Barrow kundër Mbretërisë së Bashkuar; Pearson kundër Mbretërisë së Bashkuar; Walker kundër Mbretërisë së Bashkuar Joyce Barrow, është lindur në 1943 dhe banon në Wrexham. Sydney George Pearson është lindur në 1942 dhe banon në Birmingham. Timothy Walker është lindur në 1942 dhe banon në Hipston Stour in Warwickshire. Të gjithë janë shtetas britanikë. Zonj Barrow u ankua se <b>përfutimi i saj i invaliditetit iu ndërpre kur ajo mbushi moshën 60 vjeç</b>, ndërsa një burrë në të njëjtën pozitë do të kish marrë atë përfutim deri sa të arrinte moshën 65 vjeç. Ndërsa gratë mund të pretendonin të merrnin pension shteti në moshën 60 vjeç dhe ishin të përjashtuara nga kontributet e sigurimeve shoqërore shtetërore, në rast se vazhdonin të punonin, Z. Pearson u ankua se ai nuk mund ta merrte pensionin e shtetit para se të mbushte 65 vjeç, ndërsa Z. Walker u ankua se ai ishte i detyruar të paguante kontribute të sigurimit shoqëror shtetëror pasi të mbushte moshën 60 vjeç. Gjykata theksoi se diskriminimi i pretenduar rezultonte nga një dallim në moshën kur një burrë dhe një grua kishin të drejtë të merrnin pension shteti në Mbretërinë e Bashkuar. Në dritën e justifikimit fillestar për këtë diferencë (për të korrigjuar pabarazinë financiare midis seksve), natyra e ngadaltë e ndryshimit në jetën e punës së grave, dhe në mungesë të një standardi të përbashkët midis Shteteve Europiane, Gjykata konstatoi se Mbretëria e Bashkuar nuk mund të kritikohet se e kish nisur më herët rrugën drejt një moshe të vetme të daljes në pension, apo se i kish filluar reformat me ngadalë dhe me faza, sidomos duke pasur parasysh pasojat tejet afatgjata për gratë dhe për ekonominë, në përgjithësi. Si rrjedhojë, nuk kishte pasur një shkelje të Nenit 14, apo të Nenit 1 të Protokollit Nr. 1 në asnjërin nga të tre rastet.</p>
--------	--	---	------------	----------------------------------	--

Gjykata	Numri i Çështjes	Emri	Data	Regjistri	Dispozita (t) përkatëse	Fjalë(t) kyç/përmbledhje
GjEDNj	Kërkesa nr. 42949/98, 53134/99	Runkee and White kundër Mbretërisë së Bashkuar	10.05.2007		Moshkelje e Nenit 14 në lidhje me Nenin P1-1 KEDNj	<p>Kërkesit janë shtetas britanikë që jetojnë në Mbretërinë e Bashkuar. Z. Runkee u lind më 1938 dhe jeton në Hull. Ai mbeti i ve më 15 mars 1999. Duke u mbështetur tek Neni 14 (ndalimi i diskriminimit) në bashkërendim me Nenin 8 (e drejta për të respektuar jetën private dhe familjare) dhe Nenin 1 të Protokollit Nr. 1 (mbrojtja e pronës) kërkesit u ankuan se, si burra, ata nuk kishin të drejtë të merrnin përfitimet që marrin gratë e veja (<b>Pensioni i të Vesë dhe Paga e të Vesë</b>) të barabartë me pensionet dhe pagesat që u jepen grave me burra të vdekur në kushte të krahasueshme. Kjo ishte çështja e parë ku Gjykata vendosi nëse mospagimi i Pensionit të Vejshës një burri të ve ishte diskriminues. Pensioni i Vejshës, qysh nga fillimi i vendosjes së tij dhe deri në heqjen e tij më 9 prill 2001 (me përjashtim të grave burrat e të cilave kishin vdekur para asaj date) synonte të korrigjonte pabarazinë midis të vejava më të vjetra, si grup, dhe pjesës tjetër të popullsisë. Gjykata erdhi në përfundimin se diferenca ishte e përligjur në mënyrë të arsyeshme dhe objektive. Duke pasur parasysh natyrën, që evoluon me ngadalë, të ndryshimit në jetën e punës së grave dhe pamundësinë për të përcaktuar një datë në të cilën të vejat në moshë më të vjetër, si klasë, nuk kishin më nevojë për ndihmë, Gjykata nuk ishte e mendimit se Britania e Madhe duhej kritikuar as që nuk e kish hequr më përpara pensionin. Kështu që, Gjykata shprehu mendimin unanimit, se nuk kishte asnjë shkelje të Nenit 14, të marrë në bashkërendim me Nenin 1 të Protokollit Nr. 1, në lidhje me mospagjen të drejtë për të marrë pensionin e një Vejshë.</p>

GjEDNj	Kërkesa nr. 63479/00; 14549/02; 74961/01	Bond kundër Mbretërisë së Bashkuar; Cummins kundër Mbretërisë së Bashkuar; Nelson kundër Mbretërisë së Bashkuar;	01.04.2008	Shkelje e Nenet 14 në lidhje me P1-2 (Pronë) KEDNj	Bond kundër Mbretërisë së Bashkuar; Cummins kundër Mbretërisë së Bashkuar; Nelson kundër Mbretërisë së Bashkuar; Këto çështje kishin të bënin me ankimime të kërkuarve sipas Nenet 8 (E drejta për respektim të jetës private dhe familjare), Neni 14 (Ndalimi i diskriminimit) dhe Neni 1 i Protokollit Nr. 1 (mbrojtja e pronës) se, për shkak se ishin burra, atyre iu ishin mohuar të drejtat e grave të veja. Në të tri rastet e para, Gjykata konstatoi shkelje të Nenet 14 në lidhje me Nenin 1 të Protokollit Nr. 1, në lidhje me <b>Pagesën e Nënës së Ve apo Pagesën e të Vesë</b> dhe më tej tha se nuk ishte e nevojshme të shqyrtoheshin veçan ankesat e kërkuarve sipas Nenet 14, së bashku me Nenin 8.
GjEDNj	Kërkesa nr. 63679/00	Szulc kundër Mbretërisë së Bashkuar;	08.04.2008	Shkelje e Nenet 14 në lidhje me P1-2 (Pronë) KEDNj	Gjykata konstatoi shkelje në këtë rast në lidhje me ankimimin e kërkuar sipas të cilit, si burrë i ve, atij i ish refuzuar <b>Page e Nënës Vejushë dhe Pagea e Vejushës</b> .
GjEDNj	Kërkesa nr. 64729/01	Smith kundër Mbretërisë së Bashkuar;	20.05.2008	Shkelje e Nenet 14 në lidhje me P1-2 (Pronë) KEDNj	Gjykata konstatoi se në këtë rast kishite një shkelje në lidhje me ankesën e kërkuar, në veçanti, që si i ve, atij i ish refuzuar <b>Pagea e Vejushës</b> .

Gjykata	Numri i Çështjes	Emri	Data	Regjistri	Dispozita (t) përkatëse	Fjalë(t) kyç/përmbledhje
GjEDNj	Kërkesa nr. 25379/02	Twizell kundër Mbreterisë së Bashkuar;	20.05.2008		Shkelje e Nenit 14 në lidhje me P1-2 (Pronë) KEDNJ	Kërkuesi është një shtetas britanik i lindur nën 1941 dhe banues në Francë. E shoqja e Z. Twizell vdiq në mars të 2000. Çështja ka të bëjë me ankesën e kërkuetit se, si burrë i ve, atij i ishte refuzuar Pagesa e Vejshës. Ai u ankua gjithashtu se i ishte refuzuar Pagesa e Humbjes së Njeriut të Dashur, të cilën ai kish të drejtë ta merrte sipas Aktit të Reformës së Ndihmës ekonomike dhe pensioneve 1999, të miratuar për të zhdukur diskriminimin ndaj burrave të ve, kur bashkëshortja kish vdekur pas prillit 2001. Ai u mbështet, në veçanti, në Nenin 14 (ndalimi i diskriminimit) dhe Nenin 1 të Protokollit Nr. 1 (mbrojtje e pronës). Gjykata vuri në dukje se e shoqja e kërkuetit kish vdekur pak përpara se të hynte në fuqi Akti i 1999 dhe, si pasojë, nuk mund të kualifikohet për sistemin e porsa futur të <b>Pagesës dhe Përfutimit nga Humbja e Njeriut të Dashur</b> . Ajo vuri në dukje, megjithatë, se kjo situatë kishte qenë pasojë e paevitueshme e reformimit të politikës së strategjisë sociale nga ana e Britanisë së Madhe dhe se data e ndërprerjes ishte e justifikuar në mënyrë të arsyeshme dhe objektive. Prandaj Gjykata deklaroi se një pjesë e ankesës së kërkuetit ishte e papranueshme. Megjithatë, Gjykata deklaroi se, sikundër në një numër çështjesh që ngrenë probleme të njëjta, kishte pasur një shkelje të Nenit 14, së bashku me Nenin 1 të Protokollit Nr. 1, në lidhje me ankesën e kërkuetit për mosmarrjen e Pagesës së Vejshës.
GjEDNj	Kërkesa nr. 63480/00; 61395/00; 63477/00	Hubley; Wakeling dhe Wells kundër Mbreterisë së Bashkuar;	08.07.2008		Shkelje e Nenit 14 në lidhje me P1-2 (Pronë) KEDNJ	Hubley kundër Mbreterisë së Bashkuar; Wakeling kundër Mbreterisë së Bashkuar; Wells kundër Mbreterisë së Bashkuar. Gjykata konstatoi se në të tre këto çështje, që kanë të bëjnë me ankimmimet e kërkuetve, ishte shkelur Neni 14 (ndalimi i diskriminimit), së bashku me Nenin 1 të Protokollit Nr. 1 (mbrojtja e pronës), se, si të ve, atyre iu ishte mohuar <b>Përfutimi i një Vejshje për Humbje</b> .

GjEDNj	Kërkesa nr. 65507/01; 10721/02; 63647/00; 61391/00; 63701/00	Ginnifer, Harrison, Jackson; O'Brien dhe Thomas kundër Mbretërisë së Bashkuar	17.07.2008		Shkelje e Nënit 14 në lidhje me P1-2 (Pronë) KEDNj	Ginnifer kundër Mbretërisë së Bashkuar; Harrison kundër Mbretërisë së Bashkuar Jackson kundër Mbretërisë së Bashkuar; O'Brien kundër Mbretërisë së Bashkuar; Thomas kundër Mbretërisë së Bashkuar. Gjykata konstatoi shkelje në këto pesë çështje në lidhje me ankesën e kërkuarve se, si burra të ve, atyre iu ishin mohuar përfitimet e vejushave, konkretisht <b>Përfitimi i një Vejushë për Humbje</b> , në të pesë rastet, dhe <b>Pagesa e të Vesë</b> , në rastin e Thomas-it.
GjEDNj	Kërkesa nr. 28071/02	Shireby kundër Mbretërisë së Bashkuar;	09.12.2008		Shkelje e Nënit 14 në lidhje me P1-2 (Pronë) KEDNj	Gjykata konstatoi një shkelje në këtë rast, në lidhje me ankimmimin e një kërkuar që, si i ve, atij i ishte refuzuar <b>Paga e të Vesë</b> .
GjEDNj	Kërkesa nr. 28091/02	Thorne kundër Mbretërisë së Bashkuar;	13.01.2009		Shkelje e Nënit 14 në lidhje me P1-2 (Pronë) KEDNj	Në këtë rast, Gjykata konstatoi një shkelje në lidhje me ankimmimin e kërkuarit se, si i ve, atij i ishin refuzuar përfitimet e të vejave, konkretisht <b>Pagesa e të Vesë dhe Përfitimi i Nënës së Ve</b> .
GjEDNj	Kërkesa nr. 27961/02; 42711/02; 28045/02; 42709/02; 28095/02	Booth, Mitchard, Murray, Turner dhe Twomey kundër Mbretërisë së Bashkuar; Mbretërisë së Bashkuar;	03.02.2009		Shkelje e Nënit 14 në lidhje me P1-2 (Pronë) KEDNj	Booth kundër Mbretërisë së Bashkuar; Mitchard kundër Mbretërisë së Bashkuar; Murray kundër Mbretërisë së Bashkuar; Turner kundër Mbretërisë së Bashkuar; Twomey kundër Mbretërisë së Bashkuar. Gjykata konstatoi një shkelje në këto pesë çështje, në lidhje me ankimmimet e kërkuarve se, si burra të ve, atyre iu ishin refuzuar përfitimet e të vejave, konkretisht <b>Pagesa e të Vesë</b> , në rastin e Booth-it, dhe <b>Përfitimi si Nënë e Ve</b> në lidhje me katër çështjet e tjera.

Gjykata	Numri i Çështjes	Emri	Data	Regjistri	Dispozita (t) përkatëse	Fjalë(t) kyç/përmbledhje
GJEDNJ	Kërkesa nr. 44399/05	Weller kundër Hungarisë	31.03.2009		Shkelje e Nenit 8 në lidhje me Nenin 14 KEDNJ	Kërkuessit, një baba dhe dy djemtë e tij binjakë, janë shtetas hungarezë, të lindur më 1974 dhe 2005, përkatësisht, që jetojnë në Budapest. Duke u mbështetur në Nenin 14 (ndalimi i diskriminimit), i marrë së bashku me Nenin 8 (e drejta për respektimin e jetës private dhe jetës familjare), kërkuessit u ankuan se u ishte refuzuar e drejta të merrnin <b>përfitime lindje</b> në 2005, për faktin se nëna e fëmijëve nuk e gëzonte këtë të drejtë për shkak të shtetësisë së saj. Gjykata vendosi unanimisht se kishte një shkelje të Nenit 13, të marrë së bashku me Nenin 8 të Konventës në lidhje me të gjithë kërkuessit, sepse ajo konstatoi se aty nuk kish pasur justifikim për t'i hequr të drejtën një babai natyror, një shtetasi hungarez, dhe gjithë familjes së tij, për të marrë përfitimet që synonin të mbështesnin fëmijët e porsalindur, me shkakun se nëna e fëmijëve nuk kishte shtetësi hungareze.
GJEDNJ	Kërkesa nr. 2895/07	Blackgrove kundër Mbretërisë së Bashkuar	28.04.2009		Shkelje e Nenit 14 në lidhje me P1-2 (Pronë) KEDNJ	Gjykata konstatoi një shkelje në këtë rast në lidhje me ankimin e kërkuessit që, si i ve, atij i ishte mohuar <b>Përfitimi i Nënës së Ve</b> .

GjEDNj	Kërkesa nr. 3545/04	Brauer kundër Gjermanisë	28.05.2009	Shkelje e Nenit 8 në lidhje me Nenin 14 KEDNj	<p>Kërkesja është një shtetase gjermane, e lindur në 1948 në Oberschwöditz (ish Republika Demokratike Gjermane (GDR)). Tani ajo banon në Lennestadt (Gjermani (FRG)). E lindur jashtë martese, atë e njohu i ati menjëherë. Me vdekjen e të atit në 1998, ajo u orvat të siguronte të drejtat e trashëgimisë. Kërkesa e saj u hodh poshtë në gjykatën e shkallës së parë, me shkakun se sipas Aktit për Fëmijët e Lindur Jashtë Martese (Nichtehelichengesetz) të 1969, një fëmijë i lindur jashtë martese përpara 1 korrikut 1949 nuk ishte një trashëgimtar statutor. Gjykata nuk gjeti ndonjë arsye me të cilët të përligjej një diskriminim i tillë, i mbështetur në lindjen jashtë martese, veçanërisht meqenëse përjashtimi i kërkujes nga çdo e drejtë statutorë për të trashëguar, e penalizonte atë në një shkallë edhe më të madhe se kërkuet në çështje të tjera të ngjashme të sjella në gjykatë. Si rrjedhojë, kishte një shkelje të Nenit 14 të Konventës, të marrë së bashku me Nenin 8.</p>
GjEDNj	Kërkesa nr. 33401/02	Opuz kundër Turqisë	09.06.2009	Shkelje e Nenit 14 në lidhje me Nenin 2 dhe 3 KEDNj	<p>Gjykata erdhi në përfundim se autoritetet e vendit nuk kishin treguar vullnetin e duhur për të parandaluar dhunën ndaj kërkueses (vajza dhe nëna e saj viktimë e dhunës në familje, duke ikur nga shtëpia e përbashkët), dhe në veçanti, nuk ishin ndërmarrë masa penale apo masa të tjera parandaluese të duhura kundër të shoqit. Gjykata shqyrtoi se kërkesja kish qenë në gjendje të provonte se dhuna në familje i prekte kryesisht gratë dhe se pasiviteti i përgjithshëm dhe diskriminues në Turqi, krijonte një klimë që shpinte në dhunë në familje. Duke pasur kërë në mendje, dhuna e pësuar nga kërkesja dhe nëna e saj, mund të konsiderohen si dhunë me bazë gjininë, që përbënte një formë diskriminimi ndaj grave. Pavarësisht nga reformat e kryera nga qeveria në vitet e fundit, ngurrimi i përgjithshëm i sistemit gjyqësor dhe mosndëshkimi që gëzonin agresorët, siç shihet në rastin e kërkueses, tregon se ka pasur një angazhim të pamjaftueshëm për të marrë masat e duhura për trajtimin e dhunës në familje. Si rrjedhojë, Gjykata erdhi në përfundim se kish pasur një shkelje të Nenit 14, së bashku me Nenin 2 dhe 3.</p>

**SHTËPIA BOTUESE & SHTYPSHKRONJA**



Kruga e Elbasanit, Pallatet Filipeu Nr.2  
**Tel: 048 810 177/ 178 Cel: 069 20 26 773**  
Email: [pegi@icc-al.org](mailto:pegi@icc-al.org)  
[www.botimepegi.com](http://www.botimepegi.com)  
Tiranë, SHQIPËRI